

PËRGJIGJE
BIBLËS SË MOSKËS

Riçard Vurmbrand

Stephanus Edition

Answers to Moscow's Bible

Albanian Edition

Copyright 2015 Voice Media

info@VM1.global

Web home: www.VM1.global

All rights reserved. No part of the publication may be reproduced, distributed or transmitted in any form or by any means, including photocopying, recording, or other electronic, or mechanical methods, without the prior written permission of the publisher, except in the case of brief quotations embodied in critical reviews and certain other noncommercial uses permitted by copyright law. For permission requests, email the publisher, addressed "Attention: Permission Coordinator," at the address above.

This publication **may not be sold, and is for free distribution** only.

Libri i ateistëve

Kudo që njerëzit dinë të shkruajnë, e kanë librin e tyre të shenjtë.

Po ashtu edhe bota komuniste e ka biblën e vet, që quhet *Libri ateist*. Për herë të parë është botuar në vitin 1961 nga Akademia e Shkencave të Moskës (shtëpia botuese shtetërore për shkenca politike), si vepër e përbashkët e një numri të madh specialishtësh të njohur si: historianët Beliaievi e Belinova dhe filozofët Çanishevi, Elshina dhe Emilia. Përfundimisht e redakton profesori universitar S. Kovalev. Është rishtypur disa herë qysh prej botimit të parë.

Ky libër është një përmbledhje e kredos ateiste. Është përkthyer në shumë gjuhë dhe është shpërndarë me të madhe nëpër vende të tjera socialiste. Idetë që përmban ky libër i kanë përhapur duke filluar që nga shkollat fillore e deri në fakultete, nëpërmjet radios, televizionit, filmit dhe mitingjeve ateiste. Dhe kur vdes një ateist, në fjalimin e përmortshëm, në vijën e mësimit të biblës komuniste, i sigurojnë familjes së të ndjerit, se të vdekurit përfundojnë me kaq, se nuk ka ngushëllim për këtë ndarje, se kjo është ndarje e përrjetshme, se nuk ka as jetë të përrjetshme.

Qëllimi kryesor i librit është të tregojë se nuk ka Perëndi.

Mund t'i përgjigjemi thjesht me një pyetje: Nëse nuk ka Perëndi, si mund të ekzistojnë delet?

Kjo pyetje u shtrua në një mbledhje ateiste në Rusi. Ligjeruesi kishte shpjeguar se jeta është shfaqur spontanisht dhe është zhvilluar përmes seleksionimit natyror, dhe se në luftën e ashpër për ekzistencë kanë fituar vetëm kafshët që kanë qenë më të forta e më të shpejta se të tjerat, kurse ato më të dobëtat janë shfarosur.

Atëherë një besimtar pyeti: «Por, si është e mundur që delet shpëtuan pa u shfarosur prej ujçëve? Ujkonja lind nga pesë a gjashtë të vegjël në vit, kurse delja vetëm një. Përpjestimi është 5:1 për shkatërruesin, që ka dhëmbë të mprehtë, kthetra, fuqi dhe është i shpejtë në vrapim. Delja nuk ka kurrfarë mbrojtje. Si është e mundur, pra, që delet ekzistojnë ende? Sot i mbron njeriu, por kafshet kanë ekzistuar para njeriut. Kush i ka mbrojtur delet në atë kohë? Shumë gjëra mund të shpjegohen pa pasur nevojë për hipotezën se Perëndia ekziston. Por delet me katër këmbë nuk do të kishin ekzistuar pa të, e aq më pak delet e dashura të Jezusit, që kanë qenë të pambrojtur kundër persekutimeve mizore që nga fillimi i kishës së parë.»

Përgjigjja që mori besimtari ishte disa vjet burg në burgjet sovjetike.

Libri ateist, gjithashtu do të mund të merrte përgjigje shumë të thjeshtë edhe në temën mbi Jezusin.

Në një ndejë të intelektualëve sovjetikë diskutohej rreth Shekspirit. Njëri prej tyre citoi fjalët e zonjes Makbeth pas vrasjes së mbretit Dankan në gjumë. Duke i shikuar duart e njollosura me gjak, bërtiti: «Zhduku, njollë e mallkuar! Zhduku, po të them!»

Një i krishterë e pyeti: «Çfarë mundësish ka zonja Makbeth që të lirohet nga barra e mëkatit?» Një komunist u përgjigj: «Njeriu është qenie e arsyeshme. Edukata e shëndoshë dhe këshillat e mira qofshin edhe në çastin e fundit do ta kishin shmangur nga ajo vepër e tmerrshme.» Kjo përgjigje nuk ndihmonte ngase zonja Makbeth e kishte kryer vrasjen, e të filozofosh rreth edukatës që i është dashur tashmë është e kotë. Një komunist tjetër tha: «Unë mendoj se vrasesit duhet të dënohen me vdekje.» Edhe ky propozim është i kotë, sepse njeriu i dënuar me vdekje vdes me ndërgjegje të fajshme. Komunisti i tretë siguronte të pranishmit se në shoqërinë e lumtur socialiste në të ardhmen nuk do të ketë mbretër,

nuk do të ketë egoizëm, nuk do të ketë nevojë as dëshirë për vrasje. Por shoqëria komuniste nuk ekziston askund.

Atëherë besimtari tha: «Zgjidhja a Biblës mbetet e vetmja zgjidhje e vlefshme: Gjaku i Jezu Krishtit na pastron nga çdo mëkat.»

Por ne nuk mund të ndalemi me përgjigje aq të thjeshta. Anëtarët e Akademisë së Shkencave kanë shkruar mbi 600 faqe për të vërtetuar se feja në përgjithësi, e sidomos krishterimi, është gënjeshtër. Të përpiqemi t'i kuptojmë ata dhe t'i përgjigjemi pyetjeve të tyre. Sfida duhet pranuar për hir të mirësjelljes dhe dashurisë.

Bibla ateiste është e mërzitshme. Në të vërtetë, ajo nuk ka se si të jetë ndryshe. Askush nuk mund të jetë gojëmbël për ateizmin. Ateizmi është mohim. Kush mund të shkruaj me entuziazëm për një mohim? Kush është ai që ia kushton një sonet, vepër muzikore, apo skulpturë mohimit? Feja ka frymëzuar muzikën, artin, skulpturën, poezinë. Ateizmi nga vetë natyra e vet nuk mund të ketë këtë ndikim, ai nuk ka krahë.

Sipas doktrinës ateiste njeriu është hi e pluhur — vetëm materie. Çka e shtyn materien të shkatërrojë fenë? A mundet materia ta fitojë luftën për një ideal kur ideali, duke mos qenë materie, sipas definicionit nuk është asgjë?

Bibla e Moskës po ashtu përdor metoda mashtruese dhe fjalë të ashpra të cilat nuk i kanë hije një akademie të shkencave.

Do të përpiqemi t'i largohemi sa më tepër grindjeve të mërzitshme pseudoshkencore. Ironisë e shpifjes, ne do t'i përgjigjemi me dashuri të çiltër.

Jemi në gjendje të marrim këtë qëndrim sepse kudhra nuk frikohet nga të rrahurat e çekiçit. Në Paris gjendet një monument i viganëve që paraqet një kudhër me një numër çekiçësh të thyer, dhe një mbishkrim që thotë: «Hidhni çekiçët, banda armiqësore! Çekiçët tuaj thyhen; kudhra e Perëndisë mbetet.»

Ne mund të marrim qëndrim të tillë sepse ne i shoshitim mendimet tona dhe i konsiderojmë si epërsi kur na kritikojnë. Është në dëm të ateizmit që në vendet komuniste imponojnë diktaturë. Si mund ta di një njeri se e ka mirë kur ai nuk pranon kritikën?

Në të gjitha vendet krishtere të perëndimit, ateizmi mund të propagandohet lirisht. Krishterimi nuk ka kurrfarë arsye që t'i frikësohet. Në diskutime të lira vetëm krishterimi mund të fitojë. Përfytyroni dy dhoma të ndara nga njëra-tjetra me një perde të trashë. Në njerën mbretëron errësira, kurse tjetra është e ndriçuar me një qiri. Nëse hiqet perdja, nuk mbretëron më errësira. Errësira nuk mund të fitojë kundër dritës së qiriut, sepse ajo nuk është enegji. Është mungesë e dritës. Vetëm drita, duke qenë energji, mund të mbizotërojë. Në këtë mënyrë, dhoma që ishte në errësi ndriçohet me anë të qiriut.

Të krishterët nuk frikësohen nga burgjet komuniste as nga torturat. As literaturës ateiste nuk i frikësohemi. Në luftën e ideve, fitorja përfundimtare na përket vetëm neve.

Arsyeshmëria e ateizmit

Ateistët duhet ta dinë, para se gjithash, se ne të krishterët nuk jemi armiqtë e tyre por miqtë më të mirë. Ne i duam ateistët. — Dhe dashuria kupton.

Nuk befasohe mi se ka ateistë.

Në shekullin e njëzet, kur me miliona njerëz të pafajshëm janë djegur në furra ose helmuar me gazëra dhe mbytur nëpër kampe përqendrimi nga regjime të ndryshme politike, disa prej të cilëve e shpallën veten të krishterë, është vështirë të besohet në një Perëndi të plot-

fuqishëm dhe të mirë. Nëse është i plotfuqishëm pse nuk i ndal barbarët? Nëse është i mirë pse e krijoi një botë kaq mizore?

Nuk mund ta qortojmë dikë pse është ateist kur prelatët e kishës shpeshherë gjenden në anën e shtypësit dhe shfrytëzuesit, kur ia bëjnë qejfin tiranëve ose luftojnë bashkë me rebelet, në mesin e të cilëve gjenden ata që ëndërrojnë për t'u bërë tiranë në të ardhmen.

Kur Jezusi rrinte varur në kryq tha: «Hyji im, Hyji im! Përse hoqe dorë prej meje!» Është vështirë t'i bindësh njerëzit se i Kryqëzuari është shpresa e njerëzimit ose Ai që kërkoi ujë kur kishte etje e i dhanë uthull, ishte i gjithëfuqishëm në qiell e në tokë. Nevojitej një ringjallje që të mund të shpallej e vërteta.

Në ditët tona të ashtuquajturit bijtë e Perëndisë janë vrarë me njëri-tjetrin në dy luftërat botërore. Njeriu i pagëzuar në emër të Jezusit ka dhënë urdhër të hidhet bomba atomike.

Dhe atëherë, edhe nëse bijtë plëngprishës dëshirojnë të kthehen në shtëpinë e Atit, nuk do të mund ta gjejnë.

Në vend të saj ka shumë sekte të ndryshme ku secili pretendon se thotë të vërtetën. Ata janë të bashkuar vetëm në një çështje: të mos i duan të pafajshmit të cilët ende janë të burgosur ose kanë vdekur nëpër kampe përqendrimi.

Për më tepër, shumë njerëz besimin në Zot e lidhin me besëtytni, prapambetje ose dogma të çuditshme.

Ateizmi është pasojë e tyre si dhe i shumë shkaqeve të tjera. Ndryshe nuk mund të pritet. Prandaj, është logjike pse ka kaq shumë ateistë.

Perëndia ka lënë vend për ateizëm në botë. Bibla na tregon se Perëndia ka krijuar botën materiale me ligjet e saj të brendshme, me një zinxhir të pafund shkaqesh e pasojash. Ai vetë vendosi t'ju japë jetë edhe të tjerëve përveç vetvetes që kishte. Prandaj, mundësia për ateizëm ndodhej në planin e krijimit, dhe kur u vendos që Jezusi

t'i lajë mëkatët e njerëzimit me gjakun e vet, ai u pajtua t'i lajë edhe mëkatët e ateistëve.

Në qoftë se Perëndia e lejon ateizmin, atëherë kush jemi në ta ndalojmë atë?

Ne i kuptojmë ateistët plotësisht.

Por ateistët, nga ana tjetër, duhet të japin llogari për pikëpamjet dhe anomalitë e tyre: Shumë njerëz që vuajnë në mënyrë të tmerrshme në këtë botë të krijuar prej Perëndisë, e duan atë me gjithë zemrën e tyre. Tradita dhe zakonet mund të llogarisin shkuarjen në kishë dhe pjesëmarrjen në rituale fetare. Por si mund ta shpjegojnë ateistët dashurinë përvëluese për Perëndinë që vihet re nganjëherë tek njerëzit që vuajnë më së shumti? Si mund ta shpjegojnë thirrjen krishtere: «Gëzohu në Zotin», që e kanë përjetuar njerëzit e torturuar për shkak të besimit edhe pse kanë qenë të lidhur në pranga?

Feja po lulëzon në disa vende shumë të varfëra. Njerëz të uritur mblidhen të dielave bashkë me fëmijët e tyre, duke vdekur urie, dhe i këndojnë lavdi Zotit. Përse? Si është e mundur që vejushat që kanë vetëm «dy groshë» japin të hollat e tyre të fundit me qëllim që t'i shërbejnë Zotit në madhësi?

Pyetjet që na bëjnë ateistët janë të arsyeshme. Në qoftë se Zoti është i gjithëfuqishëm, pse lejon që të mbretërojë vdekja në tokë? Pse kam mbetur pa asnjë të dashur, — pyet një ateist? Pse më vuan fëmija, ose pse më vdiq një i afërt në moshë të re?

Por si e shpjegojnë ateistët faktin se të tjerët po ashtu të ballafaquar me vështirësi e vuajtje, i pranojnë të gjitha të qetë e të gëzuar? Për ata vdekja do të thotë shkuarje tek Ati.

Qysh nga koha e ndërtimit të piramidave, kur skllëvërit vdisnin nga goditjet e kamxhikëve, dhe mohimi i Perëndisë apo rebelimi kundër tij dukej normal, na ka mbetur kjo vjershë:

«Vdekja është në sytë e mi sot
Si shërimi i një të sëmuri,
Sikur kur lirohesh prej një dënimi.
Vdekja është në sytë e mi sot
Si një kundërmim i pranverës,
Si një pushim i lezetshëm në fllad.
Vdekja është në sytë e mi sot
Si aroma e luleve të zambakut,
Si një ëndërr e këndshme.
Vdekja është në sytë e mi sot
Si moti i mirë pas shiut,
Si kthimi i njeriut në shtëpi pas punës së rëndë.
Vdekja është në sytë e mi sot
Si qielli i pastër,
Si gjuetari se s'di se ç'gjuan.
Vdekja është në sytë e mi sot
Si malli i njeriut për ta parë shtëpinë e vet sërish,
Pasi të ketë kaluar shumë vite në robëri.»

Disa njerëz e pranonin vdekjen të qetë, disa të tjerë me gëzim duke menduar se vdekja do të thoshte kthim në botën e shpirtit.

Disa bimë janë heliotropike. Por ka edhe bimë asfo-delte, që rriten vetëm në hije e në terr, mu ashtu si ka njerëz që e duan Perëndinë në proporcion me vuajtjet e tyre për të. Këta janë mistikët, asketët dhe martirët. Ata me dashuri i përballojnë mundimet për të cilat ateistët ankohen. Vuajtja nuk i largon ata nga besimi; po përkundrazi, disa kthehen në besim ose forcohen nga vuajtjet e mëdha.

Oskar Uajldit nuk i ka interesuar Perëndia dhe ka bërë jetë të korruptuar. Kah fundi i jetës ky gjeni ishte burgosur nën akuzat më të poshtëra. Në rrethana të tilla ai shkroi: «Nëse bota është ndërtuar nga vuajtja, është ndërtuar nga duart e dashurisë, sepse në asnjë mënyrë tjetër

shpirti i njeriut për të cilin është krijuar bota. nuk do të kishte arritur përsosmërinë.»

Në veprën e Dostojevskit «Krimi dhe dënimi», Raskolnikovi zhvillon një bisedë me Sonjen, prostitutë. Ajo u bë e tillë pasi babai i saj ishte pijanec, ndërkaq vëllezërit e motrat i vuanin nga uria. Ajo hoqi shumë nën këtë gjendje të imponuar nga rrethanat e hidhura. Raskolnikovi i tha: «Ti i lutesh Perëndisë bukur shumë Sonja?» Ajo u përgjigj duke pëshpëritur: «Çka do të isha pa Perëndinë?» Ai, duke dashur të dijë më tepër, pyeti sërish: «Po çfarë përgjigje të jepë Perëndia?» Ajo i tha: «Mos më pyet! Ti nuk meriton ta dish... Ai më ndihmon shumë.»

Raskolnikovi po ashtu e kishte pyetur edhe motrën e saj më të vogël, Polenken: «A e di ti se si duhet të lutesh?» Ajo i përgjigjet: «Natyrisht, të gjithë e dimë që moti! Tani që jam rritur, lutem vetë, por Kola e Lida luten me zë të lartë bashkë me nëhën. Njëherë e thonë lutjen 'Shenjtja Mari' e pastaj thonë: 'Zot fale dhe bekoje motrën tonë Sonjen', pastaj: 'Zot fale dhe bekoje babain e dytë', sepse babai i parë na ka vdekur, e ky është i dyti, por ne lutemi edhe për tjetrin.»

Si është e mundur që Sonja e Polenka e duan Perëndinë? A mos është besimi i tyre vetëm lehtësim i vuajtjes sikur droga ose alkooli? Por droga dhe alkooli ia shkatërrojnë mendjen njeriut. Besimi në Perëndinë e bëri aq të fortë Sonjen sa që e solli te pendimi Raskolnikovin që ishte vrasës dhe të kthehet në një jetë të re. Pra, ekziston njëfarë realiteti në prapa besimit të saj.

Sonja i kishte dhënë një kryq Raskolnikovit dhe i kishte lexuar pjesë nga Ungjilli. Kjo bëri që një vrasës i pa zbuluar të dorëzohet në polici, të shkojë në Sibir e të fillojë një jetë të re. Ç'do të kishte ndodhur sikur ajo t'i kishte dhënë një drapër me çekan dhe t'ia kishte lexuar një fjalim të mërziqshëm të Stalinit apo «Kapitalin» e Marksit?

Sonja, e zënë në tragjedinë e prostitucionit, dhe Ras-kolnikovi, i zgjuar nga tragjedia e krimit, besonin.

Për shumë njerëz besimi në Perëndinë është vetëm një prej gëzimeve të shumta të jetës, diçka si arti ose luksi. Por ka njerëz për të cilët besimi do të thotë gjithçka, të cilët kanë etje për Perëndinë sikur dreri për ujërat e lumenjve. Të tillët pohojnë se e njohin Perëndinë. Ata thonë se ai është i dashur dhe besnik, bile edhe nëse rrugët e tij janë misterioze dhe nëse kanë jetë të vështirë.

Këta i kuptojnë dukuritë ateiste. Po ju, ateistë, a mund t'i kuptoni ata?

Në shtator të vitit 1932, një revistë e Moskës «Molodaia Guardia» (Garda e re) pat shkruar se në pajtim me planin pesë vjeçar ateist, deri në vitin 1937 çdo manifestim fetar duhet të asgjësohet përfundimisht dhe fjala e Perëndisë të mos ndihet më kurrë. Por kjo nuk ndodhi. Përkundrazi, krishterimi po përparon në shumë vende komuniste sado që po i kërcënohen me ndalesa e persekutime. Përse?

Ateizmi është i arsyeshëm vetëm atëherë kur e zbulon arsyen e besimit të thellë.

Paarsyeshmëria e ateizmit

Shoqëria po ndryshon shumë shpejt. Sistemet fetare nuk po ecin me të njëjtin hap me ndryshimet. Shpeshherë predikuesit komentojnë diskutimet që Jezusi i zhvilloi me njerëzit para dy mijë vjetësh lidhur me problemet e asaj kohe, në vend që të japin përgjigje në frymën e Krishtit, rreth problemeve të njeriut të sotëm. Për këtë arsye shumë njerëz vijnë në përfundim se fesë i ka kaluar koha.

Shumë rituale janë të vjetëruara.

Përveç kësaj, kishat thonë se dëshirojnë t'i shpëtojnë njerëzit nga ferri i së ardhmes. Atëherë, pra, duhet ta dëshmojnë atë me dashurinë e tyre ndaj njerëzve duke

ndihmuar që ta shpëtojnë botën nga ferri i tashëm i anal-fabetizimit, urisë, mjerimit, vuajtjes, tiranisë, shfrytëzimit, ndotjes së ambientit dhe luftërave.

Të krishterët i pranojnë të gjitha kritikak e ateistëve. «Dashuria beson gjithçka» (1 Korintasve 13:7). Ne mund t'i besojmë arsytet për të qenë ateist. Ne bashkohemi me Hegelin: «Çdo gjë që ekziston është e arsyeshme.» Bile edhe qëndrimi që mban një ateist mund të ketë arsye të forta. Por e meta e ateistëve është kur nuk e pranojnë kritikën e besimtarëve.

Mistikë të mëdhenj si Maister Ekart kanë thënë se njeriu i bashkuar me Perëndinë nuk ka më Perëndi për të adhuruar. Nga kjo pozitë ai i kupton ata që nuk e adhurrojnë Perëndinë sepse nuk e njohin atë. Mendimi i krishterë e pasqyron plotësisht realitetin, kurse mendimi ateist pjesërisht.

Ateistët kanë një filozofi materialiste të cilën të krishterët e ndajnë së bashku. Parimi kryesor i doktrinës sonë është se Perëndia është mishëruar (d.m.th. është bërë materie) në Jezu Krishtin. Perëndia i të krishterëve nuk është ide, por është *person*. Qëllimi i krishterimit nuk është vetëm shpëtimi i shpirtit, por edhe ngjallja e trupit në pashkatërrueshmëri.

Porse ne nuk ndalemi në materializëm. Ateistët materialistë janë të njëanshëm: Ata nuk dinë për natyrën hyjnore të Perëndisë dhe për Shpirtin e Amshueshëm Përvjetshëm të dashurisë e të vërtetës i cili e sundon botën.

A keni parë ndonjëherë monedhë vetëm me një faqe? Apo elektricitet vetëm me një pol? Krishterimi e pranon sferën shpirtërore sikur edhe materialen. Për shkak se është i njëanshëm, ateizmi është i gabuar.

Një budalla e kishin çuar për të blerë miell dhe kripë. Ai e mori një enë në të cilën do t'i bartte dy artikujt. I kishin thënë të mos i përziente ato por t'i mbante veç. Kur shitësi ia mbushi enën me miell, budallai, duke sjellë ndër mend udhëzimet që i kishin dhënë, e ktheu enën

përmbys, dhe kërkoi që kripa të vihet në fundin e kthyer sipër. Aty për aty e derdhi miellin, por e kishte kripën. Ia sollti pronarit, i cili e pyeti: «E ku është mielli?» Budallai e ktheu enën për ta gjetur, atëherë e derdhi edhe kripën.

Ateistët nganjëherë veprojnë si ky njeri. Ata bien kritika të mira dhe të dobishme kundër fesë. E kanë kripën. Por mos e humbin miellin aty për aty? Mos po i hedhin argumentet e fesë të cilat mund të jenë të mira? Dhe në fund do ta derdhin edhe kripën e ateizmit, në çastin e krizave të mëdha? Është krenari kur krishterimi i vërtetë e ka miellin dhe kripën. Filozofia e krishterimit është ashtu siç e quan Solovievi «Teomaterializëm», duke e kuptuar materien dhe Teosin (nga greqishtja, Perëndi), krijues të saj. Vërtet, krishterimi është aq i sigurt për të vërtetën me të cilën posedon saqë është i hapur për të gjitha kritikën e kësaj të vërtete, pra, e pranon kritikën e tillë si një mamuz që siguron ngasje më të mirë në kalë të së vërtetës.

Besimi jeton duke kundërshtuar vazhdimisht gabimet e duke pranuar frymëzimin nga vendet ku janë përjetuar të vërteta të reja.

Një herë u zunë dielli e hëna. Dielli tha: «Gjethet e pemëve janë të gjelbërta», kurse hëna tha se janë të argjendta. Hëna tha se njerëzit në tokë në përgjithësi flejnë, kurse dielli tha se ata zakonisht lëvizin.

Hëna pyeti: «Pse, pra, ka qetësi aq të madhe në tokë?» — «Kush ta ka thënë këtë?» — u përgjigj dielli. «Në tokë ka shumë zhurmë.» Grindja vazhdoi një kohë të gjatë.

Atëherë erdhi era, e dëgjoji bisedën e qeshi. «Po grindeni kot. Unë fryj ditën edhe natën. Ditën kur dielli shndrit, çdo gjë ndodh ashtu si tha ai. Ka zhurmë në tokë, njerëzit punojnë e gjethet janë të gjelbërta. Natën kur del hëna, çdo gjë është ndryshe. Njerëzit flejnë, qetësia mbretëron dhe gjethet marrin ngjyrë argjendi. Nganjëherë, kur retë e mbulojnë hënën, gjethet duken të zeza. As ti, diell, as ti, hënë, nuk e di krejt të vërtetën.»

Ateistët i shikojnë gjërat nga ana materiale dhe mendojnë se i tërë realiteti është ashtu. Budistët besojnë se mendja është realiteti i vetëm dhe se bota materiale i takon Majes, sferës së iluzionit. Por Bibla përdor të njëjtat fjalë «shpirt» dhe «frymë» në hebraishte dhe greqishte. Fryn përherë nga të gjitha anët. Ata që e kanë shpirtin e Perëndisë e shohin krejt të vërtetën. Ata nuk kufizohen as me filozofinë materialiste as me idealisten.

Në të vërtetë, Bibla na paralajmëron të jemi të kujdesshëm në çështjet filozofike, sepse shumica e filozofëve e shikojnë realitetin nga pikëpamja e tyre. Por çdo pikëpamje është pikë e errët që na bënë të paafte për pikëpamjet tjera. Nga një pikëpamje e veçantë dhoma në të cilën shkruaj nuk ka derë. Kthehem në anën tjetër. Tash e shoh derën, por nuk ka dritare. Shikoj lart. Nga kjo pikëpamje dhoma nuk ka dysheme. Shikoj poshtë; nuk ka tavan. Duke ju larguar pikëpamjeve të veçanta jemi në gjendje të kemi një koncept për tërësinë. Ideali i të krishterit është që të bëhet i shenjtë, që kjo fjalë në gjuhën angleze lidhet me fjalën «i tërë». Në rusisht fjala «i shenjtë» (sviatoi) d.m.th. i ndritshëm. Njësoj është e vërtetë me shprehjet e gjuhëve gjermane. Të jesh i shenjtë do të thotë të heqësh dorë nga pikëpamjet.

Fojobahu ka thënë: «Shihet qartë sikur dielli në pikë të ditës se nuk ka Perëndi; për më tepër, as që mund të ketë.» Nuk është feja ajo që po e pohon qartësinë absolute, por ateizmi. Nëse mosekzistenca e Perëndisë është «e qartë si dielli», si është e mundur që të gjithë njerëzit (pa përjashtim) e pranojnë ekzistencën e diellit, por të gjithë njerëzit nuk pajtohen me pohimin e Fojobahut se nuk ka Perëndi?

Bile as Darvini, njëri prej kundërshtarëve që e luftoj, nuk ë përkrah këtë. Ai shkruan: «Pamundësia për ta kuptuar se gjithë kjo gjithësi e mrekullueshme bashkë me vetëdijën tonë u krijuah rastësisht, më duket argumenti kryesor për ekzistencën e Perëndisë.»

Për ateistët, ateizmi është vetëqartësi. Atëherë çfarë nevojë ka të propagandohet ajo që është e qartë? Të krishterët nuk e konsiderojnë krishterimin vetëqartësi sikur fakti që dy edhe dy bëjnë katër. Po të kishte qenë ashtu, nuk do të kishte pasur ateistë. Disa qëndrime të kundërshtarëve na duken të arsyeshme. U gjejmë vend për arsyetim. Ateizmi pranon vetëm ateizmin dhe i mohon çdo të drejtë besimit për të ekzistuar. Prandaj nuk është i arsyeshëm.

Maks Stirner, teoricien i anarkizmit individualist, në mënyrë të drejtë i vërejti dobësitë e shoqërisë. Zgjidhja e tij ishte ta zhdukë shoqërinë njerëzore. Mirëpo edhe ai ishte pjesë e saj. Shopenhaueri i rekomandoi vetëvrasje njerëzimit si përgjigje të problemeve. Por kur ra kolera në qytetin e tij, ai iku. E donte jetën. Në të njëjtën kategori janë ata që dëshirojnë ta zhdukin besimin për shkak të të metave të mëdha në mendime dhe vepra.

A duhet të heqim dorë nga palltot për shkak se disa prej tyre kanë ngjyra të këqija? A duhet ta hedhim foshnjen e pastruar bashkë me ujën e papastër?

Ne e kemi pranuar atë që është e arsyeshme në ateizëm. Tash le të kërkojnë ateistët së bashku me ne se ç'është e arsyeshme në besim. Mbase do të gjejmë një emërues të përbashkët.

Perspektiva e gabuar e biblës së Moskës

Personalitetet u mblodhën në Moskë dhe shkruan librin për problemet më të mëdha të jetës, probleme me të cilët janë marrë gjenitë e botës qysh kur filloi të ekzistojë të menduarit: ekzistenca ose joekzistenca e Perëndisë, kuptimi i jetës, shpresa dhe vuajtja, roli i besimit, etj.

Kush janë këto personalitete? Është më e rëndësishme t'i njohësh ata vetë se sa përmbajtjen e librit të tyre.

Më e vlefshme është ta njohësh mësuesin se sa të njohësh mësimet e tij. Dija gjithmonë rrjedh nga «kush jam unë?» Nëse nuk e di përgjigjen e kësaj, si mund ta di atëherë se atë që mendon ky «unë» vlen për t'ua thënë të tjerëve. Nëse «uni» nuk është i madh, çdo gjë që jep do të jetë vogëlsirë.

Autorët e biblës së Moskës thonë se ata nuk i ka krijuar Perëndia. Nuk ka pasur plan në procesin e rastësishtëm të materies që i ka krijuar ata. A mundet lëvizja e atomeve dhe protoneve dhe bashkimi i tyre i rastësishëm të krijojë trurin që do të jepte të vërtetë të kulluar?

Kur kam qenë fëmijë kam dashur të merrem me muzikë, por prindërit e mi nuk kanë qenë të pasur. Kështu ganjëherë i shkruaja nota kuturu në një copë letër por ato kurrë nuk krijuan melodi.

Ta zëmë se në lojën e lotarisë ka dy mundësi të bie numri i kuq ose i zi, mundësia për një numër me të njëjtën ngjyrë që silllet dyzet herë me radhë ndoshta është një në njëqind milion! Kjo është kur ka vetëm dy mundësi!

Çfarë mundësish ka pasur që një kompjuter aq i përsosur si truri i njeriut të krijohet rastësisht nga bashkimi i elektroneve dhe protoneve? Unë, autori i këtij libri, flas shumë gjuhë dhe di diku rreth një milion fjalë, nëse i numëroj zgjedhimet e foljeve e lakimet e emrave. Sikur çdo njeri i kulturuar edhe unë kam njohuri nga matematika, gjeografia, fizika, arti, etj. Megjithëkëtë në çfarëdo çasti truri mund të gjejë pikërisht fjalën e nevojshme me intonacionin e duhur sipas situatës që kërkon. Gjasa që vetëm ky fenomen — mos të flasim për organizimin e tërë gjithësinë — të ketë mundur të krijohet nga bashkimi i rastësishëm i grimcave elementare, që lindin nga asgjëja, matematikish është e pamundur.

Nëse numëroj tri brezni në një shekull dhe filloj t'i llogaris të parët e mi — dy prindër, katër gjyshër, tetë stërgjyshër, e kështu me radhë — së shpejti arrij shifrën e

dhjetra miliona njerëzve prej të cilëve trashëgoj prejardhjen gjenetike. Unë jam rezultat i luftës për ekzistencë në të cilën kanë marrë pjesë miliona paraardhës të mi. Mos di diçka për ta? Asgjë. Mos di diçka për trashëgiminë që kam marrë prej tyre? Ata e kanë formuar gjuhën në të cilën mendoj, kanë krijuar institucionet në të cilat jam edukuar. Unë nuk i njoh ata. Nuk njoh as fëmijërinë time, e cila është periudha vendimtare në formimin e një predikuesi të ardhshëm ateist ose fetar.

Ne jetojmë në një botë shumë të vogël. Planeti ynë është një grimcë pluhuri në gjithësi. Ne e konsiderojmë arritje të suksesshme kur mbërrijmë në një satelit të vogël të kësaj grime të pluhurit kozmik. Në planetin tonë të vogël, biosfera është diçka e vogël; po ashtu është i vogël edhe njerëzimi që jeton në biosferë. Për sa më përket mua, unë jam një vogëlsirë në mesin e miliarda njerëzve të tjerë.

Zor se një nga 10.000 veta ka dëgjuar titujt e librave më të njohur. Zor se një në një milion njerëz i ka lexuar ato. Sa veta kanë dëgjuar për një peshkop të nderuar ose për një anëtar të Akademisë Sovjetike, bashkautorë të *Librit ateist*?

Një herë kam pasur një çrregullim në kujtesë. Nuk më kujtohej se kush e ka shkruar librin «Krimi dhe dënimi». Ishte vetëm personi i njëzet që pyeta që diti të më tregojë se e ka shkruar Dostojevski.

Ne jemi të vegjël pamasë, dhe e dimë po aq pak për universin, që është më mirë ta quajmë plurivers, sa thnegla që di për marksizmin pasi të ketë shëtitur mbi një libër të Marksit.

Mua më pëlqen cicërima e zogjve, duke mos ditur se cilin prej tyre do ta zëjë shqiponja sot. E dëgjoj shushurimën e erës nëpër gjethe të drunjve, por nuk e di se cilin dru po bren krimbi. Ne lakmojmë për famë, pushtet, pasuri, kënaqësi, dituri. Edhe ata njerëz që para disa dekadash kanë pasur të njëjtat lakmi sikur ne tash janë

bërë pluhur. Dheu që të mbetet në shuajt e këpucëve, ndoshta, një herë ka qenë fytyra e një bukurosheje.

Bukharini ka qenë njëri nga teoricientët më të mëdhenj të ateizmit komunist. Në librin e tij «Materializmi dialektik», ai filloi të mburrej me këtë filozofi duke thënë se kjo lejon mundësinë për parashikimin e të ardhmes. Vetëm një gjë i mjeri nuk e kishte paraparë se shokët e tij do ta torturonin e ta vritnin.

Është guxim të shkruash libër e të bëhesh mësues i njerëzimit, por a e di se çfarë gëzimi apo tragjedie mund të përjetojë lexuesi i ardhshëm, a do të jetë i dobishëm libri në çaste të vështira?

Madje a e njuh njeriu vetëm një prej miliarda qelizave që e përbëjnë trurin e tij. Një çrregullim i vogël në to mund të shkaktojë që njeriu të shkruaj marrëzi të mëdha. Kjo u ka ndodhur gjenive. A mund të të ndodhë edhe ty? Ti e kupton marrëzinë në shkrimet e tjerëve. A mendon se në ty nuk mund të ketë marrëzi? Njeriu s'di asgjë për trupin e vet. Çka di ti për aftësitë tua psikologjike? Për çdo ditë befasohem me vetveten.

Në bëjmë një jetë misterioze në një botë misterioze, të cilën e njohim vetëm sipërfaqësisht. Jemi të mbyllur në burgun e shqisave tona.

Po të ekzistonin në tokë të qenie të cilat do të mund të emetonin rreze jashtë spektrit të pamjes sonë, po të mund të komunikonin me njëra-tjetrën në largësi valësh përtej këtyre që ne i dëgjojmë dhe i kapim, atëherë ato do të na kishin vështuar e ne nuk do të kishim ditur gjë për ekzistencën e tyre, pikërisht siç kemi jetuar me mijëra vjet pa ditur për ndikimin e viruseve dhe mikrobeve në jetën tonë. Çka nëse ekzistojnë engjëjt e ne nuk jemi në gjendje t'i perceptojmë ata?

Ateistët pohojnë se nuk ka Perëndi. Si mund të jenë të sigurt?

Ky libër është përpiluar në një burg. Roja rregullisht na i kontrollonte qelitë për gjëra të ndaluara si p.sh. për

figura të shahut, thika, gjilpëra, libra, gazeta. Nuk na i gjenin. Ne pritnim derisa të shkonin ata. Pastaj i nxirrnim nga vendi i fshehtë. Mund ta kontrollosh qelinë për një send e mos ta gjejsh atë. Por a ke të drejtë të pohosh se nuk është aty? Kush e ka kontrolluar gjithësinë e pakufi për të vërtetuar se nuk ka Perëndi?

Prandaj, a mund të jetë i sigurt autori ateist për gjërat që pohon?

Deri me dje është konsideruar si e sigurt se elementet e thjeshta janë të pandryshueshme. Ky pohim ka qenë i bazuar në përvojën mijëvjeçare, por megjithatë ka qenë i gabuar. Intelektualë të mëdhenj kanë qenë të sigurt se atomi ishte i pandashëm dhe se njeriu nuk mund të shkonte në hënë. Ata, që kishin përvojën e madhe të njerëzimit në anën e tyre, gabuan. Çfarë mundësish keni që të mos gaboni, miq ateistë?

Mësuesi krishter Tertuliani është nënçmuar për fjalët e tij: «Credo quia impossibile» (besoj sepse është e pamundur). Kurse tash shkenca e bën realitet atë që dukej absurde dhe e pamundur të arsyetohej.

Ne jemi të vegjël dhe të papërfillshëm. Ne nuk dimë. «Nëse ndokush mendon se di diçka, nuk di ende ashtu si duhet të dijë», thotë Bibla (1 Korintasve 8:2).

Kush janë kundërshtarët tanë?

Në qoftë se një polic civil ma kërkon letërnjoftimin, reagimi im i parë është ta pyes kush është ai. Ai duhet të dëshmojë se është nga policia. Përndryshe nuk ka të drejtë të më marrë në pyetje.

Në qoftë se ballafaqohem me realitetin e pakuptueshëm të gjithësisë dhe e pyes sfinksin: «Kush je ti? A ke natyrë hyjnore ne vete? A je krijuar nga ndonjë artist apo

ekziston që nga amshueshmëria?» Ndoshta do të kisha marrë këtë përgjigje: «Më trego së pari kush je ti, njeri i vogël? A je aq i vlefshëm sa që ty të zbulohet misteret më të mëdha? Dhe nëse të zbulohet, a ke aftësi ta kuptosh dhe ta pranosh të vërtetën në tërë dëlirësinë e saj, madje edhe në qoftë në kundërshtim me interesat tuaja dhe me çdo gjë që ke besuar e dashur deri me tani?»

Autorët e *Librit ateist* e mohojnë ekzistencën e Perëndisë. Por a ekzistojnë ata vetë? Kush janë ata? A mund ta vërtetojnë ekzistencën e tyre?

Kur një autor ateist dëshiron të parashtrojë pyetje të guximshme, ai duhet të ketë parasysh miliarda vite para lindjes së tij, ekzistencën e galaktikës dhe pluhurin kozmik. Është dashur të ekzistojnë yjt, mekanizmi qiellor dhe dielli në mënyrë që t'i rregullojnë lëvizjet e tokës, pa të cilën jeta do të kishte qenë e pamundshme. Ateistët mund të shtrojnë pyetje të guximshme pikërisht për atë se ekziston uji, bimët, kafshët, mikroorganizma dhe realitete të tilla si elektriciteti, nxehtësia, tharmi i bukës, fermenti i verës, rrezet kozmike, të reshurat dhe realiteti i mahnitshëm i personalitetit njerëzor. Është dashur të ekzistojë një varg i tërë i stërgjyshëve dhe gjithashtu është dashur të ketë pasur qumësht në gjirin e nënës dhe dashuri në zemrën e saj.

Edhe sikur t'i pranojmë supozimet e ateistëve, një realitet i pakuptueshëm ka krijuar, përmes bashkëveprimit të kohës dhe rastësisë gjatë një periudhe të pafund të miliarda vjetëve, ligjerues ateistë dhe shenjtër të krishterë. Përse? Kush janë ata? Pse janë ata? A janë ata me të vërtetë?

Për këtë mund të dimë aq sa dimë pse toka bashkë me sistemin diellor sillen pandërprerë sikur të kishin ndonjë qëllim të caktuar. Ato tërheqin njëra tjetrën. Por ç'është kjo tërheqje e gjithësisë? Tërheqja është fjalë të cilën e përdorim nganjëherë në dashuri. Kush dashuron? Kush është i dashuri?

Ateistët predikojnë sikur priftërinjtë. A mund t'i harrojmë predikimet e tyre të ngatërruara e të dëgjojmë shushurimën e gjetheve kur dridhen nga era, gurgullimën e ujit të përrenjve, zërin e zogjve, zërin e fëmijve? Këto na mësojnë më tepër se shumë fjalime të tjera.

Besojnë ata që jetojnë në harmoni me natyrën. Ateizmi ka filluar si një dukuri qytetëruese në mendjen e gjymtë të atyre që jetonin të rrethuar me mure shoqërore dhe strukturore.

Po çka mendoni nëse dëgjojmë qetësinë e madhe? Prej nga vjen bukuria e flokëve të borës, luleve, fierit, likeneve, që secila prej tyre ka bukuritë e saja të pashoqe? Prej nga vjen rregullimi i mrekullueshëm i pjesëve elementare në atom?

Si është e mundur që elektroni rrotullohet në orbitën e vet me qindra miliona herë në të qindmijtën pjesë të sekondit kështu që ajo është në lëvizje të përhershme të formojë sende të qëndrueshme për përdorim?

A keni dëgjuar për një makinë me tetëdhjetë bilion qeliza elektrike? Një pjesë e kësaj makine nuk peshon më shumë se 1,5 kilogram dhe është një mekanizëm i përbërë prej dhjetë miliardë qelizash, të cilat prodhojnë, pranojnë, regjistrojnë dhe transmetojnë energji. Kjo makinë e mrekullueshëm është trupi juaj. Do të ishte mirënjohes nëse dikush të dhuron një veturë. Por të është dhuruar një makinë shumë më e mirë. Prej kujt?

Si është e mundur që ndryshimet kimike në neuronet e trurit kthehen në një mendim tjetër me ndryshimin e ndjenjave? Si është e mundur që njeriu duke nxjerrur helmin e dioksid karbonit e shndërron atë në fjalë dashurie, madje edhe në fjalë e cila e mbart mesazhin e jetës së përjetshme?

Si është e mundur që kur doni të bëni një vepër të keqe, ndieni sikur një dorë e padukshme do t'ju ndalojë nga kjo vepër? Dora e kujt është kjo? Madje edhe nëse zëri i ndërëgjegjes nuk është mjaft i fuqishëm që t'ju

ndalojë nga qëllimi i lig, më vonë e ndieni në formë të keqardhjes dhe pendimit.

Kush je ti për të pyetur për identitetin e realitetit? E çka nëse realiteti përgjigjet: «Mbasi sipas arrogancës sate e mban veten si njeri autoritar, atëherë të lutem trego para se gjithash kush je ti.» A mund t'i përgjigjesh me të vërtetë një prej mijëra pyetjeve që t'i parashtron realiteti? Zhvillimi i shkencës nuk e ka rritur aq fort njohjen e fakteve siç e ka rritur numrin e pyetjeve, të cilave duhet t'ua gjejmë përgjigjet.

Ju e pyetni realitetin për misteret e tij të fundit, për kuptimin e tij, për qëllimin e tij, për ekzistencën e Krijuesit. Kujt duhet t'i përgjigjet realiteti, dhe në çfarë gjuhe duhet të përgjigjet? Fiset primitive, të cilat i kanë vizituar misionarët e parë, u mungonin fjalët për konceptet e tilla si: «dashuri», «besim», «falje», «shpirt», «i shenjtë», «tren». Misionarët ishin të kufizuar në aftësitë e tyre për t'ua kumtuar mesazhin ose të vërtetat nga vendi i tyre. A keni ju gjuhë të përbashkët me realitetin?

Prapë po pyes: kujt duhet t'i flasë realiteti? Ju pranoni vetëm arsyen. Por sipas doktrinës suaj materialiste, truri i njeriut funksionin nëpërmjet arsyes. Truri i elefantit është i formuar ndryshe. Puna e tij quhet instinkt. Ndërsa tuajit i keni vënë emër më të mirë. Megjithatë, ju pohoni se të dy trutë janë rastësi e evolucionit, dhe se grumbullimi i atomeve gjatë shekujve të tërë është i rastësishëm, pa ndikimin e ndonjë krijuesi.

Ju e konsideroni ateizmin si të vërtetë. Por para se ta zbatoni nocionin «e vërteta» në ateizëm, duhet të përcaktoni se çka doni të thoni me fjalën «e vërtetë».

Pilati pat pyetur: «Ç'është e vërteta?» Kush nuk e di përgjigjen e kësaj pyetje s'ka baza mbi të cilat mund të pohojë se diçka është e vërtetë.

Skeptikët kanë thënë: «E vërteta është dyshim që zgjatet» ose «halucinacion i pranuar nga shumica». Por ajo që përqeshet si halucinacion mund të jetë gabim i

treguar në drejtim të saktë. Alkimia dhe astrologjia kanë qenë gabime të tilla të dobishme, pararendësit e kimisë dhe astronomisë.

Si e përcaktoni ju të vërtetën?

Një marksist do të thoshte se e vërteta varet nga klasa shoqërore. Kushtet ekonomike në të cilat jeton njeriu, përcaktojnë bindjet e tij.

Në një letër drejtuar Klusit, më 7.12.1852, Marksi i përshkruan kushtet e veta ekonomike. Ai thotë se është mirë si i burgosuri sepse nuk ka pantollona as këpucë dhe se familja e tij rrezikohet duke u zhytur në varfëri të thellë. Na vjen keq për këtë. Por atëherë marksizmi është mentaliteti i njerëzve pa pantollona e pa këpucë. Sot, të gjithë proletarët, në përfundim, kanë pantollona e këpucë, më shumë se një palë. Kësisoj marksizmi nuk na përshtatet ne. Ne duhet të kemi të vërtetën tonë.

Marksizmi e shpall veten si të vërtetë e nuk ka definicion të vlefshëm për këtë fjalë.

Është interesant se marksizmi, gjoja e pranon doktrinën e proletariatit ndërkaq, i përjashton mendimtarët proletarë nga e vërteta. Marksi në letrën që ia dërgon Sorgreit më 19.10.1877, shkruan: «punëtorët vetë kur... e lënë punën dhe bëhen njerëz të ngritur profesionistë, gjithnjë ngriten 'teorikisht' bëhen të padëgjueshëm dhe gjithmonë janë të gatshëm t'iu bashkohen ngatërrestarëve...» Gjithashtu as lëvizja radikale studenteske nuk mund ta ketë të vërtetën. Marksi shkruan për «gomarllëqe të mërzitshme të studentëve rusë që nuk kanë kurrfarë vlere». Si duket për marksistët ka vetëm një definicion për të vërtetën: «E vërteta është ajo çka mendoni kur mbeten pa pantollona e pa këpucë.» Për disa arsye të fshehta pantollonat duket se janë pengesë për ta zotëruar të vërtetën. T'i lëmë të gjitha këto.

T'i japim kundërshtarëve tanë këtë definicion: E vërteta është pajtueshmëria e objektit të të menduarit (realitetit) me rezultatet e saja, mendësia jonë. Megjithatë

të, pajtueshmëria e tillë nuk vërteton se e keni kuptuar realitetin në mënyrë të drejtë. Përndryshe, si mund ta shpjegoni ekzistencën e gabimeve? Ju thuani se feja është gabim. Por feja është ajo që pajton realitetin me mendësinë e njeriut e njeriut. Njeriu mund të jetë plotësisht i sigurt për drejtësinë e mënyrës së të menduarit të vet e prapëseprapë të jetë gabim. Çka nëse je viktimë e një mashtrimi të tillë?

Ta zëmë se një i krishterë bëhet ateist. Atëherë ai do ta pranonte mendimin e mëparshëm si të gabuar. Me mendjen e tij të hapur ndaj gabimit, ai do ta pranonte ideologjinë tuaj. Si do ta kishte ditur se me siguri s'ka rënë në një besim tjetër të gabuar? Mund të ndihet i sigurt se mendimet e tij tani përkasin me realitetin. Por kështu mednonte edhe kur ishte ende besimtar. A nuk po shihni se ka një dritë përtej realitetit dhe pseudorealitetit, përtej asaj çka ne e quajmë të vërtetë e çka gabim, që të na tregojë me autoritet se ku qëndron dallimi? Madje edhe bindjet ateiste mund të jenë të pajtueshme (rrallë ka pajtueshmëri ne mendimin e njeriut) vetëm duke e njohur Dritën supreme të cilën ne e adhurojmë në besim.

A duhet i Tejetlarti të flasë me ju në gjuhën e arsyes? Po sa mund të kuptojë arsyeja? Arsyeja e arsyeton skllavërinë, monarkinë absolute, besëtytninë. Arsyeja na ka bërë diktatorë të lumtur dhe i arsyeton luftërat botërore, në të cilat janë bërë masakra në njerëz të pafajshëm. Mefistofeli thotë: «Ai e quan të arsyeshme dhe e shfrytëzon atë që të bëhet më shtazarak se cilado shtazë.» Njeriu duhet gjithmonë t'i mendojë, kuptojë e arsyejojë të gjitha gjërat.

Gëte para dy shekujsh tha se «planeti ynë është institucion mendor i gjithësisë». Kemi arsyen e një race që i ka shkëndijat e gjenive dhe të vërtetën por në mënyrë të qartë na tregon se është çmendur. Bile edhe tek njerëzit më të mençur, arsyeja është vetëm një harmoni mes impulseve të paarsyeshme.

Me qëllim që arsyeja të japë rezultate të mira duhet të jetë e panjolllosur nga ndjenjat e ulëta.

A ndodh kjo me kundërshtarët e mi?

A nuk luan kurrfarë roli frika në mendimet e tyre? Në vendet jokomuniste ateistët shpeshherë i kthehën besimit. Ta zëmë se një anëtar i Akademisë së Shkencave të Moskës, pasi t'i shqyrtojë të gjitha argumentet në favor dhe kundër, vjen në përfundim se krishterimi ka të drejtë — ashtu siç erdhi në përfundim Svetlana Stalina, Paster-naku, Siniavski, Solzhenitsini; bindjet e njeriut mund të ndryshojnë në drejtime të ndryshme — atëherë çfarë do të ishte përfundimi? Menjëherë do ta humbiste anëtarësinë e akademisë, pozitën prej profesorit, mundësinë për të botuar ndonjë vepër. Po ashtu do ta humbiste edhe standardin e lartë të jetesës. Gjeneralmajori Grigorenko, anëtar i Akademisë së Moskës, në disa çështje politike dhe ushtarake shprehu mendim të ndryshëm nga ata të qeverisë. Për këtë «devijim» ai përfundoi në një qendër psikike. A frikoheni ju, kundërshtarët e mi, ndopak? Pa liri të plotë të hulumtimit dhe shprehjes, se a e dëshmojnë të vërtetën apo jo gratë tuaja, arsyeja nuk mund të japë përfundim të drejtë. Arsyeja juaj anon kah një ndjenjë — frika.

Nuk po ju qortoj ju në veçanti. Arsyeja e çdo kujt anon kah ndjenja në një mënyrë apo në një tjetër. Tek disa njerëz ajo do të ishte dëshira për famë ose për të fituar. Ato ndjenja janë për t'i vajtuar, mirëpo në asnjë rast arsyeja vetëm nuk mund të japë përfundime të drejta.

Pse të kërkonin përfundime të drejta nëse nuk jeni të frymëzuar nga ndonjë pasion, dashuria e së vërtetës? Kështu pasioni, ndjenjë e fuqishme, megjithëse nganjëherë është pengesë, në raste të tjera mund të jetë forcë shtytëse për arsyetim të drejtë. Bile e nënkupton atë.

Nga e dimë se silogjizmat japin mendime të drejta? Pra, ne vetëm e ndiejmë atë. Dhe e ndiejmë jo vetëm në gjëra të vogla por edhe në të mëdhatë. Ajshtajni pat

thënë për teorinë e tij të famshme, para se t'i nënshtrohej eksperimentit, se e ndiente që do të jetë e saktë. Ç'është kjo ndjenjë? Kjo nuk i përket arsyes. As intuita nuk i përket arsyes. Por ato e kënaqin një Ajshtajn.

Prova nuk është vetëm e jashtme. Ka provë edhe të brendshme që nganjëherë e kundërshton arsyen tonë. Kjo bindje e brendshme, besimi, vetvetiu është njëra prej fakteve të mëdha të gjithësisë. Duhet t'i përmbahemi dhe ta sqarojmë si çdo fakt tjetër të natyrës. Arsyetimi i Ajshtajnit bazohej në parandjenja jashtë arsyes.

Ateizmi po ashtu varet nga një besim. Edhe ai i ka parandjenjat e veta. Ateizmi mbështetet në ndjenjen se ia vlen koha që harxhon duke mohuar paqenësinë. Niçe, profet i madh i Antikrishtit, kishte nderin ta pranojë këtë. Ai shkruan: «Edhe ne entuziasatët e diturisë sot, ne, të pafetë dhe antimetafizikanët, marrim zjarr nga flaka, të cilën e ka nderur një besim i vjetër me mijëra vjet — besimi i krishterë, i cili ishte gjithashtu edhe besimi i Platonit, se Zoti është e vërteta dhe se e vërteta është hyjnore.» Niçes i vinte keq për këtë, por ai e konsideronte veten «besimtar».

Në qoftë se ndjenjat kanë të njëjtin ndikim kaq të madh në bindjet e besimtarëve dhe të jobesimtarëve, atëherë pse i Tejetlarti të flasë ty, arsye krenare, e jo ndjenjave?

Lenini në «Fletorët filozofike» thotë se materja ka aftësi vetëreflektuese. E reflekton veten në të menduarit. Në të menduarit e kujt? Në atë të njeriut. Nëse ajo që mendojmë është reflektim i realitetit dhe nëse të gjitha mendimet tona janë aq shumë personale, e vërteta e cila reflektohet duhet të jetë një Person që ne e kuptojmë në mënyrë të qartë ose të errët, ose në mënyrë të shtrembër, ose edhe pa e ditur se kënd me të vërtetë e kuptojmë. Jezusi thotë se e Vërteta është person — ai vetë. Provo ta shprehësh këtë në silogjizëm. Do të vini në përfundim se pohimi i Jezusit është i vërtetë, e vërtetë misterioze.

Në qoftë se nuk e ke ndjenjen e misterit, nuk mund të arrish deri te e vërteta.

Pse e beson atë që të thotë mendja? E di se është e pabesueshme. Ndoshta vetëm sa je zgjuar nga një gjumë i thellë ku po kjo mendje të ka mashtruar me një botë joreale. Të mashtron për çdo natë. T'i mashtron ëndrrat dhe fantazitë. A është e arsyeshme të mbështetemi verbërisht në arsye?

Me miliona njerëz, duke u mbështetur në arsye, i brohoritën Hitlerit e Stalinit si gjeni të mëdhenj. Po këta njerëz më vonë i paditën ata për vrasje masive. Shpeshherë e keni kuptuar se arsyeja ka qenë gabim. Bile as nuk pretendon t'ju tregojë të vërtetën. Arsyeja është një kurvë, që ju thotë atë që dëshironi ta dëgjoni. Ateistit i thotë se nuk ka Zot; fetarit i thotë se mund të jetë i qetë; anëtarit të ndonjë partie politike i thotë se programi i saj është më i miri.

Ne të gjithë kemi bërë gabime trashanike. E tërë historia e njerëzimit është një varr i madh idesh për të cilat njerëzit kanë qenë të gatshëm të vdesin. A je i sigurt se idetë tua një ditë nuk do të konsiderohen aq të marra sikur ideja që, Atlasi mban tokën?

Duke u mbështetur në arsye, nëntëdhjetenëntë për qind te njerëzve bile edhe të shekullit tonë besojnë në vlerën absolute të ligjit të shkakësisë. Por Hajsenbergu ka të drejtë, bashkë me ata pak veta që e kuptojnë pohimin e tij: «Zgjidhja e paradokseve të fizikës atomike mund të gjendet vetëm kur të hiqet dorë nga idetë e vjetra dhe të ruajtura. Më e rëndësishmja ndër këto është ideja se fenomenet natyrore i nënshtron ligjeve të përpikta — parimi i shkakësisë.»

A keni vizituar ndonjëherë ndonjë institucion psikiatrik? Ku është kufiri në mes institucionit psikiatrik dhe jetës normale? Mund të gjendet në mikrobin e sifilizit në trurin e një gjeniu ose në një emocion të padurueshëm që ka shkatërruar një arsye të shkëlqyeshme. A e dinë autorët

e *Librit ateist* çfarë veprimi shkatërrues mund të kenë filluar mikrobet në trurin e tyre? Krushçovi e përshkruan regjimin e Stalinit si një ferr në të cilin bile edhe udhëheqësit komunistë dridheshin për jetën e tyre. Kështu, pra, edhe autorët e *Librit ateist* kanë përjetuar tronditje të tmerrshme shpirtërore. A mund të jenë të sigurt se janë plotësisht në vete? A është ndonjëri prej nesh? Ne i përkasim një gjinie e cila, përderisa jeton në këtë planet të pasur, nuk gjenë tjetër zgjidhje të problemeve të veta përveç masakrave masive për çdo tridhjetë vjet. Diçka nuk është në rregull me arsyen tonë. A kanë të drejtë ateistët që mbështetën në arsye?

Cili njeri nuk mund të kategorizohet së paku pjesërisht si maniak, neuropat, njeri me vese, ëndërrues, skizofren, megaloman, i korruptuar, i hutuar? Ku është arsyeja e përsosur, normale?

Kush je ti arsye? Trego identitetin tënd! Kush është autoriteti yt i fundit, të cilin mund ta pyesësh për realitetin dhe të kërkosh prej tij që t'i zbulojë ty sekretet e fundit?

Mbi sipërfaqen e oqeanit të realitetit ngritet një pikë e vogël — qenia ime. Ngritet brenda oqeanit. Nuk mund ta lëjë oqeanin asnjë çast. Qenia ime është pjesë e tij, e rrënuar nga stuhitë e tij.

Posa të lartësohet vetja ime si mbret menjëherë fillon ta gjykojë realitetin, në vend që të ushqehet përgjithësisht nga ai, unë nuk jam më realitet, por mosqenia, iluzion.

Ekziston vetëm një realitet — Perëndia. Ai ka krijuar, por brenda vetvetes. Në të e kemi qenien tonë, jetën, dhe lëvizjet. Ai i rrethon të gjitha krijesat që i ka krijuar. Ndër to edhe miliarda qeliza, secila prej tyre me organizim të plotë që i kanë të gjitha funksionet e jetës, pranojnë ekzistencën nga trupi, jetojnë nga ai dhe në të, pra të gjithë jemi pjesë e një realiteti më të lartë. Ne jetojmë në Perëndinë. Kur i kundërshtojmë atij, jeta e humb kuptimin e vet.

Njeriu i mençur di si ta pranojë shakanë, edhe nëse ai vetë është subjekt i saj. Pa qëllim të keq do t'iu tregojmë miqëve ateistë një shaka:

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik diskutonte problemin e Krushovit. Brezhnjevi dhe të tjerët thanë: «Ai është idiot. Ta heqim qafe.» Podgornji ndërhyri: «Mos është e mundur t'ia transplatojmë organet. T'ia transplatojmë trurin e një gjeniu.» Të tjerët dhanë pëlqimin e vet. Por nuk morën rezultatin e pritur. Kishin harruar për fenomenin e refuzimit. Truri i gjenit refuzoi Krushovin.

Merrne si shaka! Por mendja e ndritur, e ndritur nga Krijuesi dhe në harmoni me të, refuzon doktrinën ateiste.

Vështirësia për të qenë ateist

Jemi nisur të shkojmë larg aq sa është e mundur për t'u përpjekur me miqtë tanë ateistë.

Ateizmi mund të jetë kalim prej një religjioni të remë në të vërtetën shpirtërore. Ateizmi në një brez të caktuar është në përgjithësi pasojë e besëtytnive të ndonjë religjioni hipokrit të një brezi të mëparshëm. Pra, është një kalim. Mos u ndal vetëm në kalim!

Ne gjithashtu dimë se jo të gjithë ata që e quajnë veten ateistë janë me të vërtetë ateistë. Baron Holbah, njëri nga filozofet e famshëm të shekullit të tetëmbëdhjetë, e pat shpallur Perëndinë armikun e tij personal. Për të, asgjë tjetër nuk ekzistonte përveç natyrës. Natyra, sipas tij, krijon gjithçka, duke qenë vetë e pakrijuar. Kjo është pikërisht ajo çka ne besojmë për Perëndinë! Natyra është e pafund dhe e amshueshme. Përsëri, çka besojmë ne për Perëndinë. Në natyrë, ka ligje, rregull, qëllim, shpirt. Sa më shumë që të lexosh se çka kupton Holbahu me natyrë, aq më tepër fiton përshtypjen se ai vetëm ka zëvendësuar

fjalën «natyrë» me fjalën «Perëndi», për të cilin shprehte mospëlqim. Ky nuk është ateizëm i vërtetë.

Për shumë njerëz, ateizmi është vetëm një mbulesë për dështimin e një kërkimi të pasuksesshëm në ndonjë religjion. Ateizmi i tyre është religjion represiv, dhe është faji ynë pse nuk dimë të komunikojmë me ta. Të krishterët duhet ta harrojnë të flasin «krishterçe» kur kanë të bëjnë me jobesimtarët. Mjekët kanë zhargonin e tyre kur rrinë bashkë, por mjeku i urtë, kur është me pacientin përdor shprehjet të cilat mund t'i kuptojë pacienti. Nuk është e vërtetë se të gjithë mësuesit e religjionit as edhe të gjithë të krishterët dinë t'ua shpjegojnë besimin në mënyrë të kuptueshme atyre që nuk i dinë shprehjet biblike. Kjo i largon shumë njerëz nga besimi.

Prandaj duhet të kemi mirëkuptim.

Ne po ashtu kuptojmë barrën e ateistit. Sigurisht është shumë më vështirë të jesh ateist se sa të jesh besimtar. Ateistët kanë një besim shumë të përpiktë. Ata na qortojnë për besimin tonë pa fakte. Ne do t'i paraqesim faktet e besimit në këtë libër. Por kush do të mund t'i vërtetojë dogmat e çuditshme ateiste?

Dogma e parë është: «Materja ekziston nga amshimi dhe është në lëvizje të përhershme, që e ka krijuar jetën.»

Si e dinë ateistët këtë? Astronomi i famshëm Hojli paraqet prova në të kundërtën. Në librin e tij «Natyra e gjithësisë» shkruan:

«Për t'ju shmangur çështjes së krijimit do të ishte nevojshme që i tërë materiali i gjithësisë të jetë i vjetër deri në pakufi — dhe kjo nuk mund të jetë ashtu për një arsye praktike. Sepse po të ishte ashtu, s'do të kishte mbetur më hidrogjen në gjithësi. Siç mendoj këtë e kam demonstruar kur kam folur për brendinë e yjve, hidrogjeni gjithnjë e më tepër po shndërrohet në helium kudo në gjithësi; ky shndërrim është proces i njëanshëm, që domethënë, hidrogjeni nuk mund të prodhohet në ndonjë sasi të dukshme përmes shkatërrimit të elementeve tjera.

Si është e mundur atëherë që gjithësia përbëhet gati krejtësisht nga hidrogjeni? Po të ishte materja e vjetër deri në pakufi, kjo do të ishte krejt e pamundur. Kështu, po shohim se gjithësia duke qenë ajo që është, çështja e krijimit nuk mund të shmanget.

Po ashtu e dimë se sipas ligjit të dytë të termodinamikës, në të gjitha proceset vështruese të fizikës në gjithësi, një sasi e energjisë e humb vlerën e saj. Gjithësia ka marrë tëposhtën. Meqenëse po shkon në shkatërrim, duhet të ketë pasur një fillim.»

Bibla flet shkencërisht kur thotë: «Gjërat që shihen janë të përkohshme.»

Çfarë provash kanë ateistët për të kundërtën? Çka i bën të besojnë se materja ka ekzistuar përgjithmonë? Çfarë prove është ajo që gjithnjë ndryshon? Megjithatë duhet t'i besosh, e për t'i besuar është shumë vështirë. Është vështirë për të besuar se nuk ka Perëndi, nuk ka Atë të dashur, nuk ka qëllim në sende, nuk ka shpresë për jetën tonë të cilës shpejt po i vjen fundi.

A është çdo gjë grumbullim i rastësishëm i grimcave elementare? Shkrimtari komunist Anatolli Franca shkruan: «Rastësia ndoshta është pseudonim i Perëndisë, që ai nuk ka dashur ta nënshkruaj.»

Njerëzit nuk janë ateistë në momonetet e krizave të mëdha, në rrezik, kur kalojnë në ekstazë nga dashuria ose kur janë të mahnitur nga bukuria. Të rrallë janë ata ateistë që mbetën pa besuar deri në shtratin e vdekjes. Është e vërtetë se disa vazhdojnë ta luajnë rolin deri në fund; ata nuk e pranojnë me gojë deri në çastin e fundit se janë të mbytur në dyshime. Por kur një besimtar i shkathtë gjendet pranë shtratit të vdekjes së një personi të tillë, ia arrinë që ta kthejë në besim.

Krizat e mëdha në jetë i lëkundin bindjet e ateistit.

Kur Revolucioni rusë ishte në rrezik të madh, pasi trupat antikomuniste të Gjeneral Kornilovit kishin rrethuar Peterburgun, Lenini mbajti një fjalim në të cilin

thirri disa herë, «Daj Bozhe» — «Zoti na ndihmoftë për të ikur.» Ndoshta dikush mund të kundërshtojë, e të thotë se kjo nuk është një thënie e njohur në gjuhën ruse. Por Lenini kurrë nuk e ka përdorur këtë shprehje përveç në kriza të mëdha.

Tre burra e udhëhoqën luftën kundër nazizmit: Çerçili, Rusvelti dhe Stalini. Dy të parët kanë qenë të krisherterë. Çerçili ka shkruar gjashtë vëllime për memoaret e luftës. Emri Perëndi asnjëherë nuk përmendet nga buzët e dy besimtarëve. Vetëm Stalini thotë: «Perëndia i ndihmoftë operacionit 'Pishtari' (pushtimi i Afrikës Veriore)» e «e shkuara i takon Perëndisë», e të tjera.

Mao është ateist i ashpër. Por në vitin 1936, kur si anëtar i Partisë Komuniste të Komitetit Qendror u sëmurrëndë, kërkoi të pagëzohet dhe u pagëzua nga një motër nderi. Kur iu vra gruaja nga trupat e Çiang Kai-shek, ai kompozoi një këngë fetare «Të pavdekshmit». Në një intervistë me gazetën angleze «Snow» në vitin 1971, tha: «Së shpejti më duhet të dal para Perëndisë.»

Ndodhitë e tilla janë shumë mësimdhënëse. Nëse je inxhinier dhe ke ndërtuar një urë, fakti se macja kalon nëpër urë nuk vërteton se ura është e fortë. Treni duhet të kalojë mbi të. Nuk mund ta konsiderojmë doktrinën ateiste të dobishme në qoftë se është vetëm mësim në ditë të mira.

Zinoviev, kryetar i Internacionalës komuniste, pat vdekur me urdhër të Stalinit. Fjalët e tij të fundit qenë: «Dëgjo, Izrael, Zoti ynë është Zot i vetëm.» Jagoda, ministër sovjetik i punëve të brendshme, po ashtu vrrarë nga Stalini, pat thënë: «duhet të ketë Zot, sepse mëkatet më kanë zënë.» Jaroslavski, kryetar i Lidhjes së afetarëve në BRSS, iu lut Stalinit nga shtrati i vdekjes: «Digjni të gjitha librat e mia! Shikoni, ai është këtu! Më ka pritur. Digjni të gjitha librat e mia!»

Në burgjet komuniste duke ndejtur me të burgosurit komunistë, që ishin burgosur nga shokët e tyre komunistë

gjatë spastrimeve, unë vetë kam qenë dëshmitar i skenave të ngjashme.

Ju rekomandoj ju miqve ateistë që t'i peshoni gjërat më mirë.

Tash që po hy në një analizë më të hollë të librit të tyre, më lejoni t'ju shpreh mirënjohjet tona komunistëve të Bashkimit Sovjetik që mendimet e tyre i kanë shprehur me shkrim në mënyrë aq të qartë. Prej tyre kemi mësuar se çdo anëtar i Partisë Komuniste synon të jetë armik i besimit të krishterë. Në vendet kapitaliste, kudo në botë, komunistët mund të jenë miq me të krishterët dhe mund të kërkojnë dialog me vëllezërit tanë të krishterë. Mirëpo, ne e kemi të qartë se kjo është një lëvizje taktike. Qëndrimi i vërtetë i komunistëve ndaj të krishterëve është tërëguar në *Librin e ateistëve*. Ky është qëndrim armiqësor.

Përkufizimi i fesë

Libri ateist fillon me analizën e përkufizimeve të ndryshme të fjalës «fe» që janë dhënë nga filozofët.

Por nuk përmenden as Platoni i cili ka thënë se feja është sjellje e mirë ndaj perëndive, as Plutarku, për të cilin feja ishte diku në mes të ateizmit dhe besëtytnisë.

Libri fillon me mendimtarët e më vonshëm, më falni në shprehje, me gënjeshtarët. Asnjë citat nuk është i saktë.

Thomas Carlyl ka shkruar: «Gënjeshtria duhet shkelur kudo që të jetë derisa të zhduket. Unë jam për pastrimin e atmosferës kur ndiej se gënjeshtria si një murtajë më silllet përreth.»

Platoni na ka mësuar se autorët e librave duhet ta konsiderojnë veten priftërinj. E keqja e pavërtetësisë qëndron jo vetëm në gënjeshtërën që shitet si e vërtetë, por në faktin se njerëzit më në fund humbin besimin në libra të tjerë.

Është rrëfyer njëherë një histori për një beduin që kishte udhëtuar me deve nëpër shkretëtirë. Një njeri e ndali dhe i tha: «Të lutem, ma bëj një vend në shpinë të deves! Kam për të bërë një udhëtim të gjatë.» I zoti i deves e pranoi kërkesën dhe i panjohuri hipi mbas tij. Papritmas, pas pak kohe, i panjohuri me një lëvizje të shkathët e hodhi të zotin e deves për tokë dhe iku. I zoti i deves pastaj tha: «Nuk po hidhërohem pse ma vodhe deven. Kam edhe shumë të tjera. Por po pikëllohem se në të ardhmen do ta kem më zor për t'iu ndihmuar të tjerëve që i takoj rrugës.»

Libri ateist nuk i kushton aspak kujdes nëse diçka është e vërtetë ose gënjeshtër.

Në Bashkimin Sovjetik, librat e filozofëve që nuk i përkasin shkollës së materializmit dialektik gjenden në listën e librave të ndaluar. Lexuesi i zakonshëm nuk mund t'i gjejë ato. (Njëra prej akuzave kundër meje, që më futi në burg, është se gjoja unë kisha libra të tilla dhe i kisha shpërndarë ilegalisht.) Në këtë mënyrë autori mund të japë citate jo të sakta, dhe lexuesi i këshilluar gabimisht s'ka mundësi t'i marrë burimet e sakta.

Kundërshtarët e mi e citojnë Imanuel Kantin sikur na paska shkruar se feja qenka të kuptuarit e njeriut ndaj detyrës së moralit. Fjalët e vërteta të këtij filozofi janë këto:

«Feja është moral që i referohet Zotit si ligjvënës. Është njohja e detyrave tona që konsiderohen si urdhëresa hyjnore.»

Kundërshtarët e mi thonë se Ludvig Fojerbahu e ka definuar fenë si lidhje ndërmjet njerëzve. Edhe kjo është gënjeshtër. Në librin e tij «Thelbi i krishterimit», ai thotë: «Feja është ëndrra e mendjes njerëzore.»

Bile edhe përkufizimet e dhëna nga autorët ateistë janë shtrembëruar. Salomon Rainahun e kanë cituar sikur paska thënë se feja është sistem kundërtënieësh. Mënyrën e drejtë e të shprehurit e gjejmë në librin e tij «Orfeu».

«Feja është shuma e besimeve besëtytnore që e pengon ushtrimin e lirë të aftësive të njeriut.»

Është e kuptueshme ajo që e morën si të domosdoshme për t'i shtrembëruar fjalët e Uiliam Xhejmsit. Nuk kanë mundur ta citojnë mendimin e tij: «Besimi fetar i njeriut (pa marrë parasysh se çfarë doktrinash të veçanta mund të përfshijë) për mua në esencë do të thotë besim i tij në ekzistencën e njëfarë rregulli të diçkaje të padukshme, në të cilën enigmat e rregullit natyror mund të gjejnë shpjegim... Me rëndësi është se Perëndia duhet të kuptohet si forca më e thellë në gjithësi, dhe së dyti, ai duhet të besohet nën formën e një personaliteti shpirtëror.»

Libri ateist është gjithashtu i padrejtë edhe ndaj Xhejms Frejzerit. Siç e citojnë, edhe ai na del afetar, ndërsa fjalët e tij në veprën «Besimi në pavdekshmëri» janë: «Pyetjes a jeton shpirti pas vdekjes i përgjigjet gati e tërë gjinia njerëzore në mënyrë pozitive. Në këtë çështje, skeptikët dhe agnosticistët janë pjesërisht, nëse jo plotësisht, të panjohur.»

Bile nuk janë përmendur as përkufizime të njerëzve të tillë si Shllaiermaherit, i cili thotë: «Feja është ndanja e varësisë absolute nga një përcaktues i padukshëm i fatit tonë, e shoqëruar nga dëshira shpirtërore për të ardhur në marrëdhënie të harmonishme me të»; ose Emersoni: «Feja është bashkësi me Mbi-shpirtin, hyjnia jonë që arrin Hyjninë e lartë», ose Jakob Burkhardi: «Feja është shprehje e dëshirës së brendshme dhe të pathyeshme metafizike të natyrës njerëzore. Madhështia qëndron në atë se ato dëshira paraqesin tërë ndjeshmërinë e njeriut, gjithçka që ai vetë nuk mund të sigurojë. Ato janë njëkohësisht pasqyrim i nivelit të lartë dhe të ndryshëm të të gjithë popujve dhe epokave kulturore.»

Autorët e *Librit ateist* madje as nuk përpiqen që ta ndriçojnë fjalën «fe» nga emërtimet e ndryshme që i janë propozuar. Ciceroni thotë se rrjedh prej fjalës «relegare» që d.m.th. «konsideroj». Sipas Augustinit kjo fjalë do të

thotë gjetje e asaj që është humbur më parë. Laktantiusi thotë se kjo vjen nga «religare» që d.m.th. «lidh» (me një fuqi më të lartë).

Por gjëja më e çuditshme është se autorët e librit ateist, derisa pohojnë se janë marksista, e lënë pas dore thënien e Karl Marksit nga lista e përkufizimeve të ndryshme për fenë, pa dyshim që janë të hutuar për shkak të bukurisë së përkufizimit të tij dhe për shkak të komplimentit që i jep fesë.

Grindjet e të krishterëve rreth asaj që të jesh ortodoks, katolik, ose protestant, do t'i pengonin të tjerët për t'i dëgjuar fjalët e Jezusit: «Po ju jap një urdhër të ri: Duani njëri-tjetrin! Sikurse unë ju desha juve, duani edhe ju njëri-tjetrin! Nëse e doni njëri-tjetrin, të gjithë do t'ju njohin se jeni nxënësit e mi» (Gjoni 13:34-35). Kështu, pra, marksistët nuk mund ta citojnë Marksine në çështjet e fesë, ngase në librin «Vështrimet e të riut në zgjedhjen e profesionit» ai shkroi: «Perëndia i ka dhënë një qëllim të përgjithshëm njeriut — ta fisnikërojë njerëzinë dhe vetveten.» Më vonë në «Kontribute kritikës së filozofisë së të drejtës të Hegelit», shkruan: «Feja është psherëtima e krijesave të shtypura, zemra e botës së pamëshirshme, mu ashtu si është shpirti i shoqërisë së pashpirt.»

Rëndësia e këtyre fjalëve rritet kur arrin të kuptosh se Marksi ka mësuar prej Hegelit. Hainrih Haine thotë për këtë të fundit: «Një mbrëmje të bukur me yj, rrinim së bashku pranë dritares dhe bisedonim për yjtë me një entuziazëm sentimental dhe i quajtem shtëpitë e të bekuarve. Por mësuesi (Hegeli) murmuriti me vete: 'Yjtë, hëm! Yjtë janë vetëm një zgjebë vezulluese në qiell.'»

Të kesh një mësues që thotë vetëm kaq pak fjalë për yjtë dhe pastaj të japë përkufizime aq të bukura për fenë është një sukses i madh!

Është e vërtetë se Marksi thotë edhe këtë: «Feja është opium për popullin», por kur i vëjmë në kontekstin e lartpërmendur, këto fjalë e humbin kuptimin e tyre kun-

dër fesë. Opiumi e qetëson dhembjen. Asgjë të keqe nuk ka në opium. Vetëm zbulimi i anestezisë ka mundësuar zhvillimin e mrekullueshëm të kirurgjisë.

Marksit, në përgjithësi, e ka pasur një dobësi të madhe për fenë. Feja ka qenë një temë e preferuar për të. Në kryeveprën e tij «Kapitali», thotë: «Për një shoqëri të tillë (mendon për shoqërinë e bazuar në prodhimin e mallrave; çdo shoqëri i prodhon ato), krishterimi me kultin e vet prej njeriut abstrakt, më në veçanti me zhvillimin e tij borgjez, protestantizmin, deizmin, etj., është forma më e përshtatshme e besimit.»

Kështu, çdo i krishterë protestant mund të përfitojë nga rasti i Marksit. Mund t'ju tregojë kundërshtarëve «marksistë» se po e keqpërdorin emrin e mësuesit të tyre. Nxënësi i vërtetë i Marksit duhet të jetë protestant, nëse dëshiron të ketë fe të përshtatshme. Të mendojmë sa protestantë janë vrarë e burgosur nga të ashtuquajturit udhëheqës marksistë!

Ndonëse Marksit ishte ateist, ai prirej nga feja. Personaliteti i tij ka qenë i ndarë. Nxënësit e Marksit më vonë e kanë kuptuar thënien e tij «feja është opium për popullin» se është një akuzë e keqe kundër nesh.

Njerëzit kanë përdorur shumë gjëra të tjera si opium përveç fesë. Një njeri, më qëllim që të ikë nga problemet familjare, e zgjedh kiminë si opium. E kalon tërë kohën në laborator dhe e zbulon një ilaç të dobishëm. Mos i ka rënë vlera mjekësisë për shkak se zbulimi i këtij ilaçi ishte opium i një zemre të mjeruar? Nëse dikush që ka vuajtur shumë në jetë strehohet në një observator të qetë astronomik, puna për të është një opium, por yjtë që i vrojton janë të vërtetë. Pra, feja mund të jetë opium për shumë njerëz, por Zoti të cilit i drejtohen është i vërtetë.

Ateizmi dhe aktivitetet revolucionare shpeshherë janë opium për fëmijë nga familje të shkatërruara, zëvendësim i rebelimit kundër autoritetit prindor. Ateizmi mund të jetë opium për ta qetësuar ndërgjegjen e njeriut, e cila

përndryshe do të ndiente dhembje për shkak të mëkateve të mëdha. Ateizmi i mbylqortimet e ndergjegjes, pikërisht si opiumi që i lehtëson dhembjet fizike.

Thënia e Marksit «feja është opium për popullin» është krejtësisht e ndryshme nga ajo e Leninit «feja është një raki shpirtërore», ose përfundimi absurd i Bakuninit: «Nëse ekziston Zoti, njeriu është skllav; por njeriu mundet dhe duhet të jetë i lirë; prandaj Zoti nuk ekziston.» Eshtë njësoj sikur të thuash: «Ateistët pohojnë se nuk ka Zot. Por besimi në të më lehtëson. Pra ateistët nuk po ekzistuan!»

Do të kishte qenë mirë për autorët e *Librit ateist* që kanë shkruar aq shumë për Biblën dhe kundër saj, të kishin përmendur një përkufizim të fesë të dhënë nga një apostull i Krishtit: «Besimi i pastër dhe i patëmetë para Hyjit Atë është ky: kujdesi për bonjakë dhe për gra të veja në vështirësitë e tyre dhe ruajtja e pastër nga kjo botë» (Letra e Jakobit 1:27). A janë kundërshtarët tanë kundër një feje të definuar në këtë mënyrë? Unë krenohem se asnjë njeri i vetëdijshëm nuk mund të ndihet ndryshe përveçse i magjepsur nga ky definicion. Ndoshta miqtë tanë ateistë nuk luftojnë kundër një feje të tillë, por kundër një shtrembërimi të saj. Kush mund të jetë kundër kujdesit për bonjakë dhe kundër ruajtjes nga kjo ndyrësi e madhe në botë?

Origjina e fesë

«Feja nuk është lindur bashkë me njeriun. Është veti transformuese e njeriut.» Kundërshtarët tanë të nderuar thonë se këtë e ka vërtetuar shkenca. «Zbulimet arkeologjike kanë treguar se me qindra e mijëra vite, njeriu nuk ka pasur fe.»

Unë nuk jam anëtar i Akademisë së Shkencave. Sipas injorancës sime, unë besoj se arkeologjia mund t'i zbulojë vetëm gjërat që kanë ekzistuar në të kaluarën, e jo gjërat që nuk kanë ekzistuar.

Mirë, por nuk bëhet shaka me akademikët. Ata kanë një argument të fortë. I kanë zbuluar shpellat në të cilat kanë jetuar pitekantropët dhe sinantropët, paraardhësit e njeriut të sotëm. Ka pasur shumë vegla të gurit dhe eshtra të kafshëve të ngrëna. «Por gërmimet e asaj kohe kurrë nuk kanë treguar ndonjë shenjë të paraqitjes së fesë, bile as shenjat më elementare.»

Kjo më kujton një tregim. Një italian kuvendonte me një çifut: «Ju çifutet jeni shumë krenarë. Flitet shumë se jeni njerëzit më të zgjuar në botë. Rrenë e kulluar! Në Itali janë bërë gërmime arkeologjike dhe në disa shtresa tokësore, që janë të vjetra së paku 2.000 vjet, është gjetur tel, që siguron se stërgjyshërit tanë romakë qysh në atë kohë kanë pasur telegraf.» Çifuti iu përgjigj: «Në Izrael janë bërë gërmime në pjesë të tokës me vjetërsi 4.000 vjeçare e asgjë nuk është gjetur, që do të thotë se ne kemi pasur radio para se ta kishit ju telegrafin.»

Ani, çka nëse ka munguar feja te njerëzit e parë ku shprehja e besimit mund të ketë qenë pa shenja të jashtme të kultit? Mund të ketë qenë një fe e përbërë nga meditimi dhe lutja. Të jemi të sinqertë, shokë akademikë!

Por për të vazhduar diskutimin, kundërshtarët e mi duhet të shpjegojnë si ndodhi që në një kohë të caktuar njeriu u bë fetar. Ata thonë se feja u paraqit në kohën e njeriut neandertal për dy arsye. E para, njerëzit primitivë kanë pasur frikë nga vdekja, frikësoheshin se fiset e vdekura do të ngriteshin nga varret dhe t'i dëmtojnë të gjallët. E dyta, paaftësia e njeriut primitiv për t'i përballuar elementet e natyrës.

Pitekantropi ka qenë më primitiv se kromanjoni dhe neandertali. Ai ka qenë më i paaftë se këta dy të fundit. Pra, logjikisht, ai është dashur të jetë më fetar.

Ju bëj thirrje për gjykim të shëndoshë.

Kundërshtarët e mi janë akademikë, disa prej tyre janë historianë. Çka mendojnë ata për origjinën e popullit dhe shtetit rus? Ata orientohen në dokumentet më të vjetra të historisë sonë.

Atëherë kjo procedurë duhet të jetë e mirë edhe për origjinën e njerëzimit. Dokumentet më të vjetra të njerëzimit janë Maneva-Darma-Sostra, epi i Gilgameshit, Vedetë, Libri egjiptian mbi të vdekurit, Librat e Moisiut, etj. Të gjitha ato njëzëri pohojnë se ne jemi krijuar nga një qenie hyjnore, e cila ua zbuloi profetëve të vjetër thelbin e së vërtetës që fetë e ndryshme e kanë të përbashkët. Kjo do të ishte origjina e fesë.

Në qoftë se unë gaboj kur i pranoj dokumentet më të vjetra të njerëzimit, atëherë Akademia e Moskës gabon në historinë e Ruisë.

Në asnjë kontinent nuk gjendet ndonjë pllakë me mbishkrim kunjor të gdhendur në të, as nuk mbahet mend diçka e tillë që thotë se njeriu e ka prejardhjen prej majmunit. Njerëzit zakonisht dinë diçka për gjyshërit e tyre. Nëse njerëzit në kohërat e lashta kanë pasur imagjinatë mjaft të zhvilluar sa për ta trilluar një fe të ndërlikuar, pse nuk i mbajten në mend gjyshërit e tyre duke u luhatur me bisht nëpër degët e drurëve?

Prapë, po them: të jemi seriozë, shokë, akademikë! Feja vjen prej Perëndisë. Është bashkësi me të.

Njeriu më primitiv e di se «unë ekzistoj», dhe se «shumë sende rreth meje ekzistojnë». Por në qoftë se unë, shokët e mi dhe sendet rreth nesh ekzistojnë, atëherë duhet të ekzistojë edhe një gjë: ekzistenca vetë. Nëse unë dhe bota jemi, gjithashtu është edhe një fakt i thjeshtë i «qenies». Unë plakem, shokët më vdesin, duke më paralajmëruar se edhe mua po më vjem radha, ndërsa fëmijët e mi rriten. Të gjitha objektet që më rrethojnë prishen ose zhduken. Por fakti i qenies kurrë nuk zhduket. Ekziston një Qenie e pastër, pavarësisht prej ardhjes dhe shkuarjes

sonë. Unë nuk ekzistoj përgjithmonë. As gjërat rreth meje nuk ekzistojnë gjithmonë. Ato janë joesenciale. Por fakti i qenies ka ekzistuar gjithmonë. Njerëzit primitivë nuk kanë ditur ta shprehin këtë me shumë fjalë. Po edhe ata kanë ditur për një Qenie të amshueshme, supreme, emri i të cilit do të na zbulohet më vonë si Perëndi i cili thotë «Unë jam». Besimi në të dhe dëshira për t'u pajtuar me të kanë frymëzuar çdo fe në nismën e vet. Ky është themeli i secilës fe bile edhe sot.

Nëse kjo nuk është e vërtetë, atëherë pse e keni shkruar librin?

Një ligjerues ateist një herë e ka pyetur një bujk rus nëse besonte në Zot. Ai i përgjigjet pozitivisht. Sërisht e pyet: «Pse beson në të? A e ke parë ndonjëherë?» — «Jo», u përgjigj bujku. «Unë asnjëherë nuk kam parë as japonez. Megjithatë besoj se japonezët ekzistojnë. Armata jonë ka luftuar kundër tyre në luftën e fundit. Ky fakt mjafton për mua. Po të mos kishte Zot, pse lufton kundër tij?»

Pse i shkruani 700 faqe kundër një personi që nuk ekziston? *Libri ateist* po ashtu i përket kategorisë së «qenies» dhe nënkupton një Qenie të amshueshme.

Prejardhja e krishterimit

Libri ateist fillon me një kompliment që na jep ne të krishterëve. Aty thotë:

«Krishterimi, të pakten në periudhën e vet fillestare, jo vetëm që hoqi dorë nga flijimet por në të njëjtën mënyrë i la edhe të gjitha llojet e ritualeve. F. Engelsi pat pohuar se ky qe një hap revolucionar. Duke u dalluar nga fetë tjera të lashta, krishterimi refuzoi kategorikisht të gjithë kufijtë etnik që lidheshin me çështjen e besimit, predikimet e tij i drejtohen të gjitha fiseve dhe të gjithë popujve. Sa i përket problemeve të besimit, krishterimi po ashtu

në mënyrë kategorike ka refuzuar edhe pengesat shoqërore. Ata që e përhapen mësimin e Jezusit u flisnin mbarë njerëzimit, pa dallim nga prejardhja etnike apo pozita shoqërore.»

Nuk është e vërtetë se të krishterët e parë hoqën dorë nga flijimet. Vërtet, ata i lanë kafshët që flijonin. Por ata me kënaqësi flijonin edhe vetveten.

Sidoqoftë, kundërshtarët tanë flasin një herë fjalë të mira për ne. Nuk ka pasur kurrfarë dallimi kombëtar apo racial në krishterim, e kjo gati që dy mijë vjet më parë! Në Poloni dhe Bashkimin Sovjetik ka diskriminim kundër judenjve. Në Rusi të gjithë tartarët, çeçenët, ingushet, kalmikët, balkarët dhe gjermanët e Volgës janë internuar për asgjë tjetër vetëm pse janë pjesëtarë të një kombësie tjetër. Në Kinë, tibetasit janë të shtypur.

Në çdo vend komunist, pyetja e parë që ta bëjnë është: «Çfarë prejardhje shoqërore ke?» Mjeri ti nëse babai yt ka pasur ndonjëherë fabrikë. Në krishterim nuk ka pengesa shoqërore sipas mëimit të Krishtit.

Libri ateist nuk na jep më komplimente.

Ai thotë: «Autorët grekë, romakë dhe judenj të shekullit të parë nuk japin kurrfarë njoftimesh për krishterimin.» Vëreni fjalën e bukur «kurrfarë». Ky mohim është absolutisht gënjeshtër.

Autorët romakë për krishterimin

Historiani romak Taciti jetoi rreth viteve 60-120 të erës sonë. Lidhur me djegjen e Romës që ndodhi në vitin 64, ai shkruan (Analet XV, 24): «Të gjitha orvatjet e njerëzve, të gjitha dhuntitë perandorake dhe pajtimet e përndive, nuk mjaftuan t'i qetësonin përgojimet ose ta largojnë nga mendja besimin se dikush kishte urdhëruar t'i vihej zjarri. Kështu, për t'ju larguar thashethemeve, Neroni gjoja se i gjet fajtorët dhe i dënoi me torturat më të rënda, këta ishin një grup njerëzish që e quanin veten të krishterë. Emri i krishterë vjen nga Krishti, i cili u dënua me vdekje nga prokurori Ponc Pilati në kohën e sundimit të Tiberit. Besëtytnitë e dëmshme, që u shtypen për një kohë, shpërthyen sërish dhe u përhapen jo vetëm në Jude, që ishte burimi i sëmundjes, por bile edhe në Romë, ku çdo poshtërsi nga të gjitha anët e botës vjen e shfaqet këtu. Në këtë mënyrë, të parët që u arrestuan ishin ata që e pranorin (se janë të krishterë); pastaj, sipas dëshmisë së tyre, u dënua një numër i pafund njerëzish, jo aq shumë të akuzuar për shkak të zjarrvënjes sa për shkak të urrejtjes së gjinisë njerëzore. Përveç dënimeve me vdekje, përdorëshin për të shërbyer edhe si objekt argëtimi; i vishnin me lëkurë kafshësh dhe i coptonin qentë, të tjerët i kryqëzonin, të tjerëve ua vënin flakën për të ndriçuar natën pasi të ngrysej. Neroni kishte përhapur idenë për shfaqje, dhe po përgatiste një të tillë, ku ai përzihej me popullin i veshur si karrocier ose e ngiste karrocën. E tërë kjo ia zgjoi ndjenjën e mëshirës, bile edhe ndaj njerëzve faji i të cilëve meritonte dënimin më të madh; sepse e ndjeu se po shkatërroheshin jo për të mirat e popullit por për ta kënaqur egërsinë e një individi.»

Kështu «absolutja» e *Librit ateist* nuk është absolute. Kemi një historian romak të shekullit të parë që e dëshmon ekzistencën e Krishtit.

Mund t'i shërbejmë kundërshtarët tanë me të dytën: Suetini jetoi rreth vitit 75-160 të erës sonë. Ai shkruan në «Vita Claudi» (XXV, 4): «...Mbasi judenjt vazhdimisht po bëjnë trazira, të nxitur nga Kresti, ai (Klaudi) i dëboi nga Roma...»

Pra përsëri ekzistenca e Krishtit po vërtetohet, po edhe më tepër: gjatë kohës së perandorit Klaudi, Kresti kishte një numër të madh ithtarësh në Romë. Në vitin 64 pas Krishtit kanë qenë fort të persekutuar, siç e përkthyerim në njëjtë autor në «Vita Neronis» (XVI): «Gjatë sundimit të tij (Neronit) shumë keqtrajtuës u dënuan ashpër e u shtypën dhe u krijuan shumë ligje të reja; ... ndëshkimet ranë mbi të krishterët, sekt që ndjekin një besëtytni të re dhe të dëmshme.»

Me radhë vjen historiani i tretë romak, Plinti i Ri, rreth vitit 62-113 pas Krishtit. Ai i shkruan perandorit Trajan: «E kam për detyrë, Zotëri, të drejtohem ty në çështjet ku nuk jam i sigurt. Sepse kush di më mirë t'i drejtojë pavendosmëritë e mia, ose ta udhëzojë injorancën time? Asnjëherë nuk kam qenë i pranishëm në gjykimet e të krishterëve; prandaj nuk e di se çfarë janë dënimet e zakonshme as hetimet dhe në çfarë masash po zbatohen. Jam shumë i pavendosur në çështjen se a duhet të ketë dallim në moshë, se a duhet të dobëtit të trajtohen njësoj sikur ata që janë më të shëndoshë; se a duhet të falën ata që pendohen, ose nëse dikush ka qenë i krishterë njëherë a duhet të fitojë diçka kur e len atë; se a duhet të dënohet vetë emri bile edhe nëse është i pafajshëm, ose vetëm kriminelët që e mbajnë atë emër. Ndërkaq, ja se si veprojmë rastet e të krishterëve që i sjellin para meje. I pyes a janë të krishterë. Nëse e pranojnë, e përsëriti pyetjen për të dytën e të tretën herë, duke iu kërcënuar me dënime për vdekje; nëse ngulin këmbë i dënoj me vdekje.»

Mund t'i shërbejmë kundërshtarët tanë me një dokument të katërt. E kemi letrën e parë të shën Klementit, ipeshkvit të Romës, që daton menjëherë pas persekuti-

meve të Neronit ose të Domicianit. Sidoqoftë është nga shekulli i parë. Po ashtu edhe ky dokument përmban të dhëna të shumta për krishterimin. Prej tij e dimë gjendjen e kishës së Korintit në atë kohë. Na tregon se apostulli Pjetër vdiq si martir, se Pali është burgosur shtatë herë. Nga ky mësojmë edhe emrat e martirëve të tjerë Daniadit e Dirkaesë.

Shën Klementi, duke shkruar në shekullin e parë, e njuh Krishtin si realitet historik. Ai shkruan: «Krishti është prej atyre që janë të përvuajtur e jo prej atyre që e lartësojnë veten përmbi popullin e vet. Zoti ynë Jezu Krishti, skeptri i madhështisë së Perëndisë, nuk erdhi me pompozitet të krenarisë as arrogancës, ndonëse ka mundur të bëjë ashtu, por në një gjendje të përlulur, ashtu siç kishte lajmëruar Shpirti Shenjt për të.»

Një fragment nga Sulpikus Severus, shkrimtar krishter i shekullit të katërt, po ashtu është shqyrtuar në mënyrë kritike dhe është gjykuar se gjoja është bazuar në një fragment nga një shkrim i humbur i Tacitit. Na tregon për një këshillim të luftës të mbajtur nga Titi pas pushtimit të Jeruzalemit në vitin 70 pas Krishtit. Shkruan për Titin se ka shprehur mendimin se duhet të rrenohet tempulli i Jeruzalemit me qëllim që besimi i judenjve dhe kristianëve të çrrenjohet më plotësisht. Të krishterët kishin dalë nga judenjtë, dhe kur t'i zbulohen rrenjet, trangu rrëzohet lehtë. («Krishterimi i hershëm dhe paganizmi», nga Donald Spens, Dutton & Co., New York.)

Në vitin 125 pas Krishtit filozofi Aristidi ia paraqiti perandorit Hadrian një kod plot me parime morale të kishës, që ishin vjetëruar derisa e kishte përpunuar mirë sistemin e të menduarit.

Po ju citoj nga ajo:

«Ata që i shtypin (të krishterët), ata këshillohen (me Biblën) dhe i bëjnë miq. Ata u bëjnë mirë armiqve të vet. Gratë e tyre, o Mbret, janë të pastra si virgjëresha, ndërsa vajzat i kanë modeste. Burrat e tyre janë të përmbajtur

nga të gjitha kontaktet e paligjshme seksuale, edhe nga papastërtia, me shpresë se kjo do t'ju shpërblehet në botën tjetër.

Për sa i përket skllëverve dhe fëmijëve të tyre, nëse kanë ndonjë, ata i bindin që të bëhen të krishterë; e kur të bëhen të krishterë, i quajnë vëllezër pa kurrfarë dallimi.

Ata nuk pranojnë të adhurojnë perënditë e huaj; dhe shkojnë rrugës së tyre në përultësi e gëzim të plotë. Rrena nuk mund të gjesh te ta. E duan njëri-tjetrin; kujdesi për vejushat nuk mungon, dhe u ndihmojnë bonjakëve kur janë të rrezikuar. Ai që ka i jep atij që nuk ka, jep vullnetarisht dhe pa u mburrur. Kur të krishterët e gjejnë një të huaj e çojnë në shtëpi dhe gëzohen bashkë me të. Kur iu lindin fëmijët, e lavdërojnë Zotin; nëse u vdes në fo-shnjëri, e falënderojnë Zotin edhe më tepër, si për një që kalon nëpër botë pa mëkate. Por nëse ndonjë u vdes në mëkat, mjerohen e pikëllohen si për një që pritet të dalë në gjyq.

Ky, o Mbret është drejtimi i të krishterëve, dhe kjo është sjellja e tyre. Si njerëz që e njohin Zotin, ata i luten në një mënyrë që është e drejtë për të dhënë e për të marrë, dhe për shkak se e pranojnë mirësinë e Zotit ndaj tyre, ai kujdeset për ta! Për këtë arsye prej tyre rrjedh bukuria e botës. Kur të bëjnë vepra të mira, nuk bërtasin para turmës, që njerëzit t'i vërejnë; por i fshehin dhuratat që i japin sikur njeriu që e fsheh visarin. Përpiqën të jenë të drejtë sikur ata që presin ta shohin fytyrën e Mesisë së tyre për t'i marrë premtimet prej tij.

Këta njerëz janë njerëz të rinj me të vërtetë, dhe ka diçka hyjnore që gjendet mes tyre. Merrni dhe lexoni shkrimet e tyre; do të shihni se nuk po ju them këto fjalë nga vetja ime. Gjërat që i kam lexuar nga shkrimet e tyre i besoj me vendosmëri të patundshme, jo vetëm për këto të tashmës por edhe për ato që do të vijnë. Nuk kam pikë dyshimi se toka qëndron sot nga arsyeja e ndërmjetësimit të krishterëve. Mësimi i tyre është hyrje e dritës.

Le të afrohen të gjithë ata që nuk e njohin Zotin, e t'i pranojnë fjalët e ndershme që janë nga të gjitha kohërat dhe amshimi, që t'i ikin gjykimit të tmerrshëm i cili do të vijë nëpërmjet Jezu Mesisë mbi mbarë njerëzimin.»

Ç'na ka mbetur nga pohimi se shekulli i parë nuk na jep kurrfarë të dhënash për krishterimin?

Por nuk pata nevojë të grindem se nuk është e vërtetë që nuk ka kurrfarë dokumentash për krishterimin që datojnë nga shekulli i parë. Akademikët, autorët e *Librit ateist*, bien në kundërshtim me vetveten në faqet vijuese. Thonë se libri «Zbulesa» është shkruar në vitin 68 pas Krishtit. Kështu jemi në shekullin e parë. Është shkruar nga një judeas. Dhe ai fillon duke thënë se krishterimi ekzistonte dhe ishte i organizuar, bile edhe në vende larg prej Palestinës. Zbulesa fillon me shtatë letra dërguar kishave në Azinë e Vogël.

Dëshmia e ungjijve

Është një aksiomë për biblën ateiste se ungjijtë nuk janë shkruar në shekullin e parë, por që janë shkruar më vonë nga falsifikues të aftë. Ungjilli sipas Gjonit gjoja se është shkruar vetëm në fund të shekullit të dytë.

Por Injaci e citon atë, megjithëse ai u martirizua para vitit 116. Justini filozof e citon atë. Ai vdiq rreth vitit 140. Madje edhe Lojsi, kritiku freng i Biblës, e pranon se ky Ungjill kishte arritur në Romë në vitin 130.

Një analizë e thjeshtë e përmbajtjes së Ungjillit na tregon se ata nuk kanë mundur të jenë falsifikues të vonshëm. (Duke e pohuar këtë, kundërshtarët e mi e kundërshtojnë bile edhe Engelsin, i cili e përqesh mendimin se krishterimi është vepër e falsifikuesve. Shih F. Engels, «Bruno Bauer dhe Krishterimi i hershëm».)

Në fund të shekullit të dytë, kur ungjijtë gjoja se u trilluan, emri i apostujve çmohej lart në rrethet krishtere.

Atëherë pse një falsifikues që dëshironte që shkrimet e tij të besohen si frymëzim i Perëndisë, na tregon se Jezusi e quajti Pjetrin «djall» e se gjithashtu i qortoi edhe apostujt tjerë? Flalët e tilla kurrë nuk do të ishin dukur në Ungjill po të mos ishin folur. Apostujt kanë qenë shumë të respektuar. Të krishterët nuk do të trillonin fjalë të kundërta për ta.

Në fund të shekullit të dytë, Krishti adhurohej si Hyj nga e tërë kisha. Falsifikuesi i aftë nuk do ta kishte ngarkuar miqësinë e ngushtë me gratë apo klithmën në kryq, «Hyji im, Hyji im, pse hoqe dorë prej meje?» kurrë nuk do të ishte pranuar si libër i shenjtë. Të njëjtat e përshkruajnë frikën dhe shqetësimin e Jezusit në Gjetseman. Gabimet e tilla e bëjnë emrin e Shpëtimtarit të mundshëm për ta sulmuar.

Celsusi, në një libër të vitit 178 pas Krishtit, tallet me Jezusin për shkak të klithmës në kryq, duke na kujtuar se nxënësit e tij i duruan vuajtjet në heshtje trimërore. Këto të vërteta për Jezusin ai i ka mësuar nga ungjijtë. Ungjilltarët nuk i shkruan ato për t'i arritur qëllimet e veta por për shkak se ata kanë qenë dëshmitarë të ngjarjeve; prandaj nuk i kushtuan kujdes psherëtimave dhe lotëve, vuajtjes dhe dhembjes se a do t'ia ulnin vlerën Jezusit sipas mendimit të disave. Tregimet e tilla janë provë për të vërtetën dhe kohën e hershme të ungjijve.

Falsifikuesit e më vonshëm do të kishin qenë lajkatarë të mëdhenj për Jezusin. Nuk do të na kishin treguar se atë nuk e kanë pranuar bashkëkohësit e tij, nuk e kanë pranuar populli i tij, populli që e njihte më së miri, se e kanë quajtur djall, se Jezusi i thotë një të riu: «Pse më quan i mirë?»

Ungjijtë dhe letrat e apostujve kanë disa fjalë aramaike. Aramaishtja ka qenë gjuhë që e kanë folur jude-njtë në Palestinë. Po të ishin shkruar ungjijtë në fund të shekullit të dytë, atëherë pse falsifikuesit i kanë ruajtur shprehjet aramaike në botën ku flitej greqishtja? Ato

shprehje kishin kuptim vetëm në dekadën e parë të historisë së krishterimit, kur pjesa dërrmuese e të krishterëve ishin judenj.

Ungjijtë përmbajnë diskutime të mëdha ndërmjet Jezusit e kundërshtarve të tij rreth mënyrës së drejtë për ta mbajtur ditën e shtunë dhe për vlerën e ceremonive judease. Për lexuesin judeas të shekullit të parë, këto kanë qenë të rëndësishme. Të krishterët paganë të shekullit të dytë nuk do ta kishin kuptuar as nuk do t'ju kishte interesuar se çfarë diskutimesh janë zhvilluar. Falsifikuesi do ta kishte shpjeguar kuptimin e hajmalive, të dhjetën pjesë të kishës, pastërtinë e judenjve, kush ishin farisenjtë e saducenjtë, etj. Por autorët e ungjijve e marrin këtë si gjë të vetëkuptueshme, sepse ata shkruan shumë herët dhe shënuan ngjarjet e jetës së Jezusit saktësisht ashtu si ndodhën.

Askund në Besëlidhjen e Re nuk gjejmë gjurmë më të vogla të ndonjë kisha në fshat. Krishterimi ka qenë në radhë të parë dukuri qytetare. Pse atëherë falsifikuesit kanë vënë në gojë të Jezusit aluzione për jetën fshatare, për zogjtë, lulet dhe bujqësinë?

Në këtë shekull njohim specialistë për falsifikime. Në një rast kanë vizatuar kurorën e shenjtë rreth një njeriu të cilin më vonë ata vetë e paraqesin si kriminel. Falsifikuesit janë të aftë. Po të kishin qenë falsifikues ungjilltarët, nuk do të kishin bërë asi gabime trashanike, as nuk do t'ia kishin dalur që librat e tyre t'u pranohen si të shenjta.

Një hollësi të Ungjillit që vërteton saktësinë historike, si dhe kohën e tij, e gjejmë në Ungjillin e Gjonit 19:34. Na tregon se njëri prej ushtarëve me heshtë ia shporoi kraharorin Zotit tonë të kryqëzuar, «dhe menjëherë rrodhi gjak e ujë». Arsyeya nuk është dhënë. Por ungjilltari Gjon ka qenë dëshmitar i ngjarjes, dhe shkruan se ai vetë e ka parë. As ai as kurrkush tjetër në atë kohë nuk dinte të shpjegonte se ç'ngjau. Vetëm pas tetëmbëdhjetë she-

kujsh Doktor Simson zbuluesi i kloroformit, tregoi se Jezu Krishti vdiq nga ajo që në gjuhën e shkencës quhet ekstrasacioni i gjakut, ose në gjuhën tonë, vdiq zemërplasar. Kur dikush vdes në këtë mënyrë, duart i largohen nga trupi (natyrisht, Jezusi duart i kishte të shtrira në kryq); lëshon një klithmë të madhe, ashtu si Jezusi; dhe gjaku ikën në qesen e zembrës dhe ia ndalon të rrahurat zembrës. Gjaku qëndron aty për një kohë të shkurtë; e ndan serumin (ujin) dhe mpiks (rruazat e kuqe në gjak). Kur ushtari ia shporoi kraharorin (qesen e zembrës), atëherë rrodhi gjak e ujë.

A mund të besohet se një shkrimtar do ta kishte trilluar një tregim me fakte që kurrë nuk kanë ndodhur, por për të cilat do të mund të jepej një sqarim i përpiktë shkençor, që do t'i kishte vërtetuar saktësisht faktet, gati edhe pas dy mijë vjetësh?

Tregimi se Ungjilli është trillim i mëvonshëm është vetë trillim i mëvonshëm.

A është e besueshme se një person mitik, që nuk ka ekzistuar fare, të jetë themelues i qytetërimit të krishterë, qytetarët e të cilit ia kalojnë në numër silëndo perandori tokësore?

Asnjë perandori nuk ka ekzistuar për dy mijë vjet si perandoria krishtere, që ka mbijetuar persekutime, urrejtje e shkretëtime njëzet shekulle.

Krishterimi është fakti më i madh në botë — dhe ky fakt, më i madhi, u krijua nga një person që nuk ka ekzistuar?

Rrenë e kulluar! Kush mund të besojë gjëra të tilla?

Gjon Stjuart Mill shkruan: «Nuk ka vlerë të thuhet se Krishti, ashtu si na paraqitet në Ungjill, nuk është historik. Kush prej nxënësve të tij, ose prej të kthyerve në besim ishte i aftë për t'i trilluar mësimet që i atribuohen Jezusit ose të përfytyrojë jetën dhe karakterin që na paraqitet në Ungjill? Pa dyshim se nuk ishin peshkatarët e Galileës dhe nuk ka dyshim as për shën Palin.»

Kush ka mundur ta trillojë personalitetin e Jezusit — jo vetëm mirësinë e urtësinë e tij, por edhe gjeniumin e tij për t'ia dalur me njerëz dhe me problemet e tyre, aftësitë e zgjuarsitë e tij si ungjilltar?

E pra kush do të kishte qenë trilluesi i Jezusit? Judenjtë nuk kanë mundur ta trillojnë, sepse në shekullin e parë monoteizmi ishte i ngulitur aq shumë në ta sa kurrë nuk do ta trillonin një njeri që e paraqet mishërimin e Perëndisë së tyre të padukshëm.

Judenjtë i përbuznin popujt e tjerë. Ata nuk pinin ujë nga dora e samaritanit, kështu që ata me siguri nuk e kanë trilluar Jezusin, i cili miqësohej me të huajt. Jude-njtë besonin për vete se janë populli i zgjedhur. Pse ta trillonin dikë që i shuante të gjitha dallimet në popujt dhe i pranonte të gjithë njësoj?

As të krishterët e parë nuk kanë mundur ta trillojnë Jezusin.

E shohim prej fillimit se larg prej asaj që nuk kanë mundur ta trillojnë Jezusin, por vetëm kanë mundur t'ia prishin emrin e tij të mirë.

Shën Pali shkruan se në kohën e tij shumica e predikuesve predikonin nga dëshira, lakmia, dëshira për famë, nga motivet vetjake, kështu e shtrembëronin fjalën e Zotit. Predikuesit lakmues dhe egoistë nuk mund ta trillojnë Jezusin.

Bile edhe nëse ia kanë arritur ta trillojnë një Zot të mishëruar, kurrë nuk do ta kishin trilluar si judeas, njeri që i takon kombit të përbuzur, një zdruckthëtar, një njeri të pashkolluar, që u lind në grazhd dhe vdiq në kryq dhe që nuk ka lënë asnjë fjalë të shkruar pas vetes.

Gjëra të tilla nuk mund të trillohen.

Lidhur me tri pyetjet e djallit kur e tundoj Jezusin në shkretirë «Nëse je Biri i Hyjit, urdhëro që këta gurë të shndërrohen në bukë — Nëse je Biri i Hyjit, hidhu poshtë, (nga maja e Tempullit) sepse Shkrimi i Shenjtë thotë: Për ty Hyji do t'u urdhërojë engjëjve të vet, dhe ata

do të mbajnë para duarsh, që këmba jote të mos vritet në ndonjë gurë — (të gjitha mbretëritë e kësaj bote dhe madhëritë e tyre) të gjitha këto do t'i jap nëse bie përmbys para meje e më adhuron», Dostojevski në «Vëllezërit Karamazov» shkruan:

«Në qoftë se ndonjëherë në tokë ka ndodhur një mrekulli e madhe, atëherë ajo ka qenë në ditën e tri tundi-meve. Vetë deklarata e këtyre tri pyetjeve është mrekulli. Po të ishte e mundur të marrim me mend vetëm si she-bull që këto tri pyetje të shpirtit të keq janë zhdukur krejtësisht nga librat dhe se ne duhet t'i kthejmë e t'i trillojmë përsëri dhe për të bërë ashtu janë mbledhur të gjithë dijetarët e kësaj bote — udhëheqësit, kryetarët, njerëzit e shkolluar, filozofët, poetët — dhe ua kanë vënë për detyrë për t'i trilluar tri pyetje të cilat do t'i përshatëshin rastit, t'i shprehin në tri fjalë, në tri shprehje njerëzore, tërë ardhmeninë e botës dhe të njerëzimit — beso se krejt dija e botës e bashkuar nuk do të kishte mundur të trillojë asgjë të barabartë në thellësi e forcë me këto tri pyetje që t'u kanë bërë ty në shkreti nga shpirti i dijes dhe i plotfuqishëm? Vetëm nga këto pyetje, nga mrekullia e deklaratës, shohim se këtu nuk kemi të bëjmë me intelektin kalimtar të njerëzimit, por me atë që është i amshueshëm dhe absolut.»

Ingersolli, shkrimtar i njohur ateist, thotë kështu për Jezusin: «Me Renanin, besoj se Krishti ka qenë i vetmi njeri i përkryer. 'Gjithçka dëshironi t'ju bëjnë juve njerëzit, bëni edhe ju atyre' është përsosuria e fesë dhe e moralit. Kjo është e mira kryesore. Kjo është më e lartë se mësimi i Sokratit, Platonit, Muhametit, Moisiut, ose Konfuqës. Kjo zëvendëson urdhëresat për të cilat Moisiu thotë se i mori prej Perëndisë, sepse me këtë thënie të Krishtit 'Gjithçka dëshironi t'ju bëjnë juve' nuk do të kishte pasur vrasje, rrena, lakmi, luftra.»

Njeriu i përkryer nuk mund të trillohet nga apostujt e papërkryer.

Argumentet kundër origjinës së hershme të ungjijve

Mos të bëhemi të padrejtë. Paraqitem aq shumë argumente tonat sa që gati t'i harrojmë argumentet e rëndësishme të akademikëve kundër origjinës së hershme të ungjijve. Ato janë tri:

(1) Ungjijtë shkruajnë për dëbimin e tregtarëve nga Tempulli. «Por në atë Tempull nuk ka pasur tregti.» Pse doktorët ateistë e dinë këtë e nuk e thonë? Por do të citojmë nga Talmudi, që natyrisht është pranuar nga judenjtë dhe ka pasur autoritet më të lartë në punën e vet se kundërshtarët e mi. Në vepren «Shabbat», faqe 15a, thotë se pesëdhjehjet para rrënimit të Tempullit, që d.m.th. pikërisht gjatë jetës së Jezusit, ka pasur dyqane në të.

(2) «Bibla flet për një tufë derrash, 2.000 sish, në krahinën e Gadarës në Palestinë. Por rritja e derrave ka qenë e ndaluar për judenjtë që nga koha e Besëlidhjes së Vjetër. Prandaj, në Palestinë nuk kanë mundur të ekzistojnë tufa derrash.»

Çfarë mendimi ke ti, i dashur lexues, rreth konkludimit të këtij argumenti? Mos i nënvlerëso! Fjalën e kanë akademikët! Në vendin tonë nuk mund të ketë kriminalitet sepse ligji e ndalon atë. Nuk mund të ketë grindje ndërmjet komunistëve kinezë, rusë e jugosllavë sepse proletariati ndërkombëtar nuk e lejon atë. A ju duken këto çështje të besueshme?

Për më tepër, akademia e Moskës duhet të ketë një sektor të gjeografisë, i cili e di se Gadara ka qenë në Perea, në lindje të Jordanit, rajon që nuk i takonte krejtësisht Palestinës dhe nuk ishte i banuar vetëm me judenj.

(3) Autorët e ungjijve nuk kanë mundur të jenë judenj sepse nuk i përmendin kafshët që janë rritur në Palestinë në atë kohë, siç ishin: macet e egra, çakejtë dhe panterat.

Edhe një argument tjetër bindës!

E njëjta gjë më bën të mendoj se *Libri ateist* nuk është shkruar në Bashkimin Sovjetik sepse morrat, tartabiqet dhe minjtë e gjirizeve nuk përmenden në të. Por e di se sa shumë vuajten të krishterët në burg për shkak të këtyre, në vitet e para të terrorit.

Kam qenë i drejtë me kundërshtarët e mi. I kam marrë parasysh edhe argumentet e tyre për ungjijtë, jo vetëm të miat. Mbetet që lexuesi ta gjykojë vlerën e tyre krahasuesë.

Porosia e Besëlidhjes së Re

Kritikat që janë bërë kundër Besëlidhjes së Re, se është fantazmagorike e falsifikim i vonshëm, janë të pabaza.

Por nëse është ashtu, pse janë bërë, pra?

Ta zëmë se Besëlidhja e Re është libër i keq: atëherë pse janë shkruar 700 faqe për ta përgenjështuar? Për çdo vit në Bashkimin Sovjetik dalin libra të mirë e të këqij — nganjëherë shumë të këqij. Askush nuk vazhdon të luftojë me dekada kundër një libri të keq. Lexuesit vetë i lënë anash ato. Vija e Partisë Komuniste vazhdon të ndryshojë. Librat që janë konsideruar të mira papritmas ndalohen. Para njëzet vjetësh kush ka guxuar të ketë bibliotekë pa i pasur librat e gjeniut të madh Stalinit? Por një ditë erdhi urdhëri. Librat u zhdukën. Askush nuk i përgenjështroi. U dogjen në heshtje sikur të mos ishin shkruar kurrë. Pastaj Krushovi filloi të botojë përmbledhje të artikujve dhe fjalimeve të veta më modeste, të redaktuara mirë, kështu që të mos ia kujtojë lexuesit se edhe ai ka qenë njëri prej lajkaterëve të Stalinit. Gjithashtu edhe këto libra u zhdukën pa përgenjështime. Askush nuk i përgenjështon dhjetë vëllimet e Trotskit.

Pse është kjo luftë kundër Besëlidhjes së Re, e kritikojnë, e shqyejnë copë-copë, ndërkaq popullit sovjetik i është ndaluar ta ketë një kopje të saj, nga e cila do të mund ta formonin mendimin e vet?

Besimet duhet të varen nga faktet e hapura për shqyrtim. Atë që nënkupton shkenca nuk është rëndësi aq e madhe e ndonjë të vërtete të posaçme sa e drejta për ta kërkuar të vërtetën dhe për ta përhapur vlerën e saj pa u penguar.

Atëherë pse ua ndaloni Dhiatën e Re njerëzve?

Sepse ungjijtë dhe Besëlidhja e Re në tërësi përmbajnë mesazhin me rëndësi tejet të madhe për secilin njeri.

A mund ta merrni me mend një darkë të gatuar mirë pa gjellëbërës? Por natyra është gostia. Natyra e rrit grurin, misrin, pataten dhe shumë lloje të pemëve. Në natyrë ekziston dielli e shiu, lule të bukura e cicërimat e hare-shme zogjve. Ka gjëra të dobishme e të bukura, që ta kënaqin trupin e shpirtin. Kush është gjellëbërësi i gostisë së natyrës? Është Krijuesi i urtë, Perëndia.

Thuhet për një shkencëtar se kur kthehej në shtëpi nga laborator, gruaja e thirri për të ngrënë darkë. Ia vuri sallatën para. Duke qenë ateist, ai tha: «Nëse gjethet e marules, kokrrat e kripës, pikat e uthullës e vajit dhe thelat e vezëve pluskojnë në ajër që nga amshueshmëria, mund të ndodhë që të paktën rastësisht do të ketë sallatë.» «Po», përgjigji gruaja, «por jo aq të bukura dhe të përgatitura mirë si të miat.» Atomet që bashkohen rastësisht nuk e krijojnë një gjithësi aq të bukur.

Atomi është misterioz. Jeta është misterioze. Shkencëtarët janë larg nga zbulimi i sekreteve të tyre. Atëherë, Perëndia, krijuesi i materies dhe i jetës është shumë më misterioz. Ungjilli sipas Gjonit thotë: «Askush s'e pa Perëndinë.» Kur Moisiu iu lut: «Më lejo të shoh dritën vërbuese të pranisë sate», mori përgjigje të prerë: «Nuk lejoj që të shohësh fytyrën time, sepse askush nuk mund të më shohë e të mbetet gjallë.» Asnjë filozof nuk mund ta kup-

tojë, por edhe njeriu më i thjeshtë e ndien, pikërisht ashtu si asnjë shkencëtar që nuk i kupton sekretet e atomit, por çdo kush mund t'i përdorë gjërat e përbëra nga atomet.

Besëlidhja e Re na tregon për këtë Perëndi, sikundër edhe vetë natyra.

Një herë bisedova me një oficer të burgut, anëtar i Partisë komuniste. Në mirëbesim më tha një herë: «Një ditë vjeshte shikova prej dritarës një pemë të thatë. E dija se në pranverë përsëri do të jetë plot me gjethe e me sythe të reja dhe me zogj që do të cicërojnë në degë. Pastaj e adhurova 'nuk e di kush është ai' as 'çka është ai' që m'i jep pemët, grurin e lulet. Fus qymyr në zjarr e zjarri e shndërron atë në flakë të bukur. Unë e adhuroj Fuqinë ose Personin — nuk e di kush është as çka është ai — që na shpërblen të keqen me të mirë dhe nganjëherë i kthen njerëzit prej një banditi bën njeri të mirë dhe martir për shkaqe shenjtërore. Kam takuar njerëz të tillë në mesin e ju të krishterëve.» Ky oficer komunist nuk e kishte kuptuar Perëndinë, por ai e kishte ndier atë.

Autorët e *Librit ateist* e kanë lehtë t'i përqeshin konceptet primitive për Perëndinë, siç i shohin nëpër ikona: një plak me mjekërr të bardhë ulur në fron.

Të krishterët i mësojnë fëmijët me metodat fëmijnore për Perëndinë. Shumë prej tyre, kur të rritën, nuk arrinë t'i plotësojnë urdhrat biblik për t'i larguar gjërat fëmijnore. Ata mbeten me këto koncepte fëmijnore, të cilat lehtë mund të përqeshën nga ana e ateistëve. Por Perëndia është ndryshe nga konceptet e tyre të papjekura.

Këto imazhe të ikoneve sigurisht nuk janë më qesharake se imazhet e atomit të vizatuara nga fizikani i famshëm Niels Bor. Atomi është ndryshe nga ajo që ne e vizatojmë, gjithashtu edhe Perëndia është ndryshe nga ajo që ne e mendojmë. Por shkenca nuk mund të bëjë pa përngjasime. Po ashtu edhe ne të krishterët përdorim shprehjet njerëzore dhe vizatime njerëzore për t'i shprehur ndjenjat tona për Perëndinë.

Por shën Tom Akuinasi, njëri nga mësuesit tanë më të mëdhenj, shkruan: «Perëndia nuk është çka përfytyrojmë, mendojmë e kuptojmë. Nëse e kupton, je mashtruar.» Mendja jonë është tepër e vogël për ta përfshirë Qenien e Pakufishme, por — si thashë — ne mund ta ndiejmë.

Një i krishterë një herë e pyeti një ateist, me të cilin ecte nëpër livadh: «Kush i ka krijuar të gjitha këto lule të bukura?» «Harro këtë!» — iu përgjigj ateisti. «Mos ia fillo përsëri me bisedën tënde të marrë për Perëndinë. Lulët ekzistojnë vetvetiu.» I krishteri u tërhoq. Pas pak ditësh i njëjti ateist e vizitoi atë në shtëpi. Në dhomën e ndejes kishte një pikturë të bukur të luleve. Ateisti e pyeti: «Kush e ka vizatuar këtë?» I krishteri iu përgjigj: «Mos ia fillo me marrëzitë e fesë! Askush nuk i ka vizatuar lulet. Ato vetë kanë hyrë në pikturë. Natyra e ka krijuar kornizën e gdhendur. Atëherë vetvetiu piktura kërceu në mur, në një gozhdë e cila rastësisht ndodhej atje, pa e ngulur askush. Kjo është e tëra.» Ateisti e mori për keq shakanë. Por i krishteri e pyeti: «A është e logjikshme të besohet se këto tri lule në pikturë, që nuk kanë aromë as jetë, janë krijuar prej dikujt, ndërsa të besohet për miliona lule të vërteta me aromë mahnitëse që janë nëpër luginë e kodra se nuk kanë Krijues?»

Perëndia është mister. Jezusi na mëson të themi: «Ati ynë që je në qiell», e jo «Ati ynë që ecën rrugëve e mund ta takojë çdo kush në çdo qoshe.» Ai është i padukshëm në këtë botë.

Nëse e ngjesh fluturën për një dërrasë do ta mbytësh. Ajo nuk është më flutur, por kufomë. Kështu nuk mund ta kapim Perëndinë me ndonjë definicion. I ngjesim emra për të cilët e dimë se nuk janë adekuat. Krejt çka mund të themi për të është se ai është përtej çdo gjëje tjetër që mund të merret me mend.

Por Perëndia na është shfaqur në personin Jezu Krisht, Birin e Perëndisë, i cili erdhi në këtë botë. Për të flet Be-sëlidhja e Re. Ai ua ka ndryshuar jetën miliona njerëzve.

Është i gabuar pohimi i *Librit të ateistëve* se mësimet e Krishtit prishin gëzimin e jetës. Heqja dorë nga gëzimi është jo-krishterim. Mohimi i gëzimit është mohimi i asaj çka ne të krishterët e konsiderojmë krijimin e Perëndisë. Pse ta mohojmë atë çka Ati i mirë na ka dhënë? Besëlidhja e Vjetër na tregon se njeriu mund të hiqte dorë nga kënaqësitë e kësaj bote për një kohë të shkurtër. Kur përfundonte kjo kohë, duhej t'i sjellte një fli Perëndisë si simbol i larjes së mëkatit për mospërfilljen e dhu-ratës së mrekullueshme të Perëndisë: kënaqësinë. Krishterimi nuk ia ndalon askujt gëzimin. Në të kundërtën, krishterimi gëzimeve të kësaj bote ua shton edhe ato qie-llore. Çfarë kënaqësie tjetër më të madhe ka se dashuria?

Mos prano asnjë gënjeshtër të pabazë që po na ngarko-het neve, sidomos kur autorët krishterë nuk janë të lejuar të përgjigjen. Vetë fakti se ateistët na detyrojnë të hesh-tim ndërsa vetë shkruajnë tregon se ata janë të padrejtë, prandaj nuk mund t'u besohet.

Mbështete besimin në Perëndinë! — Perëndia vuan bashkë me ne. Ai merr pjesë në të gjitha pikëllimet tona. Ai e ka flijuar veten për ne. Ai na do ne.

Marks-i dhe materializmi historik i kanë hequr reali-tetit shpirtit, Perëndinë, e në këtë mënyrë e kanë shkretuar atë.

Dija e Perëndisë është çelës për ta njohur botën the-llësisht. Ne nuk kemi realitet plus Perëndi, por realitet të veshur me bukurinë e Perëndisë. Njësoj, sikur në pikturë që nuk kemi një dekor me perëndim të diellit, por kodrat, luginat, drurët që shkëlqejnë në dritën e tij.

Në disa shpella në Tajlandë janë gjetur vizatime para-historike që i paraqesin njerëzit e peshqit për të cilat thu-het se janë në «formë të rrezeve X». Artisti jo më pak se para tre mijë vjetësh i paraqet hollësitë që ai nuk ka mundur t'i shohë, por që ka qenë në dijeni për ekzisten-cen e tyre. Kur e vizaton njeriun ose kafshën, ai e përf-shin edhe skeletin e organet tjera, si: zemrën, mushkëritë

etj. Vizatime të tilla janë gjetur më herët në mesin e vendësve të Australisë.

Ne e konsiderojmë këtë art si primitiv. Nuk është i bukur si arti ynë sot, por është më afër realitetit. Në galerinë e portreteve atë që shohim të portretizuar nuk është në radhë të parë vetë subjekti por më tepër rrobat e prera nga rrobaqepësi. Nga subjekti shohim vetëm fytyrën dhe duart. Nëse ekspozohen figura lakuriqe, e shohim lëkurën. Jemi fare pak të kënaqur me këtë. Artisti primitiv e ka dashur më shumë realitetin, sepse në njëfarë kuptimi ai ka qenë më afër realitetit se sa ne sot, që e shtrembërojmë atë.

Besëlidhja e Re flet për botën dhe jetën në të njëjtën mënyrë si rrezet X që janë të padukshme. Materialistët shohin vetëm anën e jashtme të gjërave. Besimtarët shohin anën e jashtme, por gjithashtu edhe atë që i jep gjallëri botës e jetës, të brendshmën, Perëndinë duke vepruar në krijesën e tij dhe duke e rregulluar veten si dashuri në vepër.

Perëndia e dërgoi Birin e vet, Jezu Krishtin, për ne. Ashtu si bukëpjekësi që kujdeset për bukë e bujku për pemë, si këpucëtari që ju furnizon me këpucë, si profesori që ju zhduk paditurinë e ju jep dituri të grumbulluar gjatë shekujve, ashtu Jezusi, Biri i Perëndisë, i vetmi që nuk ka bërë kurrë mëkate, i mori mbi vete mëkatet për t'u kujdesur për ty. Ai të jepë drejtësinë e vet. Bëhesh si një foshnjë e lindur sërish, si njeri që kurrë nuk ka bërë mëkat. Fillon jeta e re në bashkësi me Perëndinë. Sa i përket mëkateve të tua, ai i ka marrë ato mbi vete.

Ndihesh se mëkatet kanë qenë shumë të rënda. Ato kanë bërë të vuajnë edhe të tjerët. Ndoshta janë derdhur lot e gjak për të cilët je fajtor. Jezusi nuk ka bartur vetëm mëkatet e tua, por ka bartur gjithashtu edhe dënimin për mëkatet tua. Ai e merr dënimin tënd, kur vdes në kryq në malin e quajtur Golgota afër Jeruzalemit. Plagët e tij na shërojnë ne.

Besëlidhja e Re thotë: «Vërtet, Perëndia aq fort e deshi botën sa që e dha një të vetmin Birin e vet kështu që, secili që beson në të, mos të humbë, por ta ketë jetën e pasosur» (Gjoni 3:16). Vëreje fjalën «secili», qoftë edhe autori i *Librit ateist*, kushdo; qofshin ata edhe njerëzit që kanë bërë krimet më të mëdha.

Besëlidhja e Re na mëson se Jezusi qëndron para derës dhe troket. Nëse dikush e dëgjon zërin e tij dhe e hap derën, Jezusi do të hyjë tek ai e t'i flasë zemrës tij.

Jeta nuk përbëhet vetëm nga puna për shtetin, haja, pija dhe kënaqësia seksuale. Krishti është qenie shpirtërore. Ai dëshiron të të ndihmojë ta mposhtësh mëkatën, vdekjen, ferrin dhe vetëm pret për vendimin tënd. Dhe ai jo vetëm që premtan parajsën në të ardhmen, por një jetë të shenjtë në shpirtin tënd që nga ky çast.

Besëlidhja e Re na tregon se Jezusi, Biri Perëndisë, i do aq shumë njerëzit sa që u lut edhe për vrasësit e vet ndërsa duronte dembjet në kryq. Ndoshta ti je hajdut. Jezusi ka vdekur në mes hajdutëve dhe ndërsa rrinte varur në kryq, e shpëtoi njërin sish, që u pendua, për parajsë. Jezusi nuk ka ikur nga njerëzit e këqij e të pandershëm. Ka qenë gëzimi më i madh për të kur janë falur krime të mëdha.

Ateistët e nënçmojnë Besëlidhjen e Re, sepse ajo e tregon dashurinë si parim udhëzues në jetë dhe zemrës ia bën vendin në parajsë. Mendja fillon të funksionojë drejt, ngase gabimet në jetë shpesh nuk janë asgjë më pak se mungesë e dashurisë. Mbas të shikosh një herë me seriozitet në pasqyrën e së vërtetës, që është Krishti, shpirti yt do të mbushet me dhembshuri të madhe ndaj njerëzimit dhe do të jesh mrekullisht i lirë.

Populli sovjetik nuk është lejuar të mësojë për mesazhin e Besëlidhjes së Re, sepse ai do t'i bashkonte me Perëndinë. Prandaj, sulmojnë ahpër por pa bazë. Por e kemi lehtë ne të krishterët, që dimë për realitetin e mëkatit dhe faljen e mëkatit, ta kuptojmë pse miqtë tanë ateistë

dridhen para kryqit madje edhe shkruajnë librin me 700 faqe kundër tij. Me një intuitë të padëshirueshme ateistët ndiejnë se Bibla mban të vërtetën përfundimtare.

Stalini ka vdekur, asnjë komunist nuk do të këndojë kurrë këngën: «Stalini, i dashuri i shpirtit tim»; ashtu siç nuk do të dojë të këndojë: «Krushovi më i dashuri im»; madje as pasardhësi e tij pas një shekulli nuk do t'i këndojnë Brezhnjeviti: «Kemi nevojë për ty për çdo çast.»

Mirëpo për Jezusin këndohet nëpër tërë botën gati që dy mijë vjet pas kryqëzimit.

Të përpiqen sa të duan, komunistët kurrë nuk do t'ia arrinë t'i bëjnë të heshtin këto këngë në nënën e shenjtë Rusi!

Për ta nuk do të këndohet asnjë këngë.

Tashmë po shihet se shakatë që dëgjojmë për ta tregojnë se çfarë fame do të kenë në të ardhmen.

Në botë ka shumë pikëllim. Botës i nevojitet qeshja. Kënaqem shumë kur i shoh njerëzit të gëzuar dhe nuk më pengon nëse qeshin në llogari timen. Shpresoj se edhe kundërshtarët e mi kanë të njëjtat ndjenja dhe se nuk do ta marrin për të keq nëse iu tregoj nja dy shaka që po qarkullojnë nëpër Rusi.

E para: Profesori gjatë orës së historisë e pyet një nxënës të shkollës së mesme: «Kush ka qenë Stalini?» Ai përgjigjet: «Një njeri që, duke e dashur kultin e personalitetit të vet, u bë vrasës. I ka vrarë edhe shokët e vet më të ngushtë. Ky është mësimi për të në Kongresin e njëzet të Partisë sonë.» — «Të lumtë», i thotë profesori. «Tash, përgjigju kush është Krushovi?»

Djaloshi iu përgjigj menjëherë: «Krushovi ka qenë një idiot, me të drejtë u largua nga kryesia me votat e Komitetit Qendror.» — «Fort bukur. Tash pyetja e fundit: Kush është Brezhnjeviti?» — «Edhe ai është idiot», u përgjigj nxënësi.

Profesori e ndërpreu e i tha: «Ndoshta kjo do të jetë e vërtetë edhe një vit ose dy, kur të merret një vendim për-

katës. Tash për tash ai është kryetar gjenial, dhe më duhet të të jap notë të dobët.»

Shakaja e dytë: Në një shkollë mësuesi u thotë fëmijëve: «Partia është babai ynë, ndërsa Armata e Kuqe është nëna.» Pastaj e pyeti një fëmijë: «Çka dëshiron të bëhesh?» Fëmija iu përgjigj: «Jetim.»

Disa njerëz e duan Jezusin, të tjerët e urrejnë. Shumë janë indiferent ndaj mesazhit të tij. Por askush nuk ka guxuar të bëjë shaka të këqija për të.

Sulme të parespektueshme kundër Biblës

Nga kritika e Besëlidhjes së Re, Libri ateist kalon në kritikën e tërë Biblës.

Na vjen keq se edhe këtu sulmet janë vulgare e të cekta. Ndryshe i kemi pritur. Ka edhe mënyra të lehta e fisnike të shprehjes së mosbesimit.

Për shëmbull, i tillë është ateizmi i Ludvig Fojerbahut. Ai nuk ka besuar në Perëndinë por dëshironte ta mbante fenë, që e bën njeriun të ndershëm, të dashur dhe të drejtë. Fojerbahu (Esenca e Krishterimit, vëll. II) e quan fenë «të shenjtë» sepse është «tradita e njerëzve të parë të ndërgjegjshëm», që për të do të thoshte fëmijëri. A nuk është bukur t'i mbash kujtimet e periudhës së fëmijërisë së njerëzimit, pyet ai?

Jezusi nuk do të kishte kundërshtuar nëse e quajmë fenë fëmijërore. Ai na mëson të bëhemi si fëmijët e vegjël. Ne të gjithë i çojmë kujtimet e fëmijërisë. Pse t'i hedhim brutalisht siç veprojnë komunistët? Ndoshta bëjnë ashtu sepse ata kujtohen në një kohë kur shpirtrat e tyre kanë qenë më të mirë se tash?

Ju rekomandojmë kundërshtarëve tanë të lexojnë «Meshën e ateistëve» nga Honore de Balzaku. Personazhi kryesor është kirurgu ateist, Deplen. Kur ka qenë student i varfër dhe i uritur, një ujëmbartës që quhej Burzha, i

frymëzuar nga dashuria krishtere, i kishte ndihmuar, përmes punës së vështirë dhe sakrificave personale, për t'i kryer studimet, dhe kështu Depleni u bë mjek i famshëm.

Tash Depleni e mohon besimin. Por kur Burzha iu lut nga shtrati i vdekjes të lutej për shpirtin e tij, profesori ateist, i shtyrë nga mirënjohja, pranoi t'ja plotësonte dëshirën. Prej aty e tutje, ai rregullisht lutej për katolikun e ndjerë që i kishte bërë mirë.

Po përpiqemi të tregojmë mirëkuptim për ateistët, por ndiejmë se kemi të drejtë të presim nga ateistët e kulturuar ta pranojnë se kultura e tyre varet nga Bibla dhe të jenë të paktën të denjë në sulmet e tyre.

Fridrih Niçe që i pari që deklaroi se «Perëndia ka vdekur». Ai ka qenë filozofi më i dashur i Hitlerit. Hitleri nxori përfundime të drejta. Po të kishte vdekur Perëndia, ai, Hitleri, nuk ka pasur nevojë për skrupuj rreth vrasjes së miliona njerëzve dhe fëmijëve të pafajshëm. Por Niçe nuk kishte asgjë të përbashkët me nxënësin e tij të ardhshëm. Niçe fliste për vdekjen e Perëndisë me frikë të shenjtë. Marrëzia e tij, pas shpalljes së vdekjes së Perëndisë, shkon nëpër kisha të ndryshme e këndon: «Requiem aeternam Deo», himni për vajtimin e Perëndisë. Për Niçën, Perëndia kishte vdekur. Për të ky konkluzion ishte pikënisje e dramës së tij të madhe. Por mund të shihet se me të vërtetë i erdhi keq se perëndia i tij nuk jetonte më.

Me autorët e *Librit ateist*, çështja qëndron ndryshe. Gëzohen për vdekjen e Perëndisë. Tash ata nuk brengosen më për ndërgjegjen, të vërtetën dhe dashurinë. Mund të bëjnë çka të duan.

Ateizmi është i padenjë.

R. Garodi, një kohë anëtar i Komitetit Qendror i Partisë Komuniste të Francës, shkruan: «Nuk mund ta hedhim poshtë kontributin themelor të krishterimit pa u varfëruar» (Prej anatemës deri në dialog).

Lunaçarski, një kohë ministër i arsimit në qeverinë Sovjetike, shkruan: «Nocioni për Perëndinë gjithmonë

përmban diçka të bukur të përjetshme ... Vuajtja gjithmonë banon në njeriun. Ai që nuk di ta kuptojë botën me anë të besimit është i dënuar në pesimizëm...»

Ateistët komunistë e fillojnë historinë e mendimit të drejtë me vetveten, që u sjell pasoja katastrofike. Ata përfundojnë duke mos përfillur ose duke kërkuar ta zhdukin të vërtetën që e ka përvetësuar njerëzimi gjatë zhvillimit mijërvjeçar.

Si rrjedhim, ata bëjnë një karikaturë për fenë. Ndiejmë keqardhje për këtë. Karikaturat gjithmonë janë të rrezikshme për ata që i vizatojnë.

Një e re një herë bisedoi me satirikun e njohur Hogarthin ndërsa ai bënte një vizatim. Ajo shprehu dëshirën për të mësuar vizatimin e karikaturave, të cilës Hogarthi iu përgjigj: «E mjera ti, vajzo, ky nuk është fakulteti t'ia kesh zili. Dëgjoje këshillën time e kurrë mos vizato karikatura. Duke e praktikuar shumë karikaturën, kam humbur kënaqësinë e bukurisë. Asnjëherë nuk shoh fytyra të drejta por gjithmonë të shtrembëruara. Kurrë nuk kam kënaqësinë të shoh fytyrën njerëzore të hyjnueshme.»

Ata që bëjnë karikatura të fesë janë në të njëjtën situatë. Në pasqyrën e shtrembëruar të trurit të deformuar, edhe engjëjt i duken se i kanë tiparet e djallit.

Ata nuk e dinë se nëse e lënë anash Biblën si libër të pavlefshëm, e tërë letërsia e famshme e botës do të dështojë bashkë me të. Çka do të kishte mbetur prej Dostojevskit, Tolstoit, Miltonit, Gjon Banjanit, Uolltër Skotit dhe Anatali Francës? Tenisoni ka thënë se libri i Jobit ka qenë poema më e mirë që ka lexuar ndonjëherë. Në veprat e tij ka treqind citate prej Biblës. Shekspiri ka përdorur mbi pesëqind ide dhe shprehje të marra prej Biblës. Bajroni në poemën e tij «Errësira» është frymëzuar nga libri i Jeremisë.

Bile edhe «Kapitali» i Marksit do të kishte ndryshuar bashkë me shkrimet tjera, edhe ato të Engelsit, sepse ata janë të mbushura plot me referime për Biblën.

Nëse e hedhim poshtë Biblën, veprat e Mikelangjelos, Rafaelit, Leonardo da Vinçit, Rembrantit dhe shumë piktorë tjerë të famshëm të botës do ishin të pakuptueshëm, ashtu siç do të ishin edhe veprat e mëdha muzikore të Bahut, Betovenit, Mocartit, Hajdenit, Brahmsit e të tjerëve.

Dëgjoni dëshminë e njerëzve të famshëm.

Uiliam Gledstoun, katër herë kryeministër i Britanisë së Madhe, pat thënë: «Po të më pyeste dikush për ilaçin e zemrës së vuajtur të njeriut, në çka duhet të shikojë njeriu për të përparuar si forcë që i jep zemër në vështirësitë dhe që e aftëson të ballafaqohet me pikëllimin e pashmangshëm, do t'i tregoja diçka që në një himn të mirënjohur quhet 'Tregimi shumë i vjetër' i shënuar në një libër të vjetër, që është dhurata më e madhe dhe më e mirë që i është dhënë ndonjëherë njerëzimit.» Me këtë i referohej Biblës.

Zhan Zhak Ruso shkruan: «Sa të ulëta, sa mosbindëse janë shprehjet e filozofëve me të gjitha kundërtëhëniet e tyre, në krahasim me Biblën. A është e mundur që një libër të jetë njëkohësisht aq i thjeshtë dhe aq madhështor e të jetë vetëm nga fjalët njeriut?»

Gëte shkruan: «Sa më shumë ta kuptosh Biblën, aq më e bukur bëhet ajo.»

Hajnrih Hajne, që ishte shumë larg për të qenë entuziast fetar, shkruan: «...Thellësia e krijimit e shkruar në qiellin e kaltër misterioz, lindja e perëndimi i diellit, premtimet e plotësimet, lindja e vdekja, e tërë drama njerëzore, gjithçka është në këtë libër. Bibla është libër mbi libra.»

Gjuha angleze dhe gjermane në njëfarë mënyre të veçantë nuk do të kishin qenë ashtu si janë sikur të mos kishin pasur ndikim nga Bibla. Bibla është i vetmi libër që u ka dhënë shtysë me qindra popujve e fiseve për alfabetin e parë. Me anë të mundit të njerëzve të devotshëm, ky është libri i parë që mësuan ta lexojnë.

Garibaldi, patriot italian i cili politikisht e çliroi dhe e bashkoi atdheun e vet (që e kreu këtë vepër më 1870) thotë për Biblën: «Ky është topi që do ta çlirojë Italinë.»

Këtu më poshtë kemi disa dëshmi të kryetarëve më të famshëm të Amerikës:

Washingtoni: «Mbi të gjitha, drita e pastër dhe e palëkundshme e Zbulesës ka ndikim ndriçues në njerëzimin dhe i shton bekimet shoqërisë.»

Lincolni: «Gjithmonë i pranoj këshillat e Perëndisë dhe atij ia rrëfej planet dhe asnjëherë nuk pranoj ndonjë punë pa qenë i sigurt aq sa mundem për miratimin e tij. Do të kisha qenë njeriu më kokëtrashë në këtë botë, sikur vetëm një ditë të mendoja se do të mund t'i lirohesha nga detyrat që i kam përsipër qysh se jam në këtë vend, pa ndihmen dhe dritën e atij që është më i mençur e më i fortë se të tjerët.»

Granti: «Mbaje Biblën si spirancën e lirisë sate. Shkruaj udhëzimet e saja në zemrën tënde dhe praktikoj ato në jetë. I jemi mirënjohës këtij libri, që me ndikimin e tij është bërë zhvillimi i vërtetë e qytetërimit, prandaj duhet ta shikojmë si udhërrëfyes në të ardhmen.»

Garfildi: «Zgjedhe Jezusin e pavdekshëm si mikun dhe ndihmësin tënd të përjetshëm. Ndiqe atë, jo vetëm si nazarenas, njeri i Galileës, por si një person shpirtëror të përjetshëm, plot me dashuri e dhembje, që do të qëndrojë me ju në jetë, në vdekje dhe në amshueshmëri. Shpresa e botës është e rrejshme, por sikurse shermendi që banon në hardhi, ashtu Krishti banon në të krishterin e ai kurrë nuk do të vdesë.»

MëkKinli: «Ne duhet të veprojmë, e jo vetëm të dëgjojmë. Nëse dëshirojmë t'i zbatojmë fjalët, është e domosdoshme që më parë t'i dëgjojmë ato; megjithatë shkuarja në kishë nuk mjafton. Duhet ta lexojmë Biblën, por mos të mbetet me kaq. Duhet ta zbatojmë në jetë.»

Uilsoni: «Në qoftë se secili individ në Shtetet e Bashkuara lexon për çdo ditë nga një kapitull të Biblës, shumica e problemeve tona kombëtare do të zhduken.»

Franklin D. Rusvelt: «E përsëris thënien që kam thënë para ca kohësh — se ringjallja e besimit është ajo që i nevojitet këtij vendi; se në një ringjallje të tillë do të kishim gjetur zgjidhjen e problemeve, qofshin ato politike, ekonomike ose shoqërore.»

Po ç'kanë thënë vetë komunistët?

Marks i shkruan: «Luteri duke ua dhënë njerëzve Biblën në gjuhën amtare, u dha në duar një armë të fortë kundër parisë, pronarëve dhe klerit.»

Stalini dhe Mikoiani kanë qenë seminaristë. Ky i fundit bile ka një titull në teologji. Bibla ishte ajo që formoi fillimin e shkollimit të tyre. Krushovi haptazi pohon se prej Biblës mësoi të lexojë.

Ideja themelore e çdo kushtetute socialiste — «Kush nuk punon, nuk ha» — është kopjuar tekstualisht prej Biblës (II Selanikasve 3:10).

Ideja komuniste është marrë nga Bibla, e cila na thotë:

«Në bashkësinë e besimtarëve mbretëronte një përkim i plotë. Askush nuk e quante të veten çkado që kishte, por ndër ta gjithçka ishte e përbashkët... Gjithashtu askush prej tyre nuk ishte skamnor, sepse ata që kishin ara e shtëpi i shitnin e çmimin e shitjes e binin dhe e vinin të këmbët e apostujve. Atëherë secilit i jepej aq sa kishte nevojë» (Veprat e apostujve 4:32-35).

Nxënësit e parë të Jezusit kanë jetuar në komunizëm, por komunizëm i bazuar në dashuri dhe vullnet të lirë. Askush nuk ka qenë i shtypur, as i shpronësuar. Dashuria i shtyu që gjithçka që kishin ta ndanin vëllazërisht. Pavarësisht nga ndryshimet, komunizmi i sotëm prejardhjen e ka nga Bibla.

E pranoj faktin se një njeri mund të mos besojë në Bibël, por nuk duhet të mos tregojë respekt ndaj trashëgimit të vet. A ka ndopak rëndësi se Bibla është libri i parë që është shtypur në Evropë? A ka ndopak rëndësi se misionarët e krishterë i mësuan vendasit e Afrikës ta lënë kanibalizmin, të lexojnë e të sillen si njerëz të qytetëruar?

Një ish kanibal një herë i tha një propaganduesi komunist: «Çka? Ky libër nuk është i vërtetë? E marr në shtëpi, ulem dhe e lexoj e ma mbush zemrën plot gëzim. Si mund të jetë gënjeshtër? Kam qenë njerëngrënës, pijanec, hajdut, gënjeshtar e ky libër më ka ndryshuar, më ka bërë njeri të ri. Jo, ky libër nuk mund të jetë gënjeshtër.»

Në shumë pjesë të botës propaganduesit komunistë do të ishin ngrënë nga vendasit sikur të krishterët të mos i kishin mësuar ata për krishterimin më parë. Derisa e përhapin ateizmin, këta propagandues duhet t'u jenë mirënjohës të krishterëve që kanë krijuar qytetërim dhe u kanë siguruar liri atyre për të vepruar.

Ateist i ndershëm është ai që përkulet para kishës në shenjë mirënjohje për atë se çka i ka borxh njerëzimi krishterimit. Por të pështysh në burimin në të cilin e tërë bota e qytetëruar ka pirë, është gabim i madh.

Në shekullin e shtatëmbëdhjetë, kur ateizmi ishte i rrallë ndër judenj, një jude i tha një rabini: «Unë nuk besoj në Perëndinë.» Rabini e përqafoi atë e i tha: «Sa ta kam zili, vëlla. Ti je në një gjendje shpirtërore shumë më të mirë se unë. Kur e shoh dikë që vuan them me vete 'Perëndia i ndihmoftë' e nuk i jap ndihmë. Ti që nuk beson në Perëndinë duhet t'i ndihmosh vetë. Ti duhet t'i bësh veprat të cilat Perëndia do t'i kishte bërë po të ekzistonte. Vetëm vazhdo në këtë mënyrë: ushqej të uriturit, ngushëlloj të pikëlluarit, jepju të vërtetën e gëzimin atyre që kanë nevojë, përqafoj të gjithë në dashuri e në përgjithësi sillu si do të sillej Perëndia po të ekzistonte. Pastaj eja mbas një viti e më trego a ka Perëndi a jo.»

Rabini ia doli të ketë qëndrim elegant ndaj ateistit, me

qëllim që ta inkurajojë e ta nxjerr më të mirën nga ateizmi i tij. Ju komunistët, nuk silleni kështu ndaj besimtarit.

Ju jetoni në një nivel më të ulët dhe tërë qëndrimi juaj i paqëndrueshëm.

Libri ateist i bën thirrje arsyes sonë, duke u përpjekur që me argumente t'i dëshmojë qëndrimet e veta me argumente. Në qoftë se autorët na lejojnë të arsyetojmë, pse atëherë nuk mund ta blesh Biblën në libraritë e Bashkimit Sovjetik? Populli duhet ta lexojë vetë, ta krahasojë me atë që thonë kundërshtarët e pastaj të nxjerrin përfundimet e veta. Pse është Bibla e ndaluar? A nuk besoni se njerëzit nuk janë të aftë të arsyetojnë «drejtë»? Atëherë pse të nxjerrim telashe e të paraqesim argumente? Vetëm jepe urdhrin «Mosbesim!» dhe u krye puna.

A kanë ekzistuar me të vërtetë personat e Biblës?

Kritika e Biblës është çështje e drejtë e arsyes njerëzore. Teologët e krishterë nuk kanë pasur nevojë të presin për këshillat e *Librit ateist* për të vërtetuar historinë biblike, duke i pajtuar kronologjitë biblike me ato laike e duke shqyrtuar të dhënat arkeologjike. Fakti se ne besojmë në frymëzimin hyjnor dhe pagabueshmërinë e Biblës gjithmonë na ka nxitur ta zbërthejmë hollësisht tekstin dhe përmbajtjen e saj, që të jemi plotësisht të sigurt se i kemi fjalët ashtu siç i ka frymëzuar Perëndia autorët, të pashtrëmbëruara nga përshkruesit ose përkthyesit.

Por kritika biblike siç praktikohet nga kundërshtarët tanë ateistë është krejtësisht ndryshe. Ata i mohojnë ngjarjet më të rëndësishme që i tregojnë Bibla dhe i fusin personatet biblike në sferën e mitit.

Të krishterët nuk besojnë se Bibla është libër shkencor. Ajo është një vepër orientale e vjetër me mijëra vjet,

që përmban mjaft poezi e simbolizëm, dhe nuk mund të përdoret si libër modern i shkencës.

Por faktet e Biblës mbesin dhe shkenca nuk i përgënjeshtrojnë. Është një fakt që lopata e arkeologëve gjithnjë i vërteton e kurrë nuk i hedh poshtë ngjarjet e Biblës.

Për autorët e *Librit ateist* Adami e Eva janë persona të mitit.

Nuk ka arsye të themeltë për t'i mohuar të dhënat biblike se Adami e Eva me të vërtetë kanë jetuar në tokë në kopshtin e Edenit dhe janë dëbuar nga kopshti, mu ashtu si të dhënat tjera historike që i ka ruajtur njerëzimi e që nuk mund t'i mohojmë.

Por kundërshtarët tanë na bëjnë një shërbim kur e quajnë ngjarjen mit. Miti nuk është diçka e pavërtetë, por është më tepër realitet i madh i shprehur me figura dhe simbole që dalin nga thellësia e shpirtit njerëzor dhe atij i drejtohen.

Tregimi i Adamit e Evës është më shumë se histori. Është histori dhe mit njëkohësisht.

Jeta e juaj, të dashur kundërshtarë, është një riprodhim i asaj që i ndodhi Adamit e Evës. Ka qenë një jetë e padjallëzuar e fëmijërisë në një botë pa pengesat e brengave dhe shqetësimeve rreth problemeve të mëdha. Ndoshta ju kujtohet kur mëkati, shkelja e ligjit të moralit nga i cili jetoni, së pari e pushtoi jetën tuaj dhe ju detyroi të fsheheni prej Perëndisë. Më vonë ndoshta do t'i kishit fshehur disa autobiografi prej Partisë. Nuk duhet t'ua vëjmë fajin të parëve tanë. Mos të kishin mëkatuar Adami e Eva, ne do ta kishim ngrënë pemën e ndaluar.

Adami e Eva janë arketipi i përvojës së përgjithshme njerëzore se ç'ndodh me secilin shpirt. Mitet nuk mund ta kundërshtojnë realitetin. Ata shpesh janë thellim i mendjes në disa fakte që janë karakteristike për tërë njerëzimin. Nuk mund ta nënçmosh vlerën e Mona Lizës duke thënë se është vetëm portret. Është portret i një qenie të gjallë. Portreti është aq realitet sa e paraqet qenien e gja-

llë. Mona Liza, në një kuptim të veçantë, është bile edhe më real se vetë personi që e portretizon. Është më e bukur, më e përhershme; përmbledh tiparet e saja më të mira. E korrigjon natyrën. Portreti nuk bie në kundërtënie me njeriun. Kuptimi shpirtëror i tregimit të Adamit e Evës nuk e kundërshton qenien e tyre si qenie historike.

Ajo që thashë për Adamin e Evën ka të bëjë edhe me ilaçin e mëkatit, me flijimin e Jezusit. Çdo njeri që ka gabuar diçka kërkon të ikë disi e t'ia lë fajin dikujt tjetër. Duke e ditur këtë ligj psikologjik, ikja prej fajit, Krishti pranoi të bëhet vetë fajtori. Ai, duke qenë Biri i Perëndisë, e merr krejt përgjegjësinë e jetës sonë, për të mirat e të këqijat. Ai u identifikua me ne nga dashuria që pat për ne dhe mori dënimin tonë. Atë që duroi Ai në kryq të Golgotës na ndihmon ne sikur ne vetë të kishim kaluar nëpër të gjitha mundimet e tij. Ne jemi të falur prej fajeve e mëkateve sepse Krishti derdhi gjakun e vet për ne. Atëherë u ngjall nga të vdekurit, duke na treguar neve që besojmë në të se edhe ne gjithashtu do të ngjallemi dhe të jemë me të në parajsë.

Vdekja dhe ringjallja e tij janë realitet historik. Por miti për një perëndi që vdes si flijim për mëkate e ngjallet përsëri është i vjetër qysh para Krishtit. *Libri ateist* ka të drejtë kur na kujton se për afërsisht të njëjtat gjëra u besuan për perëndinë Horus të egjiptianëve, për perëndinë Mitra, e të tjerë. Ndryshe nga Krishti, këta perëndi nuk kanë qenë historik, por realitete arketipe. Këta «perëndi» kanë qenë mashtrim i Shpërblyesit të vërtetë që i ishte premtuar njerëzimit dhe në atë mënyrë e paralajmëruan ardhjen e Krishtit. Horusi, Mitra dhe Dionisi kanë qenë emra që i jepeshin Shpëtuesit të mëkateve të cilët njerëzimi i dëshironte aq shumë. Perëndeshat Kun-Yin, Isis dhe Diana, ishin paralajmëruese të nënës së Jezusit, shprehëse të dëshirës së zjarrtë për një ideal të përsosur të pastërtisë, butësisë, vetëmohimit dhe të gjitha virtyeteve femërore.

Nuk do të brengosemi, pra, nëse kundërshtarët tanë i quajnë mite Adamin e Evën dhe Shpërblyesin e premtuar pas rënies nga parajsja.

Po përmbytja në kohën e Nojës që e shkatërroi tërë planetin? Edhe kjo është legjendë, thonë kundërshtarët tanë.

Mirëpo tregimet e Biblës janë vërtetuar nga kinezët, grekët, anglezët dhe tregimet meksikane për një përmbytje. Pllakat kunjore të zbuluara në Babiloni në vitin 1870 gjithashtu dëshmojnë për përmbytjen. Janë mahnitëse për nga ngjashmëria e të dhënave biblike. Besohet se datojnë nga viti 3000 para Krishtit, këto pllaka duhet të jenë shkruar kur përmbytja ka qenë e freskët në kujtesën e njerëzve.

Epi i Gilgameshit tregon për heroin e përmbytjes, Untapishtimin, që largohet nga prishja e përgjithshme e njerëzimit. Perënditë e mëdhenj të qytetit antik Shurupak (sot quhet Fara) vendosen ta shkatërrojnë njerëzimin me përmbytje. Perëndia Ea ia zbuloi vendimin hyjnor Untapishtimit dhe e kurseu atë me familjen e tij.

Një tregim tjetër mbi përmbytjen është gjetur në sumerishte, një gjuhë më e vjetër se asirishtja e babilonishtja.

Antropologu i famshëm Sër Xhejms Frejzer mbledhi gojëdhënat rreth përmbytjes nga vendet të ndryshme e të largëta, siç janë: Ishujt Liuord, Bengali, Kina dhe Malajzia. Kudo njerëzit edhe fiset e prapambetura e mbajnë në kujtesë këtë ngjarje të tmerrshme. Të gjithë pajtohen kryesisht se përmbytja ishte dënim për mëkatet e mëdha dhe se vetëm pak njerëz të drejtë qenë shpëtuar.

Josef Flavia në përgjithësi pranohet si njëri ndër historianët më të besueshëm të lashtësisë. Ai shkruan në «Antikitetet judease»: «Armenët e quajnë këtë vend (ku Noja me familjen e tij doli nga arka) 'Apobaterion', vendi i zbritjes.»

Edhe në tregimin e përmbytjes faktet dhe miti bashkohen. Është e ngulitur thellë në mendjen tonë e vërteta se

mëkati përgjithësisht do të përfundojë me katastrofë. Ne dimë gjithashtu se ka shumë raste kur drejtësia e disave në mënyrë të mrekullueshme i ka shpëtuar edhe të tjerët nga shkatërrimi i përgjithshëm. Tregimi historik mbi përmbytjen është mbështetur në kujtesën e shumë njerëzve të legjendave që e shprehen këtë të vërtetë. Këto legjenda janë të vërteta sa dhe vetë përmbytja.

Përmbytja në kohën e Nojës nuk është ndodhi e vetme e këtij lloji. Jezusi thotë: «Dhe, si në ditët e Nojës — ashtu do të jetë edhe ardhja e Birit të njeriut, dhe sikurse në ditët para përmbytjes, njerëzit hanin e pinin, merrnin gra e gratë burra deri në atë ditë kur Noja hyri në arkë, e nuk ua preu mendja se do t'u ndodhte gjë derisa s'erdhi përmbytja e i fshiu: ashtu do të jetë edhe në ardhjen e Birit të njeriut» Mateu 24:37-39).

Bota është tani buzë një katastrofe të re. Bibla thotë se këtë herë do të shkatërrohet me zjarr. («Elementet do të shkrihen prej të nxehtit» 2 e Pjetrit 3:10. Këto fjalë i ka shkruar Pjetri peshkatar para dy mijë vjetësh, shumë kohë para se të dinte dikush për elementet kimike, për fuqinë shkatërruese dhe për kapacitetin asgjësues të zbërthimit atomik e për nxehtësinë e tij.)

Sikurse Perëndia që e paralajmëroi Nojën, ashtu edhe kisha është paralajmëruar sot. Bota u shkatërrua në kohën e Nojës, megjithatë prishësia e saj nuk shkoi aq larg sa të ndalojë predikimin e Nojës. Çfarë gjykimi mund të presë bota e sotme që ndalon paralajmërimet! Njerëzimi nuk duhet të jetë i vetëdijshëm për rrezikun me të cilin ballafaqohet bota sot; prandaj, në *Librin ateist* mohimi për përmbytjen e vjetër ngërthen edhe mohimin e të dhënave historike.

Nuk ka fakte për ekzistencën e Abrahamit dhe pasardhësve të tij, thonë kundërshtarët tanë në vazhdim.

A ka vërtetuar ndonjë gjermim arkeologjik ekzistencën e Spartakut, udhëheqësi i kryengritjes së skllaveve, person që figuron në të gjitha historitë e socializmit? Me si-

guri jo. Supozohet se Spartaku me të vërtetë ka ekzistuar ngase një historian romak ka shkruar për të. Atëherë pse historianët socialistë nuk i masin me të njëjtin kut edhe personazhët biblik, bile edhe nëse kërkimet historike nuk do të vërtetonin asgjë për ekzistencën e tyre? Ç'iu është dashur të thonë për Abrahamin se ka qenë njeri nomad? Ne besojmë në ekzistencën e tij historike, ashtu si besojmë në realitetin historik të Spartakut, sepse historianët, autorët e Biblës, shkruajnë për jetën e tij dhe për jetën e shumë personaliteteve tjera të Besëlidhjes së Vjetër.

Përveç kësaj, të gjithë judenjtë e të gjitha kohërave e kanë ditur për vete se janë pasardhësit e Abrahamit, Isakut e Jakobit. Të gjithë arabët që kur nuk mbahet mend e dinë se Abrahami është ati i tyre. Të gjithë të krishterët e të gjithë myslimanët e botës gjithmonë e kanë nderuar Abrahamin si stërgjysh të fesë së tyre në një Zot të vetëm.

A është e mundur e tërë kjo të mos jetë asgjë?

Abrahabi e pat blerë shpellën e Makpelahut për ta varrosur Sarën. Pastaj, kjo shpellë u bë varr familjar. Aty u varrosen Izaku, Rebeka, Leahu dhe Jakobi. Një xhami dhe një sinagogë tani qëndrojnë mbi këtë shpellë, dhe është njëri prej vendeve më të shenjta të haxhillëkut për myslimanë.

Merrni me mend nëse dikush pas disa qindra ose mijëra vjetësh e viziton mauzoleun e Leninit e thotë se Lenini nuk ka qenë personalitet historik por mit. Për trupin e Leninit të thotë është vetëm figurë e dyllit. Ta zëmë se pas dy mijë vjetësh arkeologët që kanë dëgjuar për Stalinin, nuk gjejnë asgjë për sa i përket atij, as trupin, bile as figurë të dyllit. Sigurisht do ta mohonin ekzistencën e tij.

«Çfarë marrëzie», mund të thuani. Por atëherë edhe mohimi i Abrahamit është marrëzi.

Një vend në Izrael e vërteton ekzistencën e nipit të Abrahamit: Pusi i Jakobit ku Jezusi bisedoi me samaritanën, ende ekziston në Palestinë dhe është i mbuluar me një kishë të vogël greke. Pusi është menjëherë nën altar.

Por as Jakobi dhe pasardhësit e tij nuk janë persona historik, na thonë kundërshtarët tanë.

Ose autorët e *Librit ateist* janë injorantë, që nuk është e lejueshme për njerëzit që shkruajnë një libër me përgjegjësi aq të madhe, ose përndryshe me qëllim po e fshehin të vërtetën.

Në Tel Hariri më 1933 janë bërë gërmime nga arkeologu i mirënjohur, profesor Paroti. Tel Hariri është në mes të Damaskut e Mosulit pikërisht në atë vend ku thuhet se familja e Abrahamit ka ardhur në Kanaan. Tash atje është zbuluar kultura e Marit, dhe asiriologët kanë arritur ta deshifrojnë një pllakë argjili. Në të ishte raporti i Banumit, oficer i policisë së shkretëtirës që është nga shekulli shtatëmbëdhjetë para Krishtit. Raporti mban këto fjalë: «Thuaj Zotit tim këtë nga Banumi, shërbëtori yt: Dje dola nga Mari dhe e kalova natën në Zuruban. Të gjithë bengjaminët dërgonin sinjale zjarri. Prej Samanumit deri në Ilum-Muluk, prej Ilum-Mulukut deri në Mishlam të gjitha fshatrat bengjaminase në krahinën e Terkuas na u përgjigjen me sinjale zjarri; ende nuk jam i sigurt për kuptimin e këtyre sinjaleve.»

Veç kësaj, pllakat kronologjike të zbuluara në atë vend tri herë përmendin bengjaminët. «Viti në të cilin Iahduliimi shkoi në Hen dhe vuri dorë mbi teritorin e Bengjaminin» thotë një mbishkrim nga sundimi i mbretit Iahduliim. Nga sundimi i monarkut të fundit në Mari, kemi dy mbishkrime. I pari: «Viti kur Zimri-limi e vrau Davidin e bengjaminasve.» I dyti: «Viti pas vrasjes së Davidit të bengjaminasve nga Zimri-limi.»

Bengjamina, sipas Biblës, është biri më i vogël i Jakobit. Atëherë si mund të thonë autorët e *Librit ateist* se bijtë e Jakobit nuk janë persona historikë?

Për herë të parë që emri Izrael ndodhet në një dokument jobiblik është një mbishkrim që tash gjendet në muzeun e Kajros, nga tempulli i përmortshëm afër Tebes, në të cilin u përkujtua fitorja e faraonit Mezemptah mbi

libianët. Me qëllim që të zmadhohet triumfi i tij, përmenden gjithashtu edhe fitore të tjera të rëndësishme për të cilat thuhet se i ka arritur ky sundimtar. Përfundimi i himnit lavdërues është ky: «Kanaani është plaçkitur dhe e tërë e liga bashkë me të. Askeloni është zënë rob. Gezeri është mposhtur. Janoamin e shuam. Populli i Izraelit është shkretuar; Izraeli nuk ka pasardhës. Palestina është bërë vejushë për Egjiptin.»

Pra emri Izrael është historik që nga viti 1229 para Krishtit.

Sundimtari i asaj kohe mburrej që i kishte shkatërruar judenjtë, mu ashtu si mburrej pasuesi i tij Naseri, para se të pësonte disfatë nga Izraeli, i cili kurrë nuk do të shkatërrohet tërësisht.

Natyrisht duket gjë mjaft qesharake të shkruash një libër prej 700 faqesh për të vërtetuar se më shumë se para 4.000 vjetësh nuk ka ekzistuar një njeri me emër Abraham, se nuk ka pasur pasardhës më emra Izak, Jakob dhe Bengjamin, dhe se i tërë tregimi biblik për popullin e Izraelit është i pathemeltë. Përse u duhet ta mësojnë këtë në shkollat komuniste, po edhe nëpër fabrika e kooperativa bujqësore? Rusëve nuk ju intereson kush kanë qenë të parët e tyre para 4.500 vjetësh. Pse ju intereson ta mohojnë veçanërisht historinë e judenjve që daton prej një njeriu të quajtur Abraham?

Mohimi ka një kuptim të thellë. Më së miri shpjegohet me një shaka, e që duhet të jetë judease mbasi po flasim për popullin judeas:

Goldstajni po udhëtonte më tren. Përballë tij ishte një jude tjetër, Hershkoviqi. Ata nuk njiheshin me njëri-tjetrin. Goldstajni kishte dëshirë të hynte në bisedë, kështu që e pyeti Hershkoviqin: «Shok, të lutem, më trego sa është ora?» Hershkoviqi nuk ju përgjigj. Goldstajni ia përsëriti pyetjen disa herë, çdo herë me zë më të lartë. Por nuk pati sukses. Më në fund Goldstajni e pyeti: «Shok, unë po e shohë se paskeni orë. Pse s'po më tregon

sa është?» Hershkoviqi u përgjigj: «Shok, nuk të intereso sa është ora. Më duket se po dëshiron të bësh pak muhabet. Po të kisha thënë është ora 09.00, ti do të më kishe pyetur: 'Çfarë marke është ora?' Unë t'u kisha përgjigjur: 'Është orë zvicërane, e artë.' Ti do të kishe thënë: 'Paskeni pozitë të lartë! Përndryshe nuk do të kishit mundur të bleni kësi ore.' Unë t'u kisha përgjigjur: 'Po, jam drejtor i Ministrisë për tregti të jashtme.' Atëherë do të më kishe pyetur në cilën pjesë të Moskës banoj. Unë t'u kisha përgjigjur: 'Në rrugën Artileriana.' Do të më kishe pyetur a kam familje. Unë të kisha treguar se kam gruan dhe tri vajza. Do të më kishe pyetur mos e kam rastësisht fotografinë e tyre. Unë të kisha thënë po e kam dhe ta kisha treguar fotografinë. Ndoshta do të kishte pëlqyer vajza e madhe Estera dhe më kishe pyetur a mund ta bëj një vizitë. Mirësjellja do të më kishte detyruar të them po. Do të ishe dashuruar në Esterën e do të kishe kërkuar të martohesh me të. Dhe pse ta martoj vajzën me një njeri që nuk ka as orë dore?»

Ekzistenca e Abrahamit dhe pasardhësve të tij duhet të mohohet, sepse po ta kishin pranuar kundërshtarët tanë ekzistencën e Abrahamit, sipas shkrimeve të Biblës dhe të gjitha tradita e qindra e miliona judenjve, krishterëve dhe myslimanëve do të kishim pyetur pse është Abrahami aq i dalluar që emri i tij të mbetet në histori edhe pas katër mijë vjetësh. Përgjigjja e vetme mund të kishte qenë: ai është i famshëm sepse i ka besuar Perëndisë, i ka dëgjuar urdhrat e tij dhe ka qenë i gatshëm ta flijojë edhe birin e vet më të dashur për të. Atëherë ne do të kishim pyetur se a e ka takuar Abrahami Perëndinë ndonjëherë. Përgjigjja është se ai shpesh e ka dëgjuar zërin e Perëndisë duke i folur në mënyrë të qartë. Do të na kishte interesuar për ta ditur çka i ka thënë Perëndia. Përgjigjja do të kishte qenë se përveç tjerash Perëndia i ka thënë se dëshironte të bënte besëlidhje me të. Nga fara e tij, që do të thotë, nëpërmjet një pasardhësi të tij, të gjithë popujt

do të bekoen. Pasi që çdo kush dëshiron të ketë jetë të bekuar, do të kishim pyetur për emrin e këtij pasardhësi të Abrahamit që do t'na jepte lumturinë. Përgjigjja është e thjeshtë: Në fillim të Besëlidhjes së Re tregohet se Jezusi është ky pasardhës i Abrahamit. Do të kishim pyetur si mund të marrim bekim prej tij. Atëherë do të kishim dëgjuar mesazhin e Biblës: Jezusi ka vdekur në kryq për ne mëkatarët. Ai e mori dënimin tonë për fajin që ne e kemi bërë. Kush beson në të, i falen të gjitha mëkatet dhe fiton jetën e pasosur tashti edhe në parajsë.

Prandaj autorët e *Librit ateist* veprojnë me kujdes, ashtu sikur shoku Goldshtajn në shaka. Ata e bijnë shkurt bisedës. Personat e Biblës nuk kanë ekzistuar kurrë. Ata e kanë orën në dorë por nuk tregojnë sa është.

Qëllimi i tyre është që ta mohojnë të vërtetën biblikë, të gjejnë gabime dhe kundërthënie në të.

Çlirimi i judenjve nga robëria egjiptiane

Bibla thotë se judenjtë kanë qenë robër në Egjipt, por se Perëndia i çliroi nga robëria me dorë të fuqishme, duke bërë mrekulli për ta. Egjiptianët që i ndoqën u mbyten në detin e Kuq. Ky tregim i Biblës pa dyshim është i keq për ata që mbajnë skllëvër. Ua sjell ndër mend skllavëve, atyre që jetojnë nën diktaturë, se Perëndia është për çlirimin e tyre.

Për këtë arsye, edhe kjo faqe e historisë duhet të hiqet. Autorët e *Librit ateist* në mënyrë të hirshme na sigurojnë se e tërë kjo është gënjeshtër e pastër. Ata shkruajnë:

«Që një shekull e gjysmë, gërmimet arkeologjike në Egjipt po vazhdojnë e që po bëhen me hollësi të mëdha, por në një numër të konsiderueshën monumentesh që janë gjetur, në mbishkrimet e shumta që janë deshifruar, në figura dhe në gjëra të tjera, nuk është gjetur asgjë për ta vërtetuar legjenden biblike për robërinë e Egjiptit.»

A është mirë për komunistët t'ia bëjnë një kritikë të tillë Biblës?

Dalja nga Egjipti ndodhi para më shumë se tre mijë vjetësh. Revolucioni rus ka ndodhur vetëm para gjashtëdhjetë vjetësh. Tashti udhëto nëpër Bashkimin Sovjetik e shko prej një librarie në tjetrën dhe shiko nëse gjen një libër të vetëm që shkruan se Trotski ka ndikuar për t'i sjellë bolshevikët në pushtet. Ne brezi i vjetër e dimë se në atë kohë Trotski ka qenë kryetar i Sovjetit të Petrogradit dhe ka qenë bashkëpunëtori më i ngushtë i Leninit; në të vërtetë duhet të thuhet se Lenini e Trotski e bënë Revolucionin. Por më vonë Stalini u hidhërua me Trotskin dhe ia fshiu emrin nga historia. Më vonë u tha se Revolucioni ishte vepër e Leninit me Stalinin dhe me bashkëpunëtorët e tij më intim. Roli i Stalinin që përshkruar si më i rëndësishmi — deri në vitin 1956. Provo tashti të gjesh një libër nëpër libraritë e Rusisë e cila thotë se Stalini ka pasur një rol të rëndësishëm në Revolucion dhe nuk do të gjesh asnjë, sepse Krushovi, duke iu kundërvënë Stalinin, ia fshiu emrin edhe atij. Tash vonë edhe emri i Krushovit u fshi. Nëse armiqësia politike mund t'i fshijë të gjitha faktet që janë shkruar për rolin e njerëzve në ngjarjet më të rëndësishme të botës sot, me gjithë përparimin e shtypit, fotografisë dhe mjeteve të komunikimit, atëherë nuk është vështirë të pranohen zbrastësitë në historinë e egjiptianëve.

Por nuk mund të zhduken të gjitha faktet.

Kundërshtarët tanë të nderuar përsëri tregojnë mungesë të njohurive arkeologjike.

Ata nuk dinë për mbishkrimet e kohës së Ramses II, që janë gjetur në Beisan, në vitin 1923, të cilat pohojnë se ai punësoi robër semitas (në pllakat Tell-el-Amarna hebrejntë paraqiten me emrin «Khabiri») për ta ndërtuar një qytet që mban emrin e tij.

Qerpiçët e gërmadhave të qytetit, që gjenden në muzeun e Kajros, janë të vulosura me fjalët «Ramses».

Mund të shihen se disa janë të lidhur me kashtë dhe disa pa kashtë ose ndonjë material tjetër që i lidh. E tërë kjo vërteton dekretin e faraonit që shkruan në librin e dytë të Biblës, «Dalja», që jep urdhër se izraelitët nuk duhet të furnizohen më me kashtë.

Bibla thotë se dhjetë fatkeqësitë mbi egjiptianët i ka çuar Perëndia që t'i detyrojnë ata t'i lirojnë skllëvërit judenj. Fatkeqësia e fundit ishte vdekja e të gjithë të parëlindurve, duke filluar me të parëlindurin e faraonit, që ishte në fron.

Nëse pohimi i Biblës është i saktë, biri i Amenhotepit të Dytë, faraoni i «Daljes», do të ketë vdekur në atë gjykim. Amenhotepi i Dytë vdiq në vitin 1423 para Krishtit, dhe pas tij erdhi Totmesi i Katërt. Në një bllok të madh graniti që është i vendosur ndërmjet këmbëve të sfinksit të Ghizehit është e gdhendur ajo që quhet mbishkrimi i ëndrrës së Totmeut të Katërt. Kjo na thotë se ky faraon i ardhshëm kur ishte i ri binte për të fjetur e në ëndërr i vinte një sfinks dhe e habiste me profecinë se ai një ditë do të bëhej mbret i Egjiptit.

Mbasi ligji i fëmijës së parë respektohej në Egjipt, ai nuk ka mundur të jetë biri i parë i Amenhotepit, ose shpresat për ardhje në pushtet kanë qenë aq të vogla sa që ai është befasuar me premtimin e sfinksit. Kështu, pra, biri i parë i faraonit ka vdekur në fatkeqësinë e dhjetë.

A nuk është ky një konfirmim i çuditshëm i tregimeve të Biblës? Historia e vjetër egjiptiane është mjaft e njohur. Ka shumë të dhëna. Por asnjë nuk flet për zhdukjen e ushtrisë egjiptiane me mbretin e saj, theksojnë kundërshtarët tanë.

Kisha dashur ta di cili popull ka dëshiruar t'i shënojë disfatat e veta. Kur ushtria sovjetike u zbraps nga kufinj të Stalingradit, Stalini nuk e shpalli disfatën. As gjermanët nuk e shpallën të tyren kur ndodhi e kundërta. Historianët egjiptianë kanë vepruar njësoj me të vërtetën sikurse edhe historianët e sotëm botëror.

Në këtë çështje nuk e kemi palën egjiptiane në shqyrtim. Vetëm kaq. Por e kemi Biblën, që tregon jo vetëm për palën judease, por për fjalët e Perëndisë dhe mreku-llitë e tij. Nuk ka arsye të mos besohet çlirimi i mreku-llueshëm i robërve, ndonëse mund të jetë e pakëndshme për robëruesit dhe lajkatarët e tyre.

Libri ateist gjithashtu thotë se nuk kanë mundur të dalin prej Egjiptit gjashtëqind mijë judenj të rritur siç pohon Bibla, sepse sipas kësaj del se në tërësi kanë qenë të paktën tre milionë judenj. Nuk ka dyshim që tre milioni njerëz nuk kanë mundur ta kalojnë detin e Kuq për një natë; as nuk kanë mundur të jetojnë në gadishullin e vogël të Sinait.

Kemi një problem me hebraishtën, në të cilën është shkruar pjesa më e vjetër e Biblës. Fjala «alfot» që d.m.th. «mijëra» po ashtu d.m.th. «shtëpi». Nuk jemi të sigurt nëse origjinali i hebraishtës së Biblës do të thotë se gjashtëqind mijë judenj dolën nga Egjipti apo ndoshta thotë gjashtëqind shtëpi, gjashtëqind familje të mëdha. Gjuha është diçka që evoluon. Fjalët që i përdorim sot nuk kanë pasur të njëjtin kuptim para treqind apo katër-qind vjetësh. Në përgjithësi, kur Bibla përdor shprehje hiperbolike, ato pjesë të Biblës nuk mund të jenë aq të lehta për t'i kuptuar sikur në kohën kur janë shkruar. Por po të kishte pasur gënjeshtër në të, nuk do ta kishin pranuar si libër të shenjtë, ashtu sikundër historia zyrtare e Bashkimit Sovjetik nuk do të ishte pranuar po të kishin thënë se armata e Kuqe në Luftën e Dytë Botërore përbëhej prej 20 miliardë ushtarësh. Fjalët në atë kohë kanë pasur kuptim tjetër nga ai që kanë sot.

Në pallatin perandorak në Tokio ruhen tri shenja të Perandorisë japoneze — një shpatë shumë e vjetër, një diamant dhe një pasqyrë e mbretit të madh. Prapa në pasqyrë janë disa shkronja të shkruara të cilat vetëm në kohët e fundit janë deshifruar në Japoni. Pas Luftës së Dytë Botërore, vëllai i perandorit, princi Takahito Maka-

sa, filloi të bëjë hetime në judaizëm. Kur perandorin e vizitoi rabini Goldman i tempullit Bet-Izrael në Hertford, që ishte kryetar ekzekutiv i Komisionit për Mirëqenien Kombëtare Judenje, princi u përkujdes që rabini ta shikojë pasqyrën e perandorit të madh. Pa kurrfarë vështirësie rabini i identifikoi shkronjat që ishin fjalë hebraishte «Ehjah Asher Ehjah» — «Unë jam ai që jam». Përkërisht fjalët e Biblës, që i gjejmë në librin «Dalja» 3:14!

Menjëherë princi dhe rabini filluan të spekulojnë se fjalët hebraishte që i ka shkruar Moisiu në Bibël i paskan gjetur në një objekt të shenjtë japonez, dhe supozohej se në kohërat e vjetra, gjatë robërimit babilonas të judenjeve, anëtarët e dhjetë fiseve të Izraelit ia paskan sjellë këtë pasqyrë si dhuratë perandorit sundues.

Në vitin 1941, peshkopi japonez Jujai Nakada botoi librin «Japonia në Bibël». Duke u mbështetur në dokumentet të kohërave të lashta, ai thotë se në vitin 216 pas Krishtit, 100.000 njerëz erdhën nga Lindja e Mesme në Japoni. Ata sipas historisë japoneze quhen fisi Hata, dhe kanë pasur ndikim të madh në ekonominë dhe kulturën japoneze. Fisi Hata e quante veten Israj, që është mjaft afër emrit Izrael, dhe tregonin për një udhëheqës të madh, që e quanin princi Hata Kaua Katsu, i cili si foshnje u shpëtua nga uji dhe pastaj e sollën në një pallat të mbretit dhe më në fund ai i çliroi nga robëria. Në këtë mënyrë erdhi tregimi i Biblës për Moisiun në Japoni.

Provat jobiblike për historinë e Biblës janë të panumërta. Natyrisht ato nuk mund të hidhen poshtë.

Kundërthëniet në Bibël

Libri ateist përmend kundërthënie në Bibël.

Në librin e dytë mbi Samuelin 8:4 thuhet se Davidi, në përleshje me Hadadezerin, i mori atij 1.700 kalorës, ndërsa në librin e parë të Analeve 18:4 thuhet se Davidi zuri rob 7.000 kalorës. Kundërshtarët tanë të nderuar nuk mund të pajtohen më këto dy thënie të ndryshme.

Çka do të kishin thënë sikur ta kishin gjetur një histori të Luftës së Dytë Botërore që thotë se në betejën e Kievit njëqind mijë rusë janë zënë rob, ndërsa pesëdhjetë faqe më vonë thotë se në betejën e Kievit vetëm dhjetë mijë rusë janë zënë rob?

Sqarimi është i thjeshtë. Gjatë luftës së fundit ka pasur tri beteja për Kievin. Numri i robërve ndryshon në këto beteja. Pse duhet të besojmë, pra, se në këto dy libra të Biblës përshkruhet e njëjta betejë kundër Hadadezerit?

Një kritikë tjetër e Biblës: Bibla thotë se atë çka ka bërë mbreti David « ishte e mirë në sytë e Zotit dhe ai nuk ua ka kthyer shpinën urdhrave të tij, gjatë tërë jetës ». *Libri ateist* pyet: « Po a ka mëkatuar? » Bibla vetë tregon në një vend tjetër se çfarë mëkati të rëndë ka bërë.

Sigurisht që ka mëkatuar, por këto mëkate i janë falur dhe shlyer, prandaj nuk i janë llogaritur më përpara Perëndisë. Ato janë harruar. Mrekullia është se ai që pendohet është i drejtë para Perëndisë, dhe për këtë arsye është në kontekstin e dashurisë mëshirëplote të Perëndisë që Bibla thotë fjalë aq të mira për Davidin. Mëkatari i falur, në sytë e Perëndisë, është më i bardhë se bora.

Le të pendohen miqtë tanë ateistë se edhe ata do të falën!

Autorët e *Librit ateist* janë të lumtur pse kanë zbuluar se apostulli që quhet Tadeu në Ungjillin sipas Mateut quhet Juda biri i Jakobit në Ungjillin e Lukës. Çfarë gabimi i rëndë! Por t'i kthehemi atyre. Si pajtohen ata me faktin

se njëfarë Ulianovi në përgjithësi paraqitet si Lenin dhe, Gjugashvili njëri nga biografët është Stalini për të tjerët?

Kundërshtarët tanë zbulojnë në Bibël një mori «kontraditash» kësodore. Nuk vlejnë për t'i shqyrtuar.

Kështu, për shembull, ata vëjnë në dukje se Jezusi njëherë u ka thënë nxënësve të vet t'i shesin edhe rrobat për të blerë shpata. Në anën tjetër, kur Pjetri desh i ta mbrojë Jezusin, ai i tha: «Ktheje shpatën në vend të vet!»

Fjalët «shitni petkat e bleni shpata» i tha Jezusi pas darkës së fundit kur ai ishte në rrugë për në Gjetseman, duke e ditur se do të arrestohej. Mbase ishte vonë në mbrëmje dhe nxënësit nuk kishin rast për të blerë asgjë, është e qartë se ai nuk u thoshte të blenin shpata për t'i përdorur menjëherë. Porse, ai i paralajmëron nxënësit e vet për rreziqet e mëdha me të cilat do të ballafaqohen ata gjatë shumë shekujve e që duhet të jenë të gatshëm për ta mbrojtur veten dhe drejtësinë.

Ai që nuk është i gatshëm për ta mbrojtur një çështje të drejtë, ai nuk e do atë. Çdo nënë që e do fëmijën e vet do të luftojë deri në pikë të fundit për ta mbrojtur atë nga një sulmues që ka ndër mend ta rrembejë ose ta mbyisë.

Kur njëri prej nxënësve përpiket ta sigurojë Jezusin me fjalët: «Ja, këtu ka dy shpata», Jezusi përgjigjet me një prekje ironike: «Mjaftojnë.» Do të vijë koha për nxënësit e tij ta kuptojnë më mirë.

«Ktheje shpatën në vend të vet» që urdhri i Jezusit për një situatë të vetme. Ai nuk desh i që ta mbrojnë. Dëshira e tij ishte që ai të vdesë për mëkatet e botës.

Autorët e *Librit ateist* kanë gjetur edhe një kundërthenie në Ungjillin sipas Lukës: Meqenëse populli ishte në anën e Jezusit, kryepriftërinjtë duhej të mendonin për të gjetur mënyrën për ta vvarë fshehtas kështu që ithtarët e tij s'do të mund ta mbronin, ndërsa disa ditë më vonë, turma bërtet: «Kryqëzoje!» Kundërshtarët tanë thonë se një ndryshim aq rrënjësor në zemërimin e banorëve vendas për një kohë aq të shkurtër vërtet është e pamun-

dur; prandaj, tregimi i ungjilltarit Lukë nuk mund të jetë i vërtetë.

Sa mëkat se anëtarët e Akademisë së Shkencës nuk kanë mësuar asgjë nga tragjedia e popullit të vet.

Një mëngjes në Moskë, të gjitha radiostacionet filluan programet me kendimin e himneve të lavdisë për Stalinin, ashtu siç kishin vepruar për njëzet vjet. Gjithashtu edhe gazetat atë mëngjes ishin plot me lëvdata. Ishte dita kur fillonte Kongresi i Njëzet i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Atë ditë, Krushovi mbajti një fjalim ku tha se Stalini, të cilin tërë populli edhe ai vetë e kanë lajkatur disa dekada me radhë si gjenium më të madh, ka qenë në realitet një vrasës dhe torturues masiv, jo vetëm për kundërshtarët, por edhe për shokët e vet. Si pasojë e këtij fjalimi, i tërë populli rus menjëherë u kthye kundër ish-udhëheqësit të tyre largpamës dhe, në vend që t'i thurnin lavdi, gjenin mënyra për ta përqeshur. Madje së shpejti ia hoqën kufomën prej varrit.

A mund ta besojnë autorët e *Librit ateist* këtë tregim? Ose mos thonë se është legjendë?

Masa e ndërron mendimin shumë shpejt. Kështu ka ndodhur me rastin e njërit prej udhëheqësve më të degraduar në botë, Jozef Stalinit, dhe po kështu ka ndodhur me rastin e njeriut më shembullor të njerëzimit, Jezusin e Nazaretit.

A nuk iu kujtohet anëtarëve të Akademisë së Shkencave se ata vetë njëherë i këndonin këngë lavdie Stalinit, dhe pastaj edhe ata ia ndërruan melodinë?

A thua kaq shpejt kanë harruar se si demonstroi rrugëve me parulla për solidaritetin e përjetshëm të popujve komunistë, për vëllazërimin e përjetshëm me komunistët kinezë, rumunë dhe jugosllavë? A e dinë ata sa shpejt u kthye «solidariteti i përjetshëm» në grindje të parëndësishme? Pse nuk marrin mësim nga përvoja e tyre e hidhur e t'i kuptojnë ngjarjet e para dy mijë vjetëve dhe ta kuptojnë se natyra njerëzore është e njëjtë në të gjitha

kohërat, dhe se kundërthëniet që na paraqitën nuk janë në Bibël por në mendje dhe në zemrën e njeriut?

Mendimi se Juda nuk ka pasur nevojë t'u japë shenjë njohjeje ushtarëve që kishin ardhur për ta arrestuar Jezusin është qesharak, bile edhe foshnjarak. Për shkak se Palestina ishte vend i vogël e Jezusi kishte udhëtuar shumë nëpër Galile e Jude, nuk ka arsye të besohet se ka qenë si fytyrë e njohur. Sot njohim personalite të rëndësishme sepse ua shohim fotografitë nëpër gazeta e në televizor, por në atë kohë nuk ka pasur mjete të tilla komunikimi. Kështu që ka pasur me mijëra njerëz që kanë dëgjuar për Jezusin, por kurrë nuk e kanë parë sy më sy. Ushtarët romakë dhe shërbëtorët e kryepriutit Kajfa ndoshta nuk kanë treguar interesim për t'i dëgjuar predikimet e Jezusit sikurse edhe oficerët komunistë të shërbimit sekret që nuk do të dëshironin t'i dëgjojnë predikuesit në vendet e tyre komuniste, përveç kur kanë qëllime të mbrapshta. Pra, është krejt e natyrshme se kanë pasur nevojë për një shenjë njohjeje për personin që kanë dashur ta arrestojnë. Përveç kësaj, takimi ishte natën në errësirë, e si mund ta dallonin në dritën e dobët të pishave në mes të dymbëdhjetëve dhe, kërkohej identifikim i saktë.

Autorët e Librit ateist — «heronjtë» të gjithë ata që në kohën e Stalinit e kundërshtuan tiraninë e tij por që patën një fat të jashtëzakonshëm për t'i shpëtuar burgosjes (ata ose nuk e kanë kundërshtuar Stalinin, ose mëshirshëm i ka mbrojtur Perëndia të cilit nuk i besojnë) — janë pikërisht ata që e nënçmojnë Jezusin pse ka pasur frikë në kopshtin e Gjetsemanit, ku u arrestua, dhe për dëshpërimin në kryq!

Të kesh virtyte të larta është me të vërtetë gjë e bukur. T'i fshehësh këto virtyte sikur pemët që i fshehin frytët nën gjethe është për t'u përgëzuar. Qëllimi i Krishtit ka qenë ta hapë rrugën drejt qiellit, të tregojë se Perëndia i pranon edhe më të dobët. Për ta ndërtuar këtë urë, ai nuk e ka luajtur rolin e heroit. Po të kishin qenë veprat heroit-

ke e të pakapshme në të gjitha rrethanat, atëherë ne njerëzit mesatarë dhe nënmesatarë kurrë nuk do të kishim mundur ta kuptojmë. Për këtë arsye, ai ra në nivelin e njeriut të dobët, duke u lutur në kopshtin e Gjetsemanit, «Ati im, largoje prej meje këtë kupë mundimesh», dhe britma në kryq, «Hyji im, Hyji im, përse hoqe dorë prej meje!», me qëllim që ne, që shpesh biem në dëshprim dhe dëshirojmë që kupa e fatit të hidhur t'na largohet, duhet ta gjejmë në të mikun besnik. Ky ka qenë qëllimi i sjelljeve të Krishtit. Nuk është e drejtë ta quajmë frikacak.

Libri ateist flet për disa kontradikta midis Besëlidhjes së Vjetër dhe Besëlidhjes së Re.

Kështu ata vëjnë në dukje se në Ungjillin sipas Gjonit, shkruan se askush nuk e ka parë Perëndinë ndonjëherë, ndërsa në Besëlidhjen e Vjetër patriarku Jakob thotë: «E kam parë Perëndinë ballë përballë.» (Zanafilla 32:30).

Shpjegimi është i thjeshtë.

Gjuha hebraike në kohërat e Biblës ka qenë shumë e varfër prandaj ka pasur shumë homonime. Një fjalë ka pasur shumë kuptime. Fjala Perëndi në atë kohë kishte kuptim para së gjithash Krijuesi i qiellit e tokës. Kjo fjalë u përdor gjithashtu edhe për Krishtin. Në Dhiatën e Vjetër engjëjt disa herë quhen Perëndi, bile nganjëherë edhe njerëzit. Krijuesi i thotë Moisiut: «Do të vë si perëndi mbi faraonin» (Dalja 7:1), dhe në një psalm, judenjve si popull i zgjedhur, u thuhet: «Ju jeni perëndi» (Psalmi 82:6). Kur Jakobi thotë: «E kam parë Perëndinë ballë përballë», ai mendon për një engjëll, ndërsa Gjoni në Besëlidhjen e Re flet për Perëndinë në kuptimin më të lartë të fjalës, realiteti i fundit, Krijuesi i qiellit e tokës.

Por mjaft me këtë.

Libri ateist e shikon Biblën nga poshtë, nga këndvështrimi njerëzor. Nga ky kënd është me të vërtetë e pakuptueshme. Merre një ojme të qëndisur bukur, shikoje nga ana e mbrapshtë, dhe do të jetë një kryqëzim penjsh të

pakuptim. Duhet ta shikosh nga ana tjetër për t'ia parë bukurinë. Kësisoj edhe Bibla nuk duhet të shikohet nga poshtë, nga këndvështrimi i njeriut, që është rebeluar kundër Perëndisë.

Me anë të shpirtit të krishterët kanë bashkësi të drejt-përdrejtë me botën e padukshme. Ata e shikojnë Biblën nga kjo perspektivë prandaj janë në gjendje ta kuptojnë harmoninë dhe kuptimin e thellë të saj. Ata gjithashtu e kuptojnë edhe kufizimin e Biblës, ku na zbulohet Perëndia në gjuhën njerëzore.

E kam dëgjuar një tregim për Robert Mofatin, misionar në Afrikën Jugore, që deshi t'ua përshkruante trenin fiseve lokale. I vuri dy shufra hekuri në tokë, si binarë, pastaj i radhiti disa pendë që si vagona njërin pas tjetrit, dhe më në fund e kishte vënë një ibrik të madh që nxirrte avull mbi kokë të kaut të parë. Pa dyshim, kur kanë udhëtuar afrikanët më vonë në Evropë dhe kanë parë si duket treni, kanë qeshur me përshkrimin e Mofatit. Por gjuha e afrikanëve nuk ia mundësonte t'u tregonte çfarë ishte me të vërtetë treni. Po ashtu edhe Perëndia duhet të përdorë shprehje tokësore për t'i shpjeguar gjërat qiellore dhe shpirtërore, për të cilat nuk ka shprehje adekuate në gjuhën njerëzore.

Por megjithatë, sa shumë të frymëzon dhe të ngrit moralisht ky libër!

Volteri pat shkruar se për njëqind vjet Bibla do të vjetërohej dhe do të harrohej, e do të gjendej vetëm nëpër muze. Por njëqind vjet mbasi e shkroi Volteri këtë, shtëpia e tij shfrytëzohej nga Shoqata Biblike.

Bibla është përkthyer në 1.300 gjuhë, dhe me miliona kopje shitën për çdo vit — e kush i hyn mundimit të lexojë Volterin më?

Për sa i përket aftësive të natyrës, s'ka dyshim se Platoni ka qenë shumë më i aftë se shën Gjoni, që ishte një peshkatar i thjeshtë, ose Mark Aureli që ishte mendimtar shumë më i madh se Pjetri. Por sot pakkush e lexon Mark

Aurelin ose Platonin, ndërsa shkrimet e Gjonit e Pjetrit janë fjalët e jetës për mbarë njerëzimin.

Shkencëtarët shpesh kanë mendime të ndryshme rreth zbatimit të të dhënave.

Edhe faktet për natyrën mund të keqinterpretohen. Kështu, pra, edhe Libri i shenjtë mund të keqinterpretohet ose të keqpërdoret, por kjo nuk ia ul vlerën.

Kundërshtarët e mi kanë shkruar qindra faqe për ta përgerjështuar Biblën, libër njëmend i panjohur për ta.

Nëse prezantohem me një njeri, nuk do të thotë se e njoh atë. I shoh vetëm rrobat e këpucët. Prej trupit, vetëm koka e duart i shihen. Nëse e shoh të zhveshur, prapë-seprapë nuk e njoh, sepse shpirti i mbetet mister. Teksti i Biblës drejtpërsëdrejti është vetëm një petk i jashtëm. Alegoritë janë trup i saj, e vërteta shpirtërore është shpirti i saj. Bukuritë e misterit të saj i zbulohen vetëm atyre që e duan Perëndinë, atyre që janë të gatshëm t'i japin zemrat Shpirtit të Tij hyjnor. Peizazhi i bukur rroket nga syri anatomik dhe interpretohet nga truri. Në të njëjtën mënyrë, gjërat shpirtërore, thotë shën Pali, vërehen dhe ndërmjetësohen nga Shpirti i Perëndisë.

A të mëson krishterimi t'i bëhesh servil pushtetit tiranik?

Fjalët e Jezusit «Jepni cesarit çka i përket cesarit» janë provë e mjaftueshme për autorët e *Librit ateist* se ai mësoi servilizëm kah ajo që sot mund ta quajmë sundimtar kolonial.

Jezusi kurrë nuk ua tha këto fjalë nxënësve të vet. Ato ua tha kundërshtarëve më të mëdhenj, farisenjve. E gjithë jeta e tyre ishte tallje me fenë. Kështu që Jezusi u tha: «Jepni cesarit çka i përket cesarit e Zotit çka i përket Zotit.» Ishte i sigurt se kur përpiqen të veprojnë ashtu, kun-

dërshtarët e tij shpejt do ta kuptojnë se nëse i kënaqin kërkesat e sundimtarëve të marrë (shumë sundimtarë romakë kanë qenë të marrë), atëherë nuk do të mbetej asgjë për Zotin.

Nxënësit e Jezusit e kanë kuptuar mirë se ç'donte të thoshte me këto fjalë, të cilat shpesh janë keqpërdorur nga të tjerët.

Nëse dikush ka qenë i pandershëm dhe dëshiron të ndreqet me atë që është përklarë, së pari duhet të vërtetohet saktësisht se çfarë borxhi i ka e pastaj t'ia paguaj. Po, çfarë borxhi i ka pasur judeu Cezarit? Çfarë borxhi i ka çeku Kosiginit? Kurrfarë.

Bile edhe në Romë, asgjë me ligj nuk i përkiste Cezarit. Jul Cezari, gjeneral ngadhënjimtar romak, duke u kthyer nga një ekspeditë nga Galia e përmbysi Republikën me forcë ushtarake. Në këtë mënyrë ai nuk ishte sundimtar i ligjshëm. Atë e zëvendësuan tiranët, shumica prej tyre ishin më të përshtatshëm për shtëpi korrektuese se sa për fron. Këta tiranë ia morën lirinë popullit të Perandorisë romake e nuk i dhanë asgjë.

Bile diçka edhe më pak se kjo i përkiste Cezarit në Palestinë. Gaj Pompeu përfitoi nga ndarja e judenjve në fraksione, e pushtoi me forcë këtë vend të vogël dhe u imponoi regjimin e terrorit e korrupsionit.

Cezari kurrë nuk ka ndërtuar rrugë në Palestinë. Jude-
njtë e kanë kryer punën. Ai nuk ka ndërtuar asnjë shtëpi. Nuk ka mbjellë asnjë pemë. «Jepni Cezarit çka i përket Cezarit» është thënie patriotike, revolucionare e cila në esencë mohon çdo të drejtë të pushtuesit.

Po të kishte thënë ndonjë qytetar i ndershëm në Bashkimin Sovjetik gjatë pushtimit nazist, «Jepni Hitlerit çka i përket Hitlerit, jepni Zotit çka i përket Zotit», këto fjalë do të ishin kuptuar si: «Dëboni Hitlerin bashkë me trupat e tij, sepse asgjë nuk u takon atyre në Bashkimin Sovjetik. Bile as nuk ka të drejtë të jetë këtu.» E njëjta gjë do të vlente për pushtimin sovjetik në Çekoslovakia.

Është e qartë se pushteti romak, dhe kryepiftërinjtë judenj që ishin kukulla të tyre, u dhanë të njëjtin interpretim fjalëve të Jezusit. Fakti qëndron në atë se Jezusin nuk e konsideruan si qytetar të ndershëm të Perandorisë por si një rebel dhe e kryqëzuan.

Libri ateist e keqparaqet të vërtetën kur i përshkruan autorët e Besëlidhjes së Re si lajkatarë të autoriteteve romake.

«Nuk ka akuza kundër qeveritarit romak», thonë ata. «I tërë faji për kryqëzim i hidhet judenjve, ndërsa Pilati përshkruhet si vëzhgues pasiv.»

Është lehtë të thuhet gjëra të tilla në një vend ku nuk lejohet Bibla. Në Veprat e Apostujve 4:27, lexojmë: «Qe, në këtë qytet, vërtet, bënë lidhje Herodi e Ponc Pilati me paganë e me fiset e Izraelit kundër Jezusit — Shërbëtorit tënd të shenjtë të cilin ti e shugurove.» Turma judenje, e nxitur nga piftërinjtë, ka kërkuar kryqëzimin e Jezusit. Por Pilati me iniciativën e vet ia shtoi torturat njëren mbi tjetren. Këtë e dimë nga fjalët: «Atëherë Pilati mori Jezusin dhe urdhëroi të rrahet me frushkuj.» (Gjoni 19:1). Teksti nënkupton shturje të poshtër të një qeveritari romak që gjen kënaqësi në frushkullimin e një të burgosuri edhe pse është plotësisht i bindur për pafajsinë e tij. Pastaj në Bibël qartë tregohet se Pilati e dorëzoi të kryqëzohet.

Me çfarë të drejte pohojnë komunistët për të krishterët e parë se kanë qenë servilë të pushtetit romak, dhe e përshkruajnë Pilatin vetëm si vëzhgues pasiv? Ndoshta me «të drejtën» e uzurpuesve të monopolit për botimin e librave dhe për një përshkrim kundër të krishterëve dhe lirisë për t'u përgjigjur.

Shën Gjoni nuk është i vetmi që fajëson qeveritarin romak. Të gjithë ungjilltarët e paraqesin si simahor.

Mateu shkruan (27:26): «Pasi Pilati e frushkulloi Jezusin, ua dorëzoi të kryqëzohet.» Marku shkruan (15:15): «Pilati pasi e frushkulloi Jezusin ua dha të kryqëzohet.»

Luka e citon Pilatin haptas duke thënë (Luka 23:14): «...nuk i gjeta kurrfarë faji... prandaj, do ta ndëshkoj e do ta liroj» .

Autorët e Besëlidhjes së Re asnjëherë nuk ua kanë mbuluar fajin romakëve për kryqëzimin e Jezusit. Edhe ata janë fajtorë. Më vonë historianët krishterë shënuan me përpikëri se si pushteti romak i hidhte të krishterët tek kafshët e egra duke iu nënshtruar gjithë mizorive.

Të krishterët e vërtetë e të gjitha kohërave nuk kanë qenë dhe nuk janë aspak servilë si dhe kurrë nuk i kanë pranuar tiranët si sundimtarë të drejtë. As nuk e kanë konsideruar si detyrë për t'iu përlulur atyre. Libri i parë kundër krishterimit me sa mund të dimë është «Fjala e vërtetë» nga Celsusi. Është shkruar rreth vitit 175 pas Krishtit. Ai i qorton të krishterët pse nuk e mbrojnë Perandorin, pse nuk luftojnë për të, pse nuk marrin pjesë në ekspeditat ushtarake dhe në akcione. Të krishterët e Bashkimit Sovjetik i konsiderojnë krerët komunistë shtypës. Ata nuk pranojnë lajka nga nxënësit e Krishtit.

«Libri ateist» citon edhe një rresht nga Bibla për të treguar se krishterimi mëson nënshtrim të verbër ndaj sundimtarëve të padrejtë, prandaj, është edhe pengesë për përparimin e njerëzimit. Ky tekst gjendet tek Romakët 13:1-3: «Çdo njeri le t'i nënshtrohet autoritetit që ka mbi vete. Sepse, nuk ka pushtet që nuk vjen prej Perëndisë; ato që janë i ka vënë Perëndia. Prandaj, ai që i kundërshton pushtetit, i kundërshton rendit të vendosur prej Perëndisë; ata që i kundërshtojnë, dënojnë vetveten.»

Por, po ky kapitull tregon se ç'do të thotë i krishteri me shprehjen «autoriteti që ka mbi vete» të cilit duhet t'i nënshtrohet. Vetëm ai që është shërbëtor i Perëndisë e meriton këtë emër, ai që u jep lavdata atyre që bëjnë të mirën dhe shpreh indinjatë ndaj atij që bën të keqen (rreshti 3 dhe 4). Në qoftë se sundimtari bën të kundërtën, nëse e dënon të mirën dhe shpërblen të keqen, nuk e pranojmë më se pushteti i tij vjen prej Perëndisë. Rreshta

të Biblës si të mësipërmit bënë që të krishterët t'i përballonin tiranisë.

Në mesjetë, Savonarola u dogj për shkak se pat thënë: «Asgjë nuk është më e neveritshme për tiranin se shërbimi për Krishtin dhe jeta e virtytshme krishtere. Sepse këto janë në kundërshtim të plotë me normat e tij.»

Po ju citoj një diskutim mes Marisë, mbretëreshës së Skocisë dhe reformatorit protestant, Gjon Knoksit:

Maria: «E ke mësuar popullin ta pranojë një fe tjetër nga ajo që lejojnë sundimtarët. Dhe si mund të jetë kjo doktrinë prej Perëndisë, kur e dimë se Perëndia i urdhëron shtetasit t'i nënshtrohen autoriteteve të larta?»

Knoksi: «Zonjë, si fe e vërtetë nuk e ka marrë as fuqinë burimore as autoritetin nga sundimtarët e botës, por nga i vetmi Perëndi i Përjetshëm, kështu nuk janë qytetarët të detyruar t'ia japin formën fesë sipas shijeve të sundimtarëve... Nëse të gjithë pasardhësit e Abrahamit e kishin pranuar fenë e faraonit... çfarë besimi do të kishte sot në botë? Ose po ta kishin pranuar apostujt fenë e Perandorisë romake, çfarë besimi do të kishim sot?»

Maria: «Mirë, po asnjëri prej tyre nuk u ngrit kundër autoriteteve.»

Knoksi: «Megjithatë, zonjë, nuk mund ta mohosh se kanë kundërshtuar. Nuk u janë nënshtuar... në një farë mënyre kanë kundërshtuar.»

Maria: «Mirëpo, nuk kanë kundërshtuar me shtatë.»

Knoksi: «Perëndia, zonjë, nuk ua kishte dhënë forcën dhe mjetet.»

Maria: «A po mendon se ta kishin pasur forcën do ta kishin përdorur kundër sundimtarëve të tyre?»

Knoksi: «Nëse sundimtarët e tyre i kishin kaluar kufijtë, zonjë... nuk ka dyshim që do të kishin kundërshtuar bile edhe me forcë. Sepse, ç'thua nëse një prind çmendet e do ta mbysë fëmijën e vet? A nuk duhet ta kapin me zor e t'ia marrin shtatën apo armën tjetër? Është po ashtu, zonjë, edhe me sundimtarët që dëshirojnë

t'i mbysin fëmijë të Perëndisë që janë shtetas të tyre. Fanatizmi i tyre i verbër nuk është asgjë tjetër veçse tërbim i marrë... prandaj atyre u duhet hequr shpata nga dora, duhet t'ua lidhin duart e t'i burgosin derisa t'u kthjellohet mendja e atëherë nuk do të ketë më kundërshtim ndaj sundimitarëve, por vetëm nënshtrim që është në pajtim me fjalën e Perëndisë.»

Cili komunist do të kishte guxuar t'ia thoshte këto fjalë Stalinit?

Bibla e ka frymëzuar Linkolnin e Wilberforsin të luftojnë për zhdukjen e skllavërisë. Marksi në veprën e tij «Kapitali» e pranon rolin e të krishterit Shaftesburi për paraqitjen e ligjeve që i mbrojnë punëtorët në Britaninë e Madhe. Kaunt Leo Tolstoj, ka qenë i krishterë rus, që i mohoi çfardo lloj pushteti carit. Tomas Xheferson, kryetar i Shteteve të Bashkuara, shkruan: «Jam betuar në altarin e Perëndisë ta luftojë përjetë armiqësinë e tiraninë që sundon mbi njeriun» dhe «Rebelimi kundër tiranëve është nënshtrim ndaj Perëndisë.»

Linkolni shkruan: «Nëse skllavëria nuk është e keqe, asgjë tjetër nuk është e keqe.»

Emersoni shkruan: «Nëse ti ia vë zinxhirin skllavit rreth qafe, tjetri të lidhet vetë rreth qafës sate.»

Fjalët e Emersonit janë dëshmuar si profetike. Partia Komuniste Sovjetike u ka vënë zinxhirë kundërshtarëve të vet politikë: së pari, monarkistëve, pastaj çifligarëve, socialistëve opozitarë, udhëheqësve kombëtarë që i përkasin kombit rus, dhe i kanë shtypur kombët tjera, ukrainasit, bjellorusët dhe gruzinët. Por pastaj skaji tjetër i zingjirit iu është lidhur për qafe edhe komunistëve. Shoku Krushov e tha këtë në një fjalim në Kongresin e njëzetë të Partisë. Ai theksoi se Stalini i ka likuiduar gati të gjithë anëtarët e Komitetit Qendror me spastrimet e tij famëkëqija.

Krishterimi nuk është në anën e skllavërisë, por komunizmi është në atë anë.

Linkoln në mesazhin e tij të Kongresit të Një dhjetorit, 1862, ka thënë: «Duke ua dhënë lirinë skllavëve, ua japim lirinë të lirëve.»

Që nga lufta e Dytë Botërore, vendet krishtere i kanë liruuar kolonitë e tyre. Në anën tjetër pushteti sovjetik i ka robëruar popujt baltik, hungarezet, çekët. Komunistët kinezë kanë robëruar Tibetin.

I këshilloj miqtë ateistë që ta kujtojnë thënien e vjetër: «Mos fol për litar në shtëpinë e atij që ka varë veten.»

Do të ishte më mirë për komunistët mos ta përmendin skllavërinë. Unë vetë kam qenë skllav në një kamp komunist.

Por këto argumente nuk janë të domosdoshme sepse, si zakonisht, *Libri ateist* e kundështron vetveten. Për ta shpjeguar rritjen dhe fitorën e mrekullueshme të krishterimit, ateistët, që nuk e pranojnë se Perëndia vepron në këtë çështje, thonë se shumica e të kthyerve në krishterim kanë qenë skllavër «sepse skllavërit në rrethet krishtere fitonin një pozitë të cilën nuk mund ta gëzonin me të tjerët».

Pali në letrën që ia dërgon Filemonit e porosit atë që ta pranojë një shërbëtor që i kishte ikur, jo vetëm pa e ndëshkuar por ta pranojë «si vëlla të dashur». Ky ishte shpirti i krishterëve të parë.

Atëherë pse, pra, të krishterët e parë nuk e zhduken skllavërinë? Sepse kanë qenë të persekutuar. Nuk kishin ndikim në shtet. Shumica prej tyre kanë qenë vetë skllavër. Vetëm pak kohë më parë një kryengritje e madhe skllave e organizuar nga Spartaku qe shtypur me gjak dhe me dhjetra mijëra skllavër u kryqëzuan. Vetëm të marrët ngrejnë krye kur e dinë se kryengritja do të pësojë disfatë.

Perëndia është paraqitur vetëm një herë në Malin Sinaj kur i jep Dhjetë urdhëresat. Mënyra se si paraqitet është kjo: «Unë jam Zoti, Perëndia yt, i cili të nxori nga Egjipti, ku ishe skllav.» Perëndia i paraqitet popullit të

vet si çlirues i skllavërisë më tepër sesa krijues i qiellit e tokës. Ky është Zoti ynë.

Na bën për të qeshur *Libri ateist* kur lexojmë se besimi i krishterë «u ka shërbyer dhe u shërben klasave mbizotëruese, e përkrah dhe e përforcon rendin shoqëror dhe politik që është i bazuar në shfrytëzimin dhe shtypjen, etj, etj.»

E dimë se nuk duhet të brengosemi për akuza të tilla, sepse e dimë se kemi të bëjmë me akademikët. Me shkurtëpamësinë karakteristike, ata nuk dinë të shkruajnë në mënyrë thukët. Këtë e shohim kur vazhdojmë të lexojmë më tutje. Vini re se ç'thonë të njëjtit autorë në një pjesë tjetër të librit: «Udhëheqësit e Reformacionit e kanë përkthyer Shkrimin e shenjtë në gjuhë të ndryshme. Bibla për herë të parë arriti tek masat e gjera popullore, që së shpejti në njërën prej tezave të saja zbuluan se është e arsyeshme të luftohet për barazinë shoqërore.» Ja, pra. «Bibla arsyeton luftën për barazinë shoqërore.» «Bibla mëson skllavëri dhe nënshtim ndaj tiranëve.» Dy thënie nga i njëjti grup autorësh në të njëjtin libër!

Akademikët që shkruan *Librin ateist* mund të mendojnë çka të duan. Eprorët e tyre dijnë më mirë. Ata e dijnë se të krishterët nuk janë servilë të diktatorëve. Kjo është dëshmuar me vrasjen e miliona vëllezërve dhe motrave dhe dhjetra e mijëra të tjerë që ende janë në burgje.

Ateistëve më mirë u bie të kenë kujdes e mos ta përmendin përkuljen para sundimtarëve mizorë. A nuk e kanë hyjnuar Stalinin, të cilin tash e shpallin njërin ndër vrasësit më të mëdhenj në histori? Anëtarët e Akademisë së Shkencave nuk janë fare të rinj. Prandaj, ata kanë qenë lajkatarë të Stalinin, ose përndryshe nuk do të ishin gjallë për ta gjykuar.

Unë kam qenë në burg gjatë regjimit të Stalinin dhe pasardhësve të tij. A nuk duhet të ketë të njëjtat të drejta kisha e nëndheshme e Rusisë sikur edhe ateistët për ta kundërshtuar tiraninë? Po çka thuani për hyjnimin e vra-

sësit tjetër Mao Ce Dunit të Kinës së kuqe? Të gjithë komunistët kinezë, ateistët, i përkulën. Mbi një milion të krishterë kinezë janë vvarë, por më parë kanë pranuar të vdesin sesa t'i përlulën atij.

Të krishterët e vërtetë kanë qenë dhe janë luftëtarë për liri. Rreth kësaj çështje nuk kemi nevojë të mësojmë asgjë nga miqtë tanë ateistë. Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Australia nuk kanë kampe për skllëvër. Bashkimi Sovjetik e Kina e kuqe kanë.

T'i paraqitësh të krishterët si lajkatarë të tiranëve është sikur t'i paraqitësh në karikaturë. Prandaj, krishterimi nuk është ajo që e hedhin poshtë ateistët, por një parodi e saj.

Parajsa qiellore apo tokësore

Libri ateist e citon Fridrih Engelsin kur thotë se shpresa e të krishterëve është në qiell, në jetën e përjetshme pas vdekjes. Sipas tij krishterimi nuk ka dëshirë të bëjë transformimin shoqëror në këtë botë.

Nga ana tjetër, lëvizja komuniste synon drejt çlirimit të tërë klasës punëtore në botë.

Kjo është një rrenë e kulluar.

Nuk është e vërtetë se të krishterët kanë vetëm synim qiellor. Jezusi na mëson të lutemi me këto fjalë: «U bëftë vullneti yt, si në qiell ashtu në tokë!» Te Gjoni 3:12 Jezusi na përkujton: «Kur ju flas për gjëra që ndodhin në tokë...»

Luka në fillim të ungjillit të tij na tregon se kur njerëzit e pyeten Gjon Pagëzuesin ç'të bënin, ai nuk u përgjigj, «luftoni për jetën e përjetshme.» Gjoni u përgjigj në mënyrë tokësore: «Kush ka dy palë petka le t'i ndajë me atë që nuk ka. Edhe ai që ka ushqime le të bëjë ashtu.» Tagrambledhësve iu tha: «Mos kërkoni asgjë më tepër se ju është caktuar.» E ushtarëve nuk u tha, «kërkoni paraj-

sën», por u tha: «Askënd mos merrni me të keq! Askënd mos paraqitni rrejshëm dhe jini të kënaqur me rrogën tuaj», që ishte mbi mesatarën e rrogave të atëhershme (Luka 3:11-14).

Jezusi i dëboi tregtarët nga Tempulli me kamxhik. Ai botërisht i akuzoi skribët dhe farisenjtë për gëlltitjen e pasurisë së vejushave. Një djaloshi të pasur i tha: «Nëse do të jesh i përsorur, shko, shit çka ke, faljau skamnorëve» (Mateu 19:21).

Krishterimi në programin e vet ka edhe transformimin e shoqërisë së kësaj bote. Është fakt i çuditshëm se anëtarët e qeverisë sovjetike vetë thonë se duhet ta arrimë e ta tejkalojmë nivelin ekonomik të vendeve me trashëgim krishterë, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndoshta ata kanë jetë më të pasur nën hijen e krishterimit sesa qytetarët e Bashkimit Sovjetik.

Në Amerikë dhe në vendet tjera të perëndimit, punëtorët mund të shkojnë me vetura në kishë, ose të shpallin grevë për rritjen e rrogave. Në Bashkimin Sovjetik punëtorët nuk kanë as biçikleta për të shkuar në mbledhjet komuniste nga të cilat nuk guxojnë të mungojnë.

Pasuria dhe liria e Perëndimit nuk janë fituar pa luftë. Megjithatë, po të kishin qenë të drejta qortimet e Engelsit që ia bënë krishterimit, kjo luftë nuk do të kishte ndodhur.

Engelsi shkruan: «Doktrinat shoqërore të ungjijve paraqesin një rezistencë fetare pasive kundër padrejtësisë, revoltë të gjunjësuar, që në fakt do të thotë justifikim i të shtypurit dhe, në rend të parë, justifikim i parimit të së keqes shoqërore të lashtësisë — skllavërisë. Krishterimi nuk është ideologji e njerëzve të shtypur që ngriten në luftë revolucionare, por ideologji e njerëzve të shtypur që i kanë humbur shpresat për të luftuar dhe kërkojnë çlirim në lutje dhe shpresojnë në shpëtim me anë të mrekuillive.»

Kjo është gabim. Mësimi kryesor i Ungjillit është se i krishteri duhet ta ndjekë shembullin e Krishtit. A ka qenë

Krishti pasiv kundër padrejtësisë? Ç'mendojnë tregtarët që i ka dëbuar me kamxhik për qëndrimin e tij. A është rezistencë pasive kur ai ballafaqohet me priftërinjtë dhe farisenjtë në tempullin e tyre, kur i quan gjarpërinj dhe hipokritë?

A është «Himni», kënga lavdëruese e virgjres Mari, këngë dorëheqjeje? Ajo thotë se Biri i saj do t'i rrëzojë princat prej froneve të tyre dhe do t'i lartësojë të përvujtit. Ai do t'i mbushë me të mira ata që nuk kishin ç'të hanë e të pasurit do t'i kthejë duarthatë. Ky nuk duket të jetë nënshtrim i urtë ndaj shfrytëzuesve.

Urtësia i mëson nxënësit e Krishtit të jenë pasiv e të butë ku nuk ka shpresë për ta përmbysur tiraninë, por kudo që kushtet për një përmbysje të tillë kanë qenë të pjekura, të krishterët kanë luftuar për të.

Kur fshatarët u ngritën kundër çifligarëve në kohën e reformacionit, argumentet kryesore kanë qenë fetare.

Himnet e tyre revolucionare ishin:

«Kur Adami rrëmihte e Eva turrte,

Kush pra ishte zotëriu?»

Dhe:

«Kala e fortë është Zoti ynë,

Fortesë që kurrë nuk thyhet.»

Kur filloi lëvizja e proletarietit industrial në Britani, kënga e të krishterëve qe:

«Bijtë e Britanisë, ndonëse jeni në skllavëri, Zoti, Krishtesuesi juaj, u dha liri; të gjithëve jetë dhe liri u dhuroi, por askurrë skllav nuk krojioi.»

Të parët që i organizuan demonstratat të cilat çuan në Revolucionin e vitit 1905 në Rusi nuk qenë miqtë tanë komunistë, por punëtorët krishterë nën udhëheqjen e priftit Gapon. Komunistët përfituan nga kjo dhe më vonë e varën priftin.

Krishterimi është aq revolucionar sa edhe komunizmi, por revolucionet tona dallohen. Revolucionet komuniste fillojnë me gjakderdhjen e kundërshtarëve të tyre, të pa-

fajshme ose të dikujt tjetër. Atëherë gjakderdhja kalon në shprehi, madje edhe në kënaqësi, dhe në fund kemi një tirani më të keqe se ajo që është përmbysur.

Lenini një herë ka shkruar: «Terrori e Çeka janë absolutisht të domosdoshëm.» Cari Nikolas II kurrë nuk e ka llogaritur terrorin në domosdoshmëritë politike.

Sa njerëz ka vrarë? Sa njerëz ka vrarë Kerenski? Atëherë pyete veten sa njerëz ka vrarë Stalini?

Është shumë e mundur se ai vetë e ka helmuar Lenin, i cili ia kishte mësuar metodën e terrorit. Pastaj i vrau gati të gjithë shokët e ngushtë të Leninit.

Bile edhe sot, një numër i madh qytetarësh sovjetik vdesin nga uria dhe nga mundimet në kampet përqendruese të Rusisë. Komunizmi po vret me miliona njerëz në Kinë. Terrorin e atjeshëm e pohojnë edhe gazetatat sovjetike. Në Poloni, Gomulka, duke ushtruar diktaturën e proletariatit, vrau proletarët. Revolucionet komuniste gjithmonë janë negative dhe destruktive.

Ne të krishterët jemi revolucionarë në një kuptim krejtësisht tjetër. Të krishterët së pari dhe më së shumti e përdorin shpatën e Shpirtit Shenjt, e cila vret mëkatin pa e vrarë mëkatarin.

Me shpatën e Shpirtit Shenjt, të krishterët kanë përmirësuar shumë keqtrajtime. Aty ku mbretëron qytetrimi i krishterë, njerëzit janë të lirë, të lirë bile edhe për të qenë ateistë. I thërras kundërshtarët e mi të ndershëm ta japin emrin e një personi të vetëm që është burgosur për shkak se është ateist në Shtetet e Bashkuara, Britani të Madhe ose në Gjermani. Por në vendet komuniste me miliona vëllezër e motra besimtarë janë burgosur ose janë vrarë. Kush ka luftuar për liri dhe kush e ka fituar atë — ateistët apo të krishterët?

Të krishterët nuk e përjashtojnë domosdoshmërinë e kundërshtimit ndaj tiranisë. Por shtypësit me mizoritë e tyre i detyrojnë të ngritën kundër tyre dhe kur rrethanat janë të volitshme, qëllimi i tyre gjithmonë është që ta

zëvendësojnë tiraninë me regjim që e do paqen e drejtësinë, ndërsa Marksi e përkrahte «revolucionin e përhershëm», shprehje të cilën ai e shpiku. Për çka revolucion i përhershëm? Revolucion për hir të revolucionit? Mos të arrihet asnjë qëllim? A nuk do të ketë një utopi si qëllim? Ky është sadizëm i pastër.

Të krishterët nuk e harrojnë se kryengritësi i parë qe djalli. Ata nuk përdorin kryengritjen si mjet në radhë të parë, bile as kundër regjimit komunist.

Ata janë të interesuar për fatin e gjërave në tokë, porse kanë synime më të mëdha se vetëm për gjërat materiale. Njeriu është si bretkoca që jeton në fund të një pusi të errët, nga i cili nuk mund të shohë asgjë jashtë në botë. Besimtarët janë njerëz, të cilët ndonëse jetojnë në kushte të tilla, e dëgjojnë këngën e laureshës. Dhe mrekulli mbi mrekullitë — ata e kuptojnë këngën! Ajo flet për diellin, hënën, yjtë, malet e kodrat e blerta dhe për detin e mrekullueshëm. Ata kanë besim në këtë këngë. Ata janë të sigurt se ekziston parajsja qiellore. Pa i braktisur gjërat tokësore, ata luftojnë për këtë dhe i ftojnë edhe të tjerët në këtë luftë.

Nëse ka njeri që beson në mundësitë e evolucionit më shumë se Darvini, atëherë është i krishteri që bën këtë. Ai beson në lindjen e sërishme shpirtërore. Ai beson se bretkoca mund të bëhet laureshë, se njeriu mund të bëhet pjesëtar i natyrës hyjnore, dhe këtë jo me anë të një procesi të gjatë, por menjëherë me anë të besimit në Jezu Krishtin.

Duke i besuar të gjitha këto, të krishterët luftojnë për drejtësi e njëkohësisht luftojnë për parajsën qiellore.

A ka Zot?

Deri tash në këtë libër kam ndjekur porosinë e Jezusit: «Nëse ndokush të detyron të ecësh me të një milje, ti bëj dy.»

Kundërshtarët e mi me argumentet e tyre donin të ndjeknin një drejtim të caktuar. Unë kam ecur me ta. Kam diskutuar për argumentet e tyre bile edhe kur çështja nuk ka qenë aspak me rëndësi.

Por tash dëshiroj të përqendrohem në çështjen kryesore mes atesitëve dhe të krishterëve: A ka Zot të cilin duhet ta adhurojmë, të mbështetemi në të, i cili na mbron dhe na ngushëllon, apo nuk ka?

Sipas R. Garodit, teoricient komunist francez, tërësia dhe absolutësia nuk është Zoti, por «emri njeri». Nuk ka asgjë më të lartë se njeriu. Të krishterët besojnë në Zotin, në premtimet që jep për këtë jetë dhe për jetën e përjetshme. Garodi shkruan: «Ne ateistëve asgjë nuk na është premtuar dhe askush nuk na pret.» Vërtet fjalë të pikëllueshme! Ateistëve nuk u është premtuar bile as miqësia e shokëve të tyre. Garodi, pasi i shërbeu Partisë komuniste tërë jetën, në fund u përjashtua nga Partia. Askush nuk e priti t'ia shtrijë dorën për ndihmë ose në shenjë miqësie kur që i pikëlluar. Mbeti i vetmuar.

Një kompozitor i ri ishte i varfër dhe paguante një dhomë me qira. Një mik e inkurajoi duke i thënë: «Kur të vdesësh, do ta vëjnë një mbishkrim në mur të kësaj shtëpie.» Kompozitori u entuziazmua: «E ke përmjëmend?» «Po», iu përgjigj ai. «Do të ketë një mbishkrim JAPIM DHOMË ME QIRA.» Nuk ka çka të pres Garodi më shumë pas vdekjes. Bile edhe në këtë jetë, përjashtimi nga Partia vetëm ia lëshon vendin një tjetri që mashtrohet si ky.

Njeriu është Zot. E tërë kredoja komuniste jeton me këtë besim.

Duke pasur para sysh këtë mashtrim një poet ilegal sovjetik, I. Gabai, u shty të shkruaj këta rreshta:

Kredoja e vonshme e Jobit

Unë jam zot vetë. Por çfarë zoti qyqan e i çuditshëm,
I paarsyeshëm, i çmendur dhe krahëthatë.
Zoti mos e dhashtë që dikush ta dojë një zot të tillë
As të jetë si ai — Zoti ju ruajt prej tij!
Zot? — ndoshta. Zot i egër, i mbrapshtë.
Por nëse me të vërtetë unë jam «njeri i padjallëzuar»,
Zoti të ndihmoftë ty të bëhesh ateist i qetë;
Të jesh zot — Zoti mos e dhashtë!
Jam zot — por i pafuqishëm në trazira.
Dhe përmes logjikës së kufijve të prisht,
Muzetë tani banojnë në tempuj,
Dhe zotat banojnë në mesin e turmave.
Më fal për maninë e madhështisë,
Por nuk ka madhështi të Zotit në fatin tim.
Veten ta ndëshkoj dhe t'ia fali mëkatët vetes.
Më fal për maninë e madhështisë!
Madhështia e Zotit për të ndëshkuar —
Këtë nuk ia dëshiroj asnjë fqinji,
Nuk guxoj ta dua një urdhër të tillë.
Zoti mos e dhashtë që t'i përkuleni këtij zoti,
Ta shfajësosh veten ose ta shkarkosh nga faji.
Unë jam ai që jam. Zoti — vetëm Ai është Zot.
Sa krenari e madhe, sa pikëllim;
Zoti mos e dhashtë që t'i besosh vetëdijes sate
Dhe të jetoni duke e thirrë atë. Zoti mos e dhashtë!

A ka Qenie më superiore se njeriu? A ka Zot, në kuptimin e zakonshëm të kësaj fjale, Krijues të qiellit e tokës, Ai për të cilin Jezusi na mësoi na quajmë Atë?

Në Tempullin e Jeruzalemit (sikur edhe në shumë tempuj egjiptianë dhe mitraist), ka ekzistuar vendi tejet i shenjtë në të cilin mund të hynte vetëm kryepriifti një

herë në vit, në kuadër të ceremonisë impesive fetare.

Në kohën e Jezusit vendi tejet i shenjtë ishte i zbrazët. Arka e besëlidhjes e pruar, në të cilën ruheshin rrasat ku ishin të shkruar urdhrat e Perëndisë, ishte bartur dhe fshehur disa shekuj më parë nga Jeremia në kohën e pushtimit babilonas. (2 mbi Makabenjtë 2:1-7). Kur u rindërtua Tempulli pas çlirimit të judenjve nga robëria, arka e shenjtë nuk u gjet. Absolutisht nuk kishte mbetur asgjë në vendin tejet të shenjtë.

Kjo zbrazëti kishte një kuptim simbolik.

Kabala, libër i shenjtë i judenjve që përmban tradita të vjetra fetare, e quan Zotin «Ein» — i paqenë. Duket gjë e çuditshme nëse e gjejmë një libër të thellë fetar me një emër të Zotit me të cilin ateistët do të pajtoheshin. Mirëpo kuptimi është i qartë për ata që e njohin Zotin.

«Zoti nuk është» në atë kuptim «ai nuk është çka ne mendojmë se është.» Mendimet tona nuk janë mendime të tij, as rrugët tona nuk janë rrugë të tij.

Mirë e ka pasur Fojerbahu kur ka thënë se njeriu i ka krijuar perënditë sipas imagjinatës së vet. Por Fojerbahu nuk ka qenë origjinal. Ai e thotë këtë me qëllim që të kundërshtojë. Luteri, njëri prej mendimtarëve fetar më të mëdhenj në histori, pat thënë tre shekuj më parë: «Fides est creatrix Dei» (besimi është krijuesi i Zotit).

Njeriu mendon për shkaqet dhe qëllimet e sendeve, për misterin e natyrës dhe të jetës dhe mendja e tij e pjell nocionin për Zotin. Zoti është biri i tij, bir i dashur i mendjes së tij. Por posa njeriu ta kuptojë, atëherë menjëherë vjen në përfundim se Zoti është krijuesi i të gjitha gjërave dhe i vetë atij, se ai ka ekzistencë objektive jashtë vetëdijes së tij, se njeriu i ka borxh atij gjithçka. Kësisoj prej Zotit Biri, vjen deri të nocioni Zoti Ati. Këto dy nocione i mësojmë në Bibël dhe janë të lidhura njëra me tjetrën në mënyrë të papërshkrueshme, me dashuri të patregueshme, Shpirtin e shenjtë. Zoti e ka krijuar njeriun që ka besim. Besimi e krijon nocionin «Zot».

Në këtë mënyrë e kuptojmë nocionin për Zotin.

Por Zoti, Krijuesi ynë, i kalon aftësitë tona. Ai nuk është vetëm aq sa mund të kapë mendja jonë.

Teologjia ka dhënë shumë argumente se Zoti ekziston. Këtyre argumenteve, kundërshtarët e besimit u kanë sjellë kundërgargumentet.

Unë nuk do të grindem. Vaj për atë Perëndi që ka mbetur ta mbrojë dikush. Zoti mund ta zbulojë veten. Nuk ka nevojë të sjellim prova për ekzistencën e diellit — aq më pak atëherë për Krijuesin e tij. Ka çaste kur diellin e mbulojnë retë. Atëherë ata që dëshirojnë ta shohin duhet të presin. Nëse Zoti dëshiron të fshihet e t'ju zbulohet vetëm atyre që e kërkojnë me zell, duhet ta respektojmë vullnetin e tij.

Zoti e përdor dritën për t'i dhënë jetë çdo qenie, por as Zoti as drita nuk shihen. Kush e ka parë dritën ndonjëherë? Në një gyp pa ajër të mbyllur krejtësisht nuk shihen rrezet e dritës. Atë që e quajmë ne pamje e dritës është pamje e objekteve që ajri i ndriçon me anë të dritës. Drita në vete është e padukshme.

Duhet t'i lësh anash ndjenjat e arsyes kur dëshiron ta njohësh Zotin, ndonëse arsyeja mund të ndihmojë.

Njeriu vështron qëllime në natyrë. Fara e mbjellur në tokë varet nga kushtet si nitrogjeni, ajri dhe uji të cilat i nevojiten për të dhënë fryt. Rezultati shihet kur të rritet bima. Qëllimi është të japë fryt. Vezorja e mbarsur e merr ushqimin e nevojshëm nga mitra për t'u bërë foshnjë. Prapë është në pyetje arritja e qëllimit. Por as fara as vezorja nuk mund t'ia arrijmë qëllimit. Këto duhet të vijjnë nga një Qenie e dijshme, që ushtron ndikim mbi to.

Përveç kësaj, shohim se njeriu i përshtatet ambientit, ose përndryshe nuk do të kishte arritur deri në ditet tona. Domethënë, përkundër keqpërdorimeve që bën njeriu, ne jetojmë në një realitet i cili, nganjëherë me përpjekjen tonë e nganjëherë edhe pa të, na jep atë atë që është e nevojshme për jetë. Kur të lindemi, si foshnje nuk mund

të konsumojmë asgjë tjetër përveç qumështit, dhe pak kohë para se të lindemi, në gjirin e nënës mblidhet qumështi. Gjatë rritjes kemi nevojë për qumësht më të trashë, gjë që edhe ashtu ndodh në gjirin e nënës, pra, qumështi ndryshon sipas nevojave tona.

Në lindim me mushkëri dhe gjejmë ajrin. Kemi nevojë për ujë dhe ai është i siguruar. Pas disa muajsh kemi nevojë për lëndë të tjera ushqyese që gjenden në perime e mish të cilat gjithashtu ekzistojnë në botë.

Jemi të ndjeshëm ndaj sëmundjes. Por tash e dimë se dikush i ka përgatitur ilaçet kundër sëmundjeve të ndryshme që janë bërë nga bimët, kërpudhat ose nga kristalet e tokës.

Për çdo nevojë njerëzore ekziston realiteti përkatës që shërben për ta furnizuar atë.

Çfarë arrogance apo injorance na bën të mendojmë për një nevojë tejet themelore, për etjen e shpirtit tonë pas Zotit — etje që ka krijuar shumë mitologji dhe religjione — a s'ka realitet që ia plotëson dëshirën.

Një ditë vjeshte një sorrë fliste me një dallendyshe të re një vjeçare. Sorra i tha dallendyshe: «Po shoh se po bëhesh gati për udhëtim të gjatë. Për ku po fluturon?» Dallendyshja iu përgjigj: «Po ftohet koha këtu. Mund të ngrihem. Po fluturoj për një vend më të ngrohtë.» Sorra e mençur e qeshi: «Por mos e harro vendlindjen. Ti je lindur këtu para pak muajsh. Si e di ti se ka vend më të ngrohtë për t'u strehuar derisa bën ftohtë këtu?» Dallendyshja u përgjigj: «Ai që ka vënë dëshirën në zemrën time për vende të ngrohta nuk më ka mashtruar. Unë i besoj atij, prandaj po nisem.» Dhe dallendyshja gjeti çka kërkonte.

Në këtë mënyrë vepron çdo shpirt që ka besim.

Shpirti i njeriut bëhet i ftohtë si akulli pa Zotin. Ndoshta ju kujtohet Homunkuli — njeriu i krijuar artificial në një epruvetë në pjesën e dytë të Faustit. Gjithmonë kishte të ftohtë. Njeriu ngrihet kur mendon për vete se

është vetëm si një vepër e ndërlikuar e reagimeve kimike. Ne shpresojmë në një Atë, burim i ngrohtësisë, dashurisë dhe dritës. Ashtu si plotësohen nevojat themelore të njerëzimit në realitet, po ashtu plotësohet edhe nevoja e shpirtit. Ne mund ta gjejmë dhe ta njohim Zotin.

Megjithatë, asnjë lëmi nuk mund të gjurmohet pa mjete. Nuk mund t'i shohim yjtë me anë të mikroskopit ose mikrobet me anë të teleskopit. Njerëzit që nuk dinë të mendojnë mirë vijnë në përfundim se Zoti nuk ekziston për shkak se nuk mund ta kapin me anë të shqisave, që janë funksionim i jetës në sferën e materjes. Shqisat nuk janë mjet i mirë për ta parë Zotin.

Ashtu sikur mikrobiologjia që i ka instrumentet e posaçme e astronomia të vetat, ashtu edhe besimi ka një instrument të vetin me anë të të cilit mund ta shohë Krishtin. Jezusi thotë: «Lum ata që janë të pastër në zemër sepse do ta shohin Perëndinë.» Ki zemër të tillë sepse edhe ti do ta shohësh!

Me siguri lexuesi do ta kuptojë se fjala «shoh» ka dy kuptime. Njeriu sheh një objekt material sepse fotonet që reflektohen nga ai objekt bien në sy. E shoh drejtësinë e një çështjeje duke i peshuar argumentet në mendje. E shoh dashurinë e një personi ndaj meje me anë të sjelljeve të tij. I mbylli sytë dhe mund ta evokoj figurën e dikujt që e dua edhe pse është larg prej meje. Asnjë foton nuk kthehet në sytë e mi por megjithatë e shoh. Mund t'ua tregoj ëndrrat e fantazitë. Gjysmën e jetës e shohim në këtë mënyrë.

Si e shohim Zotin?

Në imagjinatën tonë ruhen imazhe, dhe mund ta marrin një imazh si prej albumit. Por nuk janë vetëm imazhet e botës materiale që ruhen në këtë kasafortë. Ekzistenca ime nuk fillon në ditën e lindjes as në ditën e shtatzënisë. Unë kam ekzistuar përgjithmonë në mendjen dhe planin e Perëndisë. Kam ardhur në këtë botë për një kohë të shkurtë si një shtegtar dhe i huaj.

Një kohë kam jetuar si kërthi. I kam imazhet e asaj kohe njësoj sikur edhe ato të mëvonshmet, veçse nuk mund t'i evokoj këto nga jeta e foshnjërisë. Por psikanaliza ose hipnoza mund ta vërtetojnë se ato janë aty. Ato mund të riaktualizohen.

Kështu çdo njohje për Zotin është rinjohje. Zemra që është pastruar nga mëkatet, nga pasionet, gabimet, frika, brengat dhe urrejtjet përsëri mund ta shohë Zotin, nga i cili vjen.

Por duhet t'i cilësojmë fjalët «shoh» dhe «imazh» në këtë raport, sepse e shoh një realitet për të cilin nuk ka shprehje në gjuhën njerëzore.

Kur Marko Polo, evropiani i parë që shkoi në Kinë, u kthye e u tha miqve të vet se kishte takuar njerëz të verdhë me sy të pjerrtë e flokët gërshet, ata e quajtën: «Marko Polo, gënjeshitari». Çfarë mundësish kishte për t'i vërtetuar fjalët e veta? Ai vetëm mund t'u thoshte: «Shkoni atje ku kam qenë unë, ballafaqohuni me rreziqet që kisha unë, kaloni vështirësitë nëpër të cilat kalova unë, atëherë edhe ju do t'i shihni.»

Unë nuk mund ta bind një skeptik se virusi ekziston. Ai vetë duhet ta shikojë në mikroskop.

Lum ata që janë të pastër në zemër sepse do ta shohin Perëndinë. Njëri prej problemeve për ta njohur Zotin është pastërtia e karakterit. E vërteta themelore është monopol i patjetërsueshëm i pastërtisë. Kur dikush më flet për Zotin ose kundër tij, zakonisht i bëj këtë pyetje: «Sa i pastër je ti që të mund të jesh i besueshëm? Vetëm ata që janë më të bardhë se bora mund ta njohin këtë çështje.»

Kush është Zoti?

Derisa ateistët nuk e pranojnë fljimin e Krishtit në kryq që na pastron nga mëkatet, nuk mund ta shohin Zotin. Por kanë të drejtë të na pyesin: «Ju që thoni e shohim Zotin, na tregoni kush është ai!»

Pyetje shumë e rëndësishme për të dy palët! Ateistët mund të thonë: «Kush është ai ekzistencën e të cilit po e mohojmë?», sikur edhe të krishterët që mund të përgjigjen: «Kush është ai që i besojmë?»

Pra, kush është Zoti?

De Brogli, teoricienti më i madh bashkëkohor për çështjet e dritës, shkruan: «Sa do të kishim ditur nëse e dimë se çka është një rreze drite.» Biologu i shquar Jakob von Jeksyll shkruan: «Askush prej nesh nuk e di se çka është jeta.» Ndërkaq ne duhet të përgjigjemi kush është Ai që jep jetën dhe dritën!

Ku qëndron vështirësia për t'u përgjigjur? Kur pyesim: «Çka është drita ose jeta?» ose «Kush është Zoti?» vështirësia nuk qëndron në fjalët «Çka», «Kush», «jeta», «drita» ose «Zoti». Në njëfarë mënyre mund ta shpjegojmë se çka dëshirojmë të themi me këto fjalë. Ajo që ia prish kuptimin është fjala më e vogël në pyetjen e parashtruar, fjala «është». Çka do të thotë fjala «është»? Nëse nuk e kuptojmë këtë, atëherë e tëra mbetet enigmatike.

Një ndarje e madhe kalon nëpër krishterim që përqendrohet rreth fjalës «është». Sipas Dhiatës së Re, që është shkruar në greqisht, Jezusi në darkën e fundit me nxënësit e vet para se të kryqëzohej, ua ndau bukën e ua dha duke u thënë: «Ky është trupi im», dhe kupën me verë, duke thënë: «Ky është gjaku im.» Të krishterët ortodoks dhe katolik besojnë se fjala «është» në këtë kontekst ka vetëm një kuptim: se të krishterët gjatë kungimit hanë korpin dhe pinë gjakun e vërtetë të Jezusit. Kur priftërinjtë përsërisin fjalët e Jezusit gjatë liturgjisë, ndodh një

ndryshim në elemente. Së jashtmi, ato mbetën buka dhe vera. Por brendia është transformuar. Ajo që ishte buka dhe vera është bërë trupi i Krishtit. Protestantët e lexojnë të njëjtën Bibël dhe ndryshe e shpjegojnë fjalën «është». Për ta kjo fjalë do të thotë se buka gjatë kungimit të shenjtë simbolizon trupin e Krishtit, mirëpo megjithatë është vetëm bukë, por që ka një vlef të tjetër, sikur unaza kur ta jep e dashura.

Vetë fakti se mijëra libra janë shkruar rreth kësaj çështje dhe se institucione të mëdha janë ndarë tregon se fjala «është» nuk është aq e thjeshtë sa duket. Ju që doni ta dini «Kush është Zoti?» ose «Çka është drita?», na thuani së pari se çka kuptoni me fjalën «është».

Krishterimi nuk ka qëndrim negativ ndaj kulturave të mëparshme. Siç kemi thënë, ai përfshihet në të menduarit e filozofisë greke kryesisht nga Aristoteli. Krishterimi mori konceptin e një Zoti i cili, pa lëvizur vetë, shkakton të gjitha lëvizjet e botës. Ai rri i qetë në fronin e patundshëm dhe i sundon të gjitha sendet e të gjithë njerëzit që janë në lëvizje të përhershme. Aristoteli kishte për të thënë se Zoti «është» në kuptimin më të thellë të fjalës.

Por një lëvizës i palëvizur është i pakapshëm për mendjen. Ajo që është e palëvizshme nuk mund të jetë aktive. Motori që e lëviz një makinë i ka lëvizjet e veta. Motorin e vë dikush në lëvizje — atëherë ai lëviz.

Realiteti nuk njeh qenie. Kanti në «Kritikën e arsyes së pastër» shkruan: «Të jesh nuk është kallëzues i vërtetë... Në përdorimin logjik është vetëm lidhje këpujore ose lidhje e një mendimi.» Të thuash Zoti është i mirë ose i drejtë ka kuptim. Të thuash se Zoti ose ndonjë send tjetër është, d.m.th. të mbetësh në sferën e fjalëve të kota.

Kur e pyesim veten çka do të thotë Qenie, përgjigjja është se qenia ekziston vetëm si diçka që është, zhvillohet, lëviz dhe ndryshon. Herakliti ka thënë: «Panta rhei» — «Gjithçka rrjedh.» «Nuk mund të lahesh dy herë në të

njëjtin lumë.» Nuk mund të lahesh bile as «një herë», sepse gjatë kësaj kohe ndërsa lahesh trupi yt ndryshon, gjithashtu ndryshon edhe lumi.

Pjesët prej të cilave përbëhet bota, elementet kimike, si dhe realiteti shpirtëror, nuk janë ekzistencë, por ngjarje, ndodhi. Ndërsa unë e shqiptoj fjalën «hekur», elektronet në atome të hekurit sillen me miliarda herë rreth bërthamës. Kur të vij tek shkronja e fundit ‘r’, hekuri nuk është më në të njëjtën gjendje sikur ishte kur e shqiptova shkronjen ‘h’. Zbritni në fushën e mikrofizikës dhe do ta shihni rëndësinë për ta kuptuar këtë. Asnjë grimcë elementare në lëvizjen e saj të vazhdueshme nuk ka durim të mjaftueshëm të qëndrojë në vend të vet të paktën të më japë kohë sa të them se «ajo është». Ndërsa them «Atomi është», ai jeton një histori aq të pasur sa në krahasim me të e tërë historia e njerëzimit duket një gjë e vogël. Sër James Jeans ka thënë: «Materja nuk është diçka që është, por diçka që ndodh.» Materja nuk është ekzistencë por rrjedhë. Çdo gjë — e sidomos qenia e gjallë — ndryshon dhe përtërihet pëherë.

Si mundet të qëndrojë pa lëvizur ai që lëviz gjithçka? Po të ishte i lejuar pikturimi i Perëndisë dhe po të mund ta paraqiste realitetin, piktura me besnike e Perëndisë do të ishte ajo e Mikelangjellos në tavanin e Kapela Sistinas, që e paraqet Perëndinë duke fluturuar në stuhi. Në librin e Biblës «Ruta», lexojmë për krahët e Zotit.

Kundërshtarët e mi thonë se Zoti nuk ekziston. Ata nuk e dinë se mësuesit e krishterë të rangut të lartë e patën thënë këtë kohë më parë, megjithëse ata i dhanë këtij mohimi kuptim të drejtë. Filozofi skolastik Gjon Skot Erigena, shkruan: «Drejtëpërdrejt, Zoti nuk ekziston, sepse ai ia tejkalon qenies.» Toma Akuinsi thotë: «Qenia hyjnore, që në përmbajtjen e vet, nuk është ‘ekzistencë’ e zakonshme. Është një qenie ndryshe nga çdo qenie tjetër. ‘Esse’ hyjnore (latinisht: jam, ekzistoj) nuk është ‘Esse’ e zakonshme.»

Fjala «qenie» nuk është vetëm emër por është edhe folje. Asnjë qenie e krijuar nuk mund të shprehet vetëm me anë të emrit, sepse zhvillohet, lëviz, jeton një histori. Kategorinë «është» nuk mund ta zbatosh në kuptimin e kufizuar për të pasur një gjendje të caktuar të krijimit, e aq më pak të Krijuesit. Kur thoni «Zoti është», nuk keni thënë asgjë për të. Zoti ndodh.

Ekziston një ndodhi, «Hyjnia». Ai është ardhja dhe bërja vigane. Emri i tij në hebraisht quhet «El», që shpreh marrëdhënie: «El» d.m.th. «drejt», lëvizja e Alfës drejt Omegës. Përkthimi i emrit të tij drejtpërdrejt nga hebraishtja që ia zbuloi Moisiut «Ehjuh asher ehjuh» është «Jam ai që jam».

Psalmisti David pyeti veten kush është Zoti dhe u përgjigj: «Udhëtoi me një qenie engjëllore dhe fluturoi, po, fluturoi në krahët e erës.» Bibla na tregon se Zoti udhëton me qenie me krahë, ose më mirë të themi me ndodhi me krahë, sepse edhe engjëjt nuk «janë» por ndodhin. Në një psalm tjetër lexojmë: «Ai i shndërron retë në karrocë. Ai fluturon në krahët e erës.»

Krahasoni këtë shëmbëlltysë orientale, që është parandjenja gjeniale për konceptimin modern të botës, me idenë për një motor të palëvizshëm të gjithësisë dhe do të zbuloni se sa ka të drejtë Bibla. Tek Zoti nuk ka ndryshueshmëri, asnjë shenjzë lëvizjeje, sa i përket karakterit të tij të vendosur të dashurisë. Por manifestimet e kësaj dashurie janë të reja për çdo çast.

Kjo krijon vështirësi në përgjigjen e pyetjes «Kush është Zoti?», ngase ai gjithmonë e derdh mirësinë e tij mbi njërzimin në forma të reja. Flaka e kësaj dashurie është në ndryshim të përhershëm, ashtu siç ndryshon flaka e zjarrit. Nuk mund të krijosh në të vërtetë një portret të njeriut. Çdo njeri është shprehje e shumë fytyrave tjera. Nuk mund ta thuash me të vërtetë të vërtetën. E vërteta gjithmonë është një varg pohimesh për një send ose një njeri që ndryshon.

Prandaj hebraishtja, gjuha në të cilën Zoti na e dha zbulesën e tij për herë të parë, nuk e ka fjalën «fytyrë», por vetëm «fytyrat» — *panim*. Çdo njeri dhe objekt e ndryshon pamjen vazhdimisht. Edhe për Zotin Bibla e përdor këtë shumës, *panim*. Edhe ai e ndryshon vazhdimisht të shprehurit e dashurisë e të drejtësisë.

Kur pyetni «Kush është Zoti?», me mijëra mendime e pamje të kalojnë si kaleidoskop nëpër kokë, secila më e bukur se tjetra. Prandaj judenjtë e kanë pasur të ndaluar ta shprehnin Perëndinë me anë të pikturave.

Gjuha hebraishte i shmanget fjalës «është». Jezusi kur flet në hebraishte ose në dialektin e aramaishtes, asnjëherë nuk thotë: «Ky është trupi im» por vetëm: «Ky – trupi im.» (Rusët, sikurse edhe kinezët, gjithashtu i shmangen foljes «jam».) Po t'i kishin njohur teologët shprehjet biblike më mirë, do të kishte një grindje më pak rreth asaj që Jezusi kurrë nuk e tha.

E dimë se Zoti është, Alfa, Krijuesi i qiellit dhe tokës. E dimë çka do të jetë: «gjithçka në gjithçka». Ç'është tashti? Ai nuk është një «është». Zoti përshkon prej një poli në tjetrin.

Ateistët kanë një argument. Ne nuk mund të tregojmë kush është Zoti, as ata nuk mund të tregojnë çka është ateizmi. Gjithashtu edhe kjo është në evolucion të vazhdueshëm. Ateizmi i budallenjve të vjetër që e mohonin Zotin, ka kaluar nëpër shumë faza për t'u bërë atiezëm militant dhe i fortë shkencërisht e për të sunduar në vendet komuniste.

Por fakti se ne nuk mund të tregojmë kush është Zoti nuk na i lëkund mendimet.

Apostulli Pal shkruan: «E në të vërtetë, përkryemeritë e tija të papashme: pushteti i tij i amshuar dhe hyjnia, atje që prej krijimit të botës, mund të shihen me anë të mendjes në saje të veprave të tija: prandaj nuk kanë si të arsyetohen» (Romakëve 1:20).

Gjordano Bruno është autori i lojes me fjalë «intellectio» (intelekti) është «interna lectio» (mësimi i brendshëm) që na e jep natyra.

Sa më shumë që di për një makinë, aq më shumë e çmoj inxhinierin që e ka konstruktuar atë. Sa më i bukur të jetë pallati aq më tepër çmohet arkitekti.

Lista e shkencëtarëve ateistë që e japin kundërshtarët e mi është e rrejshme.

Gjithësia jonë e mban emrin e Ajshtajnit. Ai di diçka për të. Në librin e tij «Bota si e shoh unë», shkruan:

«Nëse njeriu e spastron judaizmin e profetëve dhe krishterimim ashtu si na mëson Jezu Krishti, nga të gjitha shtesat e mëvonshme, sidomos nga dredhitë e priftërinjve, njeriu i është lënë mësimi që është i aftë t'i shërojë të gjitha sëmundjet e shoqërisë njerëzore. Është detyrë e çdo njeriu vullnetmirë të luftojë me vendosmëri në botën e tij të vogël për ta bërë këtë mësim vërtet human forcë të gjallë, aq sa të mundet. Nëse bën përpjekje të singertë në këtë drejtim, pa u mposhtur e shkelur nga bashkëkohësit e tij, do ta quaj veten dhe bashkësinë e tij të lumtur.»

Në një parathënie të biografisë së vet Berneti thotë: «Jeta kozmike e fesë është motivi më i fuqishëm dhe më fisnik për kërkime shkencore të natyrës.»

Milneri librin e tij «Relativiteti dhe struktura e yjve» e fillim me këto fjalë: «Në fillim Zoti e krijoi qiellin e tokën.»

Biologu Hans Speman shkruan: «E pranoj se në veprat e mia eksperimentale shpesh kam ndier praninë e një dialogu, ku duket se bashkëbiseduesi im është më inteligjent.»

Immanuel Kanti shkruan: «Ashtu si fytyra që është e bukur sepse përmes saj shihet shpirti, ashtu bota është e bukur sepse përmes saj shihet Zoti.»

Hegeli, themeluesi i dialektikës moderne dhe mësuesi i Karl Marksit, e lut filozofinë ta shpëtojë fenë.

Francis Bekoni thotë: «Filozofia e studiuar në mënyrë

të cekët të largon nga Zoti, kurse studimi në thellësi të kthen te Zoti.»

Afetarët, nëse dëshirojnë të jenë të logjikshëm, nuk duhet të jenë ateistë por angosticistë. A nuk paska Krijues? Atëherë, gjithësia qenka një grumbullim i rastësishtëm i joneve, elektroneve, fotoneve dhe protoneve, i paudhëhequr nga asnjë dituri. Edhe truri im është rezultat i një evolucioni të tillë të rastësishëm, sipas ligjeve të vëna pa ligjvënës. Si është e mundur, pra, që truri im, që nuk është organ i vullnetshëm, u konstruktua me zgjuarsi, që mund t'i kuptojë në mënyrë të drejtë aq shumë gjëra në gjithësi? Stalini ka thënë se nuk janë të njohura të gjitha gjërat, por mund t'i njohim. Si është e mundur që unë kam asi truri që mund të dijë gjithçka? Nëse vëmë llamba, bateri dhe tel në një vend pa bërë kurrfarë projektimi, a do të mund të kapin ndonjë transmetim të radios? A do të bashkoheshin rrotat, vidhat, burmat dhe frenat për ta bërë një automobil me të cilën mund të udhëtojë njeriu?

Biologu Maks Hartman flet për «mrekullinë e harmonisë mes gjithësisë dhe trurit tonë». De Brogli thotë se ka më shumë mister se sa ne besojmë për faktin se shkenca është e mundshme. Ajnshtajni shkruan: «Ajo që është përjetësisht e pakuptueshme është ajo që mund të kuptohet.»

Madje edhe Volteri, për të cilin ateistët gabimisht mendonin se është një prej tyre, pat thënë këto fjalë: «Bota është krijuar me inteligjencë. Prandaj është krijuar nga një inteligjencë... Inteligjenca e Njutonit vjen nga një inteligjencë tjetër.»

Kush mund të besojë se ekzistojnë orët pa pasur orëndreqës? Ora tregon kohën sipas lëvizjeve të tokës. Kush e bëri këtë kronometër?

Gjëja e dytë që i bën përshtypje kujtdo që me vëmendje e shikon krijimin është rregulli i prerë në natyrë, e që as kjo nuk mund të jetë rezultat i rastit.

Juksili thotë: «Në natyrë lexojmë një partiturë të tërë.»
Gjeologu Klus shkruan: «Ne e dëgjojmë muzikën e tokës.»

Kanti, që është kritik i shumë provave të arsyeshme, solli me anë të teologjisë për besim në ekzistencën e Perëndisë, pohime dhe vlera të së ashtuquajtures prova kozmologjike. Rregulli i natyrës na e dëfton Krijuesin.

Çarls Darvini, viktimitë e mënyrës tregtare dhe utilitare të jetesë në Britaninë e Madhe të asaj kohe, ishte i mendimit se edhe natyra gjithashtu vepronte sipas parimeve utilitare. Por kjo nuk është kështu. Në natyrë vepron një artist dhe arkitekt me imagjinatë të mrekullueshme.

Bukuria e pashoqe e pendëve të palloit nuk mund të shpjgohet si zhvillim i akumulimit të variacioneve të vogla, sepse ato ia shtojnë bukurinë njëra-tjetrës. Edhe sorra e gjen shokun e vet, edhe bari skaj rrugëve sikur zambaku i bukur i tërheq bletët për t'i ushqyer.

Pse janë kot aq të bukur disa peshq të vegjël? Ky është arti për hir të artit. Pse papagalli ka aftësi të flas. Pse ekzistojnë zogjtë me zile, cicërima e të cilëve është sikur cingërima e zileve të vogla? Është vetëm imagjinatë e një artisti. Po brirët e drerit? Pse zebra e ka trupin ashtu vijavija? Pse secila lule ka ngjyra të ndryshme?

Niçe ka thënë: «Në secilin prej nesh është një fëmijë që dëshiron të luaj.» A nuk ka diçka të tillë tek Perëndia që e shtyu të krijojë të gjitha këto gjëra? A nuk i përket kjo natyrës Hyjnore që shprehet në lindjen e një foshnje në stallë dhe në djaloshin që luan me shokët në rrugët e Nazaretit?

Prej nga erdhën këndët e përpikta, simetritë dhe bukuritë e formave të kristalta?

Si është e mundur që në Lindjen e Largët ekziston zogu rrobaqepës, që me flijet e pambukut i qep gjethet për ta bërë folenë?

Si është e mundur që pëlhura e merimangës ia kalon aftësive teknike të njeriut? Peri i pëlhurës së merimangës

përdoret në thjerrëzat astronomike si njësi matjeje. Njeriu nuk mund të prodhojë diçka më të mirë, që do të qëndronte më gjatë e të mos ndryshonte me ndryshimin e temperaturës.

Njeriu e ka shpikur radarin. Por këtë e kopjuar nga lakuriqi. Sot kemi instrumente optike të mrekullueshme, por cila prej tyre ia kalon syrit të njeriut?

Njoh një komunist që është bërë i krishterë duke ia shikuar dredhat delikate të veshit të fëmijës së vet. Pa dyshim janë bërë me plan. Nuk kanë mundur të krijohen me bashkimin e rastësishëm të atomeve.

Si nuk mund t'i besoni Krijuesit të mençur kur e shqyrtoni më hollësisht veshin e njeriut ku bashkohen 24.000 nerva dhe e përcjellin lajmin në tru?

Shikoje me kujdes kërcellin e grurit: lartësinë e ka diku nja 130 cm kurse diametri është 5 mm. Sa për krahasim ta marrim me mend një ndërtesë të lartë 250 metra (do t'i kishte nja 100 kate), e të jetë në sipërfaqe vetëm prej një metre katror. Në majë të kërcellit është fryti i rëndë. Lëkundet nga erërat por nuk thyhet. Kërçeli ka një sistem mekanik të konstruktuar për mrekulli. Ende ka mbetur mister për njeriun se si e thith ujin deri në majë. Ne i përdorim pompat për ta çuar ujin në katet e larta të ndërtesave. Ne nuk mund të bëjmë diçka të mrekullueshme si kërcelli.

Fizikani Urej, zbuluesi i hidrogjenit, shkruan: «Asnjëra prej teorive rreth origjinës së botës nuk ka zgjidhje pa supozimin e mrekullisë.»

Mbasi folëm për ujin — le të ndalemi e t'i shohim mrekullitë e tij. Të gjitha objektet fizike bymehen nga të nxehtit e tkurren nga të ftohtit; vetëm uji e rrit vëllimin kur ftohet dhe e formon akullin. Akulli duke qenë më i lehtë se uji qëndron mbi sipërfaqe të ujit. Krijon shtresë të fortë, e cila i mbron peshqit nga të ftohtit. Pa këtë karakteristikë të ujit, jeta në lumenj do të kishte qenë e

pamundur, dhe njerëzit primitivë që kanë jetuar prej peshqve nuk do të kishin mbetur gjallë.

Nga vjen kjo mrekulli? A është diçka vetëm e rastësishme, apo vjen nga Krijuesi i mençur?

Ta lejojmë specialistin e njohur, Verner Siemens, të flasë: «Sa më shumë që depërtojmë në sferën e forcave harmonike të natyrës, që janë të rregulluara nga ligjet e pandryshueshme dhe të përhershme, të fshehura nga arsyeja jonë me një vel të trashë, aq më tepër jemi të shtyrë drejt përruljes, sa më e vogël që duket njohuria jonë, aq më tepër rritet dëshira për të përrë nga ky burim i pashterreshëm i shkencës dhe diturisë. Po ashtu në të njëjtën masë rritet edhe admirimi ynë ndaj diturisë së pakufishme, e cila e përshkon tërë krijimin.»

Është e vërtetë se ne nuk mund të tregojmë, «Kush është Zoti?» por këtë forcë të padukshme mund ta shohim nëse i shikojmë me kujdes gjërat që i ka krijuar ai. Ato tregojnë se Zoti është sundimtar i fuqishëm dhe artist i mrekullueshëm. Prej tyre mësojmë se Zoti është Zot i rregullit.

Kur nxënësit e pyeten Jezusin t'u dëftonte Atin, ai u përgjigj: «O Filip — i tha Jezusi — kaq shumë kohë jam me ju e nuk më njohe ende? Kush më ka parë mua, ka parë edhe Atin. Si thua, pra: 'Na e dëfto Atin!' Po a nuk beson se unë jam në Atin e Ati është në mua?... Ati që banon në mua i kryen veprat e veta» (Gjoni 14:9,10).

Me këto fjalë, Jezusi na mëson se çka duhet të mendojmë për personalitetin e Tij dhe për veten tonë.

Mbasi ka kuptim përpjestues, të themi se kush më sheh mua ose ty, bile edhe nëse je autor i librit ateist, e sheh Atin, sepse të gjithë jemi të krijuar sipas shëmbëllyrës dhe përngjasimit të tij.

Shën Gregori i Nisas shkruan: «Njeriu është fytyra njerëzore e Perëndisë.»

Shën Makariosi shkruan: «Ndërmjet Perëndisë e njeriut ekziston lidhja më e ngushtë familjare.»

Shën Bazili thotë: «Njeriu është qenie që i ka marrë urdhrimet për t'u bërë Perëndi.»

Njeriu, kushdo qoftë — ateist, kriminel, shenjt — është i mrekullueshëm para së gjithash për shkak të strukturës së tij trupore. Bile edhe njeriu më i keq e më i urryer ka zemër, që është një pompë të cilën asnjë inxhinier nuk mund ta konstruktojë — pompë që e qarkullon gjakun nëpër trup 600 herë në ditë. Në periudhën prej presëdhjetë vjetësh, kjo ndodh 1.840.000.000 herë, e kjo bëhet pa u ndërprerë as një minutë të vetëm.

E dyta, njeriu është krijesë e mrekullueshme nga virtyti i shpirtit të tij, realitet tjetër i çuditshëm, pothuaj i papërcaktueshëm. Është aq i përsosur sa, në njëfarë kupitimi, mund të bëjë edhe pa trupin. Pavarsia e tij e tregohet në Simfoninë e nëntë të Betovenit të shurdhër; ose në dedikimin e jetës së Helena Kellerit, e cila, ndonëse ishte e shurdhër, memece dhe e verbër, u bë autore dhe bamirëse e madhe; ose në faktin që Paskali në moshën nëntë vjeçare i rizbuloi aksiomat e gjeometrisë së Euklidianit; ose në jetën e Mocartit, që filloi të kompozojë muzikë në moshën pesë vjeçare.

Shpirti gjithashtu e tregon pavarsinë nga ndjenjat në përvojën e mendjemprehtësisë, telepatisë, parandjenjes dhe hipnotizimit.

Në gjendjen hipnotike të rrahurit e zezës bëhet aq i lehtë saqë është gati si një fije. Njeriu pothuajse nuk merr frymë fare. Gjaku mezi i lëviz nëpër enët e gjakut në tru. Mbase nuk arrin në kapilare. Nuk merr oksigjen të mjaftueshëm, kështu që mbushet me lëndët e dekompozuar. Truri është i angazhuar me aktivitet shumë të ulët, por mendja e të hipnotizuarit aktivizohet jashtë mase. Mjafton që t'ia lexosh një vjershë vetëm një herë, e ai do ta përsëritë pa gabime. Nëse ia lexon një fragment të Biblës në hebraisht, edhe nëse ai nuk e di gjuhën, do ta përsëritë me përpikëri. Do t'i kujtohen ngjarje të vogla nga fëmijëria.

Shumë më tepër ka në sferën e shpirtit.

Por njeriu ka edhe strukturën e tretë të mrekullueshme. Nëse me trup i ngjan botës shtazore (kjo nuk është asgjë për t'u turpëruar, bile edhe nëse dikush shkencërisht e kundërshton teorinë e evolucionit. Shën Francis nga Asisi flet për «vëlla ujkun» dhe me qejf do të kishte thënë «vëlla majmuni»), por njeriu e ka edhe shpirtin, me të cilin i ngjan Perëndisë.

Kundërshtarët e mi as nuk e pranojnë ekzistencën e tij, sepse nuk mund të vërtetohet me anë të shqisave. Si mund të vërtetohet ekzistenca e shpirtit kur ai vetë është vërtetuesi? Syri nuk sheh vetë, hunda nuk mund ta ndiejë nuhatjen vetë. Shpirti nuk është spektakël i mbështetur në shqisa. Ai është spektator dhe reagon sipas shijes së vet në atë që i vjen në sferën e vet.

Aristoteli ka thënë: «Nëse në njeriun e pranoni vetëm atë që është njerëzore, e tradhtoni njeriun dhe ia doni të keqen, sepse me anë të gjithçkaje që është thelbësore në qenien e tij — shpirtit — njeriu është diçka më shumë se vetëm jetë njerëzore.» Është panjerëzi të jesh vetëm njerëzor. Është e padenjë ta quajmë një krimb vetëm krimb: ai është gjithashtu edhe flutur gjatë procesit. Prandaj nuk duhet ta degradojmë njeriun, për të cilin Jezusi thotë: «Ju jeni perëndi» (Gjoni 10:34). Në një farë ka më tepër se vetëm fara: ajo përmban potencial lulësh.

Njeriu është qenie që i përngjan Perëndisë. Unë nuk mund t'ju them se si duket Perëndia, por shikoni njeriun, shikoni shembujt më të mirë të njerëzimit e do të shihni diçka hyjnore: do të shihni gëzimin e jetës, entuziazmin krijues, thellësitë e diturisë, shijen për bukuri, gjallërinë e jetës dhe aftësinë e pastër për të dalluar e zgjedhur gjithnjë e më mirë.

Çfarë qenie e mrekullueshme është njeriu! Njeriu është përngjasim dhe shëmbëtyrë e Perëndisë, sepse ai është edhe krijues i botës: i botës së tij të brendshme. Natyra jashtë meje është një vorbull energjie, mori va-

lësh, rrezatim dhe lëvizje elektronesh, protonesh dhe grimcave elementare; por valët e qeta bëhen të zëshme, rrezatimi i padukshëm bëhet i dukshëm dhe bota e pakuptueshme bëhet e kuptueshme.

Jashtë meje, ekziston një realitet. Unë e rregulloj atë në sasi, cilësi, shkakësi, përfundim dhe modalitet. Unë e kuptoj këtë si një realitet kaotik në një rrjetë që e kam thurur vetë dhe kam bërë prej saj një botë të rregullt. Natyra i realizon bukuritë e saja në mua. Kur e shikoj trëndafilin, rritet e merr të skuqur të shkëlqyer dhe jep aromë. Po të mos kishte ekzistuar njeriu, trëndafilin nuk do të kishte pasur vleftë por do të kishte qenë vetëm një grumbullim i atomeve.

I vetmi objekt në natyrë që e njoh intimisht nga brenda është vetja ime. Edhe në veten time ka diçka, aftësia që vë në rregull një kaos, që krijon botën time, qoftë mirëdashëse që do të më sjellë gëzim, qoftë e errët që do të më dëshprojë mua dhe të tjerët. Në të gjitha sferat e diturisë ne jetojmë në saje të ekstrapolimit. Ne fillojmë prej të njohures e shkojmë kah e panjohura. Nëse unë jamë diçka më shumë se sa dikush nga jashtë mund ta vërejë, a nuk është e mundur se ka më shumë në botën që më rrethon se sa duket në sipërfaqe?

Lenini i bën komplimente peshkopit Berkeli, theme-luesit të filozofisë solipsiste, duke e quajtur filozof ideal më i zorshmi për ta mposhtur, vetëm pse Berkeli kishte dhënë një argument të arsyeshëm për besim në Zot, argument që mua më duket më i fuqishmi. Ai thotë se bota ekziston vetëm në mendje; jashtë mendjes realiteti është kaotik. Ai është një «tohu va bohu». Pra, është mendja që krijon një botë nga ky realitet, duke ia diktuar ligjet e saja, duke e vënë në korniza të rregullta dhe duke e kategorizuar. Bota mund të ekzistojë vetëm në mendje; por njeriu nuk ka ekzistuar gjithmonë, as mendja e tij nuk ka ekzistuar gjithmonë. Prandaj, para se të paraqitet njeriu, ka qenë një mendje tjetër në të cilën ka ekzistuar bota.

Njeriu e konsideron veten si të organizuar. Mendja në të cilën gjithmonë ka ekzistuar bota quhet Perëndi.

Edhe unë jam krijues i një bote, i një bote të brendshme — pra, «jam» krijues! Prandaj, kush më sheh mua sheh Atin.

Unë nuk mund t'ju tregoj se kush është Perëndia, por mund të kuptoni diçka për hyjninë kur e shikoni njeriun.

Vështroni Jezusin e Nazaretit

Vështroni shembullin më të madh dhe më të mirë të njerëzimit që e njihni, qenien më të dashur, e atëherë do të shihni në të diçka nga Ati!

Por ekziston Biri i njeriut në të cilin mund ta shihni Zotin në një mënyrë të posaçme. Ky është Jezusi nga Nazareti — sepse ai nuk ka qenë vetëm Biri i njeriut, por Zoti i mishëruar.

Zoti di gjithçka, por ka pasur disa gjëra që i ka njohur pa i përjetuar. Gjykatësi mund të di tërë kodin penal, të gjitha ligjet dhe prapëseprapë të mos gjykojë drejt, sepse ai kurrë nuk e ka jetuar jetën e të bugosurit. Të jetosh pesë vjet në burg është krejt ndryshe nga ajo t'ia caktosh dikujt pesë vjet burg për kundërvajtje në kodin penal e pastaj të shpallësh vendim.

Zoti nuk gënjen, as që ka bërë ndonjëherë kundërvajtje ndaj kodit moral, ndërsa këto mëkate janë pjesë të jetës me të cilat jemi të rrethuar për çdo ditë. As Zoti as engjëjt nuk vdesin. Vdekja për ta është vetëm një spektakël të cilin e vështrojnë prej së jashtmi.

Prandaj Krishti, Biri i Perëndisë, u bë njeri me të gjitha tiparet dhe kufizimet e njeriut. Si mashkull që ishte ai dinte për tundimin ndaj femrave; si zdrukthëtar i varfër në një popull të shtypur, dinte për tundimin e rebelimit e pandershmërisë. Si i burgosur i rrahur e më vonë i kryqë-

zuar, dinte për tundimin e dëshpërimit dhe të zemërimit. Ndonëse kurrë nuk ka bërë mëkat, ai dinte për mëkatin. Gjatë tri viteve të shërbimit, armiqtë e tij shpesh e fyenin pse rrinte me njerëz të ulët e me vejusha.

Jezusi, Biri i Perëndisë, vendosi të marrë pjesë në natyrën njerëzore me të gjitha përgjegjësitë dhe ta shijojë vdekjen, në këtë mënyrë jo vetëm që u bë gjykatës i drejtë i njeriut, por edhe mbrojtësi e Shpëtuesi i tij. Me ardhjen e Jezusit në këtë botë, Mbretëria qiellore është më afër nesh.

Me çka mund ta krahasojmë këtë vepër plot dinjitet të Birit të Perëndisë?

Mund ta krahasojmë me përpjekjen e Osbornit për përmirësimin e kushteve të vështira në burgjet e SHBA duke jetuar vetë si i burgosur disa vite — vetëm për t'u përgatitur për kryqëzatën trime më pas.

Mund ta krahasojmë me veprat e disa mjekëve që injektuan veten me mikrobe helmuese për t'ju ndihmuar miqve të tyre e në të cilën mënyrë paten sukses.

Megjithatë jo! Këto krahasime nuk na tregojnë asgjë, sepse në këto raste njeriu e rrezikon jetën e vet për të tjerët, për miqtë e vet, ndërsa në rastin e Jezu Krishtit ka qenë krejt ndryshe.

Krishti është Zot, dhe para syve të tij bota jonë është mikroskopike. Të gjithë popujt para tij janë si një pikë ujë në një kovë ose si një grimcë pluhur në peshore. Vepra e tij madhështore mund të krahasohet me dashurinë e marrë që ka ndonjë njeri ndaj insekteve gjakpirëse. Ato dridhen ndërmjet gishtërinjve të njeriut kur ai don t'i mbysë. Por ai pranon të bëhet insekt, të jetojë jetën e insektit që ka prirje për ta dëmtuar njeriun, të vdesë si insekt, me qëllim që, kur të kthehet në gjendjen e mëparshme, më në fund të mund të jetë gjykatës i drejtë i insekteve, të mund t'i mbrojë nga shfarosja e pamëshirshme, të mund t'i mbrojë me autoritet dhe të mund t'i bëjë ato në kijesa bamirëse.

E di se shumëkush do të ofendohet nga ky shembull, por duhet të ketë qenë e pakuptueshme për engjëjt që Krishti të vendosë të mishërohet në një gjini të neveritshme e mëkatare.

Krishti nuk zbriti vetëm në nivelin e njeriut. Në trupin e virgjres Mari, që mbeti shtatzënë në një mënyrë misterioze, u zu në embrion, mori ushqim nga materiet organike dhe inorganike dhe i kaloi nëntë muaj në bark të nënës për t'u bërë njeri. Dhe çfarë Njeriu! Ai nuk u mishërua si hero Bar Koçbahu, as si iniciatori i madh Apoloni nga Tyana, as si Platoni filozof. Krishti, për ta shpëtuar njeriun (të gjithë njerëzit) u desht të lëshohej poshtë në nivelin e njeriut. Prandaj, pasi Jezusi vetë iu nënshtrua procesit të zhvillimit të njeriut, u bë zdrukthëtar, anëtar i një klase shoqërore të pangritur. Ka qenë i varfër për nga shprehjet; ndonjëherë i është dashur të bisedojë në nivelin më të ulët, sepse ky ka qenë niveli i njerëzve më të cilët ka zhvilluar bisedua. Ai i ka njohur dobësitë, hidhërimin, dhimbjen, frikën dhe e kanë vënë në radhët e kriminelëve.

Këto gjëra në Jezu Krishtin që janë ofenduese për njerëzit bëhen, për ata që i kuptojnë, nxitje për ta adhuruar përulësinë e tij të madhërisme dhe dashurinë e pafund.

Nëse e pyesim Krishtin pse u flijua, na përgjigjet me thjeshtësi të madhërisme se Perëndia aq fort e deshi botën sa që e dha një të vetmin Birin e vet kështu që, secili që beson në të mos të humbet, por ta ketë jetën e pasosur. Ai thotë se Ati e ka dërguar.

Ne nuk mund të tregojmë se kush është Perëndia, por duke shikuar Krishtin, kuptojmë diçka për karakterin e tij. E shohim se ajo që e shpreh Perëndinë më së tepërmi është dashuria, drejtësia dhe mirësia ndaj njerëzimit. E kuptojmë se ka dashuri të tillë që e ka shtyrë ta japë Birin e vet të vdesë për ne.

Krijimi

Por pse në mënyrë të tërthortë? Pse duhet ta shohim Zotin në natyrë, në Jezu Krishtin? Pse nuk mund ta shohim ballë për ballë?

Në Talmudin e Babilonit thotë se një perandor e kishte thënë rabinit: «Dëftoma Perëndinë!» Rabini i përgjigjet: «Do ta shohësh me sy të tu me një kusht. Së pari, duhet ta shikosh diellin pesë minuta.» Perandori e shikoi diellin por menjëherë iu desh t'i mbyllë sytë. Atëherë rabini i tha: «Nuk mund ta shikosh diellin të paktën një minutë, që është një krijesë e vogël e Perëndisë — ndërsa kërkon ta shohësh Atë që u jep shkëlqimin yje!»

Është e qartë se për intelektualin e sotëm besimi ka vështirësitë e veta.

Ai e kupton se gjithçka ndodh sipas ligjeve të natyrës. Prej një gjëje, tjetra zhvillohet sipas ligjeve të përpikta, ashtu që gjërat që ekzistojnë janë rezultat i zhvillimit të mëparshëm. Kodrat, luginat, lumenjtë dhe qeniet e gjalla nuk janë krijesa në atë kuptim të cilin zakonisht i japim kësaj fjale, ashtu si yjtë që nuk janë krijesa por zhvillim prej një gjendjeje të mëparshme. Disa yj janë të vjetër, të gatshëm për t'u shuar, të tjerët janë në formim, e disa të tjerë janë shumë të rinj. Yjtë e të gjitha kohërave bashkë-jetojnë në gjithësi. Atëherë — kur ndodhi krijimi? Këto lloje që ekzistojnë sot nuk kanë ekzistuar gjithmonë. Dihet se ka evolucion brenda llojeve. Në këtë kontekst, nuk janë të gjitha qeniet e gjalla krijim i drejtpërdrejtë i Perëndisë.

Vështirësia zhduket kur e kosiderojmë Zotin jo vetëm si Qenie që e ka krijuar botën. Ai është Zot i gjallë dhe *jetëdhënës*. Ai lëviz gjithçka sipas ligjeve të fizikës, që janë shprehje e karakterit të tij. Prandaj, është vështirë ta kuptojmë atë.

Herakliti thotë: «I pëlqen vetë natyrës të fshehet.» Kjo është edhe më e vërtetë për Zotin, për të cilin Solomoni thotë: «Zoti thotë se do të banojë në errësirë» (1 mbi Mbretër 8:12).

Sa më e bukur që të jetë një qenie, aq më shumë beki-me jep, kurse vetë mbetet në hije. Ashtu është Zoti, dhe për këtë ai nuk shihet. Ne duhet ta kërkojmë burimin e bekimeve tona. Luteri thotë: «Asgjë nuk është e vogël pa Zotin por është shumë e vogël, asgjë nuk është e madhe pa Zotin por është shumë e madhe, asgjë nuk është e shkurtë pa Zotin por është shumë e shkurtë, asgjë nuk është e gjatë pa Zotin por është shumë e gjatë, asgjë nuk është e gjerë pa Zotin por është shumë e gjerë, asgjë nuk është e ngushtë pa Zotin por është shumë e ngushtë.» Diku tjetër në shkrimet e tij ai shton: «Asnjë Qenie nuk mund të jetë më e pranishme e më qendrore se Zoti dhe pushteti i tij.»

Ne nuk mund ta shohim Zotin përveç kur shpirti i tij lëviz, ashtu siç nuk e shohim erën përveç kur fryn.

Vetëm me anë të meditimeve dhe ushtrimeve shpirtërore, me anë të pastërtisë të cilën ta jep besimi në flinë e Jezu Krishtit, të zgjohen ndjenjat e shpirtit dhe e ndien praninë e Zotit. «Lum ata që janë të pastër në zemër sepse do ta shohin Perëndinë», thotë Jezusi.

Po shihni pra, ju e njihni Zotin, ndonëse nuk mund t'u tregoni atyre që nuk janë të pastër se si është ai, sepse ju vetë nuk *jeni* më, por *bëheni* (formoheni). Ju ndryshoni prej lavdije në lavdi, në përngjasimin e tij.

Zoti është

Kam parë të krishterë duke vdekur në burg me fjalët e fundit: «Zoti është». A e kanë pasur gabim? Natyrisht jo. Edhe unë kam dëshirë që kur të vdes këto të jenë fjalët e fundit që dalin nga goja ime.

Jeta që jetojmë është e niveleve të ndryshme. Shkencë-tari e di se të gjitha objektet materiale janë vorbulla të grimcave elementare, në largësi proporcionale mes tyre siç janë toka me diellin. Por ai nuk ngurron të ulet në karrige, sepse e di se ajo është një objekt i fortë. Në një kuptim çdo mur është zbrazëti e madhe brenda të cilit elektronet sillen në orbita të mëdha. Por kur e vështrijmë nga rrafshi tjetër, muri është gjithçka tjetër pos zbrazëti. Duhet të ruhesh nga ky mur i urtë. Mund ta përplasësh kokën keq nëse ecën drejt tij me teorinë atomike në mendje.

Njësoj është edhe me fenë. Ekziston një rrafsh i lartë filozofik ku, siç kemi sqaruar, nuk mund t'i përdorni fjalët «ekzistoj» ose «jam» për Zotin, pasi ato janë tepër të thjeshta. Zoti është më shumë se ekzistencë. Ne të krishterët kemi vend në kokë për ta shqyrtuar mohimin ateist për Zotin. Por ateistët e njohin realitetin vetëm ashtu si paraqitet në një rrafsh dhe, për këtë arsye ata gabojnë e, më këtë e rrezikojnë veten. Është edhe një rrafsh tjetër ku Zoti ekziston dhe është.

E vërteta e pjesërishme është diçka e rrezikshme. Nuk e çmojmë pa arsye «të vërtetën, krejt të vërtetën dhe asgjë tjetër përveç të vërtetës».

Çdo njeri i ngritur e di se ne jetojmë njëkohësisht në gjithësinë e Njtonit dhe të Ajnshtajnit, secila me ligjet e veta. Ata që e njohin vetëm gjithësinë e Njtonit nuk do të kishin mundur të shkojnë në hënë as nuk do të kishin pasur energji atomike. Ne njëkohësisht jetojmë edhe në botën ku nuk mund ta takojmë Zotin dhe në botën tjetër,

të cilën ateistët nuk e njohin, në të cilën Zoti ekziston, është, dhe na lejon të kemi bashkësi me të.

Kjo është bota e shpirtit, e besimit praktik.

Karrigat, muret, buka ekzistojnë dhe përdoren si të tilla pavarësisht nga teoritë molekulare dhe atomike. Në të njëjtën mënyrë, pra, ekziston edhe Zoti.

Në disa raste, prania e tij i kalon pengesat e vetëdijes, sidomos në çastet e krizave.

Ka raste të njohura nga historia, dhe unë vetë njoh shumë raste të tilla te ateistët — udhëheqësit komunistë — që kanë vdekur në burgjet komuniste, viktimat e spastrimeve komuniste, e, që fjalët e tyre të fundit ishin: «Zot, Zot!» ose «Jezus!»

Është mirë të pyesim prej nga vjen ky besim në Zotin në mendjen e miliona njerëzve gjatë historisë. Ateistët që e mohojnë Zotin mohojnë nocionin që ekziston në mendjen e tyre. Filozofi anglez Loku ka qenë i mendimit se në intelektin tonë nuk ka asgjë tjetër përveç asaj që kalon nëpër shqisat tona. Një njeriu në xhungël të Guineas së Re i mungon ideja për «televizor», sepse në botën e tij nuk ekziston objekti përkatës. Nëse njerëzimi kurrë nuk ka përjetuar diçka prej Zotit, prej nga i erdh një ide e tillë në kokë?

Engelsi në kohën e tij ka qenë i gatshëm për t'u përgjigjur në këtë çështje, kur thotë se koncepti ynë për Zotin është pasqyrim fantastik në mendjen tonë për realitetin shoqëror. Atëherë të krishterët u përpoqen ta dëshmojnë se Engelsi e kishte gabim, se Zoti nuk është pasqyrim fantastik, por nocioni për të është pasqyrim i saktë i realitetit hyjnor. Është koha për t'ju qasur problemit nga një këndvështrim tjetër.

Unë e pranoj se besimi në Zot është pasqyrim fantastik, dhe shtoj se vetëm ajo që është fantastike është reale. Krijt «realizmi» që mohonte se njeriu kurrë nuk do të mund të shkojë në hënë, ose të futet me nëndetëse nën akullin e Polit Verior, ose të arrijë të fluturojë rreth tokës

brenda një kohe të shkurtër, ose ta shpërbëjë atomin, ose të ndërtojë shtëpitë me gazra natyrore — i gjithë «realizmi» i tillë është dëshmuar gabim. Gjithashtu edhe «realizmi» i atyre që jetojnë në botën e Perëndisë dhe e mohojnë ekzistencën e tij është dëshmuar i gabueshëm. Në anën tjetër, fantazitë e Leonardo da Vinçit dhe të Zhul Vernit dhe të tjerëve si këta janë bërë realitet. Edhe ëndërruesit që ecin bashkë me një Zot që nuk mund të shihet apo preket, pa e zhvilluar aftësinë e besimit, e perceptojnë realitetin që e përshkon tërë krijimin.

Vetëm fantastikja është realitet në shkencën moderne. Niels Bor pyet: «A është ndokush aq i marrë sa ta ketë arritur të vërtetën?»

Çka është shkenca? Ajo është disiplinë e cila bën që të realizohet ajo që është fantastike.

Shkenca ka zbuluar se në bërthamën e qelizës, në ADN, ka një kod në të cilin të gjithë brezat e vjetër i kanë përcjellë përvojën dhe vetitë e tyre brezave të rinj. Tani kjo dituri duhej të bartej prej bërthamës deri aty ku formohen proteinat. Pra, në bërthamë ka njëfarë aparati fotokopjues, që bën fotokopje të ADN. Dhe është «dikush» që punon me aparatën fotokopjues. Kopja nuk është plotësisht besnike. «Ai» që punon me aparat është si ai që, ndërsa e bën fotokopjen, e mbulon ndonjë pjesë të dokumentit ose i shton të dhëna të posaçme. Dhe ARN e bart këtë dituri jashtë qelizës.

Çfarë tregimi fantastik! Asnjë romancier nuk mund ta shpikë një më të mirë. Kjo fantazi është e vërteta për organizmin tonë.

A mund të jetë edhe besimi pasqyrim fantastik? Atëherë është pasqyrimi i drejtë i realitetit fantastik dhe i Krijuesit të tij fantastik.

Mendja e njeriut ka natyrë të dyfishtë. I kupton veprat dhe fantazitë. Po të mos kishte fantazuar mendja, njerëzimi nuk do të kishte ecur përpara. Qytetërimi është plotësimi i ëndrrave të mëparshme. Unë nuk e pranoj atë

besim që përbëhet vetëm prej fakteve, sepse nuk do ta kishte plotësuar natyrën time të dyfishtë. Besimi duhet ta plotësojë dëshirën sipas fantazisë, sipas mitit.

Marksii dhe Engelsi shkruanin fakte, shfrytëzimi i tmerrshëm që ekzistonte në kapitalizmin e hershëm. Por ata nuk u ndalën me kaq, sepse ishin njerëz. Pas analizës së fakteve, fantazia filloi të punojë: ëndrra për shoqërinë e re pa shfrytëzim, pa luftra, dhe me drejtësi shoqërore. Fantazitë e shkencës janë plotësuar. Shumë njerëz që kanë jetuar me besim, kanë arritur jetë të shenjtë, që është fantazi e pastër. Por shoqëria marksiste është utopi. Kështu Engelsi nuk kishte të drejtë të qortojë krishterimin sa i përket fantazisë — ndonëse ne e marrim këtë për kompliment.

Ju mund të përgjigjeni se është e mundur të imagjinohen gjërat që janë të pamundshme. Në këtë mënyrë mund ta fantazosh një ishull diamanti prej një kilometër katror në mes të oqeanit, megjithëse një ishull i tillë nuk ekziston. Mirëpo, çdo gjë që ke «imagjinuar» është e vërtetë. Në natyrë ka ishuj, ka oqean, ka diamant, ka edhe madhësi prej një kilometre katror. Kështu i ke bashkuar realitetet në mënyrë të papërshtatshme, por ti e ke imagjinuar vetëm realitetin. Pra, në mendjen tonë nocioni që kemi për Zotin është ngatërruar me ide të gabuara. Mund të besoj në një Zot të keq, Zot në formën e njeriut, Zot të fisit a të kombit, e kështu me radhë, por gjatë tërë kohës kam të bëj me realitetin, qoftë në mënyrë të drejtë apo të gabuar. Zoti ekziston dhe është ashtu si është — e jo ashtu si e mendojmë ne të jetë.

Engelsi nuk ka pasur nevojë të na thotë se besimi është absurd.

Nëse Zoti nuk i kalon suazat e të menduarit tim, atëherë nuk është Zot por një qenie e vogël si unë. Nëse filozofinë e një filozofi e kupton fëmija pesë vjeçar, atëherë ai filozof nuk është filozof. Zoti për të qenë Zot duhet ta kalojë arsyjen tonë me atë çka është e me atë që vepron.

Ajri që thithim ne është kombinim i azotit dhe oksigjenit dhe i përgjigjet plotësisht mushkërive tona. Distanca që ka toka me diellin dhe hënën është pikërisht ajo që nevojitet për ta mbajtur jetën, shëndetin dhe lumturinë. Reshjet e shiut dhe borës e bëjnë tokën pjellore. Batica dhe zbatica e detit e mbajnë të pastër dhe të freskët bregun e detit. Vitaminat e domosdoshme për trupin janë të mjaftueshme. Ligjet dhe forca e natyrës janë të gatshme që t'i hynë në punë njeriut. Zoti e ka mbushur tokën me bukuri e hijeshi. Ka male magjepse e lugina të begatshme, lisa të gjatë e fusha të gjelbra, drita e hënës, qetësia e shkretirës, cicërima e zogjve — që të gjitha këto dëshmojnë për faktin se Perëndia e krijoi tokën për kënaqësitë tona.

Nëse një i ri e dashuron një vajzë e i tregon një shtëpi të bukur me një kopsht të shkëlqyeshëm përreth dhe i thotë: «Këtë e kam bërë për ty», vajza nuk do të dyshojë për dashurinë e tij. Pikërisht kështu ka ndodhur në mes Perëndisë dhe nesh. Ai e ka krijuar ushqimin për ne, ka krijuar pasuritë e nëntokës, mineralet e llojeve të ndryshme, që të gjitha të mund t'i shfrytëzojë njeriu. Të gjitha këto janë dëshmi që Perëndia ekziston dhe i plotëson nevojat tona.

Mendoni për bletët se si i formojnë hojet me 10.000 zgavra për të grumbulluar mjaltin, 12.000 zgavra të mbushura me mjaltë për larvat dhe vendin për matkën. Kur hetojnë se temperatura po ngritet dhe dylli mund të shkrihet kështu që mjalti humbet, atëherë ndahen në grupe, e vëjnë rojën te hyrja, secila e zë pozitën e vet dhe me krahë e krijojnë një sistem të ajrosjes për ta ftohur mjaltin — diçka të ngjashëm me ventilatorin elektrik. Bletët e mbledhin mjaltin në një sipërfaqe prej 30 km katror. Si është e mundtur që truri i bletës aq i vogël që është e të bëjë mrekulli të tilla nëse pas tij nuk qëndron një mendje më e madhe — mendja e Perëndisë?

Një grup shkencëtarësh në Çikago kanë bërë një eksperiment. Në një dhomë kanë futur një tenjë femër të një lloji të rrallë. Gjashtë kilometra më larg e kanë lëshuar një tenjë tjetër të gjinisë mashkullore nga i njëjti lloj. Përkundër tymit të qytetit, përkundër largësisë dhe përkundër faktit se tenja femër ishte në dhomë të mbyllur, pas pak orësh mashkullin e gjeten duke rrahur krahët në dritare të dhomës ku ishte e mbyllur femra. Si e sqaroni një gjë të tillë pa pasur një qenie inteligjente — Zot, që i ka krijuar të gjitha!

Peshqit i bëjnë vezët në fjordet e Norvegjisë dhe nga këto vezë del brezi i ri i peshqve që në njëfarë mënyre e gjejnë rrugën nëpër oqean deri te Deti Karibik. Kur t'u vijë koha për shumim, kthehen saktësisht tek te njëjtat fjorde prej ku kanë ardhur. Njeriu mëson njëzet vjet për t'u bërë kapiten i anijes që të udhëtojë nëpër Oqeanin Atlantik. Kush i ka mësuar peshqit të udhëtojnë?

Për ata që i kanë sytë hapur, zgjuarsia e Zotit shfaqet në një milion mënyra.

Kur kam qenë në burg, dallëndyshtet e bënin folenë në qeli dhe për çdo vjeshtë shtegtonin. Përsëri të njëjtat dallëndyshe ktheheshin nga vendet e largëta si Mozambiku në burgun e Rumanisë, saktësisht në qelinë numër dymbëdhjetë nga e cila ishin larguar para gjashtë muajsh.

A ekziston Zoti? Kjo pyetje nuk duhet të bëhet. Në çdo veprim të vërtetë në formën e kryefjalës dhe kallëzuesit, kryefjala përfshihet në kallëzues. Zoti është qenie ideale, shuma e të gjitha cilësive më të larta, siç janë dashuria, mirësia, drejtësia, gjithëfuqishmëria, e të tjera. Nëse i ka të gjitha përsosuritë (që duhet t'i ketë, ose përndryshe nuk do të ishte Zot), edhe ai ekziston. Një Zot që nuk ekziston nuk do të kishte pasur përsosuritë. Të pyesësh: «A ka Zot?» është njësoj si të pyetësh: «A ekziston ekzistuesi?»

Zoti është. Unë jetoj me këtë bindje dhe shpresoj të vdes me këtë pohim. Po e përdori shprehjen Zoti është vetëm se kam të bëj me ateistë. Përndryshe është e tepërt.

është tautologji, sikur të thuash «Të gjithë beqarët janë meshkuj.» Kur e thoni fjalën «beqar» kuptohet se është «mashkull». Gjithashtu kur thoni fjalën «Zot», ekzistenca e tij është e nënkuptuar.

Lutja ekziston. Si erdhi njerëzimi te kjo? Prej nga rrjedh kjo dukuri? Kurrkah. Njeriu gjithmonë ka filozofuar rreth Zotit dhe gjithmonë ka kërkuar komunikim me të. Që të dyja, filozofia dhe besimi praktik nganjëherë kanë qenë primitive, nganjëherë krejtësisht gabim, por megjithatë kanë qenë të pranishme.

Një fis indian në Amerikën Veriore lutej kështu:

Oj tokë nëna jonë, o qiell ati ynë, ne jemi bijtë e juaj.

Flitë që kërkonin ne ju kushtojmë me përlulje.

Na bëni një petk nga rrezet shkëlqimplota të diellit,

Agim i bardhë le t'i endi penjtë,

Mbrëmja e kuqe le t'i thurë,

Shiu murmurues le ta stolitë dhe ylberi le ta qepë.

Na bëni një petk nga rrezet shkëlqimplota të diellit,

Dëshirojmë të shëtisim atje ku zogjtë këndojnë.

Dëshirojmë të shëtisim atje ku ka gjelbërim,

Oj tokë nëna jonë, o qiell ati ynë.

Shën Augustini përshkruan përvojën e lutjeve të tij kur ishte fëmijë: «Më çuan në shkollë të shkollohem, të mësoj për gjërat e dobishme për të cilat nuk dija gjë. Sa herë që nuk mësoja më rrihnin. Zot, o Zot, çfarë vuajtjesh kam pësuar unë atëherë dhe sa jam mashtruar! Megjithatë, i takova njerëzit, Zot, që të luteshin ty. Prej tyre mësova — për t'i formuar përshtypjet për ty — se ti je madhështor dhe i plotfuqishëm, që na dëgjon dhe na ndihmon, bile edhe pa iu zbuluar shqisave tona. Është e vërtetë se edhe si fëmijë të jam lutur ty, ti ke qenë strehimi dhe ndihma ime, dhe, tërësisht jam dhënë pas teje dhe, ndonëse kam qenë i vogël, nuk të jam lutur me entuziazëm më të vogël që të mos rrihem në shkollë.»

Ushtarët sovjetikë, shkolluar në shkollat ateiste, luteshin në frontin e luftës. Duke mos ditur diçka më të mirë, shumë prej tyre luteshin kështu: «Zot dhe shpirti i nënës, ndihmona!» Anëtarët e vjetër të Partisë Komuniste, që ranë viktime të spastrimeve në kohën e Stalinit, kanë qenë në të njëjten qeli me mua dhe më kanë treguar se në çastet e vështira janë lutur.

Kjo lutje është krejt ndryshe nga lutjet madhështore të shën Gertrudës: «Jezus, unë jam ti; ti je unë. Unë nuk jam ti; ti nuk je unë. Ne të dy së bashku jemi një qenie krejt e re.»

Megjithatë njerëzit luten. E kam takuar një lektor që i lutej Zotit për të pasur sukses në fjalimet afetare, nga të cilat siguronte jetesën.

Me ose pa vetëdije njeriu kërkon komunikim me Përndëinë e cili ekziston, i cili është dhe mund ta takosh. Dhe nëse nuk tërhiqesh, e takon atë.

Profecia

Autorët e *Librit ateist* e mohojnë mundësinë e çdo profecie. Ata i largojnë profecitë «në emër të shkencës». Si është e mundur atëherë që Sër Isak Njuton, shkencëtar siç thonë librat për të, njeriu që e kanë quajtur «baba i arsyes», ka shkruar librin «Vëzhgimet e profecive»? Njutoni është ai që solli kronologjinë e parë të realitetit shkencor për historinë e Jezusit.

Por në vend të grindjes rreth asaj se a është e mundshme profecia, le t'i analizojmë faktet. Faktet e vërtetuara flasin vetë. A ka fakte që tregojnë se profecitë janë realizuar?

Edhe njohuria sipërfaqësore e Biblës na tregojnë për qindra profeci që janë plotësuar dhe për të tjerat që po plotësohen para syve tanë.

Para së gjithash, janë plotësuar profecitë për Jezu Krishtin, që është tema kryesore në Bibël.

Në Bibël është profetizuar se Krishti do të jetë pasardhës i Abrahamit dhe do t'i përkasë fisit të Judës. Profeti Mikeja ka paralajmëruar shtatë shekuj para lindjes së Krishtit se kjo lindje do të ndodhë në Betlehem. Pothuajse në të njëjtën kohë profeti Isaia foli për veprimtarinë e shërbimit të tij dhe e dha një përmbledhje për jetën e tij. Profeti Zakaria e paratha se Jezusi do të hyjë në Jeruzalem me përulësi, kaluar mbi gomarë. Psalmi 41 e parathotë tradhtinë e Jezusit që do t'i bëhet nga një nxënës i veti. Zakaria tregon se sa do të marrë ky tradhtar për ta tradhtuar dhe se ç'do të ndodhë me paratë. Gjithashtu u paratha se Jezusi do të rrihet e mundohet.

Rreth pesë shekuj para Krishtit profeti Zakaria tha se do ta shohin atë që e shporuan. Davidi tregon se do t'i shpohen duar e këmbë. Po ashtu edhe ringjallja e Jezusit është profetizuar.

Të bën për të qeshur pohimi se «plotësimin» e disa profecive e ka kurdisur Jezusi me ithtarët e vet — siç janë: hyrja në Jeruzalem me gomar, ose kur thotë në kryq «Kam etje!» Po mos u morën vesh ushtarët romakë me qëllim për ta plotësuar profecinë që thotë në një psalm: «I ndanë petkat e mija duke hedhur short» (Psalmi 22: 19)? Çka dinte ushtari romak ose çka i interesonte për profecitë e judenjve? Megjithatë secili kronist i kryqëzimit i shënon me përpikëri hollësitë për hedhjen e shortit të ushtarëve mbi petkun e Jezusit. Gjoni shkruan hollësisht për këtë, e tregon se petku i poshtëm ishte shumë i vlefshëm për ta ndarë në pjesë, prandaj hodhën short, kujt t'i bjerë (Mateu 27:35; Marku 15:24; Luka 23:34; Gjoni 19:23-24).

Po ç'thoni për ngjarjen më të rëndësishme, ringjalljen e Jezusit? Mos e kanë kurdisur edhe këtë?

Edhe nëse ka qenë gënjeshtari më i madh, siç kishin dashur ta paraqesin ateistët, a ka mundur, para rojes së

kujdeshme të romakëve dhe judenjve, ta kurdisë që të mos vdesë në kryq, të mos ia thyejnë asnjë asht sikurse cubave që u kryqëzuan me të (që është plotësim i një profecie tjetër), të zgjohet nga varri i ruajtur mirë dhe i vulosur? Edhe nëse ia ka arritur këtyre, a ka mundur të shpresojë në nxënësit e tij frikacakë që ta thyejnë rojën romake, ta rrokullisin gurin e vulosur dhe ta lirojnë pa farë pengesash? Kjo nuk mund të merret me mend.

Momsen, historian i shquar i Perandorisë romake, e quan kryqëzimin e Shpëtimtarit si faktin më të fortë për historinë romake. Ky fakt nuk ka mundur të kurdiset. Ka qenë plotësim i profecisë.

Profecitë për popullin judeas

«Nuk ka profeci», thonë ata. Ata që i quajmë profetë kanë qenë vetëm njerëz të mençur që kanë ditur t'i parashohin ngjarjet e mëvonshme.

Sipas *Librit ateist*, gjenitë më të mëdhenj të njerëzimit kanë qenë Marksi, Engelsi, Lenini e të tjerët si këta. Ata në mendjen e tyre kishin atë që *Libri ateist* e konsideron si mënyrën më të fuqishme për t'i kuptuar ngjarjet politike shoqërore — kjo mënyrë është materializmi historik.

Marksi ka shkruar një libër që quhet «Çështja judenje». Natyrisht ai e kishte potencialin me të cilin materializmi historik e pajis mendimtarin. Si është e mundur që ai duke jetuar në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, nuk dinte gjë se judenjtë, të shpërndarë ashtu si ishin në tërë botën, do të ktheheshin në vendin e tyre e të kenë shtetin e vet? Lenini jetoi në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Lëvizja zioniste tashmë ekzistonte dhe bëhej gjithnjë e më e fortë. Ai (gjeniu më i madh i njerëzimit) nuk e konsideroi fare si të mundshme se judenjtë do të bashkoheshin në shtetin e tyre, madje ai si vrojtues i mprehtë i çdo hollësie nga jeta politike, i armatosur me

armë të fuqishme të materializmit historik, bile as nuk i përmend zionistët. Ai nuk shënoi asgjë nga kjo lëvizje as që ka pritur se do të triumfonte.

Stalini ka shkruar një libër me titull «Çështja kombëtare». Në këtë libër, që u shkrua para Luftës së Parë Botërore, ai që njëherë ateistët e shpallen gjeniu më të madh të njerëzimit, nuk i njeh judenjtë si komb, ngase populli judenj nuk hyn në definicionin e tij për kombin.

Por kombi judenj me zhvillimin e vet nuk e përfilli as antisemitizmin e Marksit as faktin se ata nuk u pranuan si komb në librin e Stalinit. Judenjtë e formuan shtetin, që është plotësim i profecisë së një libri krejtësisht tjetër — libri që ateistët e përcmojnë më së shumti — Bibla.

Frideriku i Madh, mbreti i Prusisë, një herë i tha kapelanit: «Më jep provë të vërtetë për frymëzimin e Shkrimit të shenjtë». Kapelani iu përgjigj: «Judeu është prova e vërtetë, Lartmadhëri». Judenjtë dhe historia e tyre e mrekullueshme janë edhe një provë tjetër për të vërtetën e profecisë biblike.

Për çudi, disa prej autorve të *Librit ateist* janë judenj, që më këtë plotësohet profecia që thotë se disa judenj do të jenë mallkim për tërë popujt. Por gjithashtu ka judenj që luftojnë ateizmin dhe e përhapin Fjalën e Perëndisë, në këtë mënyrë e plotësojnë profecinë tjetër në të njëjtën Bibël që thotë se pjesa tjetër e popullit në Izrael në ditët e fundit do t'i kthehet Shpëtimtarit Jezu Krishtit dhe do të fitojë bekim të madh.

Profecitë për judenjtë fillojnë para nja 4.500 vjetësh me premtimin që i jepet judeut të parë, Abrahamit. Ky është: «Do të jap shumë pasardhës dhe ata do të bëhen një komb i madh» (Zanafilla 12:2).

Bota e krishterë e mban emrin e një judeu, Jezu Krishtit. Kampet komuniste mbajnë emrin e një judeu tjetër, Marksit. Edhe gjithësia në tërësi e mban emrin e një judeu, Ajnshtajnit. Mbi gjashtëdhjetë për qind të fituesve të çmimit Nobel janë çifutë, ndër ta edhe shkrimtari sovje-

tik, Boris Pasternak. Judenjtë — njerëzit si Trotski, Zinovievi dhe Kamenevi — kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në Revolucionin e Tetorit. Lenini ka qenë gjysmë jude. Judenjtë sot luajnë një rol të madh në luftën antiqeveritare në Bashkimin Sovjetik. Litvinovi, shkrintari Daniel, Levitin Krasnov dhe luftetarët tjerë për liri që kanë pësuar në burg, janë judenj. Judenjtë janë aktiv në jetën politike dhe ekonomike të Shteteve të Bashkuara dhe të shumë vendeve tjera. Në shumë vende të perëndimit kanë pozita në qeveri. Judeu Teller quhet «baba i bombës bërthamore».

Dr. Sale Harrison në librin e tij «The Remarkable Jew» (Judeu i shquar) shkruan: «Askush nuk dyshon se judenjtë sot e mbajnë pasurinë e botës. Kudo që ndodhen, janë bërë magjistarë të financave.»

Basil Mowll në librin e tij «Bible Light in Present Events» (Drita e Biblës në ngjarjet e sotme), thotë: «Nëse i llogaritim me kujdes profesorët universitarë të Evropës perëndimore, me përjashtim të Britanisë së Madhe para Luftës së Parë Botërore, na dalin se shtatëdhjetë për qind janë judenj dhe me bindje judease.»

Femra e parë në histori që u punësua nga kuria e Romës, ishte një e krishtere me origjinë judease.

Simon Weil, jude, është sot njëri nga teologët më të shquar të katolicizmit.

Hebraishtja është e vetmja gjuhë që është ringjallur dhe sot vazhdon të flitet në Izrael. Kjo gjë nuk ka ndodhur me latinishtën, greqishtën e vjetër, sllavishtën, irlandishtën, uelsishtën ose ndonjë gjuhë tjetër të vjetër.

Kësisoj, profecia është plotësuar. Një fis i vogël beduin u bë një komb i madh — i madh në të gjitha aspektet, për të mirë e për të keq. Bile edhe Jaroslavski, themelues i Shoqatës Ndërkombëtare për Afetarë dhe udhëheqës i kësaj lëvizjeje, ka qenë jude.

Profecia vazhdon: «Do të të bekoj.» Kush ka marrë bekim nga komunizmi i detyrohet një judeu, Marksit.

Kush ka marrë bekimin nga kapitalizmi i detyrohet jude-njve që kanë shërbyer si mjet për formimin e këtij sistemi. Kush ka marrë bekimin nga krishterimi i detyrohet një judeu, Jezusit.

Fjala e Perëndisë në të njëjtin kapitull thotë: «Do t'i bekoj ata që të bekojnë ty dhe mallkimi im do të bjerë mbi ata që të mallkojnë ty» (Zanafilla 12:3). Është i qartë fakti se historia gjithmonë i ka favorizuar miqtë e jude-njve. Kur Spanja i dëboi judenjtë, i perëndoi dielli perandorisë së saj. Rusia cariste i ka përndjekur judenjtë dhe e ka marrë dënimin e merituar. Po ashtu edhe Gjermania naziste. Vendet ku judenjtë janë të lirë e gëzojnë lirinë edhe vetë.

Shumë kohë pas Abrahamit është parakallëzuar se judenjtë do të shpërndahen nëpër botë. Sot tri raca janë të shpërndara: romët, armenët dhe judenjtë, por judenjtë janë të shpërndarë më së shumti. Ka shumë pak vende pa judenj.

Jezusi e paralajmëron rrënimin e Jeruzalemit që ndodhi në vitin 70 pas Krishtit. Profeti Ozea (9:17) paralajmëron: «Zoti do t'i braktisë, sepse nuk deshen ta dëgjojnë: dhe do të enden nëpër botë»; dhe ashtu u bë. Në «Ligjin e përtërirë» 28:37 shkruan: «Në kohën kur Zoti do t'ju shpërndajë, bota do të çuditet me ju; do të bëjnë shaka e do t'ju përqeshin»; dhe ashtu u bë. Është përqeshje e zakonshme shprehja «jude i ndytë».

Gjithashtu është paralajmëruar edhe kthimi i judenjve në Palestinë, e kjo ndodhi para syve tanë. Populli i Biblës, që me zemër të këputur endej nëpër botë, përsëri e fitoi atdheun e vet.

Bibla na tregom disa herë se Perëndia dëshiron që judenjtë të mbetën popull unik — dhe në të vërtetë ashtu janë.

Origjina e popujve të tjerë është e përzier me legjenda e mite. A di dikush të tregojë se kush ka qenë rusi i parë? Ose kush ka qenë gjermani a turku i parë? Pyete cilindo

jude kush ka qenë judeu i parë, dhe në mënyrë të vendosur do të përgjigjet: «Abrahami».

Judenjtë janë unik si dëshmi për besueshmërinë e Biblës. Unike është edhe shpërndarja e tyre nëpër botë si dhe zhvillimi i tyre. Judenjtë janë vetëm një gjysmë për qind të popullsisë së botës, megjithatë sa disproporcionues është vuajtja e tyre, por gjithashtu edhe çlirimi, kthimi i tyre në vendin e vet. Ata janë unik nga fakti se e tërë historia e tyre është paralajmëruar. Zoti i ka thënë Moisiut: «Lufta do të bjerë mbi ju dhe do t'ju shpërndaj nëpër mbarë botën. Vendi juaj do të shkatërrohet dhe qytetet do të mbeten të shkreta» (Levitiku 26:33). «Zoti do t'ju shpërndajë nëpër botë, dhe do të zvogëlohet numri juaj, atje ku Zoti do t'ju çojë» (Ligji i përtërirë 4:27).

Më vonë, edhe një profeci e paralajmëron bashkimin e popullit të shpërndarë të Izraelit: «Do t'ju mbledh nga të gjitha vendet, t'ju bashkoj e t'ju çoj në vendin tuaj» (Ezekieli 36:24).

Judenjtë janë unik dhe kanë mbetur të papërzier me gjithë faktin se kanë qenë të shpërndarë në mbarë botën. Kudo që gjendet judeu, ai është jude. Nuk është rus jude, por është jude rus. Judenjtë mbeten judenj, ndonëse nuk kanë forcë përqendruese dhe qeverisje botërore.

Ata janë popull i vetëm që nuk u asgjësuan gjatë pësimeve përmджekjeve të papara. Faraonet e Egjiptit, mbretërit asirianë, perandorët romakë, lufta e kryqëzatatave, inkuizitorët dhe nazistët i kanë dëbuar nga atdheu, i kanë mërguar, robëruar, konfiskuar, torturuar, masakruar me miliona — cilido popull tjetër do të ishte thyer — por judenjtë kanë mbijetuar.

Perëndia u ka premtuar se do t'i mbledhë të dëbuarit e Izraelit e t'i bashkojë të shpërndarët e Judesë nga të katër anët e botës. Kjo është thënë nga Isaia që jetoj nja 700 vjet para Krishtit e 800 vjet para shpërndarjes së judenjve pas rrënimit të Jeruzalemit. Si e ka ditur se judenjtë do të shpërndahen e pastaj do të bashkohen ngado që të jenë?

Një numër i vogël prej judenjve që janë kthyer në Izrael janë fetarë. Shumica prej tyre nuk e njohin Shkrimin e shenjtë dhe profecitë, dhe prej atyre që i njohin, vetëm një pakicë beson në të. Megjithatë ata janë kthyer në vendin e tyre — mund ta quani këtë impuls të verbër, pikërisht sikur zogjtë që shkojnë në jug gjatë kohës së dimrit — ose, me fjalë të tjera, fuqia e Perëndisë po i shtyn që të plotësohet fjala e tij.

Në një profeci tjetër në të cilën përmendet kthimi i judenjve në Palestinë, thuhet se do të kthehen në dy mënyra (Jeremia 16:14-16).

Zoti do të dërgojë «peshkatarë» që do t'i «peshkojnë» judenjtë, kështu që lëvizja zioniste «peshkoi» me mijëra judenj me karremin e vates së tyre kombëtare.

Në të njëjtin rresht thotë po ashtu se Zoti do të dërgojë edhe «gjahtarë» që do t'i «gjuajnë» judenjtë. Antisemitizmi në mbarë botën, e sidomos në kohën e Hitlerit, ka bërë «gjah» në judenj, e me këtë i çuan në drejtim të Palestinës.

Edhe një profeci tjetër për judenjtë e që na befason është se ata do t'i kthehen Krishtit në kohën e fundit. Edhe kjo gjithashtu është në përmbushje e sipër.

Tashmë ju kam përmendur judeun Ajnshtajn që ka qenë adhurues i Nazarenasit.

Franc Verfel, poeti i famshëm judeas, ka shkruar një libër të njohur krishter me titull: «Kënga e Bernardetit». Shallom Ash, romancieri i shquar judeas, është bërë i krishterë dhe ka shkruar librin e mirënjohur «Jezusi nga Nazareti». Martin Buber, filozof i shquar judeas, e quajti Jezusin «Vëllau im i madh». Henri Bergson tregon haptas për besimin e tij krishterë. Niels Bohr, fizikan i shquar, ka qenë jude i krishterë. Gjithashtu ka qenë edhe August Pikard, njeriu i parë që shkoi në stratosferë.

Të ndalemi e të shohim se edhe komunistët kanë profetizuar, porse ato nuk janë plotësuar. Engelsi në një letër dërguar Sorge-it më 10. shtator 1888, pat parashikuar se

brenda dhjetë vjetësh Kanadaja do të aneksohej nga Shtetet e Bashkuara. Ka kaluar një shekull por nuk duket se ka shenja për një gjasë të tillë.

Shoku Krushov në vitin 1958 profetizoi se brenda pesë vjetësh Rusia do ta arrijë dhe ta kalojë nivelin material të Shteteve të Bashkuara. Kanë kaluar më tepër se tridhjetë vjet e Bashkimi Sovjetik ende importon grurë nga Amerika! Njeriu që nuk është i frymëzuar prej Perëndisë nuk mund ta profetizojë të ardhmen.

Miqtë tanë ateistë e kanë paraparë solidaritetin e përjetshën ndërmjet vendeve komuniste, kurse tash kanë grindje mes vete. Profecia e besueshme është privilegj ekskluziv i Shpirtit të Perëndisë e vërtetuar në Fjalën e Perëndisë.

Profecitë për ditët e mëvonshme

Libri ateist i mohon profecitë me këto fjalë: «Shumë profeci biblike janë folur pasi që kanë ndodhur ngjarjet e paralajmëruara. Tekstet përkatëse janë futur në Bibël post factum — që d.m.th. pas përfundimit të ngjarjeve përkatëse.»

A mos presin miqtë tanë ateistë të besojmë se fitorja e Izraelit në histori, valëvitja e flamurit zionist në shtëpinë e Hitlerit në Nyrnberg dhe restaurimi i shtetit të judenjve — të gjitha ngjarjet e shekullit nëntëmbëdhjetë — janë futur tash vonë në Bibël? A nuk dëshmuuan pergamenat e Detit të Kuq, që datojnë nga shekulli i fundit para erës sonë, për epokën e profecive? A nuk na paralajmëron Pjetri (peshkatar) në Besëlidhjen e Re se elementet do të shkrihen nga nxehtësia e madhe, që është një shenjë për shkatërrimin bërthamor?

Luftërat botërore nuk kanë qenë të mundshme para 3.000 vjetësh, sepse nuk ka ekzistuar komunikimi ndër-

mjet kontinenteve, veçse ndoshta në një shkallë shumë të thjeshtë.

Por profeti Jeremia, që jetoi nja 600 vjet para Krishtit, i paralajmëron luftërat botërore. Ai nuk e ka ditur se a ekzistonte Amerika, Australia apo Japonia, por shkruan se: «shpata do të bjerë mbi të gjithë popujt... e liga do të shkojë prej një populli te tjetri... do të ketë vrasje... prej një skaji të botës deri në skajin tjetër» Jeremia 25:27-33).

Profecia u plotësua pas njëzet e gjashtë shekujsh. Me mijëra njerëz u vranë në luftë që u shtri nga Japonia deri në Rusi e Francë, luftë në të cilën vdiqen amerikanë, kinezë, gjermanë, judenj dhe shumë të tjerë. Këto gjëra janë paralajmërim i shkatërrimit të ardhshëm të botës.

Jezusi kur flet për ditët e fundit (mbarimin e botës) thotë: «Atëherë do të jetë mjerim aq i madh, sa që mjerim të tillë nuk ka pasur që se u krijua bota deri tani, as nuk do të ketë më» (Mateu 24:21). Dhe ashtu është.

Kurrë në historinë e njerëzimit nuk ka pasur mjerime më të mëdha nga ato që i bënë nazistët duke djegur njerëz në furra e duke i mbytur në dhoma të gazit, ose vrasjet masive të Stalinit a Mao Ce Dunit.

Kur Jezusi tha: «Dhe po të mos shkurtoheshin ato ditë, askush nuk do të shpëtojë», në atë kohë nuk kanë ekzistuar kurrfarë mjete shkatërruese të cilat kanë mundur ta rrezikojnë njerëzimin. Njerëzit kishin shigjeta e heshta. Askush nuk mundte ta rrezikojë ekzistencën e mbarë njerëzimit. Tani ekzistojnë mjetet për shkatërrim të përgjithshëm.

Po pse të shkojmë aq larg? Vetë komunizmi është plotësim i profecisë. Është si Antikrishti që paralajmërohet në Bibël: «Iu dha pushteti të bëjë luftë kundër shenjtërve dhe t'i fitojë. Iu dha pushtet mbi çdo fis, popull, gjuhë dhe komb» (Zbulesa 13:7).

Edhe një profet tjetër përshkruan një pushtet të tillë si komunizmi. Ai thotë se dëshira e tyre do të rritet si ferri,

janë si vdekja dhe nuk kënaqen derisa t'i bashkojnë të gjithë popujt e t'i bëjnë për vete.

Ne të krishterëve kjo ambicie na duket e paarsyeshme. A ka qenë Stalini i lumtur kur ua imponoi dëshirën e vet një miliard njerëzve dhe kur i duartroktonin si gjenit më të madh? Gruaja e tij bëri vetëvrasje. Ai i ka burgosur anëtarët e familjes së vet. Nuk ka pasur besim në askënd, bile as në miqtë e tij më të ngushtë, dhe kishte arsye për këtë. Ihtarët e tij pritnin të vdiste e ta shpallnin kriminel. Krushovi thotë se Stalini një herë kishte deklaruar: «Unë nuk kam besim as në vetvete!»

Ka një tregim për një pasanik që ka qenë shumë i sëmurë. I kishin thënë se do të shërohej vetëm po të vish-te këmishën e një njeriu të lumtur. Ai e çoi shërbëtorin ta gjejë një njeri të lumtur e t'ia blejë këmishën pa marrë parasysh çmimin. Por shërbëtori nuk gjeti njeri të lumtur. Çdo kush ia kishte zili lumturinë tjetërkujt, ose lakmonte të kishte më shumë, ose kishte ambicie të paarritshme. Pas shumë kërkimeve gjeten një druvar, të zhveshur deri në brez, që me gëzim e kryente punën e rëndë, e ndër-kohë këndonte. E pyeten: «A je i lumtur?» Ai u përgjigj: «Plotësisht.» Atëherë i ofruan një shumë të madhe parash për t'ia blerë këmishën. Për fat të keq nuk kishte këmi-shë.

Lumturia nuk gjendet në sundimin kundrejt botës, por në bashkimin me Perëndinë. Miqtë tanë komunistë nuk dinë për këtë sekret. Prandaj ata kanë ambicie të mëdha, megjithëse kurrë nuk janë të kënaqur dhe gjithnjë e më tepër largohen nga Utopia për të cilën thonë se po e ndër-tojnë.

Miqtë tanë ateistë shpeshherë ankohen për përparimin e ngadalshëm të punëve në Bashkimin Sovjetik. Po i sigurojmë: do të kenë sukses! Antikrishti të cilit ata po ia përgatitin rrugën do të ketë pushtet mbi botën. Komunizmi do të triumfojë, në histori, për një kohë të shkurtë.

Por në mbarim të botës Jezusi do të kthehet përsëri.

Këmba e tij do të shkelë në malin e Ullinjve në Izrael. Bibla thotë: «Do ta shohë çdo sy» (Zbulesa 1:7). Edhe kjo ka qenë e pakuptueshme në kohën kur Gjon ungjilltari e ka shkruar. Si kanë mundur njerëzit në Spanjë ose Afrikën Veriore ta shohin Jezusin duke u ngjitur në qiell nga mali i Ullinjve dhe si do të mund ta shohin duke ardhur përsëri?

Tani televizioni po e provon profecinë e Biblës si të vërtetë. E tërë bota shohin lojnat olimpike. E tërë bota do ta shohë kthimin e Jezusit.

Atëherë «në emër të Jezusit do të përkulet çdo gju i atyre që janë në qiell, në tokë e në nëntokë dhe çdo gjuhë do të dëshmojë se Jezu Krishti është Zot, në nder të Përndisë Atë» (Filipianëve 2:10).

Pasi të kthehet Jezu Krishti përsëri, e ta marrë të gjithë pushtetin në duar të veta, atëherë do të vijë mbretëria e paqes në botë, nuk do të ketë mëkate as vuajtje.

Para asaj kohe, ne duhet të kalojmë nëpër katastrofa të tmerrshme. Ndër shenjat që tregon se po afrohet fatkeqësia janë edhe konferencat paqësore dhe bisedat për zvogëlimin e armatimit, që janë të paralajmëruara në Bibël kështu: «Ndërsa njerëzit do të thonë: 'Ç'paqe dhe ç'siguri!', shi atëherë, porsì dhimbjet e lindjes të gruas shtatzënë do të vijë papritmas mbi ta rrënimi dhe nuk do të mund të shpëtojnë» (1 Selanikasve 5:3).

Kur apostulli Pal e shkroi këtë profeci, njerëzit nuk kishin me çka ta shkatrojnë tokën. Toka nuk mund të shkatërrohej me shpata e me shigjeta. Sot bota ka armë bërthamore.

Profecia bëhet veçanërisht e rëndësishme në ditët e sotme. Jezusi ka paralajmëruar se «Jeruzalemin do ta shkelin paganët derisa të zgjasë koha e paganëve» (Luka 21:24). Fakti se judenjtë në vitin 1967 fituan pavarësinë mbi mbarë Jeruzalemin dhe Palestinën mund të jetë shenja e parë se i është afruar fundi kohës së paganëve, e kjo është koha kur paganët (jojudenjtë) mund t'i kthehen

besimit në Krishtin dhe të shpëtohen për amshim. Është momenti më i ngutshëm kur njerëzit duhet të besojnë në Krishtin dhe t'i kthehen atij derisa nuk është bërë vonë. Është plani i djallit që mu në këtë kohë *Libri ateist* të ngjallë dyshime për rëndësinë dhe ekzistencën e profecisë.

Me përpjekjet e tij ky libër është vetë plotësim tragjik i një profecie që thotë: «E njëmend, predikimi për kryqin, për ata që dënohen, është marri... » (I Korintasve 1:18).

Kundërshtarët tanë ateistë shpesh i vizitojnë kishat ortodokse që të dinë diçka për to. Nganjëherë ndërsa gjen-den në kishë e thonë një lutje në heshtje, ju duket se janë kapluar nga shenjtëria e vendit.

Atje i dëgjojnë këngët e vjetra të popullit rus, si: «Oj Mari, hirplote: Zoti është me ty.» Nëse i dinë profecitë e Biblës, do ta gjejnë himnin e Marisë tek Luka ungjilltar, i cili i shënoi këto fjalë kur ajo ishte e zënë me barrë me Jezusin: «Që tani të gjitha breznitë do të më quajnë të lumtur» (Luka 1:48).

Të krishterët kurrë nuk dyshojnë në profeci sepse e shohin se shumë prej tyre zbatohen në jetën e tyre. Kur t'i kthehemi besimit në Jezusin, e kuptojmë se kjo ka qenë paraparë shumë kohë më parë. Në Bibël lexojmë se Perëndia na zgjodhi para krijimit të botës që t'i përkasim Jezu Krishtit (Efesianëve 1:4). Sa larg në të kaluaren shkon kjo profeci!

Pastaj i gjejmë profecitë për të ardhmen: «Që me mirësinë e tij ndaj neve në Jezu Krishtin ta tregojë në shekujt e ardhshëm pasurinë e patregueshme të veten» (Efesianëve 2:7). Kështu ne e dimë se çfarë kuptimi ka jeta jonë dhe se mirësia e Perëndisë ruhet për ne.

Kush e krijoi Perëndinë?

Ekziston një Perëndi. Ne mund të kemi bashkësi me të. Ai na është zbuluar me anë të profetëve dhe me anë të Birit të vet, Jezu Krishtit.

Natyra është si një gosti. Në të ka banana, shalqi, domate e grurë. Por nuk mund të ketë gosti pa gjelbërës. As botë nuk mund të ketë pa Krijues. Ky është argumenti më i mirë për ekzistencën e Perëndisë.

Por kundërshtarët tanë kanë të drejtë të përgjigjen me një pyetje tjetër. Nëse gjithçka e ka krijuesin e ju thoni se Zoti është krijuesi i të gjithave, atëherë edhe Zoti duhet të ketë krijues. Kush e krijoi atë? Nuk do të ishte punë e mirë t'i shmangemi përgjigjes duke thënë se kjo pyetje është blasfemi. Mua më duket mjaft e drejtë. Unë vetë e kam bërë këtë pyetje si fëmijë.

Çdo masë a materie është në lëvizje të përhershme. Ato nuk janë saktësisht të njëjta siç ishin para një sekondi. Gjithmonë ka një shkak që ka shkaktur ndryshimin. Lëvizja e materies matet me anë të kohës. Gjatë kalimit të kohës, disa materie e ndryshojnë gjendjen, që kur t'u vijë koha, bëhen shkaktare të ndryshimeve të reja. Materia është e papërfytyrueshme pa një shkak fillestar.

Por ekzistenca në kohë nuk është forma e vetme e ekzistencës. Ekziston edhe pakohësia, në të cilën nuk ka fillin as fund; nuk ka shkak as pasojë. Kjo është sfera e Zotit. Ai ka krijuar gjithçka. Ai i përket sferës së vetekzistencës. Askush nuk e ka krijuar atë.

Cila u krijua e para, pula apo veja? Kjo është pyetje e vjetër. Nëse veja u krijua e para, kush e bëri, pra? Nëse pula, prej nga erdhi, pra? Mund të bisedoni rreth kësaj me mijëra vjet pa ardhur në ndonjë përfundim nëse nuk e kuptoni se me këtë pyetje nënkuptohen tri gjëra: ekziston pula / ekziston veja / ekziston «e përparmja» dhe «e pastajmja».

«E përparmja» dhe «e pastajmja» janë kategori të mënyrave tona të të mënduarit për t'i kuptuar gjërat, mënyra në të cilat ne i kuptojmë fazat e njëpasnjëshme të materies që është në lëvizje të përhershme. Por koha nuk është asgjë tjetër veçse lëvizje që shërben për të matur. Koha nuk ka ekzistencë objektive, të pavarur nga trupat e fenomenet. Kjo është ABC-ja e teorisë së relativitetit të Ajnshtajnit. Energjia kinetike i shkakton lëvizjet dhe i jep jetë nocionit të kohës. Po ç'thoni për fushën gjigante të potencialit elektrik? Është joaktive. Merrne me mend botën vetëm me potencial elektrik. Nuk do të kishte pasur as lëvizjen më të vogël, nuk do të kishte pasur asgjë për ta matur. Do të kishte qenë botë pa kohë. Sfera e shpirtit dhe e Zotit janë jashtë kohës. Ne e quajmë këtë amshim. Amshimi nuk është kohë e pafund, por është pakohësi, pra, në të nuk ekziston koha fare.

Ta sqarojmë kuptimin e kësaj që përmendem më lart.

Supozojmë se në një planet që është larg 2.000 vjet dritë, ka qenie që janë shumë më të zhvilluara se ne, që me teleskopët mund ta shohin jo vetëm planetin tonë, por edhe banorët që ka në të.

Ta zëmë se këto superqenie e shikojnë sot Betlehemin. Ç'do të kishin parë? Lindjen e Jezusit, djetarët, Marinë, Jozefin, foshnjen — këtë do të kishin parë sepse nevojitet të kalojnë 2.000 vjet që të arrijë drita te ky planet i largët. Për ne lindja e Jezusit është ngjarje e së kaluarës, kurse për ata kjo do të ndodhte sot.

Merrni me mend superqenie të tilla në një yll 3.500 vjet drite larg! Ata do të kishin parë bijtë e Izraelit, nën udhëheqjen e Moisiut, duke udhëtuar për Palestinë. Do t'i kishin parë duke u gëzuar për lajmin se Shpëtimtari do të vijë. Për ta, lindja e Jezusit do të ishte një ngjarje e ardhshme.

Një ngjarje që për planetin e tonë është e kaluar, për një planet tjetër është e tashme, kurse për një tjetër e

ardhshme. Si është ashtu që shpirti mund të kuptojë se ç'po ndodh njëkohësisht në të tri planetet? Nuk ka të kaluar, të tashme dhe të ardhshme.

Problemi «cila u krijua e para, pula apo veja?» është i zgjidhur. Nuk ekziston e përparmja as e pastajmja. Ky problem nuk ka kuptim në sferën ku nuk ka të kaluar e të ardhshme, ku nuk ka shkak as pasojë. Kështu pyetja «Kush e ka krijuar Zotin?» nuk mund të parashtrohet, sepse nuk ka të përparme e të pastajme.

«E tashmja» e jonë nuk është me rëndësi për fenomenet kozmike, ashtu si nuk është me rëndësi as ajo se çka ndodh në atom. Dritën e yjeve që e shohim ne sot mund të jetë zhdukur para shumë vjetësh. Antipartikulli «omega-minus-baron» jeton vetëm një të 15 miliardën të sekondës. Ne ia shohim gjurmat shumë kohë pasi të jetë zhdukur.

Ajnshtajni shkruan: «Secili përcaktim kohor apo sistem koordinatash e ka kohën e vet.» Si dhe: «koha ka rëndësi vetëm atëherë kur trupit në fjalë i është përcaktuar koha.» Për shpirtin e amshuar, koha nuk ekziston. Këtu gjithçka është e lidhur dhe krijon një bashkësi. Zoti është një. I tërë realiteti që e ka krijuar ai është një fushë e vetme gravitacioni. Kur të vijmë te pika Omega, shqetësimi ynë i përhershëm që matet me kohë, shndërrohet në soditje të bekuar, në ekstazë dhe në entuziazëm të adhurimit.

Ka një tregim për një murg të cilin e kishte çuar kryemurgu me punë në pyll. Atje për një çast e dëgjoi një zog nga parajsja. Kur u kthye në manastir, portieri nuk e njohu. Kryemurgu dhe të gjithë murgjit tjerë iu duken të panjohur. Askush nuk e njohte. Më në fund, dikujt iu kujtua se një libër i vjetër i manastirit tregon për një murg që kishte shkuar në pyll para shumë shekujve dhe se nuk ishte kthyer kurrë më. Për të vetëm një çast kishte kaluar; kishte dëgjuar një muzikë të bukur të parajsës. Për të tjerët, ndërkohë, shekujt kishin kaluar.

Kjo legjendë mesjetare sot është bërë provë e fortë shkencore për të ashtuquajturin paradoksi i Langevinit.

Koha që kalon treni prej një shtylle te tjetra është më e shkurtër për një vrojtues që ndodhet në tren se sa për një vrojtues që qëndron në peron. Jo vetëm koha që është më e shkurtër për të parin, por për gjithçka që ka në tren, bile edhe ora e tij ngadalëson.

Ta zëmë se një raketë shkon shpejt gati sa shpejtësia e dritës. Njerëzit në tokë duke i shënuar të rrahurat e zemrës të astronautit do të kishin konstatuar se zemra i është ngadalësuar. E njëjta gjë do të kishte ndodhur me lëvizjet në trupin e astronautit, ndonëse për vetë astronautin çdo gjë do të kishte qenë njësoj.

Sipas llogaritjes së pamohueshme të Langevinit, nëse njeriu nisjet prej tokës me shpejtësi më të vogël se drita për të dymijtën pjesë, pas një viti udhëtim të kohës së tij kur të kthehet me të njëjtën shpejtësi në tokë (d.m.th. dy vjet pas nisjes së tij duke matur kohën me orën e tij), do të ishte kthyer dy shekuj më vonë sipas kalendarit tonë. Nëse stërnipi i vajzës së tij është lindur në ditën e nisjes kur astronauti ka qenë tridhjetë vjeç, ai do të ishte njëqind vjeç, ndërsa ai vetë do të ishte tridhjetë e dy vjeç.

Një raketë e tillë nuk është vetëm fantazi. Ekziston diçka për të cilën shpejtësia e dritës është lojë fëmijësh. Kjo është raketa e shpirtit. Për një sekond, mendimi im kalon prej njëres galaktikë në tjetrën, prej atje te nëna plakë, prej atje te parajsa, prej parajsës te një qeli këtu afër në të njëjtin korridor të burgut dhe përsëri kthehet tek yjtë e largët. Pastaj kaloj në bashkësi me Adamin e Abelin, por menjëherë mund t'i lë ata e të kaloj në kohën e ardhshme me mijëra vjet përpara, e të kthehem në qelinë time dhe të ha darkë të cilën porsa ma sollën. Shpirti nuk është i lidhur me kohën e hapsirën. Vdekja ndodh në kohë. Në kohë ngjarjet pasojnë njëra pas tjetrës. Unë kam lindur, jam zhvilluar, do të vdes, do të ngjalle përsëri.

Në sferën jashtë kohës ngjarjet nuk vijnë njëra pas tjetrës. Atje nuk ka vend për të vdekur personaliteti im.

Nëse udhëtoj me tren me shpejtësi të pandryshueshme në një drejtim të caktuar, fitoj përshtypjen se vendbanimet po kalojnë pranë meje. Mund t'i shoh nga dritarja si një lumë të pafund lokalitetesh. Por në të vërtetë, lokalitetet bashkëjetojnë njëkohësisht. Vetëm për mua duket si rrjedhë. Në kinema e shoh jetën e disa personave prej lindjes deri në vdekje, më të gjitha problemet e tyre. Megjithatë në kasetën e filmit këto ekzistojnë të gjitha njëkohësisht. Vetëm për mua këto vijnë me radhë gjatë kohës.

Ne jemi mësuar me kufizimin e peshës. Ka qenë zbulim i madh kur astronautët e parë e kuptuan se mund të jetojnë edhe në gjendje të papeshë. Ne jetojmë në një kohë në të cilën ngjarjet paraqiten dhe zhduken. Prandaj i besojmë vdekjes e tretjes. Por ekziston gjithashtu edhe sfera jashtë kohës, sfera e Zotit. Ai është autori i pakrijuar dhe krijues i të gjitha krijesave. Në të e kemi jetën e përjetshme, ekzistencën dhe lëvizjet. Ndërsa jemi në kohë, jetojmë një jetë sikur të ishte e përbërë prej një ngjarje në tjetrën. Por që t'ia zbatojmë shpirtit nocionin e kohës është po aq marri sikur t'ia zbatojmë edhe fizikës nukleare.

Sipas teorisë së relativitetit, në shpejtësinë e dritës ndalet çdo orë, përkundër të gjitha përpjekjeve për ta shpejtuar. Pra, a nuk është e arsyeshme se në Bibël Zoti quhet «dritë» kurse të krishterët «drita e botës»?

Të gjithë përkulen kur e dëgjojnë emrin e Ajnshtajnit, porse kundërshtarët e mi do të kishin bërë mirë mos të harrojnë se Lenini e sulmon parimin e relativitetit, se Maku i cili e ka frymëzuar punën e Ajnshtajnit është shpallur nga Lenini si Juda (tradhtar) i shkencës dhe, për një kohë të gjatë filozofët sovjetik e lanë anash Ajnshtajnin dhe tërë lëmin e kibernetikës.

Jeta pas vdekjes

Marksistët nuk dinë çka është jeta. Akademiku rus Oparin thotë: «Jeta është një nga format e lëvizjes së materies.» Ç'duhet të bëjë një i ri me një definicion të tillë? A duhet të pyesë babanë e marksizmit: «Si t'i besoj jetës?» «Si mund ta shfrytëzosh jetën më së miri?» Por babai nuk mund t'i japë përgjigje të birit në pyetjen, si duhet të sjellet njëra prej formave të lëvizjes së materies me vetitë e saja, me ligjet e pandryshueshme. Sa më e fuqishme është përgjigjja e krishterë: «Jeta është person, Jezu Krisht, miqësinë e të cilit mund ta pranoni dhe shembullin e tij ta vazhdoni. Jeta është mëshirë e përhershme. Periudha e saj në tokë duhet të shfrytëzohet në mënyrë të pakursyer për të tjerët, kurse amshimi në parajsë — për të cilën jeta tokësore është paradhomë — për t'u kënaqur me Krijuesin dhe me lavdinë e tij.»

Marksistët duke mos ditur se çka është jeta, nuk e dinë as çka është vdekja. Prandaj vdekja është terror, pa ngushëllime e pa shpresë të besimit. Është ngushëllim edhe më i keq t'i thuhet njeriut të pësuar: «Ne vdesim e zhdukemi përgjithmonë. Por socializmi po përparon e së shpejti do të shëtisim në hënë.»

Marksi në kulmin e pikëllimit i shkruan në një letër Lasalit kështu: «Vdekja e birit më ka tronditur thellë, dhe e ndiej humbjen aq fort sikur të kishte ngjarë dje kjo punë, ndërsa gruaja ime e gjorë është thyer krejtësisht pas kësaj goditje.»

Ne i kuptojmë ndjenjat e tij. Ai nuk dinte për fitorën e Krishtit mbi vdekjen.

I krishteri sovjetik Talantovi vdiq në burg për shkak të besimit. Biri i tij i madhi e vazhdoi luftën e krishterë. Edhe ai vdiq në burg. Biri i dytë gjithashtu e përkrahu krishterimin. Edhe ai vdiq në burg. Asnjërin nuk e frikësoi vdekja.

Skripnikovi u vra në Bashkimin Sovjetik për shkak të besimit krishterë. Bija e tij Aida, pa marrë parasysh fatin e babait të vet, e vazhdoi të njëjtën rrugë. Ajo është ende e re. Tashmë është burgosur katër herë sepse e pranon besimin në Krishtin.

Për ateistët vdekja është si shpata e Demoklesit që iu rri mbi kokë duke jua kujtuar se së shpejti gëzimi — ose pikëllimi — do t'i zhduken.

Vdekja nuk i frikëson ata që e njohin atë.

Jezusi thotë: «Kush jeton e beson në mua, nuk do të vdesë askurrë» (Gjoni 11:26). Ai i tha këto fjalë pranë varrit të një njeriu që kishte besuar në të. Jezusi e vërtetoi mirë. Lindja e vdekja janë mënyra se si ne e kuptojmë realitetin e jetës nga perspektiva e kohës. Të krishterët nuk kanë nevojë t'i frikësohen vdekjes.

Gjatë Revolucionit rus nën terrorin e madh të Çekës, që dhënë urdhri për një grup të krishterësh të mbyten në ujë. Njëri prej tyre tha: «Ne shkojmë te Zoti! Çfarë rëndësie ka a hymë në tokë apo në ujë?» Ata nuk kishin frikë.

Libri ateist e shpall besimin në jetën përtej varrit si «bazat e teorisë fetare» dhe «jashtëzakonisht të rrezikshëm».

Por çka është jeta nëse asgjë nuk vjen pas vdekjes?

Ta zëmë se ideali komunist është i përsosur. Do të kishim një shoqëri të përkryer pa dallim ndërmjet të pasurve e të varfërve, pa luftëra e revolucione, me pasuri, kulturë e lumturi për të gjithë. Sidoqoftë njerëzit do të vdesin. Të varfërit vdesin lehtë. Ata nuk kanë shumë për të humbur. Për njerëzit e lumtur vdekja është katastrofë. Kirovi, sekretar i përgjithshëm i Partisë Komuniste për rajonin e Leningradit, vlarë nga Stalini, ka qenë në pozitë të lartë. Ai është kënaqur me jetën. Fjalët e tij të fundit kanë qenë: «Kam dëshirë të jetoj, e të jetoj, e të jetoj.» Mos ta kishte vlarë Stalini, ai do të kishte patur një vdekje natyrore pas pak vjetësh e fjalët e tij të fundit kishin për të qenë të njëjta.

Të gjithë do të vdesim. Vendimi për këtë nuk varet nga ne. Nëse asgjë tjetër nuk ka pas vdekjes, atëherë edhe jeta më e mirë nuk është asgjë më shumë se një gosti e ofruar njeriut për ta dënuar para se ta ekzekutojë. I jepet diçka e shijshme pastaj varet. Ndoshta jeton në një shoqëri ideale, por më në fund kalbet e harrohet përgjithmonë.

Përpiquni ta ngushëlloni dikë që po vdes nga kanceri, ose familjen e tij, më këto fjalë: «Po ndërtojmë një shoqëri të lumtur komuniste»; ose «Shkenca po arrin suksese të mëdha. Njeriu ka qenë në hënë e së shpejti do të shkojë në Venerë.» Nuk gjen shumë ngushëllim në këto fjalë. Por foli atij që po vdes dhe atij që është i pikëlluar për Atin qiellor, për shpresën e krishterë dhe jetën e amshueshme me Krishtin e do të shihni dallimin.

Nëse ateistët kanë të drejtë e nuk ka jetë pas kësaj, atëherë: «Çdo e djeshme ndriti dhe përcollti kope të çmendursh në një vdekje pluhuri.» dhe «Jeta nuk është gjë tjetër veçse hije shëtitëse, aktor i humbur, që bërtet e shkundet pas rolit të vet mbi skenë për pak kohë dhe nuk ndihet më: nuk është tjetër veçse përrallë prej budallait, plot bujë e plot tërbim, që nuk ka asnjë kuptim.» (Shekspiri)

Por jeta vazhdon pas vdekjes. Mendimi për amshimin dhe shpërblimin për të mirën e të keqen është i skalitur thellë në zemrën e njeriut.

Të krishterët e flijojnë jetën sepse ata besojnë në jetën e përjetshme. Por pse e flijojnë jetën komunistët? Komunistët kanë vdekur nëpër burgjet cariste për hir të marksizmit. Askush nga Partia nuk i përkujton. Ata janë harruar. Edhe sot ka komunistë që vdesin nëpër burgje në disa vende jokomuniste. Pse vdesin ata? Të krishterët besojnë se do të shpërblehen me jetën e përjetshme. Por çfarë kuptimi ka që një ateist e jep jetën, duke e ditur se vetëm një herë jeton, për një ideal realizimin e të cilit nuk e përjeton, e as bukurinë nuk ia shijon? Jeta në ko-

munizëm njësoj si edhe në kapitalizëm do të përfundojë me vdekje. Komunistët kurrë nuk do ta kishin dhënë jetën, nëse në thellësinë e shpirtit të tyre, të cilin arsyeja nuk mund ta arrijë, nuk e kishin ditur se varri nuk është fundi dhe se ata që kanë dhënë gjithçka për një qëllim të mirë do të shpërblehën.

E tërë shkenca moderne bazohet në ligjin e ruajtjes së energjisë, siç e shpjegon Lavoisieri. Asgjë nuk humbet, asgjë nuk mungon, gjithçka ruhet. (Ky ligj ndalohej rreptësisht të zbatohet përveç në atom.)

Njeriu është një deng energjie në forma të ndryshme: energji e kondensuar në materie, nxehtësi, elektricitet dhe në energji shpirtërore. Ç'ndodh pas vdekjes me këto forma të ndryshme të energjisë? Energjia e kondensuar në atome nuk humbet. Trupi kalbet kurse atomet e tij shndërrohen. Nxehtëësia e trupit nuk humbet. Kur ftohet furra, nxehtësia e saj gjendet në atmosferë përreth. Kur një trup fillon të ftohet për shkak të vdekjes, temperatura në atë rreth të afërt rritet për një shkallë të vogël. Energjia që lirohet nga trupi kthehet në energjinë e përgjithshme të natyrës. Po çka ndodh me energjinë shpirtërore në çastin e vdekjes, me fuqinë e vullnetit, me kapacitetin e të menduarit dhe me ndjenjat? Mos shndërrohet kjo energji pas vdekjes në një formë më të dobët, për shembull në formë mekanike? Nëse është ashtu, atëherë pas vdekjes do të kishin qenë në gjendje të kërcejmë dy herë më lartë se përpara, gjë që është qesharake. Jo! Energjia shpirtërore mbetet edhe pas vdekjes. Përndryshe, ligji i Lavoasierit dështon. Shpirti im kthehet në energjinë e përgjithshme shpirtërore, pra, i kthehet shpirtit të amshueshëm — Zotit.

Nëse shpirti ynë është përgatitur për këtë, nëse i ka kultivuar cilësitë e mira në këtë fushë — dashurinë, të vërtetën, besimin, shpresën, paqen, fisnikërinë, butësinë — atje do të jetë në elementet e veta. Jeta e ardhshme do të jetë parajsë, ku do të shijojmë atë që kemi shpresuar.

Nëse shpirti ynë hyn në atë fushë krejtësisht i papërgatitur, plot me mëkate e dëshira për t'i kënaqur epsшет, që nuk mund të plotësohen, jeta e tij do të jetë tejet e mjerë. Ky do të jetë ferri.

Sikur avulli që zhduket në ajër në mënyrë të padukshme, ashtu kalon jeta. Por as avulli as shpirti nuk pushon së ekzistuari. Apostulli Jakob shkruan: «Po çka është jeta juaj? Është avull që duket për një moment dhe zhduket menjëherë» (Jakobi 4:14). Por nuk kalon në asgjë. Avulli shndërrohet në ujë. Asgjë nuk humbet përgjithmonë. Kjo jetë kalon, por nuk bëhet asgjë. Vemja bëhet kukule, kukuleja flutur. Të vdekurit nuk i shohim. Kjo nuk do të thotë se ata nuk ekzistojnë më.

Ta zëmë se mund të flasim me një embrion dhe t'i tregojmë se jeta që e bën në bark të nënës është vetëm përgatitje për një jetë tjetër. Jeta e vërtetë fillon në një botë tjetër të panjohur për embrionin, në kushte që nuk mund t'i marrë me mend. Embrioni do të ishte përgjigjur sikur *Libri ateist*, po ta kishte inteligjencën e një akademiku do të kishte thënë: «Mos më lodh me këto besëtytni fetare! Kjo jetë është e vetmja dhe nuk ka tjetër. Rrena të kulluara të klerikëve lakmues!»

Por ta zëmë se ky embrion mund të mendojë më mendjemprehtësi me të madhe se akademikët tanë. Do të kishte thënë me vete: «Në kokë po më zhvillohen sytë. Po për çfarë arsyeje? Asgjë nuk ka për të parë. Këmbët po më rriten. Nuk kam as vend për t'i shtrirë. Pse po rriten? Pse krahët e duart po më rriten? Më duhet t'i mbaj të rrudhura. Po më pengojnë mua edhe nënën. I tërë zhvillimi im në bark të nënës është i pakuptim po qe se nuk vjen një jetë me dritë e ngjyra dhe shumë sende për t'i parë syri. Vendi ku do ta kaloj jetën tjetër duhet të jetë i madh dhe ndryshe nga ky. Atje do të vrapoj. Prandaj po më rriten këmbët. Do të jetë një jetë me punë e mundime. Prandaj po më rriten krahët e grushtat, që nuk më vynë asgjë këtu.» Pasqyrimi i zhvillimit të tij do ta kishte shty-

rë embrionin të mendojë për jetën tjetër, ndonëse nga ajo jetë nuk ka farë përvoje.

Në të njëjtën gjendje jemi edhe me ne. Kisha e Krishtit na mëson se kjo jetë ka një karakter embrional dhe është vetëm përgatitje për jetën e vërtetë që pason. Si e dimë këtë? Nëse Zoti (ose natyra, bie fjala) na ka krijuar vetëm për këtë jetë, do të na kish dhënë së pari mençurinë dhe përvojën e breznive të kaluara e pastaj fuqinë e të riut. Atëherë do të kishim ditur të jetojmë. Por e vërteta është se ndërsa jemi të fortë e të rinj, na mungon mençuria dhe shpeshherë i humbim vjetët për asgjë. Kur ta kemi grumbulluar mençurinë e përvojën, kortezhi i funeralit na pret te dera. Atëherë pse e grumbullojmë mençurinë? Pse, pra, sytë, këmbët e duart rriten në embrion? Vetëm e vetëm për atë që vjen më pas. Zhvillimi ynë në këtë jetë na tregon për jetën e ardhshme.

Trupi e shpirti jo vetëm që zhvillohen ndaras por kanë edhe kundërshtime. Pasi që të jemi rritur, trupi fillon të dobësohet e shpirti pasurohet. Shpirti e trupi janë si dy udhëtarë, njëri ngjitet përpjetë, tjetri bie teposhtë. Udhëtojnë në drejtime të kundërta. Çfarë logjike mund të më bëjë të bësojë se kur trupi është shkatërruar dhe i ka ardhur fundi, edhe shpirti do të përfundojë me të? A nuk ka më shumë të ngjarë se, pas ngritjes lart të fluturojë në qiell të qiejve, siç thotë Mao Ce Duni për shpirtin e gruas së vet (shih vjershën e tij «Të pavdekshmit»)?

Shumë vite i kam kaluar mbyllur në vetmi, pa libra. Kam menduar për situata të ndryshme, sikur të isha president i Bashkimit Sovjetik, mbret i Anglisë, papë, milioner, lypës. Të gjitha ato situata i mendoja. Ato janë të parafytyrueshme sepse janë të mundshme. Jeta është e pasur. Ajo ka mundur prej një tetari të bëjë një perandor francez dhe prej tij një të burgosur në një ishull. Të varfërit janë bërë milionerë. Pasanikët janë bërë varfanjakë. Stalini, biri i një këpucëtari pijanec, nxënës i ish shkollës gjorgjiane, u bë diktator jo vetëm i Bashkimit

Sovjetik, por edhe i tërë bllokut komunist. Shpejt pas vdekjes së tij emri iu fshi nga historia. Të gjitha këto janë të mundshme në jetë dhe për këtë arsye mund të përfytyrohen. Jam përpjekur ta përfytyroj veten të vdekur, por nuk kam pasur sukses ngase vdekja nuk është mundësi e jetës.

Nëse përpiqesh shumë ta përfytyrosh veten të vdekur, gjëja e fundit që e përfytyron është se e sheh veten të shtrirë në arkivol. Fakti se e sheh veten në arkivol tregon se nuk je i vdekur. I vdekuri nuk e sheh veten. Paaftësia për ta përfytyruar veten të vdekur nuk është argument i vogël në favor të jetës së përjetshme.

Është me rëndësi që mos ta ngatërrojmë jetën e përjetshme me kohën e pafund, që këto të dyja janë në kundërshtim. Koha e pafund nuk ekziston! Përjetësia është pakohësi.

Këtë mund ta shohim në mundësinë e jetës së ëndrrës, në të cilën veprimet mendore nganjëherë shfaqen me shpejtësi ekstreme. Një varg veprimesh për të cilat nevojitet kohë e gjatë kalojnë nëpër mendjen tonë për një çast të shkurtë gjatë ëndrrës. Edhe marrëdhëniet e hapësirës zhduken. Mund të përshkojmë largësi të mëdha për një sekondë. Në ëndërr nuk jemi të lidhur me kohën e hapësirën dhe, duke menduar në jetën e ëndrrës, e kuptojmë se muret e hapësirës dhe të kohës që na rrethojnë ndërsa jemi të zgjuar, fshehin prej nesh një cilësi tjetër të jetës përtej sferës së kufizuar të cilën e kemi zakon ta quajmë «realitet».

Për t'i kënaqur dëshirat e trupit nuk nevojiten shumë gjëra: ushqimi, veshmbathja, strehimi, pushimi, një moshë e caktuar, një partner të gjinisë së kundërt. Si është e mundur, pra, që kapitalistët ose klasa e lartë në Bashkimin Sovjetik i kanë të gjitha këto dhe nganjëherë janë melankolik dhe të pakënaqur? Si është e mundur që njerëzit e burgosur për shkak të besimit, të urit, duke u dridhur nga të ftohtët, në pranga, të ndarë me vite të tëra

nga të dashurit e tyre, galdojnë nga gëzimi? Çka është kjo qenie misterioze që mund të dëshpërohet edhe pse trupi i ka të gjitha të mirat ose mund të gëzohet edhe pse trupi vuan? Është diçka tjetër nga trupi. Ky është shpirti.

Shpirti e tregon varësinë e ndërsjellë dhe pavarësinë e tij nga trupi gjatë jetës në tokë. Është aq i pavarur nga trupi sa që mund të vendosë për vetëvrasje. Shpirti mund të vendosë ta vrasë trupin e vet për shkaqe psikologjike. Nuk ka arsye të besohet se vdekja e trupit nënkupton edhe vdekjen e këtij vullneti të fortë që është qenie e pavarur.

Në librin e dytë «Mbi Mbretër» (25:16) në Bibël, gjenet një shprehje e çuditshme. Numërohen shumë gjëra të ndryshme që mbreti Solomon i kishte ndërtuar për Tempullin. Numërimi përfundon me këto fjalë: «Bronzi i të gjitha këtyre enëve ishte pa peshë». A ka bronzi pa peshë? Bile edhe pupla e ka peshën e vet. Vetëm kur mendojmë për një objekt të veçantë, e kemi parasysh peshën. Kjo do të thotë se një copë bronzi, një pupël, gjithçka e ka peshën e vet. Bronzi si përgjithësim nuk ka peshë.

Filozofia skolastike ka pasur të drejtë kur e bën dallimin ndërmjet esencës së një objekti dhe rastësisë së tij. Esenca e bukës është se ajo është diçka e bërë nga brumi e që shërben si ushqim. Kjo esencë nuk ka peshë. Buka mund të jetë e cilësive të ndryshme. Mund të jetë bukë elbi, gruri, e freskët ose bajate, e vogël ose e madhe. Peshë e saj varet nga këto kritere. Peshë, ngjyra, madhësia janë përcaktuar nga rastësia. Esenca nuk e ka asnjërin prej tyre. «Buka» është nocion në shpirtin tim. Aty është e papeshë, derisa ta marrë formën e veçantë. Ashtu është dhe bronzi, nëse nuk e ka të caktuar madhësinë dhe formën.

Bile edhe atëherë, objektet peshojnë vetëm kur i tërheq graviteti. Në një anije kozmike, në një gjendje të papeshë, objektet fluturojnë përçark. Pa ndikimin e gravitetit, ato nuk kanë peshë.

Mbreti Solomon kishte ndërtuar një tempull shpirtëror. Asnjë ushtar babilonas nuk mund ta barte atë që kishte ndërtuar ai në mendjen e tij për nder të Zotit.

Në Bashkimin Sovjetik, më 1.7.1968 hyri në fuqi ligji sipas të cilit fëmijët mund t'u merrëshin prindërve e të vendosëshin në një shkollë ateiste nëse ata i edukonin në frymën krishtere. Prinërit e krishterë e duruan këtë presion. Nga familja Sloboda janë marrë tre fëmijë; nga familja Malozemlov janë marrë shtatë. Kush mund ta ndajë njeriun me mendimet e tij shpirtërore nga fëmija i vet?

Ekziston esenca «fëmijë» dhe ekzistojnë rastet. Kjo e fundit ndryshon. Fëmija im ka qenë embrion, në fillim ka qenë si një kafshë, pastaj një foshnjë, më vonë çupë e vogël që luante me kukulla. Tani shkon në shkollë. Mund ta përqafoj fëmijën ndonëse mund të jetë larg. Mund të jetë fëmijë i dëgjueshëm ose i padëgjueshëm. Rastet ndryshojnë. E vërteta është se fëmija im kurrë nuk ndryshon. Marrëdhënia nënë-fëmijë i përket sferës së esencës. Ne nuk frikohemi nga ajo se çka u bëjnë komunistët fëmijëve, në botën e ratësive. Marrëdhënia nënë-fëmijë kurrë nuk ndryshon.

E njëjta gjë vlen edhe për jetën. Cila jetë mbaron me vdekjen?

Unë kam bërë jetë të pasur e të varfër, të lumtur e të pikëlluar, kam jetuar në liri e në burg, kam jetuar i shëndoshë e i sëmurë. Nëse identifikohem me njëren prej formave të jetës, atëherë jeta ime përfundon aty ku përfundon ajo formë me të cilën jam identifikuar. Për disa njerëz jeta e humb vleftën kur humbet luksi.

Por ne të krishterët jetojmë në esencialën.

Jezusi thotë: «Unë jam Udhë, e Vërteta dhe Jeta» (Gjoni 14:6). Fjala «jam» nuk përdoret në hebraishte, gjuha në të cilën ka folur Jezusi, ashtu siç nuk përdoret as në rusishte. Jezusi ka thënë: «Unë — Udhë, e Vërtet dhe Jeta». Ai identifikohet me nocione abstrakte.

Natyra i njeh vetëm lisat, pishat e mollët. «Druri» është abstraksion i formuar në mendjen time. Mund t'i shfarosni drunjtë në mbarë botën, por nocioni «dru» nuk do të preket nga kjo katastrofë.

Në natyrë ka vetëm njerëz të vërtetë, si Grigoriev, Ivanov, Gjerasimov, rus, ukrainas, amerikan, i varfër, i pasur, femër, mashkull. Ka njerëz që kanë jetuar vetëm për vete, ka edhe asi që janë flijuar për të tjerët. Njeriu mund të jetë aktiv ose soditës në jetë.

Jezusi nuk identifikohet me një lloj të caktuar të jetës, por me nocionin abstrakt «jetë», me të gjitha që ka jeta. Ai na mëson që edhe ne të bëjmë të njëjtën gjë. Unë nuk e identifikoj jetën time me Wurmbrandin, i lindur para shumë vjetësh dhe i nënshtruar vdekjes. Unë jam jeta, që gjithmonë ka ekzistuar në Zotin, që e ka marrë formën e jetës njerëzore me Adamin e Even, jeta që kurrë nuk do të mbarojë. Jeta ime si fëmijë i Perëndisë është e pashkallë tërrueshme.

Trupi nuk është «uni» im. Në njëfarë kuptimi, kam pasur shumë trupa, atë të embrionit, të foshnjërisë, të fëmijërisë dhe të rinisë. Shën Pjetri shkruan: «Deri sa jetoj në këtë trup» (2 e Pjetrit 1:13). Unë kam jetuar në disa trupa, por është një dallim i qartë ndërmjet meje e banesës sime ku banoj për një kohë.

Jezusi në kopshtin e Gjetsemanit tha: «Shpirtin ma kaploi një trishtim që çon në vdekje» (Mateu 26:38). Kush toni vëmendje kësaj shprehjeje! Çdonjëri mund të thotë kështu. Jezusi flet për shpirtin dhe për zotëruesin e shpirtit që e mban atë dhe e mëkëmb kur është i trishtuar. Por unë nuk jam identik me një gjendje të caktuar shpirtërore, ashtu si nuk jam identik as me një gjendje të caktuar të trupit.

Unë vuaj në trup ose në shpirt. E di se vuaj. Di mjaft sa për të ditur se po vuaj. Cili është realiteti i fundit në mua që sheh gjithçka që ndodh e që unë e quaj «uni i vërtetë»? Ai e di se, «tani jam shëndosh» ose «tani po

vdes.» Kush është ai që i di dhe i sheh të gjitha këto ndryshime? Ai vetë është i pandryshueshëm. Ai nuk është një jetë, por është jeta, Biri i Perëndisë në mua. Ai që nuk vdes.

Jezusi thotë: «Unë jam e Vërteta.» Si është e mundur të zhduket e vërteta? Nëse edhe unë identifikohem me të vërtetën, me tërë të vërtetën, atëherë kush mund të më shkatërrojë? Është e vërtetë e pamohueshme se $2+2=4$ pa marrë parasysh a jam në burg ose në liri, i gjallë ose i vdekur. Unë bëhem një me të vërtetën, që nuk varet nga rrethanat e jashtme.

Nëse bashkohem me Krishtin, nëse i marr për vete fjalët: «Unë jam Udhë, e Vërteta dhe Jeta», do të jetoj përgjithmonë.

Organizmat më të pazhvilluar në jetë janë njëqelizoret. Ata shumëzohen me anë të ndarjes. Prej një bëhen dy, prej dy katër, e kështu me radhë. Sot kemi ameba të panumërta. Por a ka vdekur ameba e parë? Ajo ka ndryshuar formën e ekzistencës. Në vend që të jetë në një membranë, është shumëzuar në pakufi. Për çdo ditë, vdesin me miliona ameba, por të gjitha janë vetëm pjesë të amebës së parë. Kështu ameba e parë vazhdon të jetojë në to. Pavdekshmëria po na paraqitet qysh në shkallën e parë të organizmit më të thjeshtë. Pra, a mund të vdesë qenia më e zhvilluar në tokë?

Ne e ruajmë pikturën e Leonardo da Vinçit e skulpturën e Mikelanxhellos me kujdes të madh. A nuk do t'i ruaj Krijuesi të paktën me të njëjtin kujdes artistët e këtyre veprave?

Ekziston jeta e përjetshme, dhe një Hitler i papenduar nuk mund të shkojë atje, në të njëjtin vend me fëmijët e pafajshëm që i ka varur, ekziston parajsja për të drejtë dhe ferri për të padrejtë.

Ateistët bëjnë keq gjatë jetës sikur të mos kishin për të vdekur kurrë. Si mund ta dinë se në çastin e fundit nuk

do të pendohen për atë që kanë bërë, për miliona njerëz që i kanë lënë pa dëgjuar Fjalën e Perëndisë?

Le të marrin mësim nga fjalët e fundit të kundërshtarëve të mëdhenj të krishterimit.

Taleirandi: «Po ndiej dhimbjet e të mallkuarit.»

Mirabeu: «Më jepni opium e ta harroj jetën e përjetshme.»

Volteri: «Më ka braktisur Zoti dhe njerëzit. Do të shkoj në ferr. O Krisht, o, Jezu Krisht!»

Çarlisi IX, mbret i Francës: «Sa gjakderdhje, sa vrasje, sa keq kam bërë. Jam i humbur, po e shoh këtë fort mirë.»

Tom Paine: «Do ta kisha dhënë pasurinë e botës, po ta kisha, vetëm që 'Epoka e arsyes' (libër antikrishter) të mos botohej kurrë. O, Zot, ndihmomë! Krisht, ndihmomë! Rri me mua! Në ferr do të jem i vetmuar.»

Shpresoj se është dëshmuar të paktën se besimi në jetën e përjetshme nuk është aq qesharak sa e paraqesim autorët e *Librit ateist*. Ata e ndiejnë vetën të lirë për të bërë ashtu sepse kishin monopolin në duart e tyre.

Në një simpozium ndërkombëtar të mjekëve u diskutua se cili operacion është më i vështiri. Një gjerman tha se operacioni më i vështirë është i trurit, një francez tha se është ai i zemrës. Delegati sovjetik tha se operacioni më i vështirë është i bajameve. Të gjithë qeshën, por ai tha: «Fjalët e mia po ju duken marrëzi. Ju nuk e dini se që nga Revolucioni, ne e hapim kafkën dhe i nxjerrim bajamet kah truri, sepse nuk guxojmë ta hapim gojën.»

Unë e kam hapur gojën pa lejen e pushtetit komunist. Kur flasim të krishterët, shihet se e kanë mirë.

Shkenca dhe feja

Punëtorët e sigurimit në vendet komuniste janë të njohur për aftësitë e tyre që t'i detyrojnë njerëzit e pafajshëm të pranojnë krime të pakryera. Me mijëra «kriminelë» të tillë u rehabilituan nga Krushovi. Por metodat nuk kanë ndryshuar.

Ndër të burgosurit e torturuar nga Shërbimi sekrek i Bashkimit Sovjetik është edhe njëfarë shoku që quhet Shkencë. I rrahur, i djegur me hekur të skuqur, i munduar në mënyra të ndryshme, ky i burgosur me emrin Shkencë tha fjalë sensacionale, që përsëritet në *Librit ateist*. Asnjë shkencëtar i vërtetë nuk i jep pesë pare për to. Vetëm dëgjoni disa prej tyre:

«Shkenca e vërteton në mënyrë të pakundërshtueshme se nuk ekziston fuqi mbinatyrore.» (Ne të shkretët, njerëzit e paditur besojnë se shkenca mund t'i vërtetojë vetëm gjërat që ekzistojnë.) «Shkenca vërteton se jeta është e shpërndarë në gjithësi... Numri i planetëve në të cilat jetojnë qenie të pajisura me arsye është tejet i madh. ...Teza shkencore mbi bota të shumta të banuara i jep një të goditur vdekjepruese dogmës së faljeve të mëkateve, që është esenca e krishterimit... Është vërtetuar mosekzistenca e mrekullive», e të tjera.

Duhet ta hedhim poshtë krejt këtë paragraf si të pavlefshëm. Të kalojmë te një thënie tjetër.

Një e vërtetë e *Librit ateist* është se ndërmjet shkencës dhe besimit ekziston një konflikt i papajtueshëm. Ndërmjet *cilës* shkencë e *cilit* besim? Të dyja janë në zhvillim të përhershëm. Besimi nuk ëshë më ai që ka qenë para pesë shekujsh, bile as para një shekulli.

Të krishterët e parë kanë menduar se Jezusi do të kthehej derisa ata ishin gjallë. Kanë menduar se bota është e rrafshët, se toka është qendra e gjithësisë, me Zotin që rri sipër, jo fort larg, duke u marrë kryesisht me

ngjarjet që ndodhin në tokë. Të krishterët nuk mendojnë më kështu.

Atë që shfaq Perëndia është e përjetshme. Atë që mendon njeriu rreth saj është e përkohshme.

Por edhe shkencë ndryshon. Një nxënës i shkollës së mesme nuk e pranon më si përfundimtare teorinë e Euklidit, ose të Galileut, ose të Njutonit. Kundërshtarët tanë përdorin një trik të vjetër: ata e krahasojnë shkencën moderne me besimin primitiv, shkencën e shekullit njëzet me konceptet e besimit judenj të para 3.500 vjetëve, kur ata porsa kishin dalë nga shekujt e skllavërisë, ishin analfabetë dhe jetonin në një nivel kulturor shumë më të ulët sesa romët e sotëm. Ky është turp. Është sikur ta krahasosh Bashkimin Sovjetik sot me Amerikën e ditëve parakoloniale, kur vetëm indianët jetonin në të, për ta treguar epërsinë ekonomike të Bashkimit Sovjetik.

Shkencë e sotme duhet të krahasohet me mendimin më të zhvilluar fetar të sotëm, e atëherë do të shohim përkim më parë se konflikt.

Kështu duhet të jetë. Përsëri do ta citojmë Ajnshtajnin: «Shumica e njerëzve thonë se intelekti është ai që e bën shkencëtarin të madh. Gabim e kanë; është karakteri.» Karakteri nuk është vlerë shkencore, por është vlerë fetare dhe morale. Askush nuk mund të jetë shkencëtar i vërtetë pa pasur një karakter të bazuar në ndershmëri dhe drejtësi. Këto janë vlerat që i mëson krishterimi.

Një njeri që ka vetëm shkencën nuk është i besueshëm si shkencëtar. Duhet ta ketë sinqeritetin; duhet të besojë në atë që zbulon në laborator. Duhet të shpresojë, sepse pa shpresë kurrë nuk do t'ia kishte kushtuar kohën humltimeve. Duhet ta ketë entuziazmin, përndryshe nuk do t'ia kishte kaluar orë të panumërta në laborator. Duhet ta ketë përlësinë që ta pranojë rregullin e sendeve. Duhet të ketë qëllim të vetëm, sepse nëse ka interesa të shpërndarë, nuk do të zbulojë asgjë. Shkencëtari duhet të jetë në gjendje të bashkëpunojë me kolegët e vet. Kërko-

het durim, sikur në rastin e Madam Kurit, që i pastroi tetë tonë uranium të papërpunuar për të nxjerrë pak miligram radium. Duhet të ketë gjykim të drejtë. Duhet t'i tregojë botës saktësisht se çka ka zbuluar pa e zmadhuar asnjë grimë. Duhet të jetë i mençur dhe vetëmohues, ta fshehtë atë që është e dëmshme për njerëzimin. Një njeri që është *vetëm* shkencëtar nuk është shkencëtar. Para së gjithash duhet t'i pranojë vlerat etike të cilat njerëzimi nuk i ka marrë nga ateizmi por nga feja.

Stalini pat shpallur: «Shkenca është shpëtimtari i njerëzimit.» Këtë e tha mu në prag të kohës së atomit kur shkenca i pat zbuluar mjetet për shkatërrimin e botës përnjëherë, dhe armët me anë të të cilave mund të fshihej njerëzimi nga faqja e dheut. Kjo, krejt për shkak se disa shkencëtarë nuk e çmuan vlerën në të cilën ishte e ndër-tuar e tërë godina e shkencës. Shkenca duhet të jetë e lidhur ngusht me fenë, përndryshe nuk do të mund të na ndihmojë për të arritur lumturinë. Pikërisht se nuk ka pasur bashkëpunim ndërmjet shkencës dhe fesë, njerëzimi ka humbur besimin në paqe sot më tepër se para zbulimeve të mëdha të epokës moderne.

Madje as ateizmi nuk është i mundshëm pa vlerën etike të krishterimit, pa marrë parasysh sa të çuditshme mund t'ju duken këto fjalë.

Libri ateist shkruan: «Koncepti materialist thotë se në botë nuk ekziston asgjë tjetër përveç materies së përjetshme dhe infinite që është në lëvizje». Nëse nuk ekziston asgjë tjetër përveç materies, atëherë filozofia materialiste, që thotë se gjithçka është materie, edhe ajo qenka materie. «Asgjë tjetër nuk ekziston përveç materies». Atëherë edhe bindjet ateiste qenkan materie. Kundërshtarët tanë e duan ateizmin, kurse e urrejnë fenë. A janë dashuria dhe urrejtja e tyre materie? Ata luftojnë për një ideal, shkruajnë për një ideal, madje edhe duke e mohuar ekzistencën e vlerës shpirtërore. Ata vetë jetojnë në këto vlera, edhe në qoftë se i përçmojnë ato.

Ata gjithashtu shkruajnë: «E vërteta e materializmit dialektik është vërtetuar nga të gjitha të dhënat e shkencës dhe praktikës, kurse drejtësia e filozofisë idealiste dhe e fesë nuk mund të vërtetohen nga askush.»

Kështu të gjitha të dhënat shkencore dhe praktike po pohojnë se ne jemi vetëm materie! Edhe autorët e librit të cilët po i përgenjështrojë janë vetëm materie. A mundohet materia ta bindë një kuantitet tjetër materiesh? Kundërshtarët e mi janë një grumbull materiesh, ashtu siç jam edhe unë. Pse harxhojnë kohën dhe energjinë për të ma ndërruar mendimin?

Sipas tyre materia është në lëvizje të përhershme, sipas ligjeve të saja të brendshme. Nuk mund ta bindësh atomin të lëvizë nëse natyra nuk e ka paracaktuar, ashtu sikur që nuk mund t'ia ndryshosh lëvizjet një planeti. Atëherë pse mundohen të më bindin *mua*?

Ateistët shpeshherë janë shumë më të mirë se teoritë e tyre. Ushtarët ateistë kanë dhënë jetën gjatë luftës për t'i shpëtuar shokët e tyre. Cili idiot do të kishte vdekur për të mirën e një tavoline të drurit? Kush është ai që heq dorë nga gëzimi për ta bërë një copë letër të lumtur? Ateistët, që japin jetën për shokët e tyre, ose që ua kushtojnë kohën të tjerëve për t'i çliruar nga besëtytnitë fetare, në thellësi të zemjës së tyre nuk besojnë se ata dhe shokët e tyre janë vetëm materie. Pikërisht ashtu si shkenca që nuk mund të funksionojë pa fenë, ashtu ateizmi dhe ateistët nuk mund të ekzistojnë pa i respektuar disa vlera të saja themelore.

Është e vërtetë se disa shkencëtarë janë në konflikt me fenë, po kush e di se si do të zhvillohet shkenca? Po ashtu është vështirë për të paraparë evolucionin e fesë.

Nuk ka arsye të besojmë se ky konflikt është i papajtueshëm. Edhe nëse e zëmë se nuk pajtohen, shkenca dhe feja nga jashtë mund të kundërshtohen por megjithatë të dyja të kenë të drejtë, siç është rasti me teorinë e dritës, që njëra pohonte se drita përbëhet prej thërmrijave, tjetra

pohonte se përbëhet prej valëve. Të dy teoritë dolën të sakta në eksperiment. Mendimi se e tërë e vërteta duhet të sintetizohet në mendjen tonë është i gabuar, mbasi ne jemi të kufizuar dhe mund ta njohim të vërtetën vetëm pjesërisht.

Nuk ka kurrfarë rreziku në faktin se dy shkencëtarë, duke matur me përpikëri, arrijnë në përfundime të ndryshme. Pse atëherë të brengosemi nëse një shkencëtar në njërën anë e një besimtar në anën tjetër, duke u nisur nga parasupozime krejtësisht të ndryshme, arrijnë në përfundime të ndryshme?

Është i njohur rasti i Lord Reileihit dhe Sir Uiliam Remzit. Këta të dy e zbuluan azotin në mënyra të ndryshme, por gjithnjë ka pasur një dallim të vogël mes peshave atomike. Këta i mbajten rezultatet të papajtueshme. Nuk u përpoqen t'i harmonizojnë ato; nuk panë kurrfarë katastrofe në mospajtim. Më në fund konflikti ndërmjet këtyre dy përfundimeve doli i dobishëm për shkencën. Në azotin e njërit, u zbulua Argoni, element i panjohur deri atëherë.

Në përgjithësi nuk duhet t'i trembemi konfliktit ndërmjet shkencës e fesë. Në zemrat tona kemi vend për realitetin e plotë. Këtij konflikti duhet t'i drejtohem me fjalët e Jezusit: «Leni të rriten bashkë deri në të korra» (Mateu 13:30). Ne u japim liri të dy mendimeve të kundërta.

Krejt kjo është hipotetike, sepse diçka nuk është në rregull me zbulimin e kundërshtarëve të mi rreth konfliktit të tmerrshëm ndërmjet shkencës dhe fesë. Shumica e shkencëtarëve nuk dinë asgjë për këtë konflikt.

Me tërë nderimin e duhur për rangun e akademikëve si kundërshtarët e mi, ata duhet ta pranojnë se Ajnshtajni e ka njohur shkencën bile pak më shumë se ata. Kjo vërtetohet nga fakti se bota e mban emrin e Ajnshtajnit e jo të autorëve të *Librit ateist*. Ajnshtajni flet për një inteligjencë më të lartë e cila na zbulohet me anë të natyrës.

Ndoshta dëshironi ta dini çka thotë fizikani i njohur Maks Plank në autobiografinë e tij:

«Feja dhe shkencë natyrore janë përherë në luftë të përbashkët, luftë që kurrë nuk pushon kundër skepticizmit dhe dogmatizmit, kundër mosbesimit dhe besëtytnisë, dhe parulla gjithmonë ka qenë dhe do të jetë 'drejt Zotit'».

Autorët e *Librit ateist* janë njerëz të shkencës. Atëherë le të japin një sqarim shkencor mbi faktin se shkencëtarët kaq të njohur nuk paskan ditur gjë për konfliktin ndërmjet shkencës dhe fesë! Maks Plank madje mospajtimin ndërmjet shkencës e fesë e quan «problem fantom».

Libri ateist e thotë edhe këtë: «Mes shkencës e fesë gjithmonë ka pasur një luftë të pandërprerë dhe të papajtueshme.» Ata kurrë nuk do të mund ta vërtetojnë këtë.

E citova Ajshtajnin dhe Plankun. Po si qëndron puna me shkencëtarët tjerë? A kanë ditur ata diçka për konfliktin?

Sir Isak Njutoni ka jetuar një shekull më përpara, por praktikisht ne ende jetojmë në botën Njotoniane. Për t'i tallur miqtë e vet afetarë, ai në laborator e bëri sistemin diellor në miniaturë. Një afetar e pyeti: «Kush e bëri këtë?» Njutoni u përgjigj: «Askush.» — «Gënjeshtër, marrëzi!» u përgjigj afetari. «Ma thuaj të vërtetën: kush e bëri këtë?» Atëherë Njutoni iu përgjigj: «Nuk është asgjë tjetër veç një imitim i një sistemi të madh, dhe nuk po mundem të të bind ty se kjo lodër e thjeshtë nuk ka projektues as krijues! Mos ti beson se origjinali madheshtor, prej të cilit është marrë projekti, është krijuar pa krijues? Më thuaj, me çfarë arsytimi arrin deri te një zgjidhje e tillë e papajtueshme?»

Profesorët ateistë e pranojnë se Njutoni e përfundon veprën e tij themelore shkencore «Parimet matematikore të folozofisë së natyrës» me shpjegimin rreth «sundimit të një fuqie dhe Qenie të zgjuar» dhe me shprehjen e besimit në një impuls fillestar, domethënë, në një krijim.

Këtë e shpjegojnë me faktin se Njutoni jetoi në fillim të shekullit të tetëmbëdhjetë, kur njerëzimi nuk dinte për shumë procese atomike, biologjike dhe kimike të cilat i njohim sot, kur shkenca ishte ende e lidhur me teologjinë. Gjithashtu pohojnë se fakti që Njutoni ishte fetar e ka penguar në shkencë. Por atëherë mbetet enigma se në shekullin e njëzetë gjithësia e Njutonit është bërë gjithësi e Ajnshtajnit. Ajnshtajni dinte së paku diçka për proceset atomike, për zhvillimin më të ri të shkencës, dhe ai që ia kishte nisur si ateist në rini u bë besimtar nga fakti se arriti në kulm të shkencës.

Por të nxitojmë për të parë se Ajnshtajni nuk i brengos fort kundërshtarët e mi. Ata përfitojnë nga fakti se veprat e tij janë të ndaluara në pjesët e sundimit komunist në gjithësinë e Ajnshtajnit. Nuk mund t'i gjeni në asnjë librari. Bile edhe në akademi, mbahen të fshehta në biblioteka. Askush nuk mund t'i konrollojë autorët e *Librit ateist*, kështu që mund të thonë se Ajnshtajni nënvizonte me konsekuencë «papajtueshmërinë ndërmjet shkencës dhe fesë». Tashmë ju kam cituar fjalët e tij që dëshmojnë të kundërtën.

Kundërshtarët e mi me kënaqësi e përmendin Laplasin, i cili tha se nuk kishte nevojë për «hipotezat» Zot. Para së gjithash, Zoti është vërtetuar nga fakti se astronomi i famshëm sovjetik Tihov e fillon librin e tij të astronomisë duke thënë se s'kemi nevojë më për hipotezat e Laplasit. Por përkundër kësaj, Laplasi është shpallur hap-tas si i krishterë.

Autorët e *Librit ateist* gabojnë kur e citojnë Dekartin për t'i mbështetur teoritë e tyre. Edhe Dekarti ka qenë i krishterë. Ata e shtrembërojnë kuptimin e fjalëve të tij, duke u dhënë kuptim materialist. Ai shkruan: «M'i jepni mua materien dhe lëvizjen, e unë do të krijoj gjithësinë!» Fjalët janë të qarta. Ekzistencës së gjithësisë i duhet materia, lëvizja dhe një qenie inteligjente për ta krijuar. Fjalët e Dekartit janë: «M'i jepni *mua* materien dhe lëvi-

zjen». Pa këtë «mua», materia e lëvizja vetëm nuk mund ta krijojnë gjithësinë. Vetëm kjo «mua» vjen nga Zoti, i cili mund të kryej vepra të mëdha, sepse ne jemi krijuar si krijues.

Njeriu shpesh habitet për lirinë që e marrin akademi-kët për t'ua veshur idetë autorëve të famshëm që kurrë nuk i kanë thënë.

Por ta lëmë të kaluarën e t'i kthehemi të tashmes.

Hajsenbergu, shkencëtar i njohur atomik, nuk do të kishte mundur ta lexojë *Librin ateist*, sepse ka bërë thirrje për bashkimin mes shkencës dhe fesë! Sir Xhejms Xhins, astronom i famshëm, në librin «Enigma e gjithësisë» shkruan: «Gjithësia fillon të duket më shumë si një mendim i madh sesa si një mekanizëm i madh. Mendja nuk na duket më si futje e rastësishme në sferën e materies. Kemi filluar të mendojmë, se ne duhet ta shpallim atë si krijues dhe udhëheqës të sferës së materies — natyrisht, jo mendjen tonë individuale, por Mendjen ku atomet prej të cilave ka dalë mendja jonë... Ne zbulojmë se gjithësia dëshmon për një fuqi projektuese dhe që e mban nën kontroll, e që ka diçka të përbashkët me mendjen tonë... Nuk jemi më të huaj ose të prurë në këtë botë, siç kemi menduar më parë.»

Njutoni kishte një disfavor se i përkiste një shekulli të prapambetur. Kështu edhe *Libri ateist* shpjegon se ai është fetar; për shkak të presionit të rrethit të prapambetur ai në librin e tij «Optika» ka shkruar: «A nuk duket nga fenomenet se ekziston një Qenie, jolëndore, e gjallë, inteligjente, e gjithëpranishme, e pakufizuar në hapësirë, që sheh gjithçka në hollësi dhe kupton gjithçka aty për aty?» Por Xhejms Xhins i përket shekullit tonë ku ka përparuar shkenca, ashtu si edhe Haisenbergu.

Ta dëgjojmë psikologun e shquar, profesor Jung, i cili po ashtu i përket shekullit tonë: «Gjatë tridhjetë vjetëve të fundit, njerëzit nga të gjitha vendet e botës së qytetruar janë këshilluar me mua... Ndër të gjithë pacientët e mi në

gjysmën e dytë të jetës, kjo do të thotë përmbi 35 vjeç, nuk ka pasur asnjë që në fund të fundit problemi i tij të mos ketë qenë botëkuptimi fetar mbi jetën. Është e vërtetë se secili ishte i sëmurë, për shkak se kishte humbur atë që feja e gjallë u jep gjithmonë besimtarëve, dhe asnjëri prej atyre që nuk e ka rifituar botëkuptimin fetar nuk është shëruar».

Nuk është mentaliteti i një shekulli, por shkenca ajo që i bën njerëzit të besojnë, shkenca në të gjitha sferat e saja. Prandaj, Kepleri para shumë shekujsh shkruan: «Ne mendojmë me mendimet e Zotit sipas tij.» Sir Allister Hardi, deri vonë drejtor i degës së zoologjisë, në Universitetin e Oxfordit, shkruan: «Një farë fuqie që e quajmë Zot është e përfshirë në procesin e jetës» dhe «Unë besoj se bota e gjallë është aq fort e lidhur ngushtë me teologjinë sa edhe me fizikën dhe kiminë, që elementi hyjnor është pjesë e procesit natyror, jo vetëm mbinatyror por edhe parafizik». Ai tha edhe diçka tjetër që paraqet interes: «Ashtu si njohuria biologjike për seksin nuk e prish dashnorin, aq më pak besimi i lidhur me shkencën dhe teologjinë natyrore nuk e prish entuziazmin e bashkësisë me Zotin. Të përpiqemi ta kthejmë arsyen që e ka humbur njerëzimi».

Nuk e di si ndodhi që *Libri ateist* e quan Bernard Ruselin si shkencëtar. Nuk dimë ndonjë zbulim shkencor prej tij. Ai është person me rëndësi për kundërshtarët tanë sepse ai pajtohet me politikën majtiste. Por meqë u përmend emri i tij, mendoj se është mirë të tregojmë se çka ka shkruar për krishterimin:

«Janë disa gjëra që na nevojiten në kohën tonë, kurse janë disa tjera që duhet t'u shmangemi. Kërkohe mëshirë... Mbi të gjitha kërkohet shpresë e patrembur dhe impulsi për ta krijuar atë... Rrënja e kësaj çështje është diçka e thjeshtë dhe e vjetëruar, diçka aq e thjeshtë saqë gati më vjen turp ta përmendi nga frika e përqeshjes, me të cilën cinikët e urtë do t'i përshëndesin fjalët e mia.

Gjëja për të cilën e kam fjalën — ju lutem më falni se po ia përmendi emrin — është dashuria. Dashuria krishtere për mëshirë. Nëse e ndieni këtë, keni motiv për të jetuar, udhëheqës për të vepruar, arsye për guxim, nevojë të domosdoshme për ndershmëri intelektuale».

Tani t'i kthehemi shkencëtarit gjenial. C. Chant, profesor i astrofizikës në Universitetin e Torontos, thotë: «Nuk ngurroj të pranoj se së paku nëntëdhjetë për qind të astronomëve kanë ardhur në përfundim se gjithësia nuk është rezultat i ndonjë ligji të verbër por është e rregulluar nga një intelekt i madh». Për sa i përket dhjetë për qindshit tjetër, shumica prej tyre janë astronomë sovjetikë që nuk guxojnë ta shprehin mendimin e tyre.

Po e përsërisim se nëse ka konflikt të papajtueshëm ndërmjet shkencës dhe fesë, siç pohon *Libri ateist*, shumica e shkencëtarëve nuk dinë gjë për të.

Libri ateist si argument kundër fesë përdor shkencën e re të kibernetikës, me anë të së cilës provojnë se funksionimi i mendjes sonë është sikur funksionimi i një makine. Asnjëra nuk ka shpirt.

Vërtet është një gjë e mrekullueshme se pajisjet kibernetike riprodhojnë ose imitojnë fenomenin nervor, që të përkthejnë, luajnë shah dhe të zgjedhin probleme mendore shumë më shpejt se njeriu.

Por — këtu është pika ku mund t'i zëmë — pajisjet kibernetike janë krijuar nga mendja e njeriut. Tek e fundit, kjo është vetëm një reflektim i procesit mendor e jo diçka e re unike.

Njeriu mund të vrapojë, për shembull, pesëmbëdhjetë kilometra në orë. Por ka zbuluar aeroplanët reaktiv dhe raketat që shkojnë shpejt me mijëra kilometra. Njeriu sheh me sy deri në njëfarë largësie, por ka zbuluar mikroskopin e teleskopin që mundësojnë të shohë atë që është e pamundshme për syrin. Njeriu është krijuar dhe pajisur me aftësi krijuese për të zgjeruar kapacitetin e vet dhe për ta rritur dijen. Pajisjet kibernetike i përkasin kë-

saj kategorie, por prapa çdo pajisje qëndron mendja që i krijon ato.

Kush e punoi makinën e quajtur «autori ateist»? Le të pushojnë kundërshtarët e mi pakëz e ta peshojnë faktin se secili prej tyre ka në dispozicion rreth dhjetë miliardë qeliza të trurit. Çfarë Krijuesi duhet të jetë ai që i dhuron kaq shumë neurone atij që dëshiron të tallet me të! Çdo qelizë e trurit mund të jetë në kontakt me 25.000 qeliza të tjera. Numri i lidhjeve të mundshme është rreth dhjetë miliardë në fuqinë e njëzetepestë, numër më i madh se numri i mundshëm i atomeve që i njohim në gjithësi.

Mendo më tej: Secili ateist ka nja 15.000 kilometra enë të gjakut në trup për ta furnizuar trurin dhe organet tjera. Ta mposhtësh një besim të vjetër e të provuar nuk është punë e lehtë: kjo i ka djersitur kundërshtarët tanë. Çdo autor ateist ka një milion e gjysmë gjëndrra djerse në trupin e vet. Ai merr frymë ndërsa shkruan kundër fesë. Mund të marrë frymë sepse mushkëritë i ka të përbëra prej 700 milionë qelizash. Ndërsa shkruan kundër Krijuesit, zemra i rrah pa pushim; ajo i rrah me miliarda herë në jetë. Në fakt, gjatë një jete mesatare zemra i përpunon nja 600 milionë tonë gjak. A mund ta besojnë kundërshtarët tanë se një vinç që ngritë një peshë aq të rëndë ekziston vetvetiu pa ndërhyrjen e ndonjë qenie inteligjente?

Autorët e kryeveprës ateiste kanë harxhuar energji të madhe nervorenë librin e tyre. Sistemi nervor i secilit autor i ka 100 miliardë qeliza nervore, prej të cilave nëntë miliardë janë në koren e trurit. Përveç kësaj, ata nuk do të kishin mundur ta shkruajnë librin po të mos kishin qenë të shëndoshë. Shëndetin e tyre sigurojnë 30 miliardë rruaza të bardha të gjakut. Kanë gjithashtu 30 bilionë rruza të kuqe.

Nuk ka dyshim se nganjëherë kanë dalur të shëtisin për t'i stimuluar mendimet para se të vazhdojnë të shkruajnë. Binte shi; megjithatë asnjë pikë nuk u binte në

vrimat e hundës, sepse vrimat e hundës janë teposhtë, jo përpyjetë. Kush e bëri këtë hollësi?

Ah, sikur ta kishin këta akademikë vetëm zgjuarsinë e peshkatarit të njohur me emrin Gjon Ungjilltari! Ai habitet për misterin e zemrës, që i rrihte rregullisht, duke i siguruar vazhdimin e jetës. Ai që mbështetur në kraharorin e mikut të vet më të mirë, Jezusit, dëgjoi të rrahurat e zemrës së tij dhe kështu u siguroi se ekziston Zoti, mu sikur ai që dëgjon të rrahurat e tik-takut të orës dhe e kupton se ekziston orëndreqësi.

Shpresoj me gjithë zemër se kundërshtarët e mi do ta kuptojnë këtë dhe ta kuptojnë tashti — jo në ferr ku e vërteta për Zotin dhe gjithësinë përfundimisht bëhet e ditur, por shumë vonë!

I lus kundërshtarët e mi, kur mendojnë për makinën e tyre trupore, që është shumë më e mrekullueshme se një e kibernetikës, të kthehen ta vështrojnë një urë të varur të gjatë. Mirëpo idenë për urën e parë të varur e morën nga rrjeta e merimangës, e zgjatur nëpër rrugët e kopshtit. Por kush i dha merimangës mençurinë që ne e admirojmë në inxhinieri? Dhe kush e pajisi merimangën me një rrjetë që tendoset për mrekulli? Ata që e shpikën aeroplanin e parë prej Leonardo da Vinçit deri të vëllezërit Rajt, kanë mësuar prej zogjve.

Kundërshtarët e mi mund të jenë të sigurt se unë i kuptoj ata. Ata flasin në emër të shkencës, e cila bazohet në të vërtetën, dhe megjithatë atyre vetë u mungon njëri prej kushteve kryesore, që është diskutimi i lirë dhe i sinqertë.

Ta zëmë se disa akademikë sovjetik kanë ardhur në përfundim fetar, ashtu si Ajnshtajni dhe Planku. A do të kishin mundur t'i botojnë veprat që i shprehin bindjet e tyre. Sigurisht po — por vetëm fshehtazi dhe të rrezikuar për burgim. Nuk mund të kërkojmë shumë prej autorëve që shkruajnë në kushte të tilla. Çdo njeri nuk mund të jetë hero ose dëshmor.

Sunduesit e vendeve komuniste më shumë e duan doktrinën e vet se sa të vërtetën objektive. Për këtë arsye nuk e paraqesin për shqyrtim, d.m.th. në diskutim të lirë: kështu, ata i përjashtojnë akademikët nga e drejta për të folur në emër të shkencës.

Si mund të flas në emër të shkencës ai që e keqpërdor të drejtën e shprehjes dhe cilësitë e besimit të cilat kurrë nuk i ka shpallur.

Do t'ju japim vetëm disa shembuj të marrë nga *Libri ateist*. Citoj: «Sipas Biblës Perëndia i ka krijuar të gjithë yjtë, diellin dhe hënën në ditën e katërt të krijimit.» Këtu kundërshtarët e mi e kanë shtuar fjalën «të gjithë». Kjo fjalë nuk ekziston në rreshtin përkatës në Bibël. Bibla na mëson vetëm se Perëndia i ka krijuar yjtë: nuk e përjashton, ashtu siç thotë *Libri ateist*, paraqitjen e yjve të rinj. Perëndia e ka krijuar gjithësinë sipas ligjeve që i ka vendosur vetë, ligje të cilat lejojnë mundësinë e paraqitjes së yjve të rinj, sikurse në sferat tjera që lejojnë njerëz të rinj, plane të reja dhe mendime të reja.

Një citim tjetër nga *Libri ateist*: «Predikuesit e fesë thonë se Perëndia e ka krijuar jetën vetëm në planetin tonë, kurse shkencë ka dëshmuar se jeta është shumë e përhapur nëpër gjithësi».

Kur kanë thënë predikuesit e fesë se jeta ekziston vetëm në planetin tonë? Kur e dëshmoi shkencë të dytën?

Një citim tjetër: «Transformimi i natyrës nga ana e njeriut tregon qartë se dogma, sipas të cilës bota e krijuar nga Perëndia është e pandryshueshme, nuk ka bazë.» Dogma e *cilit* religjion thotë se bota e krijuar nga Perëndia është e pandryshueshme, ose që njeriu nuk do të mund ta transformojë natyrën? Bibla fillon me tregimin se Perëndia e vendosi Adamin në kopshtin e Edenit të kujdesej për të, të punonte, që do të thotë ta transformonte natyrën. Abeli ka qenë bari që mbante kafshë, kurse Kaini ka qenë bujk. Njeriu duhej të kishte ndikim në natyrë dhe ta ndryshojë atë.

Në pjesën e librit me nëntitull «Dështimi i dogmës për larjen e mëkateve» këta ateistë shkruajnë: «Klerikët përpiqen të na bindin se Zoti është i gjithëpranishëm, se fjala e tij, si një urdhër, është mishëruar njëkohësisht në të gjitha botat e banuara me qenie të gjalla. Kështu që Krishti u desh të vijë në këtë botë, të vuaj dhe të vdesë njëkohësisht në një numër të pakufishëm planetësh.» I thërras kundërshtarët e mi të japin emrin e një prifti të vetëm që ka përkrahur një marrëzi të tillë. Pikësëpari shkenca kurrë nuk e ka provuar se ekzistojnë qenie inteligjente në miliona planete tjera; së dyti, asnjë kishë nuk ka thënë se Krishti ka vdekur në shumë planete.

Por duhet të insistojmë në këtë, sepse në disa faqe më vonë autorët ateistë e thonë mu të kundërtën e asaj që e trillojnë më parë. Ata ua veshin teologëve (nuk dihet se kujt) pohimin se toka është i vetmi vend ku njeriu ka bërë mëkat, që u desh shlyerja e tij, kurse gjinitë tjera në planetet tjera kanë mbetur besnikë. Trillim pas trillimi! Teologët kurrë nuk kanë dogmatizuar rreth këtyre çështjeve!

Me një të qeshur, e jap edhe një citim nga *Libri ateist*: «Feja e pranon vetëm modifikimin natyror të gjeografisë të planetit tonë, sepse vjen nga Zoti, por ndërhyrjen krijuese të njeriut në procesin gjeografik e përjashton plotësisht». Me këtë duan të thonë se feja nuk lejon krijimin e kanaleve për ujitje. Ajo që njerëzit e vjetër fetarë, babilonasit dhe egjiptianët, kanë pasur një rrjet të gjerë të kanaleve të ujitjes nuk do të thotë gjë për ta. Kur dhe cila fe ka folur kundër kanaleve?

Këtë herë kundërshtarët e mi kanë prova. E citojnë princ Golitsin, qeveritar i provincës Astrakhan para nja 200 vjetësh, i cili kundërshtoi për një kanal që lidhte dy lumenj. Por kurrë nuk kam dëgjuar që një qeveritar i një province të jetë përfaqësues i fesë.

Një citim tjetër: «Priftërinjtë me mijëra vjet kanë predikuar se ideja për fluturimin e njeriut në drejtim të qiellit pa lejen e Zotit është e papranueshme, laike dhe i

kanë përndjekur me egërsi e asgjësuar guximtarët që orvatëshin të realizonin fluturime të tilla, e mos të flasin për udhëtimet kozmike të njeriut; kurse sot, të gjitha këto parime fetare janë thyer».

Përpiqem të jem i sjellshëm, por nuk mund të rri pa thënë se kjo është një gënjeshtër e pastër. Askush nuk mund të na jep emrin e dikuji që është përpjekur të fluturojë dhe e kanë asgjësuar për këtë arsye. A i kanë asgjësuar astronautët në Amerikë? Astronauti i parë amerikan pohon se beson në Zot, edhe astronautët e mëvonshëm lexonin Biblën ndërsa ishin në orbitën e Hënës. Kur u këthyen, bënë gosti. Asnjërin prej tyre nuk e vranë. Si mund të shkruajnë akademikët të tilla gënjeshtër?

Vazhdoj me këto citime të çuditshme nga libri i botuar nga Akademia e Shkencave të Moskës: «Disa predikues të fesë thonë se i Tejetlarti i ka shtyrë njerëzit në thellësi të gjithësisë dhe për këtë arsye raketat kozmike e satelitët nuk mund ta mbërrijnë mbretërinë e qiellit. Pse iu desht Zotit ta ndërrojë banesën?» Kur e bëri ndojë predikues një marri të këtillë?

Por autorët ateistë shumë shpejt harrojnë se ata kanë folur dhe luftuar kundër nesh me një argument tjetër: «Klerikët theksojnë në mënyrë të posaçme se njeriu nuk mund ta gjejë Zotin as shërbëtorët e tij mbinatyor, sepse këta janë qenie jolëndore, pa trup, dhe i përkasin botës shpirtërore, jo botës materiale». Kjo tingëllon pak më mirë, por ata nuk e pranojnë faktin se Zoti, duke qenë shpirt, nuk do të thotë se do të shihet nga astronauti që ka shkuar në hënë. Ata shkruajnë: «Edhe jolëndorja është e arritshme për njeriun». Të shkretët materialista, disa faqe më parë thonë se asgjë tjetër nuk ekziston përveç materies dhe lëvizjes! Tash e pranojnë se jolëndorja ekziston dhe është e arritshme për mendjen e njeriut — që është e vërtetë, po sikur ta përdomin ata mendjen për ta zbuluar Shpirtin e Përvjetshëm dhe shpirtin e tyre.

Një pohim tjetër i pavend në *Librin ateist* është se feja

e arsyeve paditurinë. Kush i themeloi universitetet e para në Europë? A nuk kanë qenë të krishterët? A nuk kanë qenë manastiret qendrat e para kulturore? Kush e mohon se gjuha gjermane dhe angleze — dhe shumë të tjera — nuk janë përsosur nga Bibla?

Miq të e mi ateistë pohojnë gjithçka! Ata e paraqitin një diktator, kurse kundërshtarët i detyrojnë të heshtin.

Një pohim tjetër nga *Libri ateist*: «Besimi e bën njeriun indiferent ndaj rrjedhave». Shërbimi Sekret i komunistëve nuk është aspak i këtij mendimi. Agjentët e tyre e dinë fort mirë se të krishterët nuk janë pasiv, madje dhe na burgosin për aktivitetet tona fetare.

Më duket se mjaftojnë citimet e lartshënuara. Do të shkaktojnë neveri tek lexuesit sa që do ta pyesin veten a meriton përgjigje një libër i shkruar në një nivel aq të ulët. Por duhet të përgjigjet sepse libri është përhapur nga përkthyes të panumërt. I është ngulitur në kokë të rinjve; sundon me forcë të kamxhikut.

Jo, shkenca nuk mund të jetë kundër fesë. Shkenca vetëm mund të jetë kundër ndonjë feje të prapambetur.

Nëse e shqiptoj fjalën «anije», kjo zgjon në mendjen time përfytyrime të ndryshme. Mund ta kem para sysh arkën e Noes, anijen primitive me të cilën polinesianët përshkuan oqeanet, anijet e vikingëve kur arritën së pari në Amerikë, ndonjë vapor para njëqind vjetësh, ose anije moderne siç është trans-Atlantiku.

Kur them «fe» ose «Zot», përsëri më zgjohen imazhe të ndryshme në mendjen time. Njerëz të ndryshëm në kohëra të ndryshme, sipas fuqisë dhe aftësisë së tyre, ndjenjave dhe aftësive shpirtërore, e kanë kuptuar Zotin në mënyra të ndryshme. Gjithashtu edhe e kanë interpretuar zbulesën e tij në mënyra të ndryshme.

Disa koncepte për Zotin janë të prapambetura dhe e kundërshtojnë shkencën. Por kjo nuk vlen për të gjitha fetë; sikurse edhe feja që nuk e pranon krejt shkencën, ngase edhe në shkencë ka gjëra të prapambetura.

Shkenca dhe feja u përkasin dy sferave të ndryshme. Shkenca na tregon vetëm aspektin material të sendeve. Nëse e pyesim një shkencëtar çka është puthja, do të thotë: «Është afrimi i dy palë buzëve me një bartje reciproke të mikrobeve dhe të dioksidit të karbonit.» Por ka diçka «më shumë» te puthja. Nga pikëpamja shkencore, çdo lule është peshë e mekanizmit biokimik që kërkon potasë, fosfat, azot dhe ujë në përpjestime të caktuara; por çdo adhurues i luleve do të kundërshtojë se shkencëtari nuk i ka thënë të gjitha për lulen. Shkenca shkon vetëm deri në gjysmë të rrugës. Një pjesë të rrugës e bën arti, një pjesë filozofia, kurse atë të fundit e bën feja.

Dini shumë pak për jetën nëse e mendoni vetëm si organizëm protoplazmatik, e harroni çka keni mësuar për të prej Shekspirit, Dikensit, Mikelangjellos, Rafaelit, nga personalitete të njohura fetare të botës, dhe nga mishërimi i Zotit, Jezu Krishtit.

A do të ishte mirë të themi se përqaftimi i dashnores shpejton lirimin e adrenalinës në gjak dhe se ky është shpjegim adekuat për gjithçka që ngjet në atë moment?

Është joshkencore dhe e padrejtë ta kufizojmë jetën vetëm me shkencën.

Autorët e *Librit ateist* kalojnë prej mendimit teorik rreth marrëdhënieve ndërmjet shkencës e fesë në anën praktike të gjërave. Luteri gjoja paska kërkuar «masa të ashpëra kundër herezisë së Kopernikut». Mbetet mister kur Luteri e ka kërkuar këtë. Kot do të kërkoni për fjalë të tilla në veprat e Luterit.

«Por a nuk e ka djegur Kalvini Servetusin, shkencëtar i famshëm?» pyesin kundërshtarët tanë. Po, për fat të keq e ka djegur. Por ashtu si thotë *Libri ateist* se u dogj në turrë drush për shkak të zbulimeve shkencore nuk është e vërtetë. Ai u dënua me vdekje për shkak se mësonte një doktrinë të rrejshme fetare. Kjo ka ndodhur para 500 vjetësh, dhe është për të ardhur keq, por nuk është mirë për kundërshtarët tanë të flasin rreth kësaj. Jo një Servetus,

por dhjetra miliona njerëz janë dënuar me vdekje e vrarë në kampet përqendruese komuniste pse kanë guxuar të përkrahin një doktrinë tjetër politike përveç asaj të diktatorit që më vonë ia mohonin vetë shokët e tij.

Gjithashtu nuk është i vërtetë as pohimi se të krisherët e kanë rrënuar bibliotekën e Aleksandrisë në fund të shekullit të katërt. Po ta kishin rrënuar ata, atëherë myslimanët nuk do të kishin mundur ta rrënonin në shekullin e shtatë.

Edhe një gënjeshtër qesharake: *Libri ateist* thotë se në Shtetet e Bashkuara, Angli, Holandë dhe në disa vende të ngjashme, shfaqet epidemia e lisë sepse priftërinjtë e klerikët janë kundër vaksinimit në baza fetare. Kur kanë pasur këto vende së paku epideminë e lisë? Në fakt, vaksinimi është ndërprerë në Shtetet e Bashkuara për shkak se kjo sëmundje është zhdukur.

A, po, ka edhe një pyetje: indeksi i kishës katolike, që ndalon leximin e disa librave! Kisha katolike e ka zhdukur këtë indeks në Koncilin e Dytë të Vatikanit. Ne po presim që vendet komuniste ta zhdukin komunizmin. Sa do të dëshironin t'i lexojnë veprat e Pasternakut e Solzhenitsinit në liri — ose të paktën Platonin, Njutonin, Bergsonin, e mos të them Biblën me komentet e saj! Madje edhe librat e Stalinit përfshihen aty; nuk mund t'i gjesh në asnjë librari.

As ajo që e thonë autorët e *Librit ateist* teorikisht për shkencën dhe fenë, as ajo që e thonë nga ana praktike e çështjes, nuk mund t'iu qëndrojë hetimeve.

Tashmë është aksiomë biologjike se veprimi krijon organin. Sytë i kemi për të parë dritën dhe ngjyrat. Veshët i kemi sepse ka tinguj për të dëgjuar, kurse duart i kemi sepse ka gjëra materiale për t'i prekur. Mendja na është dhënë sepse ka gjëra për të cilat duhet menduar. Prej nga e kemi këtë aftësi të çuditshme për të besuar? Bile edhe fëmija e ka këtë aftësi. Kështu që duhet të ketë një realitet përgjegjës. A kishte për të qenë logjike në kë-

të botë, ku gjithçka që është në ne i përgjigjet një realiteti të jashtëm, kurse aftësia e besimit që e kemi mos t'i përgjigjet asaj «të jashtëm» që kuptohet me anë të besimit? E kemi aftësinë e besimit sepse ekziston Zoti të cilit duhet besuar. Nuk ekziston vetëm materia, por ekziston edhe një realitet që nuk mund të shpjegohet sipas fizikës e kimisë pa na bërë për të qeshur.

Shkenca lutet për fe.

Toka është saktësisht në largësinë e duhur prej diellit dhe ka shpejtësinë e duhur orbitare për ta bërë jetën të mundshme në të. Po të kishim qenë pak më afër diellit, do të na kishte djegur nxehtësia. Po të kishim qenë më larg, toka do të kishte qenë tepër e ftohtë për të pasur jetë në të. Po të mos sillej Toka rreth Diellit, nuk do të kishin ekzistuar ndryshimet e stinëve.

Proteinat janë kombinim i pesë elementeve kryesore: karboni, hidrogjeni, azoti, sulfuri dhe oksigjeni. Në secilën molekulë të proteinës, ka përafërsisht nja 40-50 mijë atome. Prej arfo njëqind elementesh kimike që gjenden në tokë, vetëm këto pesë, bile në përmasa të caktuara mund të formojnë molekula të proteinës. Mos ka ndodhur krejt kjo rastësisht? Sasia e materies që do të duhet për t'u përzier dhe koha që do të nevojitej për t'u kryer kjo punë në mënyrë që të fitohen proteinat rastësisht, mund të llogaritet sipas ligjit të probabilitetit. Matematikani zvicëran Çarls Kjuste e ka llogaritur këtë. Ai thotë: «Gjasa për një ngjarje të tillë të jetë e rastësishme është 1:10 me 160 zero prapa». Kjo do të thotë se ekziston një mundësi në 10 me 160 zero pas në përzierjen e rastësishme të materies, për të fituar vetëm një molekulë të proteinës. Materia për t'u përzier do të duhej të jetë më e madhe se krejt ajo që njihet në tërë gjithësinë. Koha e nevojshme për këtë do të kishte qenë 10 me 243 zero bilionë vjet!

Profesori J. Litis ka llogaritur se hallkat e zinxhirit në një proteinë shumë të thjeshtë janë të kombinuara në 10 me 160 zero milion mënyra. Rasti nuk mund të krijojë

molekulë të tillë. Rasti kurrë nuk ka krijuar kornizën e ndonjë shtëpie ose të pianoje, që janë gjëra shumë të thjeshta në krahasim me një molekulë të proteinës.

Kur kam qenë në burg, kam dëgjuar grindje mes hajdutëve. Luanin me zare. Nëse numri gjashtë binte shpesh, hajdutët e tjerë menjëherë dyshonin se diçka nuk ishte në rregull dhe se fati nuk u ecte. Nuk rastiste që numri gjashtë të binte vazhdimisht. As rasti i vogël nuk ka mundur të na japë këtë gjithësi të rregulluar ashtu si e kemi. Filozofi, qoftë edhe filozof ateist, nuk mund të jetë rezultat i zhvillimit të materies së rastit. Rasti i thjeshtë kurrë nuk do të përfundonte si mendimtar ateist.

E citova matematikanin për të treguar se mundësia për të krijuar një molekulë të proteinës është 1 me 10 me 160 zero pas. A do ta kishte vënë ndonjëri prej kundërshtarëve tanë një rubël në lotari kur mundësia për të fituar do të kishte qenë si kjo? Do të kishte qenë rrezikim i marrë. Por ata e rrezikojnë vetveten, rrezikojnë pasurinë e përjetshme të shpirtit të tyre, rrezikojnë të vërtetën me një teori që ka mundësi të jetë e saktë sa mundësia për të fituar në lotarinë hipotetike. Profeshori Eduin Konklin, biolog i njohur i Universitetit të Prinstonit, thotë: «Mundësia që jeta të ketë ardhur rastësisht krahasohet me mundësinë e daljes së një fjalori të pashkruar nga eksplodimi i një shtëpie botuese».

Por asnjë argument i yni nuk është i vlefshëm për ateistët e vendosur. Ata dinë për kafkën e neandertalit dhe të tjerëve si ai për të provuar se Adami, që jetoi në parajsë në bashkësi me Perëndinë, nuk ka mundur të ekzistojë. Bibla fillon me diçka joshkencore; paraardhësit tanë kanë qenë njerëz shumë primitivë, që janë zhvilluar prej botës shtazore. As nuk mund të flasësh për pajtim ndërmjet Biblës e shkencës, thonë ata.

Ta zëmë se do të bëhen gërmime arkeologjike pas 5.000 vjetësh dhe arkeologët do të gjejnë dy a tri kafka të banorëve të Australisë, ose të njerëzve që ende jetojnë në

kohën e gurit në Guine të Re. Antropologët e atyre ditëve do të thonë se në kohën tonë nuk ka pasur qytetërim. Por njerëzit që lansojnë raketa në hënë jetojnë në të njëjtën kohë me shkurtabiqet. A s'ka mundur të ketë jetuar ndonjë pasardhës i Adamit, i të njëjtit zhvillim mendor si ai, njëkohësisht me njerëzit e shpellës?

Më duket se kam thënë mjaft për temën e shkencës dhe fesë.

Ajo që i ndal autorët ateistë për ta thënë të drejtën në emër të të vërtetës është mungesa e plotë e dyshimit në librin e tyre.

Autorët e Biblës, ndonëse besimtarë të fortë, asnjëherë nuk i fshehin dyshimet e tyre. Ato i gjeni në Psalmet dhe në librin e Jobit. Bile edhe Shën Gjoni kur ishte në burg pat dyshuar për Jezusin se a është Mesia. Vetë Jezusi bërtiti në kryq: «Hyji im, Hyji im! Përse hoqe dorë prej meje?»

Autorët e udhëzuesit për ateistë shprehin siguri të tripartit për gjithçka. Nuk u lejohet të dyshojnë; duhet ta plotësojnë detyrën që u është dhënë nga Partia Komuniste për të shkruar kundër fesë.

Asnjë njeri nuk është plotësisht besimtar. Edhe besimtarët kanë dyshimet e tyre. Gjithashtu asnjë njeri nuk është gjithmonë ateist. Ateistët kanë çaste kur besojnë, ndërsa autorët e Biblës, Davidi e Jobi, për shembull, nganjëherë kanë mendime që duken gati blasfemues, kundërshtarët tanë ateistë gjithmonë janë parashikues të mëdhenj. Të gjithë janë të një brumi: ateistë dhe vetëm ateistë! Kjo është e pazakonshme. Ata nuk i shprehin të gjitha mendimet e tyre.

Duket sikur nuk kanë dëgjuar kurrë për parimet e famshme të pasigurisë prej Hajzenbergut!

Në anën tuaj, miq ateistë, është forca politike. Por e vërteta shkencore është në anën tonë. Jezusi mund të konsiderohet si themelues i mendimit shkencor. Ai tha: «Shkoni e tregoni Gjonit çka patë e çka dëgjuat» (Luka

7:22); «Ne flasim çka dimë e dëshmojmë çka pamë» (Gjoni 3:11); dhe «Shikoni shpendët e qiellit... shikoni si rriten zambakët» (Mateu 6:26-28). Ai na mëson konkretisht! Të krishterët janë të mësuar të flasin çka dinë, çka dëgjojnë e shohin. Edhe shkenca bazohet në të njëjtat parime.

Shlyerja e fajeve

Libri ateist flet edhe për shumë gjëra tjera, por më duhet të kujdesem për gjatësinë e këtij dorëshkrimi. Do të dërgohet fshehtas në vendet komuniste, kështu që nuk duhet të jetë shumë i gjatë.

Por u kam borxh diçka kundërshtarëve të mi. Krishti na mëson ta kthejmë të keqen me të mirë. Ata kanë thënë gjëra të pavërteta për fenë tonë; unë duhet t'ua tregoj rrugën e shpëtimit. Autorët e një libri propagandues ateist mund të shpëtohen mu sikur edhe mëkatarët tjerë.

Ne jetojmë me këtë realitet të tmerrshëm të mëkatit. Unë i kam mëkatet e mia; kundërshtarët e mi i kanë të vetat. As filozofia humaniste as ateiste as ajo fetare, as mendimet e klerikëve apo të ateistëve nuk mund të bëjnë asgjë rreth lirimit të njeriut prej mëkatit. Për këtë arsye, Perëndia ka bërë një vepër madhështore. Unë jam përpjekur ta dëshmoj besueshmërinë e Biblës. Kundërshtarët e mi mund të mësojnë nga Bibla si të pastrohen prej mëkateve, si të bëhen fëmijë të Perëndisë dhe trashëgimtarë të jetës së përjetshme.

Shën Pali shkruan: «Krishti vdiq për mëkatet tona... Qe varrosur e të tretën ditë u ngjall së vdekuri si u tha në Shkrimin shenjt» (1 Korintasve 15:3-4).

Askush nuk mund ta kuptojë tërësisht çka ka të bëjë më mëkatet e *mia* vdekja e Krishtit në Palestinë para 2.000 vjetësh, dhe si mund të shlyhen mëkatet e *mia* me anë të flijimit të *tij* në atë kohë. Por gjithashtu nuk mund

të japin një sqarim të plotë për natyrën e elektricitetit, ose gravitetit, ose të procesit tonë fiziologjik e psikologjik. Nuk kemi nevojë për sqarim të plotë të faljes së mëkateve nëse duam ta fitojmë atë. Mjafton të besojmë se Krishti vdiq për mëkatet tona, se ai e mori dënimin tonë, dhe se na janë hequr mëkatet.

Krishti është Zot i trupëzuar. Megjithatë ai e përuli veten e mori mbi vete dënimin e mëkateve tona dhe pësoi për to. Shën Pjetri e shpreh më këto fjalë: «Nuk keni qenë të shpërblyer nga mënyra e zbrazët e jetës suaj të trashëguar nga etërit me ndonjë send të shkatërrueshëm — argjend apo ar, por me gjak të paçmueshëm të Krishtit Qengjit të patëmetë e të panjollë» (1 e Pjetrit 1:18-19).

Dhe në qiell një këngë i këndohet për lavdi Krishtit: «...dhe me gjakun tend i shpërbleve për Hyjin njerëzit e çdo fisi, gjuhe, populli dhe kombësie, dhe i bëre për Hyjin tonë mbretëri dhe priftërinj dhe ata do të mbretërojnë përmbi tokë» (Zbulesa 5:9-10).

Kur Krishti i bleu me gjakun e tij njerëzit e çdo kombësie, ai i bleu edhe komunistët edhe ateistët.

Unë thashë: Ne nuk mund ta kuptojmë shlyerjen e mëkateve plotësisht, por mund të kuptojmë diçka prej saj. Kur e kemi parasysh se Krishti është Zot dhe, si i tillë, ai është person me dinjitet të paçmueshëm, atëherë (e di se këto fjalë do t'ju trondisin, por do t'i them) vrasja e Krishtit ka qenë krim më i madh se sa të vritej e tërë gjinia njerëzore. Këtë do ta kuptoni më mirë nëse i përsiatni fjalët e Isaia: «Për Zotin, kombet s'janë asgjë, jo më tepër se një pikë uji, dhe janë si një grimcë pluhuri në peshojë» (Isaia 40:15).

Një ilustrim i thjeshtë do t'u tregojë çka mendojmë. Jam i sëmurë prej tuberkulozit, dhe me anë të ilaçeve kam mbytur me miliona mikrobe të tuberkulozit. Përveç kësaj, kam mbytur edhe shumë mikrobe tjera e insekte të llojeve të ndryshme; shumë kafshë janë therë për të më shërbyer si ushqim; nuk më bren ndërgjegjia për këtë.

Por ndërgegjija me vret për çdo të padrejtë që i bëj njeriut, sepse njeriu është shumë më i vlefshëm se insektet — njeriu është shëmbëlltë e Perëndisë. Në të njëjtën mënyrë, Krishti, që është Zot i mishëruar, është në mënyrë të pakufishme më i vlefshëm se miliarda qenie që janë vetëm njerëz, dhe për këtë arsye kryqëzimi i tij është më se i mjaftueshëm për ta shpërblyer botën mbarë prej të gjitha mëkateve — kjo me kusht të besimit në atë që ka bërë për ne. Në këtë person Zoti vuajti, vdiq për njerëzit e vet, duke e marrë mbi vete trupin njerëzor në të cilin do të mund të vdiste, sepse Zoti është i pavdekshëm.

Prandaj, Pjetri shkruan pësëri: «Krishti njëherë vdiq për mëkate tona, i Drejti për të padrejtët që t'ju shpiente te Hyji» (1 e Pjetrit 3:18). Shën Gjoni shkruan: «...Gjaku i Jezusit, Birit të tij, na pastron nga çdo mëkat» (1 e Gjoni 1:7).

Shën Gjon Pagëzuesi tha për Jezusin: «Ja Qengji i Hyjit! Ky ia shlyen mëkatin botës!» (Gjoni 1:29). Shën Pali shkruan: «E mbasi tani ju jeni të shfajësuar me anë të gjakut të tij, është më se e sigurt se ai do të na shpëtojë nga dënimi» (Romakëve 5:9). Çfarë zemrimi do të ketë shkaktuar *Libri ateist* tek Perëndia! Por ne mund të shpëtohem prej dënimit të tij, sepse «në Të (Jezu Krishtin), në saje të gjakut të tij, e fituam shpërblimin; në Të na u falën fajet me anë të begatisë së hirit të tij» (Efesianëve 1:7).

Falja e mëkateve është tema kryesore e të krishterëve që 2.000 vjet. Është shpjeguar në mënyra të ndryshme. Ka shumë doktrina rreth faljes së mëkateve.

Cilën ta zgjedhim?

Kur e pyeten shën Terezën nga Lizjeu cilin virtyt të krishterë dëshironte të praktikonte më shumë, ajo u përgjigj: «Të gjitha!» Edhe unë kisha thënë të njëjtën gjë për doktrinën e faljes së mëkateve. Të gjitha janë rezultat i përsiatjeve të thella të besimtarëve të devotshëm; nuk ka arsye ta lëmë anash ndonjërin prej tyre.

E vërtetë është doktrina e zëvendësimit, se Krishti vdiq për mëkatet tona. E vërtetë është doktrina e ndikimit të moralit, se Krishti vdiq me qëllim që me shembullin dhe flijimin e tij, të ketë ndikim në ne e na të përvetësojmë një jetë të re hyjnore. E vërtetë është teoria mbizotëruese, sipas së cilës Zoti i fal mëkatarët falas e Krishti vuajti me qëllim që të na tregojë se çdo shkelje e ligjit shkakton dënim, dhe se ne, duke i shikuar vuajtjet e mëdha të Krishtit, mund të kuptojmë se çka meritojmë për mëkatet tona. E vërtetë është teoria mistike, sipas së cilës Krishti dhe besimtari i denjë janë një, të lidhur me një dashuri të pandashme. Sikur nëna që vuan me fëmijën e sëmurë dhe sikur nusja e dashur që vuan për dhëndrin kur ka dhimbje, ashtu ne kemi vuajtur bashkë me Krishtin tonë të dashur në Golgotë, dhe në këtë mënyrë jemi një.

Por unë besoj se shpjegimi më bindës për njeriun e shekullit të njëzetë është doktrina e transferimit. Ne të gjithë e kemi mekanizmin e transferimit në psikologjinë tonë. Kur nuk mund të gjejmë diçka e jemi mjeruar për të, mjafton ta fajsojmë dikë tjetër, gruan, fëmijën, për sendin që nuk e gjejmë. Kemi kujt t'ia hedhim fajin. Nëse fëmija rrëzohet në stol, mjafton që nëna ta «godasë» stolin për lëndimin që i ka shkaktuar fëmijës, kështu që fëmija menjëherë qetësohet. Mekanizmi i transferimit është i rrënjosur thellë në neve. Zemra jonë qetësohet nëse dikush tjetër i merr problemet tona: monarkia, borgjezia, çifligarët, amerikanët, imperialistët, komunistët, Trotskisteni, Stalini, çifuti, zezaku, i bardhi, kushdo tjetër vetëm unë jo.

Jezusi me qëllim e përdori këtë mekanizëm të transferimit: prandaj erdhi në botë, duke u prezentuar si Biri i Perëndisë. Kjo është sikur të kishte thënë: «Nëse e keni këtë prirje për t'ia hedhur fajin tjetërkujt, gjëja më normale është ta hedhni mbi mua: unë e mbaj përgjegjësinë, sepse i tërë krijimi është bërë nëpërmjet meje. Jam i gat-

shëm të marr mbi vete tërë fajin dhe mëkatin. E ndieni se mëkatet tuaja meritojnë dënim. Kanti thotë: 'Krimineli duhet të dënohet.' Unë do ta marr dënimin të cilin ju e meritoni, e ju do të jeni të lirë».

U rekomandoj kundërshtarëve të mi ateistë, pasi që u kanë shkaktuar dëm miliona njerëzve duke shkruar të pavërteta kundër fesë, që ta hedhin këtë krim mbi Krish-tin, të cilin e kanë sulmuar. Krishti është Qengji i Perëndisë që i merr mëkatët e të gjithë botës; prandaj, ai i merr edhe mëkatet e autorëve të *Librit ateist*. Besoni në Krish-tin, dhe do të shpëtoheni!

Jeni munduar ta kundërshtoni fenë me teori ateiste. Kjo është foshnjarake. Analiza kritike është e pafuqishme para ankthit të brendshëm. Teoritë ateiste nuk e shpëtojnë njeriun që po vdes as familjen e tij të pikëlluar. Doktrinat tuaja nuk ju vlejné as juve kur të kaloni nëpër ankthin e dyshimit dhe pyetni veten a keni bërë mëkat të madh më këtë vepër të shkruar. Ndoshta sot nuk mendoni për këtë, por do të vijë një ditë kur do të mendoni, dita e vdekjes.

Moska, Pekini, Uashingtoni po bëjnë gara cili do të jetë qyteti me ndikim më të madh në botë. Asnjëri prej tyre! Qyteti me popullsi më të madhe, qyteti ku mbretërit dhe republikanët, kapitalistët dhe komunistët, stalinistët dhe trockistët, atesitët dhe besimtarët, priftërinjtë dhe armiqtë e tyre takohen, është qyteti i varrit. Dhe për ata që nuk besojné pas varrit ka vetëm keqardhje.

Qoftë edhe në çastin e fundit të jetës është mirë të pendoheni. Në atë moment, mund të thoni këtë lutje: «Zoti Jezus, Biri i Perëndisë, ki mëshirë për mua, mëkatarin!» Beso në gjakun e Jezusit që është derdhur për ty, dhe do të shpëtohesh.

Të dashur miq ateistë, i kaluam disa orë së bashku. Tash po ndahemi.

Në Bibël rrëfëhet ngjarja se ndërsa judenjtë ishin skllëvër në Egjipt, tri ditë rresht pat mbretëruar errësira.

Ndërsa terri që i rrethonte egjiptianët ishte aq i dendur sa që nuk mund ta shihnin njëri-tjetrin, të gjithë bijtë e Izraelit gëzonin dritën.

Kjo dritë është Fjala e Perëndisë. Njerëzit e Perëndisë e kishin këtë dritë, dhe ua ndriçonte zemrat.

Thuhet se kur Palestina ishte nën sundimin turk, një pasha mizor ua kishte ndaluar judenjve t'i ndezin dritat natën. Qytetet i kaplonte errësira.

Por në Safed, nga dritarët e rabinit Jozef Karo shihej dritë natën. Rabini lexonte Biblën. Roja e njoftoi pashën se ç'po ngjante. Ai menjëherë shkoi në shtëpinë e rabinit dhe e pa atë... e kishte marrë Biblën, ndërsa e tërë dhoma ndriçohet me një dritë që vinte prej mureve, ndonëse asnjë llambë nuk ishte e ndezur në dhomë. Muret ishin mbuluar me xixëllonja. Ato i bënin dritë.

Rabini i tha pashait: «Ligji i Zotit i ndriçon jo vetëm ata që e lexojnë atë, por edhe xixëllonjat që dëgjojnë.»

Disa prej ju ateistëve, dhe ata që u besojnë juve, do t'i lexoni këta rreshta. Jam i sigurt se do të ndriçojnë, ndonëse mendja e tyre është errësuar nga shpifjet kundër Fjalës së Perëndisë, dhe ajo dritë e shndritshme, drita e Krishtit, do ta lëshojë ngrohtësinë dhe bukurinë nëpër vendet komuniste.

Fjala e fundit

Ne i kuptojmë ateistët e shkretë që duhet të flasin sipas urdhrit. Por nëse hanxhiu i qet ujë verës, ai mund ta qetësojë ndërgjegjen duke e shitur me pakicë.

Shtatëqind faqe mohim pas mohimi, mohim i Zotit, i Biblës, i jetës së përjetshme dhe i njerëzimit tregon një zell të tepruar.

Keni shkruar një libër të mërzitshëm. Nuk është faji juaj. Nuk keni mundur të bëni më mirë. Çdo njeri ka një zbrazëti në zemër për Zotin. Në vend që ta mbushni këtë

zbrazëti me Zotin, ju e shkruar librin për ndërtimin dhe bukuritë e zbrazëtisë.

Keni qenë të shtrenguar ta shkruani. Veprat ateiste janë të vetmet që flasin për ateizmin, ndërsa Luteri thotë: «Zoti ynë e ka shkruar premtimin jo vetëm në libra, por në çdo gjeth të pranverës».

Libri juaj është i mërziqshëm, me të vërtetë. Gjithashtu edhe i helmon njerëzit që nuk kanë liri ta lexojnë Biblën dhe në këtë mënyrë ta njohin të vërtetën. Ju jeni si ai që kur e sheh vemjen thotë se prej saj kurrë nuk do të dalë flutur e bukur. Ju u thoni sythave se kurrë nuk do të çelin lule. Ju ua vritni shpirtin njerëzve duke u thënë se nuk jeni të caktuar për të qenë si Krishti në këtë jetë as në jetën e përjetshme.

Nuk dua t'ju fyej. Dëshiroj t'ju ndihmoj ta kuptoni gjendjen e tmerrshme të zemrës suaj. Ju jeni më të këqij se vrasësit. Vrasësit vrasin vetëm trupin. Ju vritni shpirta duke i bërë të paaftë të gëzohen në Zotin.

Prandaj po ju jap këshillën që Sonja i dha Raskolnikovit: «Ngrihu! Shko mënjëherë në udhëkryq, pastaj ulu e puthe tokën që e ke fëlliqur, e pastaj përulju gjithë botës, nga të katër anët e saj, dhe thuaj me zë të lartë: 'Unë kam vrarë'. Atëherë Zoti do të japë jetë përsëri. A do të shkosh? A do të shkosh?»

Edhe unë kam qenë ateist sikur ju, deri në atë ditë kur erdha në vete dhe bëra pikërisht atë që këshillon Sonja. Tash dridhem kur mendoj se çka e pret njeriun që bën një jetë të tillë. Krishti më ka gjetur dhe më ka shpëtuar nga ateizmi, nga krimi. Kjo udhë është e hapur edhe për ju.

A do të shkoni? A do të shkoni?

* * *



АЗОБҲО БАРОИ МАСЕҲ

Дар танҳой ҳабс шудан, солҳои шиканҷаву азоби ҷисмонии такрорӣ, азубу уқубати доимӣ бо гуруснагӣ ва хунукӣ, ғаму андӯҳи шустани мағз ва азоби фикрронӣ – ин таассуроти шубони румынягӣ мебошад, ки дар муддати 14 сол дар ҳабсхонаи коммунистӣ бандӣ буд.

Ҷинояти ӯ, монанди ҳазорҳо одамони дигар, танҳо имони гарм ба Исои Масеҳ ва барои дар бораи имонаш дар пеши омма шаҳодат додан буд.

Вай дар хонаҳо, дар таҳхонаҳо, дар ҷангалҳо – баъзан дар қунҷи кӯчаҳо дар пеши омма мавъиза мекард – ҳамаи инро имондорони вафодор шаҳодат медоданд, гарчанде ки нархи оқибати амалхояшонро медонистанд.

Ин таърихи онҳо – гузориши намунавии далерӣ, имони мустаҳкам ва сабри ғайриоддӣ аст. Ин таърихи калисои пинҳонӣ азоби давомноки калисоҳои зиёди ҳозираи ин ҷаҳонро ба хотирамон меорад.